

ADNAN OKTAR - HARUN JAHJA



THIRRJE PËR UNION ISLAMIK



Ky libër merret me nevojën e botës Muslimane për krijimin e një Unioni Islamik dhe rëndësinë e tij për paqen botërore nën dritën e fakteve politike, sociologjike dhe ekonomike.

Gjendja e tanishme tregon qartë se Muslimanët do të kenë ndikim në zhvillimet e shekullit 21 në një mënyrë apo tjetër. Mirëpo, ajo që vërtet ka rëndësi në këtë mes është se bota Islame në veçanti dhe njerëzimi në përgjithësi duhet të përfitojnë nga ky ndikim. Gjëja e parë që na shkon në mendje në këtë fazë është nëse bota Islamike mund të luaj një rol të tillë, duke e ditur gjendjen e saj të tanishme. Që nga koha e Profetit Muhamed (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të), Muslimanët i prinë rrugës së shkencës, argumentimit, mendimit, artit, kulturës dhe civilizimit dhe i dhuruan njerëzimit shumë të mira. Muslimanët i mësuan botës shkencën, argumentimin, mjekësinë, artin, higjienën dhe shumë e shumë lëndë tjera. Për të rinisur ngritjen e Islamit, të përforcuar me dritën dhe urtësinë e Kur'anit, Muslimanët e sotëm duhet të udhëhiqen nga parimet morale të Kur'anit dhe shëmbëlltyra e Profetit.

Përçarja dhe copëtimi i botës Islamike është një problem edhe më urgjent dhe jetik që duhet zgjidhur. Fakti se Muslimanët nuk kanë qenë në gjendje të krijojnë një Union Islamik të fuqishëm dhe aktiv është një kontribuues i madh për shumë të këqija të së sotmes. Me krijimin e një Unioni Islamik të fuqishëm, problemet e tilla ose nuk do të shfaqen më ose do të zgjidhen shumë më shpejt se që mund të parashikohet.

DY FJALË RRETH AUTORIT



I njohur me emrin HARUN JAHJA, Adnan Oktar, u lind në Ankara në vitin 1956. Pasi kreu studimet fillore dhe të mesme në Ankara, ai studioi për arte në Universitetin Mimar Sinan në Stamboll dhe filozofi në universitetin e Stambollit. Që nga viti 1980, ai ka botuar mjaft libra në lidhje me çështje politike, shkencore, dhe fetare. Duke qenë mjaft të vlerësuara në të gjithë botën, këto vepra kanë shër-

byer për shumë njerëz si mjet për të gjetur besimin në Zot dhe për të arritur një njohje më të thellë për besimin e tyre. Librat e Harun Jahjasë u drejtohen të gjithë lexuesve, pa marrë parasysh moshën, racën, apo kombësinë e tyre, sepse ata përquendrohen në një synim: të hapin horizontin e lexuesit duke e nxitur atë të mendojë për disa çështje të rëndësishme, si qenia e Allahut dhe Njëshmëria e Tij dhe të jetuarit sipas vlerave që Ai ka përcaktuar për ne.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

اللَّهُ
رَسُولُ
عِيسَى

PËR LEXUESIN

Të gjithë librat e Harun Jahjasë shpjegojnë tema që kanë lidhje me besimin nën dritën e vargjeve kuranore dhe i ftojnë lexuesit të mësojnë fjalët e Allahut dhe të jetojnë në përputhje me to. Të gjitha çështjet në lidhje me ajetet kuranore janë shpjeguar në mënyrë që të mos lihet vend për dyshim apo për pyetje në mendjen e lexuesit. Stili i thjeshtë dhe i rrjedhshëm i librave bën të mundur që çdo njeri i çfarëdo moshe qoftë dhe i çfarëdo grupi shoqëror t'i kuptojë ata me lehtësi. Falë shpalosjes së tyre mbresëlënëse dhe të ndritshme, ata mund të lexohen me një frymë. Madje, edhe ata njerëz që e refuzojnë besimin ndikohen nga faktet që dokumentojnë këta libra dhe nuk mund të hedhin poshtë vërtetësinë e përmbajtjes së tyre.

Ky libër, po ashtu, të gjithë librat e Harun Jahja mund të lexohen vetëm ose të diskutohen në grup. Lexuesit e etur për të përfituar nga librat do të zbulojnë se diskutimi është mjaft i dobishëm dhe u mundëson atyre të shkëmbejnë mendimet dhe përvojën e tyre me të tjerët.

Një shërbim i madh për Islamin do të ishte ndihma në botimin dhe leximin e këtyre librave shkruar vetëm për hir të Allahut. Të gjithë librat e Harun Jahjasë janë jashtëzakonisht bindës. Për këtë arsye, për t'ia komunikuar të tjerëve fenë e vërtetë, një nga mënyrat më të dobishme do të ishte nxitja për të lexuar këta libra.

Shpresojmë se, lexuesi do t'i hedhë një sy përmbledhjeve të librave të tjerë të autorit, të cilat janë vendosur në pjesën e pasme të këtij libri. Lënda e tij e pasur në çështjet e besimit është mjaft e dobishme dhe të sjell kënaqësi në lexim.

Në këta libra, ndryshe nga librat e tjerë, janë mënjanuar tërësisht pikëpamjet personale të autorit, shpjegimet e bazuara në burime të dyshimta, stile që nuk i kushtojnë kujdesin e duhur temave fetare, dhe as argumente të pashpresë apo pesimistë, të cilët krijojnë dyshime në mendjen e lexuesit dhe mosbesim në zemrat e tyre.

**www.harunyahya.com/albanian
www.en.harunyahya.TV**



THIRRJE
PËR UNION
ISLAMIK

HARUN JAHJA
(ADNAN OKTAR)

Për Autorin

I njohur me emrin HARUN JAHJA, Adnan Oktar, u lind në Ankara në vitin 1956. Pasi kreu studimet fillore dhe të mesme në Ankara, ai studioi për arte në Universitetin Mimar Sinan në Stamboll dhe filozofi në universitetin e Stambollit. Që nga viti 1980, ai ka botuar mjaft libra në lidhje me çështje politike, shkencore, dhe fetare. Harun Jahja është njohur mirë si autor i veprave të rëndësishme, të cilat zbulojnë mashtrimin e evolucionistëve, pohimet e tyre të pavërteta dhe lidhjet e errëta midis Darwinizmit dhe ideologjive gjakësore, të tilla si: fashizmi dhe komunizmi.

Veprat e Harun Jahjasë, të përkthyer në 72 gjuhë të ndryshme, përbëjnë një koleksion prej mëse 55,000 faqesh me 40,000 ilustrime. Pseudonimi i tij është një ndërthurje e emrave të Harunit (Aaron) dhe Jahja (John), në kujtim të dy Profetëve të nderuar, të cilët luftuan kundër mohimit të besimit. Vula e Profetit në librat e tij është një simbol i cili është i lidhur me përmbajtjen e tyre. Ky simbol paraqet Kur'anin (Shpalljen e Fundit) dhe Profetin Muhamed (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të), Profetin e fundit. Nën dritën e udhëzimit të Kur'anit dhe Sunnetit (traditës dhe mësimëve të Profetit), autori i ve vetes si qëllim të hedhë poshtë çdo ngrehinë të ideologjive që mohojnë fenë dhe të thotë "fjalën e fundit" në mënyrë që ta bëjë të heshtë çdo kundërshtim ngritur kundër fesë. Ai e përdor vulën e Profetit të fundit (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të), i cili arriti urtësinë më të lartë dhe përsosmërinë morale, si një shenjë të qëllimit të tij për të ofruar fjalën e fundit.

Të gjitha veprat e Harun Jahja kanë një qëllim të përbashkët: të japin mesazhin e Kur'anit, të inkurajojnë lexuesit për të menduar mbi çështje që kanë të bëjnë me besimin, si për shembull, ekzistenca e Allahut dhe njëshmëria e Tij dhe besimi në Botën Tjetër dhe njëkohësisht të nxjerrë në pah rrënjët e kalbura të sistemeve antifetare dhe ideologjive të devijuara.

Harun Jahja gëzon një rang të gjerë lexuesish në shumë vende



të botës, që nga India në Amerikë, nga Anglia në Indonezi, Poloni, e deri në Bosnjë, Spanjë, Brazil, Malajzi, Itali, Francë, Bullgari, e deri në Rusi. Disa nga librat e tij mund të gjenden në gjuhën Angleze, Frënge, Gjermane, Spanjolle, Italiane, Portugeze, Urdu, Arabe, Shqipe, Kineze, Dhivehi (folur në ishujt Mauritius) Ruse, Serbo-Croate (Boshnjake), Polake, Malaje, Turke, Uygur, Indoneziane, Bengali, Daneze dhe Suedeze.

Duke qënë mjaft të vlerësuara në të gjithë botën, këto vepra kanë shërbyer për shumë njerëz si mjet për të gjetur besimin në Zot dhe për të arritur një depërtim më të thellë në besimin e tyre. Mençuria dhe sinqeriteti që i karakterizon librat e tij, së bashku me një stil të veçantë që është i lehtë për t'u kuptuar, ndikon drejtpërdrejt çdokënd që i lexon. Ata që i studiojnë me kujdes këta libra, nuk mund të mbrojnë më ateizmin apo ndonjë ideologji tjetër të devijuar apo filozofi materialiste, sepse këta libra karakterizohen nga një ndikim i shpejtë, përfundime të qarta dhe janë të pakundërshtueshëm. Edhe nëse këta njerëz do të vazhdojnë të këmbëngulin në të tyren, nuk do të jetë gjë tjetër veçse një këmbëngulje të kotë, sepse këta libra përmbysin ideologji të tilla që nga themelet. Të gjitha lëvizjet bashkëkohore antifetare tashmë mbrohen ideologjikisht, falë librave të shkruar nga Harun Jahja.

Kjo është, pa dyshim, një rezultat i urtësisë dhe dritës së Kur'anit. Autori në mënyrë modeste dëshiron të shërbejë si një mjet në kërkimin njerëzor të rrugës së drejtë të Allahut. Prej botimit të këtyre materialeve nuk kërkohet asnjë përfitim material.

Ata njerëz që inkurajojnë të tjerët për të lexuar këto libra, për të hapur mendjet dhe zemrat e tyre dhe për t'i udhëzuar ata të bëhen robër të devotshëm të Allahut, kryejnë një shërbim të paçmuar.

Njëkohësisht, do të ishte një humbje kohe dhe energjie për të reklamua libra të tjerë, të cilët krijojnë çoroditje në mendjet e njerëzve, i shpien ata në kaos ideologjik dhe që nuk kanë një ndikim të fortë dhe preciz në largimin e dyshimit prej mendjeve të njerëzve, siç është vërtetuar nga përvoja e përparshme. Për librat që janë shkruar vetëm e vetëm për të nxjerrë në pah fuqinë letrare të shkrimtarit se sa qëllimin fisnik për t'i shpëtuar njerëzit nga mungesa e besimit është e pamundur që të kenë një ndikim kaq të madh. Ata që e venë në dyshim këtë mund të shohin qartë se qëllimi i vetëm i librave të Harun Jahjasë është të mposhtë mosbesimin dhe, njëkohësisht, të përhapë vlerat morale të Kur'anit. Suksesi dhe ndikimi i këtij shërbimi shfaqen qartë në bindjen e lexuesve.

Një gjë duhet të mbahet parasysh: Arsyeja kryesore për vazhdimin e mizorisë, konflikteve dhe telasheve të tjera që po përjetojnë shumica e njerëzve sot është mbizotërimi ideologjik i mosbesimit. Kësaj mund t'i jepet fund vetëm me mposhtjen ideologjike të tij dhe, njëkohësisht, duke transmetuar mrekullitë e krijimit dhe moralin e Kur'anit, në mënyrë që njerëzit të jetojnë sipas tij. Duke patur parasysh gjendjen e botës sot, që po precipiton në një spirale dhune, korrupsioni dhe lufte, është e qartë se ky shërbim duhet të jepet shpejt dhe në mënyrë të suksesshme, përndryshe, do të jetë tepër vonë.

Në këtë drejtim, librat e Harun Jahjasë marrin një rol udhëheqës. Me lejen e Allahut, këto libra do të jenë një mjet, nëpërmjet të cilit njerëzit në shekullin e XXI do të gjejnë paqen, drejtësinë, dhe lumturinë e premtuar në Kur'an.



THIRRJE PËR UNION ISLAMIK

HARUN JAHJA
(ADNAN OKTAR)





PËRMBAJTJE

PARATHËNIE	10
HYRJE	18
ISLAMI NDRIÇON BOTËN	44
PSE UNIONI ISLAMIK?	66
ÇFARË LLOJI TË UNIONIT ISLAMIK	118
DOBITË E UNIONIT PËR MUSLIMANËT	168
SHBA-të, LINDJA E MESME DHE UNIONI ISLAMIK	198
UNIONI ISLAMIK DHE PERËNDIMI	270
LAJMI I MIRË I UNIONIT ISLAMIK	290
PËRFUNDIM	308
MASHTRIMI I EVOLUCIONIT	326

PARATHËNIE

Bota Islamike mbulon një sipërfaqe të madhe gjeografike të populluar prej 1.2. miliard Muslimanëve. Një shqyrtim i historisë së saj tregon se një pushtet i fuqishëm qendror në pajtim me parimet morale dhe tolerancën Kur'anore, si edhe respektimi i të drejtave të gjithë njerëzve dhe sistemeve të besimit, ka bërë të mundur që ky rajon i madh të jetoj në paqe. Perandoria Otomane ishte shembulli më i fundit lidhur me këtë. Duke i marr parasysht rrethanat e tanishme, është çështje urgjente që të themelohet një Union i ri Islamik, i cili do t'i mundësonte botës Muslimane dhe botës në përgjithësi, të jetojnë në paqe.

Njëra prej gjërave të para që bie në sy kur analizojmë gjendjen e botës Islamike janë përçarjet e shumta të brendshme të saj për arsye të mosbesimit dhe konflikteve të rrënjosura thellë. Historia e vonshme ka parë luftën Iran-Irak, pushtimin e Kuvajtit nga ana e Irakut dhe luftën e Pakistanit Lindor (Bangladeshit) për pavarësi nga Pakistani Perëndimor. Luftërat civile dhe konfliktet e brendshme në Afganistan, Jemen, Liban, Irak dhe Algjeri për arsye të dallimeve politike dhe etnike e bëjnë të qartë se diçka nuk është në rregull me botën Islamike. Veç kësaj, pikëpamje dhe modele të papajtuësme fetare janë duke u praktikuar në botën

Islamike, sepse nuk ekziston një pushtet qendror për të përcaktuar se çka është dhe çka nuk është në pajtim me Islamin, për të vendosur konsensus dhe për të ofruar udhëzim për publikun në përgjithësi. Katolikët kanë Vatikanin dhe të Krishterët Ortodoks kanë Patriarkatin, mirëpo nuk ekziston një unitet fetar apo autoritet qendror për Muslimanët.

Megjithatë, solidariteti është karakteristikë qendrore e Islamit. Pas vdekjes së Profetit tonë Muhamedit (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të), bota Islamike është udhëhequr për një kohë të gjatë nga institucioni i kalifatit, i cili iu ofroi udhëzim fetar Muslimanëve.

Në ditët tona, po ashtu, një autoritet qendror progresiv do të mund të formohej. Themelimi i një Unioni Islamik dhe i një autoriteti qendror Islamik, të bazuar në parimet demokratike dhe në sundimin e ligjit, do të ishte një hap i madh përpara sa i përket zgjidhjes së problemeve të tanishme të botës Islamike.

Derisa përparojmë në këtë libër, do t'i analizojmë disa aspekte të këtij Unioni Islamik, siç është aftësia e tij:

1- Për t'u shtrirë në tërë botën Islamike. Prandaj, ai duhet të ngrihet mbi parimet thelbësore të Islamit dhe jo të bëhet organ i një besimi apo sekti të veçantë.

2- Për të mbështetur të drejtat njerëzore, demokracinë dhe ndërmarrjen e lirë dhe të përpigjet të përmbush misionin e tij të zhvillimit ekonomik, kulturor dhe shkencor në botën Islamike.

THIRRJE PËR UNION ISLAMIK



3- Për të v e n d o s u r raporte miqësore dhe të harmonishme me vendet apo civilizimet tjera dhe për të bashkëpunuar me komunitetin botëror dhe KB-të për çështje të tilla, siç është kontrollimi i armatimit për shkatërrim masiv, terrorizmi, krimi ndërkombëtar dhe mjedisi.

4- Për t'u marr me të drejtat e minoriteteve të Krishtere dhe Çifute, si edhe të huajve të cilët migrojnë në vendet Islamike, të ketë sigurinë e tyre prioritet dhe të çmoj dialogun dhe bashkëpunimin ndërfaqet.

5- Për të gjetur zgjidhje të drejta dhe paqësore përmes të cilave të dyja palët bëjnë kompromise për t'iu dhënë fund konflikteve në mes të jomuslimanëve dhe Muslimanëve në Palestinë, Kashmir, Filipinet jugore dhe rajonet tjera. Ai duhet t'i mbroj të drejtat e Muslimanëve, si edhe të parandaloj lëvizjet radikale Islamike që të mos e shpijnë situatën në një rrugë qorre.

Nga një udhëheqje e tillë e arsyeshme, e matur dhe e

drejtë do të përfitojnë 1.2 miliardë Muslimanë, të cilët janë duke u përballur me aq shumë probleme, si edhe mbarë njerëzimi. Një Union Islamik i ngritur mbi parimet e Kur'anit do t'i mundësojë njerëzimit të gjej paqe dhe drejtësi dhe karakteri i mirë i përshkruar në Kur'an do të sjellë lumturi. Që nga epoka e Profetit Muhammed (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të), Muslimanët ishin prijës të shkencës, argumentimit, mendimit, artit, kulturës dhe qytetërimit dhe i dhuruan shumë të mira njerëzimit.


Kur Evropa ishte në epokën e mesjetës, Muslimanët i mësuan botës shkencën, gjykimin, mjekësinë, artin, higjienën dhe gjëra tjera të panumërta. Për të rifilluar ngritjen e Islamit, të fuqizuar me dritën dhe urtësinë e Kur'anit, Muslimanët e sotëm duhet të udhëzohen duke u mbështetur në moralin e Kur'anit dhe në Sunnetin (shembullin apo mënyrën e tij të jetës) e Profetit (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të).

Si mund të realizohet ky projekt? Këtë çështje do ta shqyrtojmë në vazhdim.


Po ashtu, duhet të mbahet shënim se prej të gjitha kombeve Islamike,

Turqia në veçanti ka një rol të rëndësishëm për të luajtur, pasi që është trashëgimtarja e Perandorisë

THIRRJE PËR UNION ISLAMIK




Otomane, themeluese e një Unioni të tillë Islamik, i cili ka sunduar me sukses për më shumë se 5 shekuj. Turqia posedon infrastrukturën shoqërore dhe traditën shtetërore të nevojshme për të plotësuar kërkesat që bart me vete kjo përgjegjësi e madhe. Veç kësaj, prej të gjitha shteteve Muslimane, ajo i ka raportet më të zhvilluara me Perëndimin dhe prandaj është në pozitën më ideale për të ndërmjetësuar mospajtimet në mes të Perëndimit dhe botës Islamike. Turqia ka po ashtu një traditë të tolerancës dhe harmonisë dhe përfaqëson besimin e Ehli Sunnetit që është besim i shumicës së Muslimanëve, e jo i një sektit të caktuar. E gjithë kjo e bën Turqinë kandidatin më kompetent për të udhëhequr Unionin e paramenduar Islamik.



Harun Jahja (Adnan Oktar)

Those who desire a conflict between civilizations will cause more bloodshed and losses around the world. Establishing the Turkish Islamic Union will be the most important handicap before those who advocate conflicts.



Në fund, zgjidhjet e propozuara këtu duhet të zbatohen menjëherë, sepse rreziku i përplasjes së qytetërimeve në mes të botës Perëndimore dhe asaj Islamike është duke u rritur çdo ditë. Themelimi i Unionit Islamik do të bëjë që ky rrezik të zhduket.

Historia vërteton se bashkekzistenca e qytetërimeve të ndryshme nuk është domosdo burim i tensionit dhe konfliktit. Një shtet me kultura të ndryshme nuk përjeton vështirësi për shkak të dallimeve ekzistuese të brendshme, por për shkak të paaftësisë së vet për t'i menaxhuar ato dallime. Kulturat e ndryshme që ekzistojnë krahas krahas me njëra tjetrën zgjedhin ose konfliktin ose paqen dhe bashkëpunimin, varësisht nga shkalla ekzistuese e tolerancës dhe nëse munden apo jo të kontrollojnë këta faktorë që shpijnë drejtë jotolerancës. Aktualisht, disa Perëndimor dhe Muslimanë parapëlqejnë armiqtë dhe konfliktin ndaj tolerancës dhe harmonisë. Pra, keqkuptimet dhe paragjykimet kundër Islamit dhe Muslimanëve vazhdojnë të paraqesin vështirësi të caktuara. Në anën tjetër, Perëndimorët ndjehen të kërcënuar pa nevojë për shkak të keqkuptimeve të ndryshme. Prandaj, një zgjidhje për këto probleme për t'iu shmangur konflikteve dhe mosmarrëveshjeve edhe më të rënda është urgjentisht e nevojshme.

Siç do të nxjerr në shesh ky libër, Unioni Islamik do të luaj një rol të rëndësishëm në parandalimin e shkallëzimit të rrezikut të konfliktit, sepse të gjitha vendet Islamike do të lëvizin së bashku si një trup i vetëm.

Harun Jahja (Adnan Oktar)

Dhe çdo të mirë që e keni, ajo
është prej All-llahut, madje
edhe kur ju godet e keqja,
ju vetëm te Ai e ngritni
zërin (me lutje).
(Kur'an: 16/53)



The image shows a decorative book cover. The background is a dark green, textured surface. A wide, ornate golden border with intricate scrollwork surrounds the central content. Inside this border is a rectangular frame containing a landscape photograph of a river flowing through a lush green valley with mountains in the distance. The word "HYRJE" is printed in a large, golden, serif font across the middle of the river. The entire composition is framed by a thick, ornate golden border with intricate scrollwork and floral motifs.

HYRJE

Rënia e Perandorisë Otomane në fillim të shekullit njëzet ishte një faktor determinant që përcaktoi gjendjen e botës Islamike për pjesën e mbetur të shekullit, sepse shumë vende të reja u ngritën nga hiri i saj. Mirëpo, asnjëri prej tyre kurrë nuk arriti shkallë të njëjtë të stabilitetit dhe qetësisë që populli i tyre gëzoi gjatë epokës Otomane.

Në fillim të shekullit njëzet e një, shumë probleme presin zgjidhje dhe shumë konflikte duhen zgjidhur. Baraspeshat e shkatërruara me rënien e Perandorisë Otomane kurrë më nuk u ndreqën si duhet dhe në këtë mënyrë u krijuan vende të nxehta dhe zona tejet të ndjeshme – shumica prej të cilave rastisën të jenë në botën Islamike. Disa prej këtyre problemeve u tejkaluan me anë të masave të përkohshme, ndërsa të tjerat vazhdojnë të nxitin konflikt dhe tension deri më sot.

Shumica prej këtyre konflikteve ndikojnë drejtpërdrejt në tokat e populluara me popullatë të dendur Muslimane (p.sh. Palestina, Kashmiri dhe të tjera). Veç kësaj, pohimet në rritje të pashmangshmërisë së një përplasjeje të qytetërimeve, si edhe propaganda agresive anti-muslimane, e bëjnë botën Islamike shënjestër në sytë e disa qarqeve. Ky qëndrim, si pasojë, shkakton tension dhe shqetësim të panevojshëm dhe artificial në shoqëri. Çështje të tilla nxisin pyetjen se çfarë strategjie duhet të përvetësojnë Muslimanët e shekullit njëzet e një.

Për të përcaktuar strategjinë e drejtë, njeriu duhet të ketë njohuri të qartë për gjendjen dhe situatën e tanishme të botës Islamike. Në këtë pikë, analiza jonë për botën bashkëkohore Islamike paraqitet më poshtë.

Qytetërimi Islamik, i përfaqësuar nga perandoritë e mëdha Otomane Safavid dhe Mugal në shekujt gjashtëmbëdhjetë dhe shtatëmbëdhjetë, ishte fuqia mbizotëruese në Azinë Qendrore dhe Jugore, Afrikën Veriore dhe Evropën Jugore. Otomanët sunduan një territor të gjerë që mbulonte Ballkanin, Anadollin, Mesopotaminë dhe pjesë të Arabisë dhe Afrikës Veriore; Safavidët sunduan Persinë dhe disa territore fqinje; dhe Mugalët sunduan pjesën më të madhe të nën-kontinentit Indian. Megjithatë, sundimi i Islamit gradualisht u tkurr dhe u dobësua. Së pari, Perandoria Mugale u rrënuar dhe kështu hapi një epokë të re për Muslimanët e Azisë Jugore. Dinastia Kahar, trashëgimtare e Perandorisë Safavide, arriti të mbijetoj deri në vitet e 1920-ta, megjithëse pa fuqi dhe ndikim. Gradualisht, këto toka ranë nën sundimin Britanik dhe Rus. Ndërkohë, Perandoria Otomane, e cila po dobësohej me humbjen e vazhdueshme të tokave dhe me trazira të brendshme, përfundimisht u shemb si pasojë e Luftës së Parë Botërore.

Shembja e Perandorisë Otomane, shtetit më të madh dhe më me ndikim në botën Islamike, çoi drejt ndryshimeve historike në gjeografinë Islamike, në veçanti në Lindjen e Mesme dhe pjesë të Gadishullit Arabik. Përgjatë shekullit njëzet, shtetet-komb të formuara nga fuqitë pushtuese Evropiane mbetën burim i tensionit dhe pakënaqësisë në rajon. Bota Islamike, e cila u dha jetë qytetërimeve të mëdha, filloi të tërhiqej në vetvete. Muslimanët e Lindjes së Mesme, si edhe të Afrikës Veriore dhe Azisë Jugore, vuajtën nën sundimin kolonial. Shumica e këtyre

vendeve arritën të fitojnë pavarësinë e tyre vetëm në gjysmën e dytë të shekullit njëzet. Lufta për pavarësi ishte shumë e përgjakshme në disa vende, si në Algjeri. Miliona njerëz të pafajshëm vdiqën dhe një numër shumë i madh njerëzish u gjymtuan nga mundimet dhe persekutimi. Madje edhe pas pavarësisë dhe tërheqjes së fuqive koloniale, këto toka nuk kanë gjetur paqen dhe sigurinë. Thënë shkurt, një pjesë e madhe e botës Islamike kaloi shekullin njëzet duke u përballur me luftë, konflikte, skamje dhe varfëri të skajshme.




Megjithatë, bota e Islamit nuk ka qenë gjithmonë e tillë.

Historia e katërmbëdhjetë shekujve të kaluar zbulon një pamje krejtësisht tjetër: përparimet kulturore dhe shkencore më madhështore u bënë të mundshme përmes Islamit. Në një kohë kur Evropa ishte ende e zhytur në errësirë, Muslimanët ngritën qytetërimin më mahnitës në këtë planet dhe morali Islamik ndriçoi botën.

A ceremony made in the name of Shah Abbas I of the Safavid Dynasty.



THIRRJE PËR UNION ISLAMIK

-  OTTOMAN EMPIRE AT ITS HEIGHT
-  MUGHAL EMPIRE AT ITS HEIGHT
-  SAFAVID EMPIRE



HUNGARY

ISTANBUL

OTTOMAN
EMPIRE

SAFEV
EMPIRE

BEDOUINS

OMAN

YEMEN

KAZA

BUK



RUSSIAN
EMPIRE

KAKHS

QUING
EMPIRE


HARA

VID

TIBET

● DELHI

MOGUL
EMPIRE



ISLAMI
NDRIÇOI
BOTËN

Islami lindi katërmëdhjetë shekuj më parë në Gadishullin Arabik. Shpallja e Kur'anit Profetit Muhammed (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) nga ana e Allahut, bashkë me moralin e Islamit, u mësoi njerëzve të dhunshëm, barbar dhe të padijshëm të këtij rajoni paqen, arsyen dhe qytetërimin.

Në fillim të shekullit të shtatë, Arabia ishte një prej vendeve më kaotike të botës. Shumë fise jetonin në këto toka dhe secili prej tyre adhuronte një idhull tjetër. Ata i shpallnin luftë njëri tjetrit, derdhnin shumë gjak dhe madje vrisnin fëmijët për besimet e tyre të devijuara dhe idhujt e tyre. Besimet e tyre lartësonin mungesën e mëshirës, urrejtjen dhe dhunën në vend të dashurisë, dhembshurisë dhe mirësisë. Femrat konsideroheshin si genie më të ulëta dhe të varfrit dhe robërit shfrytëzoheshin në mënyrë të pamëshirshme.

Kjo botë e errët dhe e përgjakshme ndryshoi në tërësi me ardhjen e Islamit dhe kodeve morale të tij. Edhe pse Arabët ishin të parët që pranuan Islamin, shumë kombe tjera shpejt përqaftuan dritën që sollën parimet morale të tij. Shpallja e Kur'anit iu mundësoi Muslimanëve të arrijnë përparim të pakrahasueshëm në shkencë, kulturë, mendim dhe art. Me shpalljen e ajetit të parë të Kur'anit, popullata e këtij rajoni, e cila derisa nuk ndodhi kjo kishte ngecur në këtë rreth vicioz të mosdijes së errët dhe dhunës së përgjakshme, u thirr të lexoj dhe

THIRRJE PËR UNION ISLAMIK

*Lexo me emrin e Zotit tënd, i cili
krijoi (çdo gjë). Krijoi njeriun prej
një gjaku të ngjizur (në mitrën e
nënës). Lexo! Se Zoti yt është më
bujari! Ai që e mësoi (njeriun) të
shkruaj me pendë.*

(Kur'an: 96/1-4)



Before the advent of Islam, ignorance prevailed over Arab society.

të mendoj për herë të parë:

Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (gjithçka), e krijoi njeriun nga një droçkë gjaku! Lexo! Zoti yt është Bujari më i madh, i Cili, me anë të penës ia mësoi, ia mësoi njeriut ato që nuk i dinte. (Kur'an, 96:1-5)

Struktura e shoqërisë Arabe filloi t'i nënshtrohej një transformimi të plotë me ardhjen e Islamit. Për shembull, tradita Arabe urdhëronte vrasjen e gjithë robërve të luftës, ndërsa Profeti ynë (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të), i udhëzuar përmes shpalljes së Zotit, urdhëroi që këta të burgosur të trajtohen mirë dhe të ushqehen nga racionet e vet Muslimanëve. Ajeti në vazhdim zbulon këto cilësi Muslimane:

Ata i ushqejnë të varfrit, jetimët dhe të zënët rob edhe pse vetë janë nevojtarë, (Kur'an, 76:8)

E vetmja gjë që u kërkua prej këtyre robërve të luftës ishte që nëse dinin të lexonin dhe shkruanin, ishin të obliguar që t'iu mësonin shkrim-leximin Muslimanëve. Ndoshta për herë të parë në historinë e saj, Arabia ishte dëshmitare e dhembshurisë, faljes dhe qytetërimit. Si rezultat, ajo përjetoi një rënë prej periudhave më madhështore të përparimit kulturor.

Me kalimin e viteve, drejtësia dhe parimet e larta morale të Islamit u përhapën valë-valë në mbarë Arabinë. Drejtësia, ndershmëria dhe vendosmëria e Muslimanëve joshi shumë fise Arabe. Ushtria e fuqishme Muslimane marshoi në Mekë në vitin 630. Idhujtarët Mekas kishin frikë hakmarrjen që Muslimanët mund ta bënin mbi ta si ndëshkim për mizorinë e tyre në të kaluarën. Sipas traditës Arabe, meshkujt e fisit të mundur vriteshin dhe femrat dhe fëmijët robëroheshin. Por Profeti ynë (Allahu e mëshiroftë dhe i dhuroftë paqe) reflektoi

mëshirën e Allahut duke shpallur se askush në Mekë s'do të ndëshkohej dhe se askush nuk do të shtrëngohej të pranoi Islamin me forcë. Ky akt i faljes dhe tolerancës ka tërhequr vëmendjen e historianëve Perëndimorë. Në dokumentarin e PBS Islami: Perandoria e Besimit, Majkëll Sells, ligjërues në Universitetin e Haverfordit, rrëfen për virtytin e Profetit tonë (Allahu e mëshiroftë dhe i dhuroftë paqe) në këtë mënyrë:

Kur Muhamedi (Allahu e mëshiroftë dhe i dhuroftë paqe) erdh në Mekë, ai jo vetëm që nuk ndërmori hakmarrje të përgjakshme, por në të vërtetë, ai përqafoi pikërisht Mekasit, të cilët e kishin luftuar atë për tri vite dhe ishin përpjekur që ta vrisnin. Kjo ishte një gjë tronditëse për popullatën e këtij mjedisi. Kështu, mu në themel të një feje, njeriu gjen episode të bujarisë madhështore, vepra të shpeshta të mirësisë dhe të mëshirës së jashtëzakonshme.¹

Ajo që kishte rëndësi ishte lirimi i Mekasve nga besimet e tyre të rrejshme. Prandaj, Profeti ynë (Allahu e mëshiroftë dhe i dhuroftë paqe) u drejtua menjëherë për në Qabe, hyri brenda xhamisë së shenjtë dhe i shkatërroi të gjithë idhujt që ndodheshin brenda. Kjo ngjarje shënoi fundin e idhujtarisë dhe i dha fund gjithë mizorisë, padrejtësisë, barbarizmit dhe dhunës së bërë në



emër të saj. Pasi që u edukuan me Kur'an, Arabët zëvendësuan gjithë epokën para-islamike të padrejtësisë, shfrytëzimit dhe gjakmarrjeve me një rregull të ri të mbështetur në respekt, dashuri, dhembshuri dhe drejtësi midis njerëzve.

Kjo epokë më vonë u njoh si "Koha e Bekuar."

Toleranca, Drejtësia dhe Dhembshuria sipas parimeve morale Islamike


Përhapja e shpejtë e Islamit vazhdoi madje edhe pas vdekjes së Profetit (Allahu e mëshiroftë dhe i dhuroftë paqe). Brenda disa dekadave, Islami u përhap në gjithë Mesopotaminë dhe Afrikën Veriore dhe u shtri edhe në perëndim të Spanjës dhe në lindje të Indisë.

Arabët, të cilët kujdeseshin për tufat e tyre në shkretëtirë vetëm pak dekada më herët, tani ishin sundues të një perandorie për shkak të arsyes, kulturës dhe vetëdijes që ata kishin fituar përmes Islamit. Kjo ishte perandoria që më së shpejti u zhvillua ndonjëherë në histori. Brenda 10 viteve, perandoria Muslimane u përhap në një territor të pafund dhe vuri themelet e saj në mënyrë të vendosur. Në këtë hapësirë të pafund gjeografike, ekzistonin shumë besime të ndryshme fetare njëra përkrah tjetrës. Megjithatë, shumica prej tyre përbëheshin prej të Krishterëve dhe Hebrenjve. Muslimanët, në përgjithësi, ishin gjithmonë tolerant ndaj të gjitha grupeve fetare në tokat e tyre, nuk i detyruan njerëzit që të përqafonin Islamin dhe respektonin vullnetin e lirë të secilit person, sepse Kur'ani thotë:






S'ka detyrim në fe. (Kur'an, 2:256)


Kishat dhe sinagogat ishin të mbrojtura. Në një kohë kur detyrimi për kthim në fe ishte një praktikë e zakonshme, një tolerancë e tillë ishte unike.

THIRRJE PËR UNION ISLAMIK



KUFIJTE E ISLAMIT MS 800 -1200

-  Midis tokat e Islamit 800-1200
-  Arrin në territorin më të madh në periudhën e Halifatit Abasit
-  Seljuk bastisje
-  Berber bastisje
-  Përhapjen e mëtejshme të vlerat morale Islamike





Qubbat As-Sahra

Thuaj: "Ne i kemi besuar All-llahut, edhe asaj që na u zbrit neve, edhe asaj që i është zbritur Ibrahimit, Ismailit, Is-hakut, Jakubit dhe pasardhësve. Edhe asaj që i është dhënë Musait dhe Isait, edhe asaj që i është zbritur të gjithë pejgamberëve nga Zoti i tyre. Ne nuk bëjmë kurrfarë dallimi në mes tyre dhe ne vetëm Atij i jemi dorzuar.

(Kuran: 3/84)

Një prej shembujve më të jashtëzakonshëm të kësaj tolerance ishte pushtimi i Jerusalemit. Patriarku i Kishës së qytetit të quajtur Varri i Shenjtë frikësohej se kisha e tij do të shkatërrohej nga Muslimanët. Prandaj, Kalifi Umar vizitoi kishën dhe tha se nuk kishte nevojë të shqetësohej për asgjë. Kur erdhi koha për falje, ai kërkoi lejen e patriarkut të largohej në mënyrë që të mund të falej diku afër. Xhamia al-Aksa më vonë u ndërtua mu në atë vend.

Muslimanët i dhuruan Jerusalemit një prej veprave më madhështore të arkitekturës në botë: Kubat as-Sakra (Kuben e Gurtë), e cila u ndërtua në një shkëmb që besohej se ishte vendi prej ku Profeti Muhammed (Allahu e mëshiroftë dhe i dhuroftë paqe) u ngrit në qiej. Motivet mahnitëse dhe kubeja e artë e kësaj kryevepre të arkitekturës pasqyrojnë ndjenjën Islame të artit dhe qytetërimit.

Në këtë mjedis të tolerancës, jomuslimanëve iu dha madje edhe e drejta demokratike për t'i shprehur ankesat e tyre. Gjatë epokës Umajad, shumë të Krishterë në Damask (Sham) zinin pozita të rëndësishme në burokracinë e shtetit dhe kryenin obligimet e tyre fetare ashtu si dëshironin. Ca prej tyre madje shkruan libra që kritikonin Islamin dhe Muslimanët pa frikë nga ndëshkimi.

Në të njëjtën kohë, Evropa udhëhiqej nga një fundamentalizëm dhe barbarizëm i errët. Kisha Katolike shtypte Hebrenjtë e madje edhe të Krishterët e besimeve tjera. Kthimi me forcë në fe, si edhe tortura dhe vrasja në emër të fesë, ishin të rëndomta. Në anën tjetër, Muslimanët gjithmonë i kanë trajtuar Ithtarët e Librit (Hebrenjtë dhe të Krishterët) me tolerancë dhe dhembshuri, sepse Zoti e urdhëron këtë në Kur'an.

Kisha e Shën Gjonit e Damaskut është një tjetër shembull i

THIRRJE PËR UNION ISLAMIK

kësaj tolerance. Muslimanët, të cilët pushtuan këtë territor filluan të falin namazin e tyre të Xhumasë në këtë kishë dhe i lejuan të Krishterët të vazhdojnë ta përdorin atë për shërbimet e tyre të së Dieles. Dy besime të ndara ndanin në mënyrë paqësore të njëjtën faltore. Me rritjen e numrit të Muslimanëve në qytet, udhëheqja



Muslimane bleu kishën prej të Krishterëve me pëlqimin e tyre. Ngjitur me të, një xhami u ndërtua dhe dekori i hapësirave të mbyllura në hyrje të ndërtesave u pasurua me motive Islamike. Shtyllat e epokës së Bizantit u dekoruan me modele mahnitëse të artit Islamik.

Gjatë tërë historisë së Islamit, vazhdoi toleranca e tij ndaj Hebrenjve dhe të Krishterëve. Hebrenjtë që iknin nga terrori i Inkuizionit Spanjoll gjetën strehim dhe tolerancë në dheun Otoman. Burimi dhe arsyeja e një tolerance të tillë ishin parimet morale të Kur'anit, sepse Muslimanëve u është thënë:

Diskutoni me ithtarët e Librit vetëm me mënyrën më të mirë, por jo me keqbërësit e tjerë. Dhe thoni: "Ne besojmë në atë që na është zbritur neve dhe në atë që ju është zbritur juve. Zoti ynë dhe Zoti juaj është një - dhe ne Atij i nënshtrohemi si myslimanë". (Kur'an, 29:46)

Muslimanët dhe shkenca

Njëra prej dritave të parimeve morale Islamike që ndriçoi rrugën e njerëzimit ishte mendimi shkencor. Arabët para-islamik dhe disa shoqëri tjera të Lindjes së Mesme kurrë nuk kanë qenë të interesuara për gjithësinë dhe për mënyrën se si u krijua natyra apo se si funksionon ajo. Por ky qëndrim ndryshoi me shpalljen e Kur'anit, sepse Zoti u thotë njerëzve të mësojnë për zanafillën e qiejve dhe Tokës:

[Njerëz të mençur janë] ata që e përmendin Allahun duke qëndruar në këmbë, ndenjor ose shtrirë dhe që meditojnë për krijimin e qiejve dhe të Tokës (duke thënë:) "O Zoti Ynë! Ti nuk i ke krijuar kot këto - lartësuar qofsh (nga çdo e metë)! Prandaj na ruaj nga ndëshkimi i zjarrit." (Kur'an, 3:191)

SOME MUSLIM SCIENTISTS



Ibn an-Nafis



Thabit ibn Qurra



İbn-i Sina



Al-Kindi



Abu al-Qasim
al-Zahrawi



Muhammad Zakariya
ar-Razi



Ali Kushji



Al-Battani

Ali Kushji, supported by Sultan Mehmed II, was famous for his astronomical works.

Kjo vetëdije filloi me ngritjen shkencore të qytetërimit Islamik dhe ai pastaj nisi një udhëtim shkencor të tillë që askush nuk kishte parë para asaj kohe. Centrali që e furnizonte me energji ishte Bagdadi, kryeqyteti i Perandorisë Abasidë dhe i botës Islamike. Shkencëtarët, mendimtarët, studiuesit dhe dijetarët tjerë nga e mbarë bota Islamike u bashkuan në Dar al-Hikmah (“Shtëpinë e Urtësisë”) në Bagdad për të studiuar dhe hulumtuar fshehtësitë e gjithësisë së Zotit.

Kjo vetëdije që arritën



Miniature paintings showing the astronomical works of Muslim scientists.

THIRRJE PËR UNION ISLAMIK

shkencëtarët Musliman duke iu qëndruar besnik parimeve morale të Kur'anit, mundësoi kërcimin më të shpejtë sa i përket përparimit në shkencë deri në atë kohë. Gjerësia e pikëpamjeve, urtësia për të cilën Muslimanët mësuan nga Kur'ani, iu mundësoi atyre t'i analizojnë dhe pastaj t'i zhvillojnë më tej të arriturat shkencore të qytetërimeve tjera pa paragjykim. Dokumentet shkencore të Muslimanëve ishin përplot vrojtime, eksperimente, llogaritje dhe studime për tema të ndryshme. Në shkollat e shkencës, femrat kishin të drejta të njëjta për shkollim si meshkujt dhe dhanë kontributet e tyre shkencore.

Matematikanët Muslimanë zhvilluan sistemin decimal të numrave dhe zbuluan algjebren dhe trigonometrinë. Shkencëtarët Muslimanë ishin shumë të përkushtuar për vrojtime astronomike dhe kështu zbuluan dhe vendosën parimet e astronomisë moderne. Dijetarët



While Muslims treated their patients in extremely clean and well-kept hospitals, patients in Europe were abandoned to death. A front view of the famous Mansur Hospital at that time (to the left). The picture showing the streets of Venice at the same period reveals the civilizational gap between the two worlds.



Muslimanë llogaritën trajektoren e hënës rreth Tokës dhe regjistruan formulat. Veprat e mahnitshme të arkitekturës në mbarë botën Islamike u mundësuan vetëm përmes infrastrukturës shkencore të vendosur nga Muslimanët.

Muslim scholars in the field of medicine had a high level of knowledge. Their works became basic reference books throughout Europe. The diagram used by Muslim scientists in treating broken bones (at the bottom).




Drawings of Muslim scholars showing human anatomy and the digestion and circulation systems (to the left).

Examples from Muslim scientists' works



Apparatus designed by al-Haskafi to measure changing water levels.

The drawings used by Muslim scientists to calculate solar and lunar eclipses.



Ibn Sina's notebook in the National Museum of Damascus.



The apparatus designed by Muslim scientists to measure blood pressure.



Al- Mutadibih's work on the eye's anatomy.

Disa prej të arriturave më të mëdha të Muslimanëve ishin në fushën e mjekësisë. Në atë kohë, Evropianët e padijshëm i konsideronin sëmundjet si mallkim të shpirttrave të lig dhe kështu nuk kishin koncept për trajtimin apo për shërimin e njerëzve të prekur nga sëmundja. Mirëpo, shkencëtarët Muslimanë arritën deri të përfundimi i bazuar në hulumtime se sëmundjet shkaktoheshin nga krijesa të vogla të padukshme për syrin e njeriut dhe se pacientët duhej të izoloreshin prej njerëzve të shëndoshë gjatë trajtimit të tyre. Spitalet e para moderne në botë janë konceptuar në këtë mënyrë. Spitalet Muslimane kishin pavijone të ndryshme për sëmundje të ndryshme dhe mjekët Musliman kishin zhvilluar në mënyrë shkencore metodat e trajtimit të pacientëve. Muslimanët trajtonin sëmundjet mendore me muzikë dhe terapi, përderisa Evropianët besonin se të



Ibn el-Heytem

sëmuret mental ishin robër të Shejtanit dhe për atë arsye i digjinin në turrë të drunjve. Enciklopeditë e Muslimanëve mbi anatominë njerëzore ishin aq të sakta sa që ato u përdorën për 600 vjet në fakultetet Evropiane të mjekësisë.

Një dokumentar për botën Islame, i përgatitur për BBC-në nga komentuesi Teri Xhons, thotë si vijon për standardet e larta shkencore të Islamit:

Për shembull, një filozof nga qyteti i Haranit tashmë kishte llogaritur me saktësi distancën nga toka në hënë. Një tjetër bile kishte sugjeruar që nëse njeriu do të mund të ndante atomin, atëherë do të lirohej energji e mjaftueshme për ta shkatërruar një qytet me madhësinë e Bagdadit. Në këtë shkollë të mjekësisë në Damask në vitin 1154, mjekët tashmë ligjëronin anatominë, medicinën zbuluese, kirurgjinë higjienike, qarkullimin e gjakut, me shekuj para Harvit.²

Me shekuj përpara homologëve të tyre Evropian, mjekët Muslimanë kishin njohuri për qarkullimin e gjakut dhe iu matnin pulset pacientëve të tyre gjatë ekzaminimeve. Lindja e foshnjës zhvillohej në kushtet më higjienike të mundshme të asaj kohe. Instrumentet kirurgjike, siç përshkruhen në librat mjekësor të asaj epoke, janë dëshmi e diturisë së përparuar mjekësore.

Shkencëtarët Muslimanë bën zbulime të rëndësishme lidhur me optikën dhe natyrën e dritës. Njeriu i parë që zbuloi strukturën e syrit në hollësi ishte Ibn al-Hajthami, studimi i jashtëzakonshëm i të cilit për thjerrëzat i hapi rrugën zbulimit të kamerës. Mjekët Muslimanë zbuluan arsyt e dobësimit të të parit dhe realizuan ndërhyrje të suksesshme kirurgjike të kataraktit të syrit 1,000 vite përpara ndonjë mjeku Evropian.


Trashëgimia e shkëlqyer shkencore e botës Islamike e bëri të mundshme Rilindjen Evropiane. Shkencëtarët e Krishterë themeluan shkollat Evropiane të shkencës me diturinë dhe metodat e mësuara prej Muslimanëve. Drita e Islamit i ndriçoi ata po ashtu.

Madhështia e qytetërimit Islamik

Një cilësi e mësuar nga parimet morale të Islamit është ndjenja e lartë për art dhe estetikë. Përshkrimet Kur'anore të Xhenetit (Parajsës) janë përfytyrime të kualitetit më të lartë, të shijes më të përsosur dhe të një madhështie mahnitëse. Muslimanët kishin këtë ndjenjë arti në zemrat e tyre, gjë e cila pasqyrohej në punën e tyre dhe kështu tokat që ata sunduan u shndërruan në rajonet më moderne dhe më të zgjedhura të botës. Kur Islami u përhap jashtë në të gjitha drejtimet, me vete solli përparim dhe zhvillim.

**Dhe, në mes tyre dhe mes fshatrave të bekuara
(në Sham), ju bëmë fshatra të njëpasnjëshme dhe
ju bëmë udhëtim të përshtatshëm. Udhëtoni
të sigurt nëpër to natën e ditën.**

(Kuran: 34/18)




Tac Mahal, Hindistan

**Mashhad of Sharif
Tabataba, Cairo,
10th century.**

Mustansiye Medresesi, 1233, Bağdat

THIRRJE PËR UNION ISLAMIK



Harun Jahja (Adnan Oktar)

**Ne ju vendosëm në tokë dhe ju mundësuam
jetesën (mjetet për të jetuar), e pak
prej jush po falënderoni.
(Kuran: 7/10)**



THIRRJE PËR UNION ISLAMIK





Khiva

Buhara

Semerkand

Herat

Agra

Fatehpur Sikri

Samarra

Isfahan

Cakarta

Bağdat

Şam

Muslims who spread Islamic civilization throughout the world erected glorious mosques and other buildings in these lands.

Muslimanët sollën me vete qytetërim kudo që shkuan. Ata ndërtuan një sistem efikas për pastrimin e ujit për nevojat për ujë të pijes të një qyteti Tunizian. Uji mbahej dhe pastrohej në dy basene të mëdha dhe pastaj dërgohej në qytet përmes një sistemi të mbyllur gypash. Vetëm shekuj më vonë Evropianët filluan të shqetësohen për gjëra të tilla. Inxhinierët Muslimanë në Siri konstruktuan një sistem fantastik të mullinjve me ujë për të furnizuar qytetet me ujë.

Kryeqendra e botës Islamike, Bagdadi, ishte qyteti më madhështor dhe më bashkëkohor në botë. Planifikimi urban dhe arkitektura ishin të mahnitshme. Një udhëtar që vizitoi Bagdadin shkroi si vijon:

Të gjitha lagjet elegante të mbuluara me parqe, kopshte, vila dhe shëtitorët përplot me pazare dhe në fund xhamitë dhe hamamet e ndërtuara. Ato shtrihen me milja në të dyja anët e lumit vezullues.³

Andaluzia (Spanja Muslimane), një tjetër qendër e mahnitshme e botës Islamike, gradualisht u bë vendi më bashkëkohor dhe më i përparuar i Evropës.




The Cordoba Mosque has an impressive beauty.

**All-llahu urdhëron drejtësi,
bamirësi, ndihmë të afërmve, e
ndalon nga imoraliteti, nga e
neveritura dhe dhuna. Ju këshillon
ashtu që të merrni mësim.
(Kuran:16/90)**

Kryeqyteti i saj Kordoba ishte përplot me bukuri mahnitëse me rrugët e saj të pastra dhe të ndriçuara mirë, bibliotekat, spitalet dhe pallatet.

Në të njëjtën kohë, qytete të mëdha Evropiane si Parisi dhe Londra ishin të pista, të errëta dhe të lëna pas dore. Si rrjedhojë, të Krishterët Evropian që vizituan Kordobën ishin të mahnitur dhe të habitur me bukurinë, kulturën dhe artin e qytetit.

Granada's al-Hambra Palace, constructed by Muslims, is one of Islam's most impressive architectural works.



Thuaj: "All-llahu më urdhëroi
mua drejtësinë dhe në tërësi
kthejuni Atij në çdo namaz (lutje)
dhe adhurojeni Atë duke qenë të
singertë në lutje vetëm për të.
Ashtu sikur që ju filloi (krijoi)
së pari do të ktheheni te Ai.
(Kuran:7:29)

Në librin Islami: Perandoria e Besimit, Historiana Shila Bler e Kolegjit të Bostonit e përshkruan bukurinë e Kordobës me këto fjalë:

Qyteti i Kordobës ishte njëri prej qyteteve më të mëdha dhe më ngazëllues në Evropë në shekujt 9-të dhe 10-të. Kemi përshkrimet e njerëzve që kishin ardhur dhe kishin parë gjithë ato lule gjithandej rrugeve të gjera, atë dritë të mrekullueshme depërtuese. Qytetet veriore ishin të errëta, Kordoba kishte ujë të rrjedhshëm. Njerëzit jetonin në shtëpi të mëdha. Për dallim, në Paris, njerëzit jetonin në kasolle në breg të lumit.⁴

Një prej pak shembujve të mbetur të madhështisë së Kordobës është katedralja Katolike që ndodhet në qendër të qytetit. Fillimisht ajo ishte një xhami me një stil estetik që magjepsi mendjet e atyre që hynë në të. Eksploruesit e Krishterë të cilët erdhën në Kordobë u ndikuan thellësisht nga madhështia e saj. Në shekullin e dhjetë, një murgeshë Saksone me emrin Hrotsvitha përshkroi Kordobën si ornament të botës.

Njëra prej ndërtesave më mahnitëse të Andaluzisë ishte pallati Alhambra, i cili ishte i zbukuruar me shembuj mahnitës të estetikës dhe artit Islam. Secili detal pasqyrore po të njëjtën shije të hollë të shpirtit të lartë të Islamit. Kopshtet e tij ishin përplot me shatërvane të furnizuara me anë të një sistemi të bazuar në gravitacion. Muslimanët të cilët e ndërtuan atë ishin të frymëzuar nga përshkrimet Kur'anore të Xhenetit.

Këtu janë disa ajete për Xhenetin:

Ata do të kenë mirësi të caktuara dhe fruta të ndryshme e do të jenë të respektuar, në kopshtet e lumturisë, në kolltuqe, përballë njëri-tjetrit. Aty do t'u shërbehet një gotë e mbushur nga një burimi i rrjedhshëm, (me pije) të bardhë e të shijshme për ata që do ta pinë. Prej saj as nuk do të



THIRRJE PËR UNION ISLAMIK

trullosen dhe as nuk do të dehen. (Kur'an, 37:41-47)

(Kopshtet do të jenë) të mbjellë me pemë që bëjnë hije.

(Kur'an, 55:48)

Ata do të jenë të mbështetur në shtroje, anash me armaç mëndafshi e frutat e dy kopshteve do t'i kenë afër sa t'i kapin me dorë. (Kur'an, 55:54)

[Kopshtet e Xhenetit] do të jenë të stolisura me gjelbërim.

(Kur'an, 55:64)


Ata do të qëndrojnë në divane të stolisura me ar e gurë të çmuar, të mbështetur në to përballë njëri-tjetrit. (Kur'an, 56:15-16)

Ata do të qëndrojnë në mes të lotusëve pa gjemba. (Kur'an, 56:28-29)

Nën hije të gjera, pranë një uji rrjedhës, dhe mes frutave të llojlojshme, të cilat kurrë nuk sosen, as nuk janë të ndalura; dhe në shtroje të ngritura. (Kur'an, 56:30-34)

Pikërisht atyre u përket Xheneti i Adnit, nëpër të cilin rrjedhin lumenj. Ata do të stolisen atje me byzylykë ari dhe do të vishen me rroba të gjelbra prej mëndafshi të hollë dhe armaçi, duke ndenjur të mbështetur në shtretër të lartë. Sa shpërblim i mrekullueshëm dhe sa vendbanim i bukur! (Kur'an, 18:31)

Harun Jahja (Adnan Oktar)



*Aty janë dy
burime që gjithnjë
gurgullojnë.
(Kuran: 55/66)*


As well as architecture, Muslims had an advanced quality of and taste in clothing compared with Europe. Their textile shops produced unprecedentedly beautiful fabrics, which made European clothing appear quite ordinary.

For this reason, Muslim clothing and fabrics became symbols of luxury and status among Europeans.

The church's most valuable holy objects were kept in Muslim-made fabrics. Indeed, some clothes in Christian paintings made during the Middle Age had Islamic writing

on them. In fact, Muslims dictated fashion to the world.

Europe received other practices of civilizations from Muslims, such as bathing and using soap. Islamic civilization also contributed greatly to the development of European music. For example, string instruments widely used in the Islamic world were later adopted by Europeans. The guitar, a basic instrument of the Western music, is an adaptation of the classical ut.





Qytetërimi Islamik dhe Otomanët

Perandoria Otomane, e themeluar në vitin 1299, zhvillohej si njëra prej perandorive Islamike më të mëdha dhe më madhështore të botës. Botëkuptimi zyrtar Otoman, i bazuar në tolerancë dhe drejtësi la gjurmët e veta në tokat që sundoi me arkitekturën, tekstilet, bukurshkrimin sublim të tij dhe me një sistem të përkryer të edukimit që e lakmonte Evropa. Finesa dhe shija e sulltanëve për art admirohej nga Evropianët, të cilët ishin thellësisht të impresionuar nga madhështia e Perandorisë Otomane.

Perandoria Otomane ishte njëra prej perandorive më të mëdha dhe me jetëgjatësinë më të madhe. Në të vërtetë, vetëm Perandoria Romake në kulmin e saj mbulonte një rajon më të gjerë. Mirëpo, ajo nuk arriti të ruante madhësinë e saj për aq kohë sa arritën Otomanët. Shumë shtete që tani formojnë pjesë të Evropës, Afrikës Veriore, Azisë Qendrore dhe Lindjes së Mesme kanë monumente dhe vepra artistike Otomane të rëndësishme në aspektin historik që zbukurojnë qytetet e tyre. Shembuj të arkitekturës dhe planifikimit urban Otoman ende qëndrojnë në shumë qytete Evropiane (si Sofja, Beogradi dhe Sarajeva).

Shteti Otoman dhe sistemi qeverisës bazohej në Kur'an dhe shumë shkencëtarë politik të sotëm i referohen atij si njërit prej sistemeve më të mira shtetërore. Diplomacia shtetërore Otomane përbënte bazën e diplomacisë së shumanshme të epokës moderne.

Qytetërimi Otoman kishte ndikim të drejtpërdrejtë mbi kulturën e Evropës Perëndimore: Otomanët i mësuan

The hilya below belongs to a special collection. The other ornamental objects of the sixteenth and the seventeenth centuries are displayed in the Turkish Islamic Art Museum.



Hungarisë kultivimin e orizit, Busbeku, i dërguari i Habsburgëve i mësoi shtetet e Beneluksit për tulipanët pasi që vizitoi Stambollin në shekullin e gjashtëmbëdhjetë, Italianët mësuuan teknikat e thurjes dhe ngjyerjes së pëlhurës nga Otomanët dhe Otomanët ju mësuuan traditën e orkestrave ushtarake Evropës.⁵

Këto fakte historike tregojnë se parimet morale Islamike luajtën një rol udhëheqës në zhvillimin bashkëkohor të botës. Që nga fillimi i shpalljes së tij, Islami ka shërbyer si një dritë udhërrëfyese, duke e çuar njerëzimin drejt të vërtetës, realitetit dhe bukurisë. Muslimanët sollën me vete parimet e tyre morale kudo që shkuan, bashkë me tolerancën, arsyen, shkencën, artin, estetikën, higjienën dhe përparimin. Në një kohë kur Evropa ishte e zhytur në dogmatizmin dhe barbarizmin e errët, bota Islamike ishte qytetërimi më i përparuar dhe më bashkëkohor i botës. Vlerat e mësuara nga bota e Islamit nga ana e individëve Evropian luajtën një rol fundamental në zhvillimin e qytetërimit Evropian. Historiani Eugen Majers shpreh këtë realitet si vijon:


... Nga fundi i shekullit të nëntë deri në shekullin e dymbëdhjetë, ndikimi Islamik në shkencën dhe kulturën Perëndimore ishte shumë i madh... Rëndësia kulturore e punës së dijetarëve dhe përkthyesve Islamik për zhvillimin e shkencës dhe shkençave humane thuhet mund të mbiolerësohet... Në

këtë mënyrë, rrënjët e mendimit Perëndimor janë një përzierje e të menduarit Greko-Arabik dhe Hebre.⁶

Në anën tjetër, njëra prej arsyeve kryesore pse bota Islamike mbeti prapa në disa aspekte ishte sepse ajo u nda nga arsyeja, sinqeriteti dhe gjerësia e pikëpamjeve që mësohet në Kur'an. E themi këtë për arsye se Kur'ani është burim i udhëzimit që nxjerr njerëzimin nga errësira e mosdijes dhe e çon drejt dritës së diturisë së vërtetë. Zoti i shpalli Profetit tonë (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të).


Elif Lâm Râ. Këtë Libër ta kemi shpallur ty (o Muhamed), për t'i nxjerrë njerëzit, me lejen e Zotit të tyre, nga errësira në dritë, në rrugën e të Plotfuqishmit, të Denjit për çdo lavd. (Kur'an, 14:1)

Muslimanët e sotëm duhet të kenë dijeni për të kaluarën e shkëlqyer të qytetërimit Islamik dhe ta respektojnë përgjegjësinë që ajo bart me vete. Të mos harrojmë se Muslimanët janë përfaqësues të një trashëgimie të shenjtë, të lavdishme dhe të nderuar që ndërtoi njërin prej qytetërimeve më të mëdha në Tokë. Për më tepër, ata gjithmonë janë lakmuar dhe admiruar në masë të njëjtë nga përfaqësuesit e qytetërimeve apo besimeve tjera fetare. Eksperti i famshëm për Lindjen e Mesme Daniel Pajps flet për vetëbesimin e Muslimanëve në njërin prej artikujve të tij:



Ajo që kontribuon në këtë vetëbesim të brendshëm është kujtimi për të arriturat e jashtëzakonshme gjatë afërsisht gjashtë shekujve të parë të Islamit. Kultura e tij ishte më e përparuara dhe Muslimanët gëzonin shëndetin më të mirë, jetonin më së gjati, kishin shkallën më të lartë të shkrim-leximit, organizonin hulumtimet më të përparuara shkencore dhe teknike dhe zakonisht formuan ushtri fitimtare. Ky model i suksesit ishte i dukshëm që nga fillimi: në vitin 622 të erës sonë (e.s.), Profeti Muhammed (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) u largua nga Meka si refugjat, për tu kthyer vetëm tetë vite më vonë si sundimtar i saj. Që në vitin 715 push-tuesit Musliman kishin formuar një perandori që shtrihej nga Spanja në perëndim deri në Indi në lindje. Të jesh Musliman nënkuptonte t'i takoje një qytetërimi fitimtar.⁷

Muslimanët sot nuk duhet vetëm të kënaqen me lavdinë e të kaluarës së tyre, por duhet të punojnë që t'i ndihmojnë botës



Islamike të ngrihet edhe njëherë. Pa dyshim, Muslimanët mund të ndërtojnë përsëri një kulturë dhe qytetërim të shkëlqyer që të ndriçoj botën, por jo përderisa nuk e rikrijojnë shpirtin e unitetit dhe solidaritetit që i vinte në lëvizje paraardhësit e tyre. Nëse do të mund të themelojnë një kulturë demokratike, konstruktive, tolerante dhe paqedashëse që punon vetëm për të mirën e Islamit dhe njerëzimit dhe që shpërfill interesat personale, do të mund të ndërtojnë qytetërimin më të madh të shekullit njëzet e një. Duke iu falënderuar vlerave bazë të parimeve morale Islamike (dmth. dashurisë, dhembshurisë, mirëkuptimit dhe tolerancës), regjimet despotike që sundojnë në tokat Muslimane do të bien; do të arrihet zhvillim kulturor dhe ekonomik; Muslimanët që vuajnë nga zgjedha, mizoria dhe madje kasaphanat gjakftohta, do të gjejnë paqe dhe siguri dhe një “Periudhë e Bekuar” e re do të bëhet realitet.



PSE UNIONI
ISLAMIK?

Shumë filozofë bashkëkohor mendojnë se e ardhmja e botës Islamike ka një ndikim të drejtpërdrejt në paqen dhe sigurinë botërore, sepse potencialisht është një fuqi serioze. Përafërsisht një e katërta e njerëzimit pason Islamin, tokat e tyre përmbajnë burime të pasura natyrore dhe i gjithë rajoni ka një rëndësi të madhe strategjike. Deri në Luftën e Dytë Botërore, shumica e vendeve Muslimane kanë qenë koloni Evropiane. Disa prej tyre është dashur të ndër marrin luftëra çlirimtare për të fituar pavarësinë e tyre. Kjo gjendje ka ndryshuar pamjen e gjeografisë Islamike. Megjithatë, ndryshimi i vërtetë ndodhi pasi që mori fund lufta e ftohtë. Deri atëherë, bota Islamike merrej në kuptimin e Afrikës, Lindjes së Mesme dhe Azisë; tani, ajo është shndërruar më tepër në një çështje Euro-aziatike me Shqipërinë dhe Bosnjën në Perëndim dhe Çeçeninë dhe Taxhikistanin, Kirgistanin dhe Kazakistanin në lindje. Në vitet e 1980-ta, Turqia ishte vendi i vetëm Islamik i përfaqësuar në Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE). Tani, nëntë vende Muslimane bëjnë pjesë aty: Shqipëria, Azerbajxhani, Bosnja dhe Hercegovina, Kazakistani, Kirgistani, Taxhikistani, Turqia, Turkmenistani dhe Uzbekistani.⁸

Ndryshimet e tilla në përhapjen demografike të botës Islamike kanë pasur ndikim në termin “gjeografia Islamike”. Deri në fillim të shekullit njëzet, përveç pushtimeve afatshkurtra, pjesa më e madhe e Muslimanëve jetuan në tokat Muslimane nën sundimin

THIRRJE PËR UNION ISLAMIK




Tunisia



Endonezja

The Islamic world, which covers a vast geographic area, enjoys great wealth, with abundant natural beauty being the foremost. Under the Turkish Islamic Union, the Islamic countries will put these resources to better use.



Bosnia-
Herzegovina



Iran



The United Arab Emirates



Albania

Po edhe nëse përpiqeni t'i numëroni dhuntitë (të mirat) e All-llahut, nuk do të mund të arrini t'i përcaktoni ato. Me siguri All-llahu shumë fal dhe shumë mëshiron.

(Kuran: 16/18) Tunus



Cibuti



THIRRJE PËR UNION ISLAMIK


Buddhism used to be widespread in the Maldives, a land known for its striking natural beauty. Later on, its people embraced Islam due to the missionary activities of Muslim travelers. Today, nearly all of its people are Muslims.



Harun Jahja (Adnan Oktar)



DISTRIBUTION OF MUSLIMS



Islam is the world's most rapidly spreading religion. This map shows the general distribution of Muslims.

Islamik. Që nga fillimi i shekullit njëzet e tutje, Muslimanët kanë migruar me dëshirë në Evropë dhe Amerikë, ku gradualisht u bën pakica të rëndësishme. Aktualisht, Islami është religjioni që ka rritjen më të shpejt në këto vende. Kjo ngritje u ka mundësuar këtyre Muslimanëve që të luajnë një rol më aktiv në shoqërinë dhe politikën Perëndimore.

Prandaj, gjeografia Islamike nuk i referohet vetëm vendeve me popullatë shumicë Muslimane apo vendeve që udhëhiqen nga Muslimanët, por përbëhet nga një rajon më i gjerë. Nga Kaukazi deri në Tanzani dhe nga Maroku e deri në Fixhi, bota Islamike tani shtrihet mbi një rajon të pafund dhe mbulon tokat që u dhanë shtytje qytetërimeve më madhështore në histori.

Kualitetet gjeopolitike, kulturore dhe gjeo-ekonomike e vendosin këtë gjeografi në agjendën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të politikës botërore madje edhe sot.

Udhëkryqet dhe rrugët transitore të tregtisë botërore ndodhen brenda këtij territori. Kur e marrim parasysh se kanalet dhe lidhjet e drejta që bashkojnë Detin e Zi dhe atë të Mesdheut, Detin e Mesdheut me Gjirin Persik dhe Gjirin Persik me Oqeanin Indian janë nën kontrollin e Muslimanëve, rëndësia e botës Islamike në aspektin e baraspeshës botërore bëhet më e kuptueshme. Veç kësaj, tokat më të pasura të botës, në aspektin e burimeve të tilla të rëndësishme strategjike si nafta dhe gazi natyror, ndodhen në vendet Muslimane. Përdorimi efikas i këtyre burimeve përfaqëson një mundësi strategjike për botën Islamike për të rritur ndikimin e saj në politikën botërore.

Gjendja e tanishme sugjeron qartë se Muslimanët do të kenë ndikim në zhvillimet e shekullit njëzet e një në një mënyrë apo tjetër. Mirëpo, ajo që vërtet ka rëndësi këtu është se nga ky ndikim duhet të përfitojnë bota Islamike në veçanti dhe njerëzimi në përgjithësi. Gjëja e parë që na bie në mend në këtë fazë është nëse bota Islamike mund të luaj një rol të tillë, duke pasur parasysh gjendjen e saj të tanishme. Megjithatë, nëse i hedhim një vështrim vendeve Muslimane sot vërejmë shumë probleme, në mesin e tyre mungesa e demokracisë stabile, paaftësia për ta mbajtur hapin me përparimin teknologjik dhe një ekonomi e pazhvilluar. Një botë Islamike që bëhet gati për të luajtur një rol aktiv në politikën botërore duhet së pari t'i zgjidhë këto dhe probleme të ngjashme me to.

Mungesa e unitetit dhe copëzimi i botës Islamike është madje një çështje më urgjente dhe problem më jetik që duhet të zgjidhet. Fakti se Muslimanët nuk kanë qenë në gjendje të

THIRRJE PËR UNION ISLAMIK

Oil complexes in the United Arab Emirates and Saudi Arabia.





krijonjë
një Union Islamik aktiv
dhe të fuqishëm është një
ndër kontribuuesit kryesor për
shumicën e të këqijave të sotme.
Kur të formohet një Union
Islamik i fuqishëm,
problemet e tilla ose nuk do të
shfaqen ose do të zgjidhen shumë më
shpejtë se që mund të parashikohet.

Duhet të konstatojmë këtu se
shumëllojshmëria që gjendet në botën Islamike, si edhe
ekzistenca e shkollave të ndryshme të mendimit Islamik, nuk
paraqet ndonjë problem në këtë aspekt. Gjithashtu, Unioni nuk
është i barabartë me praktikën apo sistemin e njëjtë. Për më tepër,
kjo shumëllojshmëri duhet të bashkohet nën ombrellën e besimit
dhe mbi bazën e tolerancës dhe solidaritetit reciprok. Dallimet në
mendime, praktikë apo pikëpamje janë normale dhe të
zakonshme në të gjitha shoqëritë. Parimet morale Islamike
kërkojnë që Muslimanët të mos harrojnë kurrë se ata të gjithë janë
vëllezër dhe motra, pa marr parasysh dallimet e tyre. Çfarëdo
qoftë raca, gjuha, kombi apo dega e Islamit që një njeri mund ta
pasojë, të gjithë Muslimanët janë vëllezër dhe motra. Prandaj,
dallimet e tilla duhet të vlerësohen si burim i pasurisë e jo të
merren si burim i konfliktit apo ndarjes së mundshme. Një
pikëpamje e tillë e gabuar vetëm largon vëmendjen e njeriut prej
çështjeve reale dhe vonon veprimin e rëndësishëm parandalues
dhe urgjentisht të nevojshëm.

Harun Jahja (Adnan Oktar)



THIRRJE PËR UNION ISLAMIK

Kapitujt pasues do të merren me nevojën për një Union Islamik dhe se çfarë do të nënkuptojë ai për paqen botërore, nga perspektiva ekonomike, sociologjike dhe politike. Mirëpo, ne duhet së pari ta hulumtojmë procesin që çoi deri në shpërbërjen e botës Islamike dhe mënyrën se si ky zhvillim mund të kthehet mbrapsht.

Shkaqet e ndarjes

Bota Islamike filloi të shpërbëhej gjatë fillimit të shekullit njëzet. Deri atëherë, Muslimanët me bindje të ndryshme sektariane, të racave dhe gjuhëve të ndryshme jetonin së bashku në harmoni dhe siguri nën sundimin e Islamit dhe ishin të fuqishëm.

Njëra prej lëvizjeve më shkatërrimtare të shekullit nëntëmbëdhjetë, **nacionalizmi radikal**, kishte ndikim të fuqishëm në botën Islamike, sepse disa Muslimanë ranë nën ndikimin e ideologjive Perëndimore që u imponuan atyre. Me dobësimin dhe pastaj rënien e Perandorisë Otomane, pjesa më e madhe e tokave Muslimane u kolonizuan nga Evropa dhe Bashkimi Sovjetik. Para se kolonialistët të tërhiqeshin nga këto toka dekada më vonë, ata hartuan kufij artificial dhe në këtë mënyrë krijuan shumë shtete të reja. Kur kjo u ndërthur me nacionalizmin radikal të përhapur midis Muslimanëve, ky rajon u shndërrua në një moçal. Dallimet etnike u bënë burim i konfliktit dhe grupet e ndryshme etnike Muslimane, të cilat kishin jetuar në të njëjtin vend deri vonë, papritur filluan të jetonin në anë të ndryshme të këtyre kufijve artificial. Së shpejti, këto kombi artificiale filluan të zihen me njëra tjetrën për shkak të kufijve dhe çështjeve tjera, dhe lindën ndjenjat e armiqësisë. Disa prej këtyre grindjeve madje u përshkallëzuan në luftëra brutale të shkallës së gjerë, siç është rasti me luftën Iran-Irak. Kishte filluar një periudhë 100 vjeçare e paqëndrueshmërisë.

Dashuria e një njeriu për kombin, popullin dhe pavarësinë është një ndjenjë me vend dhe e respektueshme. Megjithatë, nacionalizmi bëhet i padurueshëm kur dashuria shndërrohet në fanatizëm. Nëse dikush ka ndjenja armiqësore ndaj kombeve tjera pa një arsye të duhur, ai, për interes të vendit të tij, do t'i

THIRRJE PËR UNION ISLAMIK

shpërfill të drejtat e kombeve apo popujve tjerë. Si rezultat i kësaj, një vend do të përpiqet të marr apo grabit tokën e vendit tjetër dhe në këtë mënyrë bëhet i padurueshëm. Në të njëjtën mënyrë, nëse njerëzit dashurinë e tyre për kombin e vet e kthejnë në racizëm, duke pohuar se janë më superior gjenetikisht, ata do të kenë zhvilluar një ide të paligjshme. Po ashtu, është gabim që nacionalizmi të shndërrohet në ideologji raciste, sepse kjo dëmton parimin Islamik se “të gjithë Muslimanët janë vëllezër dhe motra”, apo të lejohet që armiqësia ta vras atë përgjithmonë.



The twentieth century was one of oppression, violence, war, and conflict. Millions of innocent people lost their lives.

Zoti nxjerr në pah këtë qëndrim të gabuar, të njohur si “zemërim fanatik,” dhe shpall se ky është një aspekt i mosdijes. Në kontekstin Islamik, mosdija nënkupton njerëzit dhe shoqëritë që janë të larguara shumë nga feja e vërtetë, siç bëhet e qartë në Kur'an:

Dhe, kur në zemrat e mohuesve u shfaq zelltaria pagane, Allahu zbriti qetësinë e Tij në zemrën e të Dërguarit të Tij dhe të besimtarëve e i bëri ata të mbështeten fort në fjalën e përkushtimit (ndaj Allahut). Ata kishin më të drejtë e qenë më të denjë për të. Allahu është i Gjithëdhijshëm për çdo gjë. (Kur'an, 48:26)

Ky ajet flet për zemërimin fanatik në njërën anë dhe se Zoti zbriti qetësi mbi besimtarët në anën tjetër,. Gjendja shpirtërore e njerëzve të cilët zemërohen dhe bëhen agresiv për shkak të dashurisë ndaj kombit të tyre është në kundërshtim me parimet



THIRRJE PËR UNION ISLAMIK

morale Islamike. Nacionalizmi që u zhvillua në Evropën materialiste të shekullit nëntëmbëdhjetë ishte agresiv dhe radikal. Fatkeqësisht, ai ishte një formë e nacionalizmit që u bart në botën Islamike dhe në shumë vende tjera, ku nuk solli asgjë tjetër pos konfliktit dhe paqëndrueshmërisë politike.

Është në kundërshtim me parimet morale Islamike të bëhet dallim në mes të njerëzve në baza racore apo të lejohet që dallimet etnike të shkaktojnë konflikt. Zoti ynë në një ajet thotë:

All race-based theories, such as those adopted by Hitler, are great misconceptions. No race is inherently better or superior to another.





O njerëz! Në të vërtetë, Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë popuj e fise, për ta njohur njëri tjetrin. Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij. Vërtet, Allahu është i Gjithëdijshëm dhe për Atë asgjë nuk është e fshehtë. (Kur'an, 49:13)

Zoti po ashtu shpall se dallimet racore dhe kombëtare janë prej argumenteve të Tij. Këto dallime nuk duhet të jenë burim konflikti apo armiqësie, por më tepër burim i pasurisë dhe i shumëllojshmërisë:

Ndërmjet shenjave të Tij janë krijimi i qiejve e i Tokës dhe shumëllojshmëria e gjuhëve dhe e ngjyrave (racave) tuaja. Pa dyshim, në këtë ka shenja për ata që dinë. (Kur'an, 30:22)

Historia është përplot me shembuj të aftësisë së Islamit për t'i zgjidhur dallimet etnike. Profeti ynë (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) i paralajmëroi Shokët e tij që t'iu shmangen ndasive fisnore apo racore; ndarjes së njerëzve sipas

racës, gjinisë, gjuhës apo fisit; dhe dallimit midis njerëzve sipas pasurisë. Në Hutben e tij Lamtumurëse, ai deklaroi: “O njerëz! Vërtet Zoti juaj është një dhe babai juaj është një. Të gjithë ju jeni pasardhës të Ademit dhe Ademi u krijua prej dheut. Një Arab nuk është më i mirë se një jo-arab dhe një jo-arab nuk është më i mirë se një Arab, as një i bardhë më i mirë se një i zi dhe as një i zi më i mirë se një i bardhë, përveç se [sa i përket] devotshmërisë. Vërtet, më fisniku nga mesi juaj është ai që është më i devotshmi.”⁹

Pushtimet e vazhdueshme nën sundimin e Profetit tonë (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) dhe të katër kalifëve të udhëzuar drejt zgjeruan shumë kufijtë e botës Islamike dhe shumë kombe të ndryshme u bashkuan nën flamurin e Islamit. Lindja e Mesme, që deri atëherë ishte dëshmitare e shumë luftërave fisnore dhe gjakmarrjeve të rrepta, gjeti paqe dhe luftërat fisnore ndër-arabe ndaluan si brenda ashtu edhe



Harun Jahja (Adnan Oktar)



"Collision of Arab Horsemen." Oil painting on canvas,
The Walters Art Gallery, Maryland.

jashtë. Konfliktet e vazhdueshme në mes të sekteve të Krishtera u zgjodhën në mënyrë paqësore dhe fiset që kishin qenë armiq për vdekje mësuan t'i respektojnë të drejtat e njëri tjetrit dhe jetuan nën flamurin Islamik.

Muslimanët e sotëm duhet të zhvillojnë të njëjtin botëkuptim. Besimi dhe karakteri i mirë janë të rëndësishëm kur bëhet fjalë për raportet e tyre të ndërsjella, jo raca, origjina etnike, gjuha, gjendja financiare, pozita apo vendi i punës. Dashuria në mes të besimtarëve të sinqertë zhvillohet përmes frikës dhe vetëdijes për Zotin dhe dashurinë e vërtetë për Zotin dhe për veprat e mira dhe një karakter të mirë. Nëse njerëzit i përkushtohen rrugës së Zotit, e pasojnë atë me të gjitha veprimet dhe sjelljen e tyre dhe bëjnë vepra të mira me shpresën që të fitojnë kënaqësinë dhe mëshirën e Zotit, besimtarët e tjerë do t'i duan dhe respektojnë ata. Si rezultat i kësaj, ngjyra e tyre e lëkurës, raca apo pozita financiare nuk do të kenë rëndësi dhe nuk do të ndikojnë në dashurinë që të tjerët ndiejnë për ta. Kriteret e njëjta duhet të vlejnë për marrëdhëniet në mes të kombeve Muslimane, të cilat duhet të mbështeten në mendjehollësinë Kur'anore që Muslimanët janë ndihmues dhe mbrojtës të njëri tjetrit.

Njëra prej arsyeve kryesore për ndarjen e tanishme të botës Islamike është mungesa e kësaj vetëdije, nënvleftësimi i parimeve morale Islamike dhe ndikimi i ideologjive dhe lëvizjeve jofetare. Disa intelektual u çorientuan prej filozofive dhe ideologjive të ndryshme Evropiane, të cilat ishin përplot me gabime dhe besonin se futja e tyre në botën Islamike do ta ndihmonte përparimin e saj. Dëmi i shkaktuar nga ky gabim historik mund të vërehet edhe sot. Në vend të drejtësisë, devotshmërisë, dhembshurisë, tolerancës, mungesës së paragjykimeve dhe të menduarit përparimtar që nxitën vlerat e Kur'anit, përpjekja e imponimit të filozofive dhe ideologjive të rrejshme zëvendësuan rendin dhe solidaritetin e botës Islamike me kaos dhe përçarje. Në disa vende, për t'i dhënë fund kaosit, u zhvilluan modele që janë në kundërshtim me vlerat e Kur'anit. Mirëpo, kjo vetëm solli në jetë regjimet despotike që shtypën popullin.

Është e rëndësishme të mësojmë nga këto gabime të së kaluarës kur bëjmë përzgjedhjen e një strategjie të re dhe të jemi të vetëdijshëm për manipulimet dhe sugjerimet çorientuese. Historia na tregon qartë se bota Islamike mund të ngrihet përsëri vetëm nëse u kthehet vlerave dhe parimeve të saj qendrore, duke qenë uniteti dhe solidariteti Musliman më e rëndësishmja prej tyre.

Shembull nga historia: Unioni Islamik i Salah ud-Din al-Ejjubi (Saladinit)

Qëndrimi i botës Islamike ndaj kryqtarëve është një shembull i rëndësishëm në këtë aspekt. Kur ushtritë e Kryqëzatës së Parë arritën në Lindjen e Mesme, Muslimanët ishin të ndarë në fraksione që buronin nga konflikte dhe arsye të ndryshme. Kjo përçarje u pamundësoi atyre të bënin rezistencë efikase dhe kështu pushtuesit barbar Evropian ishin në gjendje të krijonin një perandori me qendër në Jerusalem pasi që masakruan popullatën vendase. Mirëpo, disa dekada më vonë, komandanti Musliman Saladini bashkoi grupet e ndryshme Muslimane nën komandën e tij dhe i mposhti pushtuesit.


Megjithatë, mposhtja e kryqtarëve nuk do të ndodhte brenda natës. Saladini jo



vetëm që bashkoi Muslimanët nën një flamur, por po ashtu filloi një vetëdijesim shkencor dhe moral. shkruan *Encyclopedia Britannica*:

Inkurajimi i shtimit dhe përhapjes së institucioneve fetare Muslimane ishte pjesë thelbësore e politikës së tij (Saladinit). Ai i inkurajonte dijetarët dhe predikuesit e fesë, themeloi kolegje dhe xhami për përdorimin e tyre dhe i autorizoi ata të shkruajnë vepra që ngritin moralin ... Përmes ripërtëritjes morale që ishte pjesë e vërtetë e mënyrës së tij të jetës, ai u përpoq ta rikrijojë, në mbretërinë e tij, një pjesë të përkushtimit dhe entuziazmit që ishte dëshmuar aq me vlerë për gjeneratat e para të Muslimanëve kur, pesë shekuj më parë, e kishin pushuar gjysmën e botës së njohur.¹⁰

A painting showing the Crusaders' 1099 massacre and destruction during their invasion of Jerusalem.



THIRRJE PËR UNION ISLAMIK

Kur ky rigjenerim moral, shkencor dhe fetar u ndërthur me unionin politik, qytetërimi Islamik rilindi edhe njëherë. Saladini, duke komanduar një ushtri të bashkuar Islamike, u shkaktoj disfatë kryqtarëve të shpërndarë dhe të demoralizuar në Betejën e Hatinit në vitin 1187 dhe çliroi pothuajse të gjitha tokat e pushtuara Palestineze, përfshirë Jerusalemin.

Njëri prej aspekteve më të rëndësishme të Unionit Islamik të Saladinit ishte se ai përfaqësonte idealet Kur'anore të drejtësisë, përmbajtjes dhe paqedashjes. Edhe pse më së shumti njihet për këtë fitore ushtarake, Saladini ishte gjithashtu shumë falës dhe i drejtë ndaj kryqtarëve si edhe ndaj të Krishterëve tjerë. Edhe pse kryqtarët kishin bërë mizori që s'mund të përshkruhen me fjalë mbi Muslimanët, Saladini nuk kërkoi hakmarrje ndaj tyre dhe

The borders of the Ayyubid Sultanate before and after Saladin's reign.



asnjë civil nuk u dëmtua kur ai çliroi Jerusalemin. Veç kësaj, ai mbajti autoritetin e tij mbi radikalët në mesin e njerëzve të tij. Pas masakrës së 3,000 civilëve të pafajshëm Muslimanë në Kështjellën e Akres, të urdhëruar nga Mbreti Riçard Zemërluani, komandanti i Kryqëzatës së Tretë, disa Muslimanë kërkuan hakmarrje: Ata donin t'i masakronin të Krishterët e Xhafasë (Tel Avivit të sotëm). Saladini i qetësoi ushtarët e tij me sukses dhe shoi etjen e tyre për gjak dhe kështu ju garantoi siguri të Krishterëve të Xhafasë.

Në fund, Saladini solli paqe në Tokën e Shenjtë duke iu dhënë kryqtarëve disa privilegje dhe duke iu bërë disa lëshime. Më 28 Gusht 1192, të dyja palët u pajtuan dhe nënshkruan një marrëveshje paqësore. Saladini bëri një gjest madhështor: Ai i ftoi komandantët e kryqtarëve, të cilët kishin vrarë me mija Muslimanë në përpjekjen e tyre për të pushtuar Jerusalemin, të qëndrojnë aty si mysafirët e tij. Ata kryqtarë që vizituan Jerusalemin u mahnitën nga falja, toleranca dhe drejtësia madhështore e Muslimanëve. Me një rast, pasi që mësoi se armiku i tij i mëparshëm Mbreti Riçard ishte i sëmurë, Saladini dërgoi për ta shëruar mjekun e tij, si dhe i dërgoi akull për t'ia zbritur temperaturën që kishte. Saladini u shndërrua në legjendë në Evropë për karakterin e tij të drejtë, i cili bazohej në vlerat e Kur'anit.

Thënë shkurt, Unioni Islamik i Saladinit u dhuroi Muslimanëve pushtet dhe fitore, si edhe mundësinë për të vendosur drejtësi, tolerancë dhe paqe që përbëjnë bazën e parimeve morale Islamike. Muslimanët u nxitën për t'i shërbyer Islamit, për ta ndaluar përhapjen e disa lëvizjeve radikale në mesin e Muslimanëve dhe për të jetuar në pajtim me Kur'anin.

Kanë kaluar tetë shekuj që nga koha e atij Unioni Islamik.

Muslimanët e sotëm kanë nevojë për një Union Islamik për të njëjtat arsye për të cilat kishin nevojë atëherë. Edhe pse bota Islamike nuk është nën sulmin e një ushtrie të një koalicioni, siç ishte në kohën e kryqëzatave, ajo po ballafaqohet me shumë kërcënime. Për më tepër, bota Islamike ka mbetur prapa qytetërimeve tjera sa i përket shkencës, teknologjisë, kulturës, artit dhe mendimit. Që nga shekulli nëntëmbëdhjetë, bota Islamike është dëmtuar seriozisht prej shumë ideologjive dhe filozofive të rrejshme të krijuara tjetërkund, të importuara në mesin e saj nga njerëzit e larguar nga udha e drejtë dhe u përhap në mesin e atyre të cilët nuk i kishin të njohura vlerat e Kur'anit. Në anën tjetër, disa radikal të cilët pohojnë se përfaqësojnë Islamin përderisa bëjnë çmos për të përmbysur parimet e tij morale, shpeshherë pa dashje u ndihmuan atyre të cilët me vetëdije po mbjellnin farën për konflikt të mëvonshëm.

Që e gjithë kjo të marr fund, Muslimanët duhet ta rindërtojnë qytetërimin e tyre në mënyrë që edhe njëherë ta udhëzojnë botën, ta ndriçojnë rrugën, dhe ta sjellin paqen dhe drejtësinë. Por që ky vizion të bëhet realitet, ata duhet ta ndjekin rrugën e Saladinit: të punojnë për rilindjen e parimeve morale, dijes dhe besimit Islamik dhe ta arrijnë Unionin politik të botës Islamike.

Bashkimi nëpërmjet respektimit të dallimeve

Domosdoshmëria për një Union të tillë bazohet jo vetëm në nevojën për një zgjidhje politike për t'i dhënë fund situatës së tanishme; më saktë, e që është më e rëndësishme, uniteti është një kusht i të qenit Musliman. Si në të gjitha fushat e jetës së tyre, Muslimanët duhet të veprojnë në përputhje me vlerat e Kur'anit në politikat e tyre kombëtare dhe ndërkombëtare. Pasi që këto

parime morale kërkojnë ribashkimin e botës Islamike si prioritet, marrja e parimeve morale Islamike si parim udhërrëfyes do ta mundësoj këtë aleancë, si edhe do ta bëj jetëgjatë dhe aktive.

Parimet morale Islamike kërkojnë që Muslimanët të jenë gjithmonë pajtues dhe të jenë vëllezër dhe motra në besim, si edhe në solidaritet dhe bashkim. Zoti i urdhëron besimtarët që të: **“mos grinden ndërmjet vete”** (Kur'an, 8:46), sepse duke vepruar kështu, kjo vetëm se do t'i dobësoj ata. Një ajet tjetër urdhëron si vijon:

Mos u bëni si ata që, pasi u erdhën provat e qarta, u përçanë dhe u grindën. Për këta do të ketë dënim të madh. (Kur'an, 3:105)

Është e pamundshme që Muslimanët të cilët kanë mendje dhe ndërgjegje të shëndoshë të mos bashkohen me besimtarët tjerë apo të jenë të përfshirë në një konflikt të vazhdueshëm me ta. Kjo është e vërtetë në baza individuale, si edhe në rrafshin e bashkësive dhe kombeve. Zoti e nxjerr në pah këtë fakt në Kur'an dhe iu ndalon kombeve Muslimane të jenë të padrejta dhe armiqësore ndaj njëra tjetrës. Kur'ani shpall se ata të cilët bëhen pjesë e veprimeve të tilla të dëmshme duhet të ndalohen dhe i udhëzon kombet tjera Muslimane që të “vendosin paqe në mes tyre”:

Nëse dy palë besimtarësh bëjnë luftë midis tyre, pajtojini ata. Por, nëse njëra palë sulmon tjetrën, atëherë luftoni kundër sulmuesit, derisa të kthehet në urdhrat e Allahut. E, nëse kthehet, atëherë pajtojini ata midis tyre, me drejtësi dhe paanësi, sepse Allahu i do ata që veprojnë me drejtësi. (Kur'an, 49:9)

Natyrisht, mund të ketë dallime sa i përket qëndrimit dhe praktikës kulturore, tradicionale dhe lokale në mes të kombeve

O ju njerëz, vërtetë Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s'ka dyshim se te All-llahu më i ndershmi ndër...



...ju është ai që më tepër
është ruajtur (këqijat) e
All-llahu është i dijshtëm
dhe hollësisht i njohur
për çdo gjë.
(Kuran: 49/13)

Chapel at Bethlehem,
Thomas Allom

Muslimane për arsye të pikëpamjeve, interpretimeve të ndryshme dhe shkollave të mendimit. Gjërat e tilla janë të natyrshme. Mirëpo, këto dallime nuk do të duhej të ndikonin që kombet Muslimane t'i kundërvihen njëra tjetrës, t'i japin fund dialogut të ndërsjellë dhe ta konsiderojnë kombin tjetër si të huaj dhe armiqësor, në vend se të pajtohen për vlerat e tyre të përbashkëta. Të vepruarit e tillë vetëm shpie drejt situatave të patolerueshme.

Zoti paralajmëron Muslimanët që të largohen prej gabimeve dhe zbulon gabimet e Ithtarëve të Librit (Çifutëve dhe të Krishterëve) në këtë aspekt si shembull se çfarë mund të ndodhë. Kur'ani shpall në ajetin 98:4 se ata u përçanë në mes vete dhe morën drejtimin e tyre, edhe pse u erdhën Dëshmi të Qarta për të kundërtën. Ajetet tjera shpallin se arsyet e kësaj përçarjeje ishin tiparet e liga të karakterit si zilia, padrejtësia dhe kryengritja kundër të vërtetës. Në vazhdim pasojnë disa prej këtyre ajeteve:

Sidoqoftë, ata u përçanë midis tyre prej smirës, vetëm pasi u erdhi dijenia... (Kur'an, 42:14)

Feja e vërtetë tek Allahu është vetëm Islami. Ata që u është dhënë Libri, patën mospajttime nga zilia që kishin midis tyre, vetëm pasi u erdhi dituria. Por kushdo që i mohon udhëzimet e Allahut, ta dijë se Allahu është i shpejtë në llogari. (Kur'an, 3:19)

Historia Hebreje dhe e Krishterë është përplot me konflikte për shkak të kësaj përçarjeje të vazhdueshme. 16 shekujt e parë të Krishterimit mund të përshkruhen gjithashtu si histori e sekteve të krishtera që ishin në luftë me njëra tjetrën. Madje edhe dallimet e vogla në interpretim çuan në akuza të ndërsjella për herezi. Me kalimin e kohës, Kisha Katolike mori primatin dhe filloi t'i persekutojë shkollat tjera të mendimit fetar që ajo i

konsideronte si heretike, siç janë Docetizmi, Montanizmi, Adopcionizmi, Sabelianizmi, Arianizmi, Plagjarizmi dhe Gnosticizmi. Persekutimi nga ana e Kishës Katolike i besimeve të tilla fetare si Katarët dhe Bogomilët që nga shekulli i njëmbëdhjetë e këndej, si edhe lufta e përgjakshme njëshekullore midis Protestantëve dhe Katolikëve, përkojnë me epokën më të errët të historisë Evropiane. Është e rëndësishme të përmendim se qytetërimi Evropian filloi të pësoi ngritje pasi që mori fund kjo luftë sektare. Siç pranojnë shkencëtarët politik, Evropa moderne lindi vetëm pasi sektet e ndryshme të Krishtera u pajtuan për tolerancë të ndërsjellë në Paqen e Vestfalias në vitin 1648.

Njerëzit ndahen në praktikat dhe në të kuptuarit e tyre fetar, sepse nuk praktikojnë parimet morale, ashtu siç janë të urdhëruar nga Zoti. Ky moral njihet modestinë. Ata të cilët distancohen nga kjo modesti, i kuptojnë idetë e tyre si të vërtetën përfundimtare, shpërfillin ata të cilët mendojnë ndryshe dhe ndiejnë armiqësi ndaj tyre. Pasi që ata nuk dyshojnë në vërtetësinë e pikëpamjeve të tyre, nuk vënë në dyshim vetveten dhe në këtë mënyrë nuk mund të përmirësohen dhe ta gjejnë të vërtetën. Kur'anit përshkruan ata të cilët vlerësojnë vetëm bindjet e tyre si vijon:

Por ata (popuj ku u çuan të dërguarit) u ndanë në grupe në çështje të fesë së tyre. Çdo grup ishte i kënaqur me atë që kishte. (Kur'an, 23:53)

Muslimanët të cilët ndiejnë frikë-respekt ndaj Zotit dhe të cilët besojnë se do të japin përgjegjësi për veprimet e tyre në Ditën e Gjykimit, duhet të jenë të vetëdijshëm për këtë gjendje. Ata të cilët e kuptojnë rëndësinë e kësaj çështje duhet t'iu tërheqin vërejtjen Muslimanëve tjerë për rreziqet e përçarjes, copëtimit dhe ndarjes dhe të punojnë për unitetin e Muslimanëve sipas vlerave të Kur'anit.

Muslimanët shembullor u afrohen të tjerëve me dashuri, dhembshuri dhe mëshirë, sepse ata i shohin të gjithë njerëzit si manifestim të disa prej emrave dhe vetive të Zotit tonë. Ata i konsiderojnë të gjithë njerëzit të cilët ndajnë besimin e njëjtë dhe të cilët besojnë në Kur'an, i binden urdhrave të Zotit dhe veprojnë në përputhje me Sunnetin e Profetit tonë (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të), si vëllezër dhe motra të tyre dhe nuk harrojnë kurrë se janë mbrojtës të njëri tjetrit. Ata duhet të përmbahen nga fraksionizmi i rrënjosur në pikëpamjet kulturore, tradicionale apo nga dallimet në pikëpamje dhe, në vend se të krijojnë një çështje kurdo që t'iu jepet mundësia, duhet të përkrahin unitetin sipas vlerave të Kur'anit. Muslimanët duhet të mbështesin njëri tjetrin në këtë union dhe të jenë tolerant dhe të kenë mirëkuptim kur kanë të bëjnë me çështje kontestuese. Siç e përmendëm më parë, Muslimanët e sinqertë të cilët janë të vetëdijshëm për rëndësinë e kësaj çështje, si edhe mendimtarët dhe intelektualët kryesor të botës Islamike, janë të obliguar në veçanti të punojnë me vendosmëri për solidaritetin dhe unitetin Musliman. Në botën

Muslimane
duhet të vendoset një
solidaritet i mbështetur në
dashuri, respekt, dhembshuri
dhe tolerancë.

Në thelbin e vet, parimet morale Islamike
përmbajnë unitetin fetar dhe vlerat e përbashkëta,
e jo kundërshtimet dhe ndarjen. Profeti
Muhammed (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin
mbi të) ju ka treguar rrugën që duhet ndjekur
Muslimanët me anë të hadithit vijues:

Në mesin tuaj kam lënë Librin e Zotit dhe Sunnetin
e të Dërguarit të Tij. Nëse mbaheni fort për to, kurrë nuk
do të humbni.¹¹

Ne duhet vetëm të veprojmë në përputhje me këtë këshillë.
Zoti ynë i urdhëron të gjithë besimtarët ta pasojnë fenë e vërtetë
dhe t'i shmangen përçarjes. Zoti thotë:

**Ai ka urdhëruar për ju atë Fe, të cilën ta zbuloi ty (o
Muhamed) dhe që pati urdhëruar për Nuhun, Ibrahimin,
Musain dhe Isain, duke thënë: "Qëndroni në fenë e drejtë
dhe mos u përçani në të!" Por për idhujtarët është e rëndë
ajo, në të cilën po i fton ti. Allahu zgjedh për këtë fe kë të
dojë dhe udhëzon drejt saj këdo që kthehet tek Ai me
pendim. (Kur'an, 42:13)**

Dhe kapuni që të gjithë ju për
litarin (fenë dhe Kur'anin) e
All-llahut, e mos u përçani!
Përkujtojeni nimetin e All-llahut
ndaj jush, kur ju (para se ta
pranonit fenë islame) ishit të
armiqësuar, e Ai bashkoi zemrat
tuaja dhe ashtu me dhuntinë e Tij
aguat të jeni vëllezër...

...Madje ishit në buzë të
greminës së xhehennemit, e Ai ju
shpëtoi prej tij. Po kështu
All-llahu ua sqaron juve
argumentet e veta që ju të gjeni
të vërtetën e lumtur.
(Kuran: 3/103)

Humayun's Tomb,
India. One of
the most important
works of the
Mughal Empire.

Forcimi i ndjenjës së unitetit

Uniteti kërkon vetëdije, përkushtim, besnikëri dhe devotshmëri. Zoti urdhëron unitetin për Muslimanët dhe zbulon se Shejtani do të përpiqet të krijoj konflikt për të ndaluar këtë unitet. Muslimanët janë të obliguar të përmbahen nga fjalët lënduese, zemërimi, mosrespektimi dhe çfarëdo lloj sjelljeje që mund ta dëmtoj këtë ndjenjë të unitetit kur kanë të bëjnë me vëllezërit Muslimanë. Nga secili Musliman kërkohet të jetë i përkushtuar ndaj të tjerëve, të jetë i durueshëm, të punoj për të mirën e të tjerëve dhe të jetë besnik dhe i sinqertë. Të gjithë Muslimanët duhet t'i përvetësojnë këto veti të larta.

Shembull i mirë për këtë është raporti në mes të atyre Muslimanëve të cilët migruan në Medine me Profetin tonë (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) dhe atyre Muslimanëve të cilët tashmë ishin vendosur atje. Muslimanët të cilët iu zotuan për besnikëri Profetit tonë (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) i mirëpritën në Medine të shpërngulurit Mekas për hir të Zotit në mënyrën më të mirë të mundshme dhe u kujdesën shumë mirë për ta. Këto dy bashkësi të ndryshme, të cilat nuk kishin lidhje të ndërsjellë fisnore, e konsideronin besnikërinë ndaj Islamit si matësin e vetëm të rëndësishëm. Muslimanët e Medinës dëshmuan besnikërinë e tyre duke hapur dyert e shtëpive të tyre, duke ndarë ushqimin e tyre dhe duke i vënë nevojat e të shpërngulurve përpara nevojave të tyre. Zoti ynë zbulon sjelljen e mirë të tyre në Kur'an:

Ndërsa ata që banojnë në Medinë dhe që e kanë pranuar besimin qysh më parë, i duan mërgimtarët që vijnë në Medinë dhe në zemrat e tyre nuk ndjejnë kurrfarë rëndimi, për atë, që u është dhënë atyre, por duan t'u bëjnë më mirë mërgimtarëve se sa vetes, edhe pse vetë janë nevojtarë.

Kushdo që ruhet nga lakmia e vetvetes, me siguri që do të jetë fitues. (Kur'an, 59:9)

Karakteri shembullor dhe superior i shfaqur në këtë ajet zbulon se çfarë duhet të jetë marrëdhënia në mes të dy bashkësive Muslimane. Profeti ynë (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) përshkruan solidaritetin në hadithin vijues:

Muslimanët janë sikur një trup. Nëse një sy dhemb, i tërë trupi ndien dhimbje; nëse dhemb koka, i tërë trupi ndien dhimbje.¹²



"The city of Faytoun." Paul Renoir, Mathaf Gallery, London.

Dashuria në mes të Muslimanëve dhe mungesa e çfarëdo keqdashjeje janë dhurata të mëdha të Zotit. Kur'ani thotë si vijon për këtë dhunti, e cila do të përmbushet plotësisht në Parajsë:

Ne do ta heqim urrejtjen nga zemrat e tyre; ata do të rrinë ulur si vëllezër përballë njëri-tjetrit në divane. (Kur'an, 15:47)

Prandaj, Muslimanët duhet të veprojnë duke qenë të vetëdijshëm se solidariteti, vëllazëria dhe një ndjenjë përkatësie janë dhurata që duhet mbrojtur me anë të durimit dhe vullnetit të fortë. Ajeti në vazhdim zbulon po ashtu rëndësinë e këtij uniteti:

Prandaj, frikësojuni Allahut, rregulloni marrëdhëniet midis jush dhe bindjuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij, nëse jeni besimtarë të vërtetë". (Kur'an, 8:1)

Profeti ynë (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) thekson rëndësinë e unitetit në hadithin vijues:

Mos kini zili njëri tjetrit, mos urreni njëri tjetrit, mos ia ktheni shpinën njëri tjetrit dhe mos dëmtoni njëri tjetrit. Më mirë, O robër të Zotit, jini vëllezër...¹³

Muslimanët janë gjithmonë të obliguar të jenë falës, por nëse grupi tjetër përbëhet prej Muslimanëve, grupi i parë duhet të jetë madje edhe më i durueshëm. Ata duhet të kujtojnë se grupi i dytë përbëhet prej vëllezërve Muslimanë dhe se të dyja palët e kanë frikë Zotin, i binden Profetit (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të), dhe veprojnë në përputhje me përkufizimet e Kur'anit për të drejtën dhe të gabuarën. Të gjithë Muslimanët e dinë se ata duhet të kenë dashamirësi për vëllezërit e tyre Muslimanë; se duhet të jenë të kujdesshëm dhe se duhet të përgjigjen me durim, dhembshuri dhe dashuri kur lindin mosmarrëveshjet. Kur'ani shpall lutjen e Muslimanëve për

**Dhe respektojeni
All-llahun e të dërguarin
e Tij, e mos u përçani
mes vete e të dobësoheni
e ta humbni fuqinë
(luftarake). Të jeni të
durueshëm se All-llahu
është me të durueshmit.
(Kuran: 8/46)**

"Interior of the Mosque of the Metwalys,"
by British painter David Roberts.

vëllezërit e tyre Muslimanë:

Edhe ata që erdhën pas tyre, thonë: "O Zoti ynë, falna neve dhe vëllezërit tanë, të cilët kanë besuar para nesh dhe mos lejo që në zemrat tona të ketë asnjë të keqe ndaj besimtarëve! O Zoti ynë, Ti je vërtet i Butë dhe Mëshirëplotë!" (Kur'an, 59:10)

Pikërisht siç janë Muslimanët të obliguar të ndërmjetësojnë për miqësi mes tyre, ata janë të obliguar të zgjedhin çfarëdo konflikti midis dy bashkësive Muslimane. Zoti thotë:

Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër, andaj pajtojini vëllezërit tuaj midis tyre dhe kijeni frikë Allahun, në mënyrë që ju të mëshiroheni. (Kur'an, 49:10)

Është e qartë se ky mentalitet krijon një ndjenjë të fuqishme përkatësie dhe uniteti, sepse Zoti ynë thotë:

Vërtet, Allahu i do ata që luftojnë në rrugën e Tij, të radhitur si të ishin një ndërtesë solide. (Kur'an, 61:4)

Kjo luftë ideologjike kundër filozofive dhe ideologjive jofetare është detyrë e gjithë Muslimanëve. Pa dyshim, është gabim historik të zhvillohet një komunitet i mbyllur që merret me çështje të brendshme në vend se të mbahet mbi supë përgjegjësia që kjo luftë ideologjike të sjell dritë në një botë përndryshe të errët. Tani, njerëzimi, e në veçanti Muslimanët e shtypur po gjurmojnë për një rrugëdalje nga kjo situatë dhe po presin për një udhëzim që do të sjellë paqe, lumturi dhe drejtësi në botë dhe do t'i përkujtoj njerëzit për qëllimin e vërtetë të ekzistencës së tyre. Ky udhëzim është përgjegjësi e bashkësisë Islame dhe të gjithë Muslimanët janë të obliguar të veprojnë në mënyrë të ndërgjegjshme.

Fakti se dhuna, terrori, mizoria, mashtrimi, pandershmëria, amoraliteti, konflikti dhe varfëria janë të zakonshme dëshmon se

e gjithë bota është përplot me “korrupsion.” Shumë çështje që janë shndërruar në problem midis Muslimanëve humbin rëndësinë e tyre përballë këtij realiteti. E gjithë kjo mizori dhe prapësi mbahen në jetë nga sisteme të rrejshme të ndërtuara prej atyre që e mohojnë ekzistencën dhe njësinë e Zotit dhe nuk e besojnë Ahiretin. Prandaj, njerëzit e ndërgjegjshëm duhet të bashkohen në ndershmeri.

Ky unitet do të jetë njëra prej fazave më të rëndësishme në mposhtjen e ideologjive jofetare. Zoti ynë vë në pah

The prevalence of violence and cruelty reveals dimensions of the responsibility upon Muslims.



aleancën e mosbesimtarëve dhe shpall domosdoshmërinë e miqësisë dhe solidaritetit ndër Muslimanët në mënyrë që bota të pastrohet nga mizoria. Kur'ani thotë:

Kurse jobesimtarët janë miq e mbrojtës të njëri-tjetrit. Nëse nuk veproni ashtu siç jeni urdhëruar, do të bëhet ngatërresë dhe shkatërrim i madh në Tokë. (Kur'an, 8:73)

Duke marr parasysh se Muslimanët kanë një përgjegjësi kaq të madhe, ata duhet të bashkohen. Nëse rrethanat i ndalojnë që ta bëjnë këtë, duhet të mendojnë për pyetjet në vazhdim:

“A është më me rëndësi kjo çështje se sa uniteti i Islamit?”

“A nuk ka zgjidhje për të?”

“A është e pranueshme të biem në konflikt me një bashkësi tjetër Muslimane në vend se të punojmë së bashku kundër ideologjive jofetare?”

Secili që përgjigjet në këto pyetje në mënyrë të ndërgjegjshme do ta dijë se prioritet më i lartë është përmbajtja prej konflikteve të pambarim dhe vendosja e një unioni të bazuar në vlerat e Kur'anit.

Muslimanët nuk guxojnë asnjëherë të harrojnë se Shejtani punon gjithmonë për të shkaktuar

armiqësi në mes të Muslimanëve për ta ndaluar unitetin dhe solidaritetin e tyre. Zoti ynë ua tërheq vërejtjen besimtarëve për këtë rrezik:

**Thuaju, robërve të Mi, që të flasin atë që është më e mira.
Në të vërtetë, djalli mbjell ngatërresa ndërmjet tyre.
Vërtet, djalli është armik i hapët i njeriut. (Kur'an, 17:53)**

Ky ajet i këshillon Muslimanët që t'iu shmangen fjalëve lënduese, tallëse, të ashpra dhe akuzuese kundër Muslimanëve tjerë dhe përmend nevojën për sjellje të mirë në kërkimin e unitetit.

Kur'ani po ashtu thekson se konfliktet e tilla dhe sjelljet tjera të dëmshme dëmtojnë ndjenjën e përkatësisë së njeriut dhe dobëson fuqinë e Muslimanëve. Zoti ynë thotë:

Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe mos u grindni ndërmjet jush, sepse do të humbni guximin e do t'ju lërë fuqia. Bëhuni të durueshëm, se Allahu, me të vërtetë, është me të durueshmit. (Kur'an, 8:46)

Siç u tha më herët, kjo vlen si për individët Muslimanë ashtu edhe për kombet Muslimane. Nëse bota Islamike dëshiron të ndërtoj një qytetërim të fuqishëm, stabil dhe përparimtar që udhëzon dhe ndriçon botën në çdo aspekt,



duhet të veprojnë bashkuar. Mungesa e një bashkimi të tillë është përgjegjëse për papajtueshmërinë dhe përçarjen e botës Islamike, mungesën e një zëri të përbashkët dhe pamundësinë e mbrojtjes së Muslimanëve të pafajshëm. Një numër i pafund i grave, fëmijëve dhe njerëzve të moshuar e të varfër kanë nevojë të madhe për shpëtim nga tirania në Palestinë, Kashmir, Turkistanin Lindor (vendbanim i popullit Ujgur të sunduar nga Kinezët), Filipinet Jugore (vendbanim i popullit Musliman Moro) dhe në shumë rajone tjera. Përgjegjësia për këta popuj i bie botës Islamike përpara kujtudo tjetër. Muslimanët s' duhet të harrojnë kurrë fjalët në vijim të Profetit (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të):

*Muslimani është vëlla i Muslimanit. Ai nuk i bën keq atij e as nuk e braktis atë.*¹⁴

Bota Islamike duhet t'i lërë mënjane konfliktet e ndryshme të saj dhe të kujtoj se të gjithë Muslimanët janë "vëllezër" dhe "motra", në mënyrë që kështu të mund të jap shembuj që pasqyrojnë karakterin e vërtetë të Islamit dhe të idealeve të tij. Ky unitet i besimtarëve është një dhuratë dhe mirësi e Zotit. Muslimanët e sinqertë duhet t'i falënderohen Zotit tonë për këto të mira dhe t'i binden urdhrin të Tij "të mos përçahen":

Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (Kuranin) dhe mos u përçani! Kujtoni dhuntinë e Allahut për ju, sepse, kur ishit në armiqësi, Ai i pajtoi zemrat tuaja e, në saje të dhuntisë së Tij, u bëtë vëllezër. Dhe ju ishit buzë greminës së zjarrit, ndërsa Ai ju shpëtoi prej saj. Kështu, Allahu jua shpjegon shpalljet e Veta, që ju të drejtoheni në udhën e drejtë. (Kur'an, 3:103)



THIRRJE PËR UNION ISLAMIK



Harun Jahja (Adnan Oktar)



Uniteti do t'i forcojë Muslimanët

Siç u përmend më herët, grindjet dhe konfliktet shkaktojnë copëtim të brendshëm, që dobëson Muslimanët shpirtërisht. Kjo është njëra prej shumë fshehtësive që Kur'ani u shpall besimtarëve dhe thekson edhe një të vërtetë tjetër të rëndësishme. Pikërisht sikur që konfliktet dhe grindjet i dobësojnë ata shpirtërisht, uniteti dhe solidariteti i forcojnë ata. Zoti u thotë besimtarëve të bashkohen dhe të bëjnë qëndresë kur atyre u bëhet ndonjë e padrejtë (Kur'an, 42:39). Ky urdhër hyjnor përmban urtësi të madhe. Për shembull, shkatërrimi i ideologjive jofetare do të jetë i mundshëm vetëm kur Muslimanët të bashkohen.

Mirëpo, ajo që me të vërtetë e bën aq të fuqishëm bashkimin e besimtarëve është besimi dhe besnikëria e tyre. Pasi që vetëm besimi i vërtetë mund të sjellë miqësinë dhe lidhjen e vërtetë, Muslimanët duhet ta duan njëri tjetrin me zemër të dëlirë dhe për të fituar kënaqësinë e Allahut, pa pasur as interesin më të vogël. Një union i ngritur mbi themelet më të forta që njeh njerëzimi – frikën dhe dashurinë ndaj Zotit – kurrë nuk do të shpartallohet, pos nëse Allahu dëshiron ndryshe. Një lidhje e tillë e fortë do t'iu jap Muslimanëve

natyrshëm fuqi që rrallë herë arrihet. Në ajetin vijues, Allahu tregon se suksesi nuk varet nga madhësia e grupit:

Sa herë, me ndihmën e Allahut, një ushtri e vogël ka ngadhënjyer mbi një ushtri të madhe! Allahu është me të durueshmit. (Kur'an, 2:249)

Një union Islamik i bazuar në besim dhe devotshmëri do t'iu ofrojë Muslimanëve entuziazmin e nevojshëm dhe fuqinë e vullnetit për sukses të madh.

Në një ajet tjetër, Zoti shpall se edhe pse mohuesit duket të jenë të bashkuar, ata nuk kanë arritur unitetin e vërtetë:

Ata nuk do të luftojnë kundër jush së bashku, veçse në vende të fortifikuara ose pas mureve. Lufta ndërmjet tyre është e ashpër. Ti mendon se ata janë të bashkuar, mirëpo zemrat e tyre janë të përçara, sepse ata janë njerëz që nuk kuptojnë. (Kur'an, 59:14)

Pavarësisht se sa solid duket të jetë një union, ai në fakt është shumë i paqëndrueshëm nëse nuk ndërtohet mbi sinqeritet dhe qëllime të sinqerta, sepse kjo nënkupton se ai mbështetet vetëm në interesa të ndryshme. Dhe, kur cilido prej këtyre interesave kërcënohet, unioni do të shpartallohet shpejtë. Sepse Zoti e ka shpallur këtë fshehtësi në Kur'an, unioni i Muslimanëve nuk është lëkundur nga humbjet e dynjasë; në të

vërtetë, ai është forcuar. Kjo vetëdije e bën këtë union shumë solid. Dijetar i madh Islamik Said Nursi përdor shembullin në vazhdim për të sqaruar pse një union i formuar nga Muslimanët e sinqertë do të jetë i fuqishëm:

Pra ne sigurisht se kemi nevojë për solidaritet dhe bashkim të vërtetë, të arritur përmes sinqeritetit – sepse misteri i sinqeritetit siguron përmes katër individëve forcën morale të një mijë e njëqind e njëmbëdhjetë sosh – vërtet, ne jemi të detyruar ta arrijmë atë.



Po, nëse tre elifët (shkronja “A” në gjuhën Arabe, e cila merr trajtën e një vije të vetme vertikale, sikurse shkronja “I” apo numri 1) nuk bashkohen, kanë vlerën e numrit tre. Por nëse ato bashkohen, nëpërmjet misterit të numrave, ato marrin vlerën e numrit njëqind e njëmbëdhjetë. Nëse katër herë katër mbesin të ndarë, ata kanë vlerën e numrit gjashtëmbëdhjetë. Por nëse, nëpërmjet misterit të vëllazërisë dhe duke pasur një qëllim të përbashkët dhe detyrë të përbashkët, ata bashkohen, duke u bashkuar krah për krah në një rresht, ata kanë forcën dhe vlerën e katër mijë e katërqind e dyzet e katër. Pikërisht siç dëshmojnë ngjarjet e shumta historike që forca morale dhe vlera e gjashtëmbëdhjetë vëllazërve që vetëflijohen ka qenë më e madhe se ajo e katër mijë njerëzve.


Arsyeja themelore e këtij misteri është kjo: Secili anëtar i një bashkimi të vërtetë e të sinqertë mund të shoh po ashtu edhe me sytë e vëllazërve tjerë dhe të dëgjojë me veshët e tyre. Sikur secili person i një bashkimi të vërtetë prej dhjetë vetëve të ketë vlerën dhe forcën e të parit me njëzet sy, të menduarit me dhjetë mendje, të dëgjuarit me njëzet vesh dhe të punuarit me njëzet duar.¹⁵

Temat të cilat i kemi shqyrtuar gjer më tani tregojnë nevojën për unitetin Islamik dhe natyrën e një bashkimi të tillë. Pjesa tjetër e librit do të merret me veçoritë e këtij bashkimi.



**Ne i pajisëm ata me një virtyt
të posaçëm, me përkujtim ndaj
botës tjetër. S'ka dyshim
se ata ishin te Ne prej
të zgjedhurve më të mirë.
(Kuran: 38/46-47)**





ÇFARË LLOJI
TË UNIONIT
ISLAMIK?

Lufta e Parë Botërore dhe Lufta e Dytë Botërore i dhanë njerëzimit një mësim në formë të masakrës së paarsyeshme në shkallë botërore, qytetet kryesore Evropiane u shndërruan në rrënoja, prona që u bënë rrafsh me tokë dhe kampe gjenocidale të përqendrimit. Perëndimi, i zënë në mes të këtyre luftërave, nxori një mësim shumë të rëndësishëm nga këto tragjedi: të krijoj aleanca për të pasur një mekanizëm efikas, të lehtë dhe të shpejtë për zgjidhjen e konflikteve. Vendet tjera Evropiane ishin përpjekur të formojnë aleanca në të kaluarën, por ato nuk patën asnjëherë jetë të gjatë ose për shkak të ndonjë konflikti me interes kombëtar ose për ndonjë arsye ideologjike. Këtë herë, Perëndimi e dinte se bashkimi i dëshiruar duhej të ishte më shumë se vetëm një pakt ekonomik apo i mbrojtjes së përbashkët; duhej të ishte një union i ndërtuar mbi vlera të përbashkëta kulturore. Është e qartë se ky është një proces i gjatë.

Këto luftëra e shkretuan ekonominë dhe industrinë e Evropës. Të mbijetuarit u desh të rindërtonin qindra qytete, të riparonin infrastrukturën dhe të rivendosnin një sistem edukativ dhe shëndetësor funksional. Lufta kishte mbaruar, por tani kolonitë po kërkonin pavarësi. Dukej punë e vështirë për të krijuar stabilitet si edhe një union në mes të këtij kaosi. Hapi i parë në këtë drejtim ishte Federata Evropiane për Thëngjill dhe Çelik, e themeluar

në vitin 1951 kryesisht për të qenë në shërbim dhe për të zhvilluar industrinë. Ky union përfundimisht u shndërrua në Bashkësinë Ekonomike Evropiane (BEE), pastaj në Bashkësinë Evropiane (BE) dhe më në fund në Unionin Evropian (UE). Përfundimisht ajo u bë një union i fuqishëm në të cilin produktet, shërbimet, kapitali dhe fuqia punëtore qarkullojnë lirshëm ndërmjet shteteve anëtare; një union që ka një valutë të përbashkët, ligje kompatible dhe madje edhe burokraci shtetërore. Sot, UE është një prej lojtarëve kyç në skenën ndërkombëtare politike.

UE: Një model i mundshëm për Unionin Islamik

Organizata e Konferencës Islamike (OKI) ka 56 shtete anëtare dhe është organizata më e madhe Muslimane në aspektin e numrit të anëtarëve dhe në aspektin gjeografik. Veç kësaj, ekzistojnë disa aleanca rajonale ushtarake dhe tregtare në mes të kombeve fqinje Muslimane, secila prej të cilave kryen funksione të rëndësishme dhe kjo përfaqëson një zhvillim pozitiv. Megjithatë, bota Islamike ka nevojë për një union më gjithëpërfshirës, një union me institucione të përhershme të autorizuar për të sjellë vendime obliguese, të zhvilloj dhe zbatoj politika të përbashkëta, të përfaqësoj tërë botën Islamike dhe të jap zgjidhje për të gjithë Muslimanët e jo të gjej zgjidhje vetëm për disa vende të nxehta në rajon. Pushteti i këtij unioni duhet të jetë ekonomik, ushtarak dhe shoqëror.

Dhe (përkujtoni) kur Zoti juaj
njoftoi bindshëm: "Nëse
falënderoni, do t'ua shtojë të
mirat, e nëse përbuzni, s'ka
dyshim, dënimi Im
është i vështirë!"
(Kuran: 14/7)

THIRRJE PËR UNION ISLAMIK



The military, political, and economic unity of the Islamic world will enable a better use of the available resources and allow it to accomplish major cultural and economic development.





THIRRJE PËR UNION ISLAMIK

Ekzistenca e një unioni të tillë do të krijojë një ambient ku do të ketë besim dhe pajtim të ndërsjellë në mënyrë që të zhvillohet një ndjenjë solidariteti. Do të adresohen shqetësimet e sigurisë së shteteve anëtare në përputhje me rrethanat dhe bashkëpunimi i gjerë do të rezultojë me standarde më të larta të jetesës në shtetet anëtare. Duke vepruar si një trup për të gjitha punët që kanë të bëjnë me të, në mënyrë të drejtpërdrejt apo indirekte, kjo botë do të jetë në gjendje të zhvilloj strategji që janë në interesin më të mirë të botës Islamike.

Në gjysmën e dytë të shekullit njëzet, zhvillimet në Palestinë, Bosnje, Kosovë, Nagorno Karabah, Kashmir dhe Açeç i mësuam një të vërtetë të rëndësishme botës Islamike. Në këto rajone, ku mijëra civil humbën jetët e tyre, një numër shumë i madh i fëmijëve u bën jetimë dhe egërsia dhe dhuna arritën nivele tronditëse, Perëndimi ose nuk reagoi fare ose ishte shumë i ngadalshëm në ndërmarrjen e veprimeve ndaluese. Një



indiferencë e tillë i përkujtoi Muslimanët edhe një herë se ata të gjithë ishin përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave të Muslimanëve tjerë dhe për përmbushjen e nevojave të tyre. Prandaj, bota Islamike duhet të reagoj shpejtë dhe të jetë proaktive, sepse vetëm kombet e bashkuara Muslimane mund t'iu garantojnë siguri gjithë Muslimanëve duke folur në emër të gjithë Muslimanëve në arenën ndërkombëtare politike si një zë i vetëm.

Bota Islamike duhet të bëhet një bllok në aspektin ushtarak, politik dhe ekonomik. Një botë Islamike e bashkuar brenda saj do të sigurojë paqen botërore dhe do t'i ndalojë radikalët që të mos shkojnë drejtë një përplasje të qytetërimeve duke u bazuar në ideologjitë e tyre që për bazë kanë interesat vetjake dhe konfliktin.



Struktura e përgjithshme e Unionit Islamik

UE-ja, një model për unionin që ne propozojmë, mund të përshkruhet si një entitet në të cilin sovraniteti, sistemi i qeverisjes dhe burokracia shtetërore e shteteve anëtare do të vazhdonin të funksiononin nën ombrellën e një kushtetute të bazuar në “kulturën Evropiane.” Në kuadër të kësaj kushtetute, shtetet anëtare do të bashkëpunonin në politikë, kulturë dhe ekonomi dhe një legjislaturë dhe administratë qendrore do të koordinonte bashkëpunimin e tyre dhe do të përfaqësonte interesin e Evropës si tërësi.

Unioni Islamik duhet të ketë një strukturë që mbron pavarësinë, kufijtë kombëtarë, të drejtat dhe interesat e shteteve anëtare. Secili shtet sovran duhet të aspirojë të bashkohet nën një kulturë të përbashkët Islamike, të zhvilloj politika të përbashkëta dhe të themeloj organet legjislative dhe administrative që do t'i vënë ato në zbatim. Qëllimi i kësaj nuk është që të arrihet një shkrim strukturorë e shteteve, por që ato të bashkohen pas politikave dhe interesave të përbashkëta për të arritur fuqinë politike që do ta kishte një union i tillë.

Në një union të tillë, Muslimanët në mbarë botën do të jenë në kontakt të drejtpërdrejt me njëri tjetrin, do t'i dinë problemet e njëri tjetrit dhe do ta ndihmojnë njëri tjetrin. Separatizmi, fraksionalizmi dhe fanatizmi do të lihen mënjanë për hir të parimit të unitetit Musliman. Fakti se bota Islamike nuk ka qenë në gjendje të arrijë konsensus për pikëpamjet, sistemet dhe modelet e ndryshme që karakterizojnë anëtarët e saj i ka ndaluar ata që të veprojnë të bashkuar. Thirrja për unitet e Unionit Islamik të propozuar nuk do të bëhet sipas racës, gjendjes ekonomike apo vendndodhjes gjeografike dhe të gjitha armiqësitë që burojnë prej dallimeve racore, gjuhësore apo

Harun Jahja (Adnan Oktar)



"I have faith that Turkish Union will one day become a reality. Even if I do not see it, I shall close my eyes to this world with the dreams of it. I BELIEVE IN TURKISH UNION AND I SEE IT. The history of tomorrow will open its new chapters with the Turkish Union. The world will find its peace in these chapters. The existence of the Turk will open new horizons to this weary world, and it will then be seen what the Sun means and what the horizon means."

THIRRJE PËR UNION ISLAMIK

kulturore do të marrin fund nën ombrellën e këtij unioni. Ndjenja e unitetit e anëtarëve të saj nuk do të bazohet në superioritetin e një kulture, kombi apo grupi ndaj tjetrit, por në frymën e solidaritetit të nxitur nga barazia, toleranca, dashuria dhe miqësia.

Njëra prej arsyeve kryesore për themelimin e Unionit Islamik është krijimi i një autoriteti qendror të aftë për të udhëhequr popullatën e përgjithshme Muslimane. Për këtë arsye, autoriteti qendror duhet të ketë një strukturë që përfshin të gjithë Muslimanët ose, me fjalë tjera, duhet të jetë në gjendje



t'i strehoj të gjitha pikëpamjet nën ombrellën e tij. Unioni Islamik duhet të bazohet mbi parimet qendrore të Islamit, të pranojë dallimet praktike si edhe teorike në pikëpamje me tolerancë dhe mirëkuptim dhe t'i kthejë këto dallime me sukses në shumëllojshmëri dhe pasuri kulturore. Nuk duhet lejuar që këto dallime të pengojnë zbatimin e vullnetit politik dhe veprimin e përbashkët. Të gjitha konfliktet në mes të kombeve Muslimane duhet të zgjidhen dhe dallimet e tyre duhet të zgjidhen në kuadër të këtij autoriteti qendror. Një Union Islamik që mund të menaxhoj punët e tij të

Nuk është ashtu (si thonë ata),
po ai që është dorëzuar
All-llahut dhe është bamirës, ai
e ka shpërblimin e vet te Zoti i
tij, për ata nuk ka frikë, as nuk
kanë pse të mërzhiten.


(Kuran: 2/112)



brendshme do të jetë në gjendje t'i zgjidhë dallimet e mundshme me qytetërimet tjera me lehtësi dhe të gjenerojë politika të përbashkëta që autoriteti i tij qendror do t'i zbatojë dhe administrojë.

Bota Islamike ka shumë çështje që kërkojnë zgjidhje dhe që janë probleme të vazhdueshme për bashkësinë ndërkombëtare: tragjedi të tilla politike si Palestina, Kashmiri dhe Iraku; lufta ideologjike ndaj terrorizmit; dhe çështje të tilla shoqërore si ngecja ekonomike, varfëria, shëndetësia dhe shkollimi. Këto çështje kryesore nuk janë çështje rajonale apo lokale; në të vërtetë, ato kanë lidhje të drejtpërdrejt me të gjithë Muslimanët. Duke pasur parasysh këtë realitet, bota Islamike duhet të arrij solidaritet në mënyrë që t'i zgjidhë ato. Askush s'mund të thotë se ajo që ndodhë në Palestinë ka të bëjë vetëm me Palestinezët, se civilët e pafajshëm Musliman të Kashmirit që vuajnë nga tirania duhet ta zgjidhin vet këtë problem, ose se fëmijët barkthate në ndonjë vend Islamik janë përgjegjësi vetëm e atij vendi. Muslimanët nuk mund ta pranojnë këtë situatë në aspektin fetar.

Megjithatë, Muslimanët kanë dështuar të formojnë një aleancë të fuqishme në mes tyre dhe kështu vendet e tjera – dhe ato jomuslimane po ofrojnë zgjidhje për këto dhe për probleme të ngjashme. Mirëpo, zgjidhjet e propozuara, nuk posedojnë interesat më të mira të Muslimanëve, ose ofrojnë vetëm zgjidhje afatshkurtra. Në shumë rajone të përçara nga konfliktet, dobësi që ndërlidhet me Muslimanët, i ndalon ata që të kenë një zë të vërtetë në tavolinën negociuese. Veç kësaj, planet e ashtuquajtura paqësore shpeshherë përmbajnë nene që bëjnë më shumë dëm se sa dobi. Bota Islamike ka obligim të krijoj një plan të përbashkët veprimi për t'i mbrojtur të drejtat e cenuara të Muslimanëve.



Numri i çështjeve që presin zgjidhje nga Unioni Islamik tregon se ai do të ketë një orar të ngjeshur. Për të funksionuar me efikasitet, ai duhet të ketë një shtab të përhershëm operativ, të formoj organet ligjvënëse dhe administrative që do t'i koordinojnë aktivitetet e tyre (duke përfshirë sektorët e tyre) dhe të siguroj se këto institucione do të funksionojnë siç duhet. Duhet të ndërtohet infrastruktura që do sjellë vendimet e drejta në kohën duhur, unioni duhet të ngjallë besim me aktivitetet e tij dhe anëtarët e tij duhet të sigurohen se të drejtat e tyre janë plotësisht të mbrojtura.

Unioni Islamik duhet të posedojë fleksibilitetin e nevojshëm për t'iu përshtatur kushteve politike që vazhdojnë të ndryshojnë dhe largpamësinë për të zhvilluar strategji të përshtatshme. Është e qartë nevoja për një autoritet qendror aktiv që mund të ndërmerr iniciativën, në vend të reagimeve refleksive ndaj ngjarjeve në botë apo të qenit i kënaqur me bërjen e kritikave apo me shprehjen e opinioneve. Kjo qendër duhet të bart në supet e veta përgjegjësinë për bashkërenditje, mbikëqyrje dhe të qenit në shërbim të interesave të gjitha shteteve anëtare njësoj. Ajo duhet t'i marr në konsideratë të gjitha zhvillimet në mënyrë objektive dhe të jetë e udhëhequr nga kërkesat e botës Islamike. Një Union Islamik që mund të gjykoj në mes të shteteve anëtare, t'i zgjidhë konfliktet e tyre të interesit dhe t'iu ofrojë mbrojtje Muslimanëve në marrëdhëniet e tyre me kombet tjera do të forcojë ndikimin kulturor, ekonomik dhe politik të botës Islamike.

Që Unioni Islamik të bëhet një fuqi e bashkuar dhe një strukturë e unifikuar, ai duhet t'iu mbrojë vlerat bashkëkohore shoqërore, t'iu respektojë të drejtat njerëzore të gjithë njerëzve dhe të bazohet në parimet demokratike. Nuk çudit fakti që të gjitha këto vlera kanë rëndësi të dorës së parë për moralin Islamik.



Një Union Islamik paqësor dhe i harmonishëm

Unioni Islamik duhet të punoj për të sjellë paqe për gjithë njerëzit, jo vetëm për Muslimanët, dhe të jetë tolerant dhe paqësor në vendimet dhe praktikatat e tij. Thelbi i Islamit është morali i mirë i shpallur në Kur'an, i cili kërkon prej Muslimanëve të jenë miqësor, bujar, të dhembshur, tolerant, të drejtë, të kuptueshëm, të durueshëm dhe të devotshëm. Islami iu bën thirrje njerëzve për një botë paqësore:

O besimtarë! Pranojeni Islamin me të gjitha rregullat e tij dhe mos shkoni gjurmëve të djallit, se ai është armiku juaj i përбетuar. (Kur'an, 2:208)

Muslimanët karakterizohen si njerëz të cilët iu binden urdhrave të Zotit, që përpiqen t'i vënë në jetë parimet morale të Kur'anit me zell, ta bëjnë botën një vend më të mirë, ta ndërtojnë atë dhe të sjellin paqe dhe lumturi. Ata përpiqen të bëjnë gjëra të mira, të këndshme dhe të hijshme për njerëzit dhe bëjnë ç'është e

*All-llahu thërret për në xhennet,
dhe atë që do, e vë në
rrugë të drejtë.
(Kuran: 10/25)*

**A mos u siguruan ata prej
ndëshkimit të All-llahut? Nuk
sigurohet kush prej frikës së
ndëshkimit të All-llahut pos
njerëzve të humbur.**

(Kuran: 7/99)

mundur për të pasqyruar dhembshurinë dhe mëshirën e pafund të Zotit tonë. Zoti i ka urdhëruar robërit e Tij të jenë të mirë ndaj njerëzve, të tregojnë interesim për mjedisin që i rrethon dhe t'i thërrasin njerëzit në rrugën e drejtë. Ajeti në vazhdim përshkruan dallimin në mes të njerëzve të cilët nuk kanë ndikim pozitiv në mjedisin që i rrethon dhe atyre të cilët gjithmonë përpiqen të bëjnë vepra të mira:

Gjithashtu, Allahu krahason shembullin e dy njerëzve, njëri prej të cilëve është shurdh-memec, nuk mund të bëjë asgjë dhe është barrë e pronarit të vet, - kurdo e kudo që ta dërgojë, nuk i sjell asnjë të mirë. A është i barabartë ky me atë që urdhëron për drejtësi dhe ndjek rrugën e drejtë?! (Kur'an, 16:76)

Porosia e këtij ajeti duhet ta udhëheq Unionin Islamik, e cila duhet të jetë platformë për zbatimin e të kuptuarit të moralit Islamik të devotshmërisë, unitetit, miqësisë, ndershmërisë, drejtësisë, besnikërisë, përpikërisë dhe të qenit në shërbim. Morali Islamik garanton lirinë e mendimit dhe të jetës së njeriut, shkurajon tensionimin dhe konfliktin midis njerëzve dhe madje ndalon dyshimin, mendimet dhe fjalët negative për njëri tjetrin. Unioni ynë i paramenduar duhet të formohet nga Muslimanët të cilët veprojnë mbi këtë bazë dhe që punojnë për paqe në botë.

Morali Kur'anor kërkon që Muslimanët të përmbahen nga lufta dhe konflikti dhe t'i

zgjdhin konfliktet përmes dialogut dhe marrëveshjes. Kur'ani e konsideron luftën si një domosdoshmëri të padëshiruar dhe si zgjidhjen e fundit që kërkon të veprohet në përputhje me norma strikte humanitare dhe morale. Muslimanët janë të detyruar që gjithmonë të anojnë nga paqja dhe pajtimi dhe të luftojnë vetëm në vetëmbrojtje nëse sulmohen nga armiku. Zoti shpall se janë keqbërësit ata të cilët fillojnë luftën dhe se Ai nuk i do ata:

Kurdo që ata ndezin zjarrin e luftës, Allahu e shuan atë. Ata përpiqen të shkaktojnë ngatërresa në Tokë, por Allahu nuk i do ngatërrestarët. (Kur'an, 5:64)

Jeta e Profetit tonë (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) tregon se është luftuar vetëm për qëllime mbrojtëse kur gjithçka tjetër ka dështuar.

Kur'ani iu shpall Profetit (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) gjatë një periudhe prej 23 vitesh. Gjatë 13 viteve të para, Muslimanët jetonin si një bashkësi pakicë e shtypur nën zgjedhën pagane. Shumë Muslimanë u torturuan fizikisht, disa u vranë dhe të tjerëve iu plaçkit pasuria. Si bashkësi, ata vazhdimisht iu nënshtruan poshtërimit dhe kërcënimeve. E megjithatë, ata mbetën paqësor dhe vazhduan t'iu bëjnë thirrje Mekasve pagan për paqe. Kur shtypja arriti një shkallë të padurueshme, Muslimanët mërguan në Jethrib (Medina e sotme), ku gjetën liri dhe miqësi dhe ku gradualisht vendosën sundimin e tyre. As atëherë ata nuk iu shpallën luftë paganëve agresiv të Mekës.

Natyra e shoqërisë Islamike është e rregullt dhe e baraspeshuar, sepse njerëzit thirren të bëjnë vepra të mira dhe urdhërohen që të përmbahen nga e keqja. Surja Bekare 2:143 shpall se Muslimanët janë dëshmitarë si dhe shembull për njerëzit si "bashkësi e mesit." Një tjetër ajet

shpall se prej tyre kërkohet të jenë shembull i të mirës për njerëzimin:

Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin: (sepse) ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni të këqijat dhe besoni Allahun. (Kur'an, 3:110)

Është e qartë se nga një organizatë e formuar prej Muslimanëve të cilët veprojnë në përputhje me mësimet e Zotit kërkohet që ajo ta mbrojë dhe ta përfaqësojë këtë moral të mirë dhe të prijë udhën e Unionit Islamik. Ajo duhet së pari t'i zgjidhë konfliktet ndër-muslimane dhe t'i sjellë paqe botës Islamike, t'i kundërvihet çfarëdo lëvizje që nxitë dhunë dhe luftë dhe të themeloj një forcë parandaluese kundër gjithë luftënxitësve. Veç kësaj, duhet të bashkëpunoj me bashkësinë ndërkombëtare sa i përket terrorizmit dhe krimin ndërkombëtar, si edhe për çështje me interes të përgjithshëm (si armët për shkatërrim në masë) dhe madje edhe të udhëheq luftën kundër këtyre kërcënimeve.

Gjenerator i zgjidhjeve

Me pak fjalë kemi përmendur disa probleme (si Palestina dhe Kashmiri) që Unioni Islamik do të mund t'i zgjidhje shpejtë. Pra, posa të formohet, ky union do të bart mbi supe përgjegjësi të mëdha dhe do të bëhet një organizatë që mund të gjeneroj zgjidhje realiste dhe të duhura.

Situata e tanishme ka ndikim negativ jo vetëm mbi Muslimanët, por gjithashtu edhe mbi shumë njerëz të pafajshëm në mbarë botën. Një numër i pallogaritshëm i njerëzve vazhdojnë të vuajnë nga belatë e korrupsionit, varfërisë, amoralitetit, shpërndarjes së padrejtë të pasurisë, mizorisë, tiranisë, konfliktit dhe padrejtësisë. Foshnjat vdesin për shkak të mungesës së ushqimit, fëmijët dhe të moshuarit lihen në rrugë për të siguruar jetesën e vet, refugjatët detyrohen të jetojnë në tenda dhe baraka dhe të sëmurët nuk mund t'i lejojnë vetes çfarëdo tretmani mjekësor – të gjitha këto probleme prekin jo vetëm botën Islamike dhe botën e pazhvilluar në përgjithësi, por po ashtu, në një masë më të vogël, edhe botën e zhvilluar.

Shumë njerëz të pafajshëm dhe nevojtar presin dorën e ndihmës. Përgjegjësitë e Muslimanëve në këtë aspekt janë si vijon:

Ç'keni ju që nuk luftoni në udhë të Allahut dhe për shpëtimin e të shtypurve: për meshkujt e pafuqishëm, gratë dhe fëmijët, të cilët thërrasin: "O Zoti ynë! Nxirrna nga ky qytet, banorët e të cilit janë keqbërës! Na cakto një mbrojtës dhe na dërgo nga ana Jote dikë që të na ndihmojë!" (Kur'an, 4:75)

Unioni Islamik do t'i zgjidhë konfliktet ndërmjet Muslimanëve dhe jomuslimanëve si edhe konfliktet ndërmjet

Muslimanëve. Aktualisht, madje edhe kontestet ndër-muslimane janë duke u zgjidhur nga shtetet Perëndimore apo organizatat ndërkombëtare nën kontrollin e tyre. Fuqitë e huaja, të painformuara lidhur me historinë dhe kulturën Muslimane, nuk duket të jenë të afta të ofrojnë zgjidhje të përshtatshme, edhe pse kohë pas kohe ofrojnë pak ndihmë. Kombet Muslimane duhet vet t'i zgjidhin problemet e veta, sepse atëherë problemet e tyre



THIRRJE PËR UNION ISLAMIK

nuk do të zvarriten në arenën ndërkombëtare, zgjidhjet e propozuara do të jenë në interesin e tyre dhe një botë e bashkuar Islamike do të bartte një porosi të fuqisë dhe stabilitetit. Njëra prej telasheve më të mëdha të botës Islamike është paaftësia e saj e tanishme për të krijuar aso politika të përbashkëta dhe strategji efikase madje edhe për çështje që në mënyrë të drejtpërdrejtë kanë të bëjnë me të.

Unioni Islamik duhet të gjejë zgjidhje për kombet Muslimane si edhe për të gjithë popujt që kërkojnë paqe dhe siguri. Secili komb ka problemet e veta politike, demografike dhe ekonomike dhe rajonet e ndryshme kanë gjithashtu problemet e tyre rajonale. Edhe pse secili prej këtyre problemeve kërkon zgjidhje dhe masa të ndryshme, problemet fundamentale dhe zgjidhjet e tyre janë të njëjta gjithandej. Shumë vuajtje dhe telashe shkaktohen nga fakti se parimet morale të Kur'anit nuk vihen në jetë ashtu siç duhet, gjë që nënkupton se zgjidhjet e nevojshme nuk janë bërë në pajtim me udhëzimin e tij. Nëse duhet të arrihen zgjidhje të drejta dhe realiste, cilësi si mungesa e paragjyqimeve, fleksibiliteti dhe mendimi i lirë, bashkë me sinqeritetin, devotshmërinë, drejtësinë dhe ndihmën, të cilat burojnë të gjitha prej parimeve morale të Kur'anit, duhet t'i udhëheqin Muslimanët.

Ekziston një lidhje e rëndësishme midis zgjidhjes së problemeve ekonomike dhe moralit shoqëror. Për shembull, njëri prej problemeve më të mëdha ekonomike është padrejtësia shoqërore, e cila në thelb është një problem moral. Nuk mund të ketë padrejtësi shoqërore në një shoqëri Islamike, sepse Zoti

kërkon që gjithë teprica e pronës apo pasurisë të ndahet me ata që kanë nevojë dhe ndalon shpenzimin e tepërt. Mjetet financiare nuk duhet të përbëjnë bazën për privilegj dhe të shndërrohen në vlerë që ndahet vetëm nga një pakicë e njerëzve, sepse morali i Kur'anit kërkon solidaritet dhe ndërgjegje shoqërore për nevojat e tjetrit. Muslimanët e sinqertë janë aq të devotshëm sa që ushqimin e tyre së pari i japin të varfërve dhe të robëruarve, madje edhe nëse vet kanë nevojë për të. Ata veprojnë kështu vetëm për të fituar kënaqësinë e Allahut, sepse:

Ata i ushqejnë të varfrit, jetimët dhe të zënët rob edhe pse vetë janë nevojtarë, duke thënë: "Ne ju ushqejmë vetëm për hir të Zotit. Për këtë, nuk duam shpërblim e as falënderim! (Kur'an, 76:8-9)

Solidariteti dhe bashkëpunimi në mes të individëve mund të arrihet lehtë në marrëdhëniet ndërkombëtare, sepse morali Islamik do t'i udhëheq kombet anëtare të unionit. Është e patolerueshme që disa shtete gëzojnë luks të tepruar derisa, në një shtet tjetër, mijëra foshnje të porsalindura vdesin nga uria. Secili njeri i ndërgjegjshëm duhet të shqetësohet nga një situatë e tillë.

Shumë organizata bamirëse dhe ndërkombëtare përpiqen në mënyrë aktive t'i ndihmojnë këto kombe të varfra e të përvuajtura. Megjithatë, përpjekjet e tyre zakonisht nuk shkojnë përtej dhënies së pakove me ndihma në rajonet e prekura. Dhe kjo ndihmë shpeshherë nuk arrin marrësit e planifikuar për arsye të dështimeve të sistemit kombëtar të pazhvilluar dhe mafies apo

organizatave banditeske të tyre. Të gjitha këto duhet të çrrënjosen dhe një mentalitet i ri i bazuar në vetëdije dhe mendje të shëndoshë duhet ushqyer përmes fushatave për edukimin e masave.

Kur të ndalohet shkapërderdhja, kur të zhvillohet solidariteti dhe të ndahen të mirat dhe posaçërisht kur njerëzit të kenë mësuar të udhëhiqen nga ndërgjegjja e tyre, kësso mungesa të baraspeshës ekonomike do të çrrënjosen. Struktura më e përshtatshme për të zbatuar këto zgjidhje do të jetë Unioni Islamik.

Të drejtat private dhe individuale duhet të jenë të drejta dhe të respektohen

Në një shoqëri të formësuar përmes parimeve të vërteta morale Islamike, të drejtat dhe liritë individuale janë shumë të



Hungry and poor people need every kind of help.

rëndësishme. Të drejtat dhe liritë personale janë të garantuara në mënyrë që njerëzit të mund të jetojnë një jetë të lirë dhe të denjë. Zoti ka shpallur në Kur'an se të gjithë njerëzit janë të barabartë para Tij, sepse superioriteti bazohet në vetëdijen e njeriut për Zotin dhe Ai i urdhëron Muslimanët që të jenë të drejtë, tolerant, falës dhe të kenë mirëkuptim ndaj njerëzve. Prandaj, ata duhet t'i respektojnë dallimet dhe të jenë të drejtë kur bëjnë vlerësimin e tyre.

Praktikat e Profetit tonë (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) në shoqërinë e parë Islamike (në Medine) kanë treguar rrugën për të gjithë Muslimanët sa i përket strukturës shoqërore dhe udhëheqjes. "Kushtetuta e Medinës," që konsiderohet si kushtetuta e parë e Muslimanëve, reflekton një shkallë të avancuar të kuptimit të ligjit dhe ilustron me shembull ndjenjën e shoqërisë Islamike për drejtësi dhe të drejta individuale. Sipas saj, të gjithë njerëzve të secilit religjion u janë dhënë të drejtat dhe liritë themelore dhe pasuria, jeta, familja dhe faltoret janë ruajtur. Me këtë marrëveshje, secili ka mundur të jetonte nën një entitet politik dhe paqja u është sjellë fiseve të cilat kanë qenë në armiqësi me njëra tjetrën për shumë vite. Jashtë Kushtetutës së Medinës, Profeti (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) gjithmonë i trajtoi paganët në mënyrë të drejtë, i respektoi kërkesat e tyre për siguri dhe mbrojtje dhe dëshironte raporte miqësore dhe të qytetëruara midis njerëzve.

Katërmëdhjetë shekuj më parë, Islami i solli vlera të tilla njerëzimit si të drejtat individuale, ligji dhe rendi, barazia para drejtësisë dhe liria ekonomike. Me përhapjen e Islamit, drejtësia që mbretëroi në tërë territorin e tij u bënë lakmia e të gjitha kombeve. Kjo ndjenjë e drejtësisë, e cila sot ende kujtohet me respekt dhe aprovim nga shumë mendimtarë Perëndimor, bëri

që shumë njerëz dhe kombe ta përqafojnë Islamin dhe ta mirëpresin sundimin Musliman. Profeti ynë (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) praktikoi sistemin e drejtësisë së Kur'anit në mënyrën më të mirë të mundshme dhe Shokët e tij dhe Muslimanët në përgjithësi vazhduan ta praktikojnë këtë moral të lartë. Kjo bëri të mundshme që Muslimanët të bëhen një bashkësi që arriti drejtësi midis njerëzve:

Ndërmjet atyre që kemi krijuar, ka njerëz që i udhëzojnë të tjerët në rrugën e vërtetë dhe gjykojnë drejt. (Kur'an, 7:181)

Islami mëson lirinë e të menduarit dhe pjesëmarrjen në qeverisje. Një proces konsultues me bazë të gjerë është njëra prej kërkesave më fundamentale shoqërore të Islamit, sepse Zoti i urdhëron Muslimanët të qeverisin me anë të konsultimit të ndërsjellë, domethënë, t'i diskutojnë punët e tyre në mes vete:

[Besimtarë janë] ata që i përgjigjen thirrjes së Zotit të tyre, e falin namazin rregullisht dhe këshillohen për punët e veta me njëri-tjetrin; për ata që ndajnë lëmoshë prej asaj që u kemi dhënë Ne. (Kur'an, 42:38)

Kur veprimi pason konsultimin, të gjithë individët do të kenë pasur mundësi të barabartë për të shprehur mendimet e tyre dhe pastaj ta gjykojnë çështjen nga shumë këndvështrime të ndryshme. Kjo gjë zvogëlon mundësinë e gabimit dhe, prandaj, rezulton me një vendim të duhur dhe për të cilin është arritur pajtimi.

Aspekti më i rëndësishëm i konsultimit është se secili përfaqësues bën gjithë çka është në mundësinë e tij apo saj për të respektuar dhe për të kuptuar këndvështrimet e ndryshme. Shqetësimi më i madh i tyre është të gjejnë idetë e duhura, më tepër se fakti se kush i propozoi ato. Me fjalë tjera, qëllimi kryesor i konsultimit është që të sillen ato vendime që janë në

interesin më të mirë të shoqërisë. Parimet morale Islamike kërkojnë që Muslimanët të mos këmbëngulin në pikëpamjet e veta, por të pranojnë pikëpamjen që është më e afërt për ndërgjegjen e tyre dhe drejtësinë. Muslimanët duhet të përmbahen nga këmbëngulja dhe krenaria e pranishme në të menduarit e stilit “pikëpamjet e mia janë më të mirat, pikëpamjet e mia duhet të pranohen prej të gjithëve,” sepse sjellja e tillë nuk e kënaq Zotin. Muslimanët duhet të jenë të vetëdijshëm se gjithmonë ekziston dikush që di më shumë se ata dhe do të ishte gabim i rëndë të insistohet se idetë e tyre janë më të mirat:

E mbi çdo të ditur është një i Gjithëdijshëm. (Kur'an, 12:76)

Parimi Islamik i këshillimit është një dritë udhëzuese për Unionin Islamik, i cili duhet të ndërtohet mbi një kulturë politike të lirisë së fjalës pa frikë nga të qenit i paditur, ku të drejtat e tyre janë të mbrojtura dhe ku pikëpamjet e secilit dëgjohen me respekt të njëjtë. Në këtë mënyrë, kombet anëtare të tij do t'i zhvillojnë shoqëritë e tyre në të cilat njerëzit do t'i respektojnë pikëpamjet e njëri tjetrit; ku qeverisin barazia, drejtësia dhe liria; ku janë të çrënjësura shtypja dhe padrejtësia. Të arriturat e tilla do t'i mundësojnë botës Islamike të garantoj sigurinë dhe lumturinë e Muslimanëve dhe do të bëhet po ashtu forca lëvizëse e kulturës dhe qytetërimit të botës sonë.

Synimi përfundimtar: Zhvillimi i Botës Islamike

Njëri prej problemeve më serioze të botës Islamike është moszhvillimi i përgjithshëm i saj. Prandaj, njëri prej prioriteteve të Unionit Islamik duhet të jetë zhvillimi i botës Islamike duke përkrahur vendet më të varfra dhe duke zgjidhur problemet e tyre ekonomike. Kjo mund të arrihet duke luftuar varfërinë, duke inkurajuar investime të reja, duke krijuar vende të punës, duke vendosur rendin dhe ligjin në tërë shoqërinë, duke mënjeluar padrejtësinë ekonomike, duke garantuar drejtësi shoqërore dhe duke forcuar bashkëpunimin dhe dialogun ndërkombëtar si edhe atë rajonal.

Problemet dhe tensionet përbrenda botës Islamike të shkaktuara nga pabarazia financiare duhet të ulen. Një bashkim dhe bashkëpunim midis kombeve Muslimane në arenën ekonomike, politike dhe ajo që është më me rëndësi, në arenën kulturore do t'iu mundësojë kombeve të pazhvilluara që të përparojnë me shpejtësi. Veç kësaj, ata të cilët kanë të vendosur infrastrukturën e nevojshme do t'iu mundësohet të shtojnë në maksimum produktivitetin e tyre. Një union i tillë do të jetë në dobi të rritjes ekonomike dhe zhvillimit shkencor dhe teknologjik.


Zhvillimi ekonomik do t'iu rris investimet në shkencë dhe teknologji dhe përparimet teknologjike do të stimulojnë rritjen e mëtutjeshme ekonomike. Zhvillimi ekonomik do të ngritë standardet edukative dhe shoqëria do të zhvillohet në shumë drejtime. Nën ombrellën e Unionit Islamik, individët do të kenë mundësi të udhëtojnë lirshëm pa pengesat e vizave apo kufijve dhe një sistem i tregtisë dhe ndërmarrjes së lirë do të nxis rritjen dhe zhvillimin e shpejtë të botës Islamike.



**Oil complexes in Azerbaijan
and Indonesia.**

THIRRJE PËR UNION ISLAMIK





Projects of "greening the deserts" play an important role in the Muslim world's economic recovery. The projects carried out in Egypt, Jordan, and Morocco have been quite successful. Economic cooperation among Muslim countries will yield better results in similar projects.

THIRRJE PËR UNION ISLAMIK

Ky zhvillim do të rezultojë në mënyrë të natyrshme me modernizimin e botës Islamike dhe arritjen e standardeve që ekzistojnë në botën e zhvilluar. Derisa parimet ekonomike të Islamit ndryshojnë nga hedonizmi që dominon pjesën më të madhe të Perëndimit, tregtia e lirë është element po aq i domosdoshëm për shoqëritë Islamike sa edhe për shoqëritë Perëndimore. Islami njeh të drejtën e çdo njeriu për pronën private dhe ndërmarrjen e lirë, por parimet morale Islamike vënë përgjegjësi të caktuara mbi individët në mënyrë që të arrihet drejtësia shoqërore. Të varfrit gëzojnë të drejtën në një pjesë të pasurisë së të pasurve, por jo në formën e tatimit të detyruar. Më saktë, të pasurit ua japin këtë pjesë të varfërve me dëshirë për shkak të besimeve të tyre. Versioni Islamik i drejtësisë shoqërore nuk arrihet përmes planifikimit dhe detyrimit nga qendra, siç shpalli socializmi dhe dështoi ta realizonte, por përmes vlerave dominuese morale të shoqërisë. Morali Islamik po ashtu ndalon të pasurit që të zhyten në konsumim dhe shpenzim të tepruar të të hollave.

The degeneration and moral collapse in societies where people are far removed from religion's morality is a major problem in many countries.



Modeli materialist shoqëror inkurajon shpenzimin, egoizmin dhe shtypjen e pamëshirë të tjerëve nga individët të cilët kanë humbur respektin dhe dashurinë e tyre për bashkëqytetarët e tyre. Gjatë dy shekujve të kaluar, ky model shoqëror ka arritur që të dominojë pjesën më të madhe të botës Perëndimore dhe ka gërryer vlerat e saj tradicionale morale Hebreje dhe të Krishtera. Si pasojë e kësaj, shumë vende Perëndimore janë detyruar ta luftojnë shpërdorimin e drogës të përhapur gjithandej, prostitucionin, korrupsionin, kumarin, shpërdorimin e alkoolit dhe krimin e organizuar. Veç kësaj, dobësimi i besimeve fetare ka krijuar një krizë identiteti: Filozofitë materialiste, të cilat pohojnë se qëllimi i jetës është të sigurohet pasuri materiale dhe të jetohej një jetë ku dominon kënaqësia, nuk mund ta kënaqin botën shpirtërore të njerëzve dhe kështu përfundojnë duke krijuar një boshllëk ku nuk ekziston kurrfarë qëllimi. Nën flamurin e lirisë, pasuesit e saj veten e tyre ua nënshtrojnë dëshirave të tyre vetjake.

Morali Islamik, në anën tjetër, i çliron njerëzit prej të gjitha llojeve të shqetësimeve dhe anktheve që mendojnë mendjet e tyre. Besimtarët janë të vëmendshëm vetëm ndaj Zotit dhe kërkojnë të fitojnë vetëm kënaqësinë e Tij. Plotësisht të vetëdijshëm për përgjegjësitë e tyre ndaj Zotit tonë, ata jetojnë në harmoni me ndërgjegjen e tyre gjatë gjithë kohës dhe, si të tillë, janë individë të kënaqur dhe të matur. Ata i ofrojnë mjedisit të tyre mirësi dhe bukuri. Ky moral i çliron njerëzit nga presioni i lakmisë, dëshirës së tepruar, frikës për të ardhmen dhe vdekjen dhe qëndrime dhe frika tjera që janë të papajtueshme me moralin fetar. Të liruar prej këtyre karakteristikave negative, ata përjetojnë lirinë dhe paqen që buron nga nënshtimi ndaj Zotit.

Prandaj, zhvillimi dhe përparimi i nxitur nga Unioni Islamik

THIRRJE PËR UNION ISLAMIK


The Petronas Twin Towers in Malaysia, 452 meters tall, are the second tallest buildings in the world.



**Përkujtoni kur ishit pakicë e të
dobët në tokë, dhe frikësoheshit se
do t'ju rrëmbejnë njerëzit
(idhujtarët), e Ai ju mundësoi
vend të sigurt (në Medinë) dhe ju
përkrahu me ndihmën e Tij, ju
furnizoi me të mira, që të
jeni mirënjohës.
(Kuran: 8/26)**








Islamic morality instructs people to avoid waste and extravagance. This is a key element in establishing social justice in Islamic societies. Social justice in Islam can be established by the society's prevalent moral values. Consequently, living by the Qur'an's values and Islamic unity will cause the Islamic world to become more prosperous.

nuk do të jetë identik me zhvillimin e paraparë nga Perëndimi. Gjatë periudhës së zhvillimit, Perëndimi përjetoi padrejtësi të madhe shoqërore. Për shembull, forca lëvizëse e zhvillimit në Anglinë e shekujve tetëmbëdhjetë dhe nëntëmbëdhjetë ishte eksploatimi i pamëshirshëm. Klasa punëtore duroi kushte të tmerrshme të punës dhe jetesës. Fëmijët e moshës së re 7 apo 8 vjeçare u detyruan të punojnë në minierat e pista të thëngjillit 16 orë në ditë; shumë prej tyre vdiqën pa i mbushur 20 vjet. Në vitet e 1840-ta, gjatësia mesatare e jetës e minatorëve të thëngjillit ra në një mesatare prej 17 vjetësh.¹⁶ Në anën tjetër, të pasurit jetonin në luks të tepruar dhe bënë shpenzime të tepruara. Të gjitha vendet e industrializuara Perëndimore kaluan nëpër këto përvoja të tmerrshme dhe u ndërtuan mbi eksploatimin dhe shtypjen e miliona të varfërve.

Modeli zhvillimor i një shoqërie të sunduar nga morali Islamik do të përmbaj drejtësi shoqërore. Perëndimi përjetoi padrejtësi të madhe gjatë zhvillimit të tij sepse liderët e tij mbështetën idetë e gabuara materialiste të natyrës njerëzore. Por, morali Islamik kërkon prej njerëzve që të jenë ndërmarrës dhe pionierë në të gjitha fushat, si edhe të jenë të mëshirshëm, vetëmohues dhe të drejtë ndaj të tjerëve. Përgjatë ngritjes së qytetërimit Islamik, Muslimanët ishin liderë botëror në ekonomi dhe ishin tregtarë shumë të suksesshëm. Mirëpo, pasuria që u fitua nuk mbeti në duart e disa njerëzve, por u shpërnda në gjithë shoqërinë. Institucione të tilla për ndihmë si organizatat e bamirësisë, komplekset shoqërore, kuzhinat popullore, hotelet e mëdha (hanet e mëdha), banjot publike dhe bibliotekat tregojnë se pasuria dhe kultura nuk mbetën në duart e një numri të vogël të Muslimanëve, por të gjithë kishin qasje në to. Unioni i paramenduar Islamik duhet ta përvetësojë këtë model zhvillimi.

Harun Jahja (Adnan Oktar)

**Nadir Divan Begi
Madrasah, 1622,
Bukhara,
Uzbekistan.**



THIRRJE PËR UNION ISLAMIK

Alaaddin Caravanserai, 1229, Aksaray,
Turkey.

A caravanserai dating
back to the 17th
century,
Punjab, India.

Sher-Dor and Tilla Kari Madrasah, Samarkand, Uzbekistan.

Shembulli i pasurisë së atyre që e japin në rrugën e All-llahut është si një kokërr prej të cilës mbijnë shtatë kallinj, ndërsa në secilin kalli ka nga njëqind kokrra.

All-llahu ia shumëfishon (shpërblimin) atij që dëshiron, All-llahu është Bujar i Madh, i di qëllimet.

(Kuran: 2/261)

Një tjetër aspekt i këtij modeli zhvillimor është mungesa e paragjykimeve. Morali Islamik kërkon që Muslimanët të mos kenë paragjykime apo, me fjalë tjera, që të mbajnë gjallë dialogun me kulturat tjera dhe të përfitojnë prej të arriturave të tyre. Për këtë arsye, mendimtarët dhe shkencëtarët Muslimanë studiuuan veprat e mëhershme Greke, Kineze, Romake dhe Indiane, prej të cilave morën dituri dhe pastaj u zhvilluan dhe u pasuruan me të kuptuarit Islamik. Bota Islame e sotme duhet t'i studioj kulturat e të tjerëve, e në veçanti ato të Perëndimit, të përfitoj nga dituria që ata kanë grumbulluar dhe pastaj ta përdor atë dhe ta avancoj për të mirën e tyre dhe të njerëzimit.

Përpjekja për ta izoluar botën Islamike prej kulturave tjera duke e bërë atë të pavarur nuk do t'iu sjellë dobi Muslimanëve. Morali Islamik kërkon që teknologjia të përdoret maksimalisht. Për shembull, Muslimanët duhet të ndërtojnë industrinë e vet të filmit për ta mësuar njerëzimin për drejtësi dhe mirësi, si kundërpeshë ndaj filmave që përpiqen t'i imponojnë moralit Islamik një gërshetim materialist. Nëse ndonjë trend arti përmban ndikime negative, Muslimanët duhet të krijojnë një formë më të bukur dhe më madhështore arti. Nëse njerëzit e admirojnë madhështinë, pastërtinë, rehatinë dhe gjallërinë e qyteteve, Muslimanët duhet të ndërtojnë madje edhe qytete më të mira dhe ta bëjnë botën një vend edhe më të mirë për të jetuar.

Pa dyshim Muslimanët mund të ndërtojnë një qytetërim që mund të krahasohet me qytetërimin e madh Islamik të së kaluarës, por për ta bërë këtë ata duhet të jetojnë në pajtim me estetikën dhe mjeshtërinë, gjerësinë e pikëpamjeve, maturinë dhe drejtësinë e vlerave të Kur'anit. Arti, kultura dhe qytetërimi Islamik jo vetëm që do të sjellin përparim për Muslimanët, por për tërë njerëzimin. Bibliotekat më madhështore, arkitekturat

më mahnitëse, rrugët më të pastra, rrugët më së miri të ndriçuara dhe shkollat, universitetet dhe spitalet më të mira do të ndërtohen nga Muslimanët dhe të gjithë njerëzit do të kenë qasje të njëjtë në to.

Ngritja e qytetërimit Islamik është e mundshme nën udhëheqjen e një pushteti qendror Islamik dhe shekulli njëzet e një mund të jetë më i ndritshmi për botën Islamike. Në kohën kur globalizimi po fiton vrull, kombet Muslimane duhet t'i zgjidhin konfliktet e tyre; të hyjnë në ndërmarrje të përbashkëta shkencore, teknologjike dhe tregtare; dhe t'i bashkojnë forcat e tyre në interes të gjithë Muslimanëve.

Më në fund, duhet thënë se Muslimanët nuk e ndajnë botën në dy pole të kundërta: "Perëndimorët" dhe "Muslimanët." Së pari, shumica e popujve Perëndimor janë Ithtarët e Librit dhe prandaj ndajnë shumicën e vlerave morale dhe fetare të Muslimanëve. Kjo është arsyeja pse shumë aspekte të kulturës Perëndimore (siç është liria e besimit, demokracia dhe vlerat familjare) janë të një rëndësie kryesore për parimet morale Islamike gjithashtu. Në anën tjetër, shumë njerëz në Perëndim kanë zgjedhur Islamin si fenë e tyre dhe vazhdojnë ta bëjnë këtë. Duke marr parasysh se vlerat e Kur'anit deri më tani nuk janë në dispozicion në mënyrë të drejtë dhe të plotë në Perëndim, është realiste të pritet që shumë më tepër njerëz do ta përqafojnë Islamin. Muslimanët duhet ta përvetësojnë këtë qëndrim për Perëndimin dhe kulturën e tij. Gjithashtu, ata duhet të kujtojnë se disa qarqe kanë qenë nën ndikimin e filozofive materialiste për më shumë se dy shekuj dhe se ato akoma kanë nevojë të lirohen prej paragjykimëve të tyre. Kjo është përgjegjësia e Muslimanëve.

**Me lejen e All-llahut toka e
mirë mbinë bimët, e ajo që
nuk është kualitative, ajo
nuk mbinë vetëm (pak) me
vështirësi. Kështu Ne i
rradhisim argumentet Tona
për ata që falenderojnë.
(Kuran: 7/58)**

The United
Arab Emirates

**E Ne nuk i krijuam qiejt as
tokën ndryshe vetëm me
urtësi (të madhe). E s'ka
dyshim se momenti i
fundit (kijameti) do të
vijë, e ti (Muhammed)
sillu me njerëzishmëri.
(Kuran: 15/85)**


The United
Arab Emirates



Ubadiye
Mescidi,
Malezya

All-llahu e di atë që ju e
fshihni dhe atë që
e publikoni. Ata (idhujt)
që i adhurojnë (idhujtarët)
pos All-llahut, ata nuk
krijojnë asnjë send, po
vetë ata
janë të krijuar.
(Kuran:19-20)

Iran



DOBITË
E UNIONIT
PËR
MUSLIMANËT

Politikat moderne botërore e bëjnë të domosdoshëm integrimin e kombeve në Unionet ndërkombëtare për interesa të sigurisë dhe ekonomisë së tyre kombëtare. Faktorë të tillë si burimet natyrore, blloqet tregtare e madje edhe vlerat kulturore luajnë një rol të rëndësishëm në këto unione ndërkombëtare, të cilat rëndom bazohen në vendndodhjen gjeografike. Shumë vende fqinje bashkojnë burimet e tyre nën ombrellën e organizatave të tilla, krijojnë aleanca mbrojtëse dhe bashkëpunojnë lidhur me një varg të gjerë çështjesh. Qëllimi i unioneve të tilla është ta mbrojnë paqen, ta kontrollojnë garën në armatim, t'i zgjidhin konfliktet përmes diplomacisë, ta promovojnë zhvillimin shoqëror dhe ekonomik dhe t'i mbrojnë të drejtat fundamentale njerëzore dhe demokracinë. Në kohën e tanishme, NATO, OSBE, UE, NAFTA, OPEK, ASEAN, G-8, D-8 dhe APEC janë unionet më të shquara ndërkombëtare politike, ushtarake dhe ekonomike.

Këto institucione janë subjekt i reformave organizative për shkak të anëtarëve të rinj apo zgjerimit të mundësive. Të gjitha këto organizata, të formuara pas Luftës së Dytë Botërore, kanë kontribuar në krijimin e stabilitetit dhe rendit në botë dhe kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin global socio-ekonomik. Kombet anëtare mbrojnë interesat e tyre ekonomike dhe ushtarake dhe gjithashtu fitojnë pozitë më të fuqishme rajonale dhe ndërkombëtare. Madje edhe bota e zhvilluar e ndien domosdoshmërinë e partneriteteve të tilla. Krijimi i zonave të tregtisë së lirë, marrëveshjet

tregtare rajonale, heqja e kontrolleve doganore dhe madje një valutë e përbashkët (si në UE) sigurojnë të ardhmen e shteteve anëtare. Marrëveshjet mbrojtëse iu mundësojnë shteteve anëtare t'i ulin shpenzimet ushtarake dhe t'i orientojnë ato burime në fushat e kulturës dhe arsimit.

Një organizim i ngjashëm do t'iu ofrojë të mira të konsiderueshme kombeve Muslimane. Për ata që kanë nevojë të madhe për zhvillim teknologjik si edhe ekonomik, hapi kryesor drejt qëndrueshmërisë është krijimi i një organizate qendrore, me fjalë tjera, një botë e bashkuar Islamike nën mbrojtjen e Unionit Islamik.

Zhvillimi ekonomik dhe përparimi i shtuar

Bashkëpunimi ekonomik është i domosdoshëm për dy arsye: stabilitet dhe zhvillim. Vendet Muslimane duhet t'iu sjellin qëndrueshmëri dhe stabilitet ekonomive të tyre. Zhvillimi i industrive dhe investimet e nevojshme janë vitale, siç është edhe nevoja për një plan gjithëpërfshirës zhvillimor dhe zhvillim të njëkohshëm të arsimimit, ekonomisë, kulturës, shkencës dhe teknologjisë. Ndërsa sektorë të ndryshëm zhvillohen në aspektin teknologjik, nivelet dhe standardet arsimore të fuqisë punëtore duhet të ngriten në përputhje me rrethanat. Shoqëria duhet të motivohet të jetë më produktive dhe bashkëpunimi rezultues ekonomik do të luaj një rol madhor në çrrënjosjen e varfërisë, analfabetizmit, shpërndarjen e padrejtë të pasurisë dhe problemet tjera të shfrenuara shoqërore-ekonomike në vendet Muslimane. Ky partneritet mund të formohet vetëm përmes krijimit të zonave të lira tregtare, unioneve doganore dhe zonave të përbashkëta ekonomike.

Shumica e vendeve Muslimane kanë rëndësi gjeostrategjike si edhe resurse të pasura natyrore (siç janë gazi natyror dhe nafta e papërpunuar). Mirëpo, këto burime dhe mundësitë strategjike nuk shfrytëzohen në mënyrë efikase. Në botën Islamike, standardet jetësore të 86% të popullatës bien nën \$ 2,000, 76% nën \$1,000, dhe 67% nën \$500 në vit. Kur të merren parasysh resurset e përgjithshme të botës Islamike,¹⁷ ky është një paradoks i mirëfilltë: Afërsisht gjysma e benzinës e konsumuar në Perëndim eksportohet nga bota Islamike, si edhe 40% e prodhimit bujqësor botëror.¹⁸ Shumë ekonomist dhe strateg pranojnë hapur se ekonomia botërore varet nga eksportet e naftës dhe gazit të botës Islamike, e në veçanti të atyre të Gjirit Persik.¹⁹

Gjiri Persik zotëron dy të tretat e rezervave të zbuluara të naftës së papërpunuar të planetit. Të dhënat e siguruar nga hulumtimet konstatojnë se vetëm Arabia Saudite zotëron 25.4% të rezervave të naftës në botë, ose 262 miliardë barel. 11% të rezervave janë zbuluar në Irak, 9.6 % në EBA, 9.2 % në Kuvajt, 8.6 % në Iran, 13% në shtetet tjera anëtare të OPEK-ut. Pjesa tjetër është e shpërndarë në



pjesën e mbetur të botës.²⁰ Hulumtimi i autorizuar nga Departamenti për Energji i SHBA-ve tregon se midis viteve 2000 dhe 2020, eksportet e naftës nga ky rajon do të rriten për 125%.²¹ Kjo nënkupton se bota do të vazhdojë t'i përmbush shumicën e nevojave të saj për energji nga importet nga rajoni i Gjirit. Për më tepër, Lindja e Mesme ka 40% të rezervave botërore të gazit natyror; 35 % e këtyre rezervave ndodhen në rajonin e Gjirit.²² Algjeria, Libia dhe vendet tjera të Afrikës Veriore kanë 3.7 % të rezervave botërore.

Kaukazi dhe Azia Qendrore janë po ashtu të pasura me naftë, gaz natyror dhe resurse tjera natyrore. Për shembull, Kazakistani ka ndërmjet 10-17.6 miliardë barel të rezervave të konfirmuara të naftës dhe rezervat e tij të gazit natyror llogaritet të jenë midis 53 dhe 83 trilion fut kub. Turkmenistani ka ndërmjet 98 dhe 155 trilion fut kub të rezervave të gazit natyror, që e bën atë prodhuesin e katërt më të madh.²³ Disa vende tjera Muslimane kanë resurse të çmueshme minerale. Për shembull, Uzbekistani dhe Kirgistani janë dy prodhuesit udhëheqës botëror të arit. Turqia ka njërën prej rezervave më të pasura të borit në botë, që tash së voni u zbulua të jetë shumë e rëndësishme dhe Taxhikistani ka kapacitetet më të mëdha në botë për prodhimin e aluminit.


Këto përparësi do të fitojnë në peshë në shekullin njëzet e një, të cilin disa tashmë e kanë pagëzuar "shekulli i energjisë". Energjia është një element thelbësor i shoqërisë moderne sa i përket ushtrisë, industrisë, urbanizimit dhe transportit. Duke ditur se aktiviteti ekonomik dhe përpunues varen në radhë të parë nga energjia, kombet do të bëjnë ç'është e mundur të kenë nën kontroll këto resurse të energjisë. Bota Islamike nuk është duke i shfrytëzuar këto resurse në mënyrë efikase, sepse shumica


e anëtarëve të saj nuk posedojnë infrastrukturën dhe teknologjinë për të rritur prodhimin dhe për të përdorur resurset e tyre natyrore për të zhvilluar industrinë e tyre. Prandaj, kontributet e resurseve në ekonominë e vendit janë të kufizuara në fitimet e eksportit. Këto vende nuk i kanë mjetet për të përpunuar naftën e vet të papërpunuar, për ta përdorur atë në komplekset e tyre industriale apo për të zhvilluar industrinë e tyre. Çka është edhe më keq, disa kombe Muslimane nuk kanë madje as mjetet e nevojshme për të eksploruar dhe hulumtuar resurset e veta natyrore apo për t'i zbuluar dhe nxjerrë ato. Eksplorimet e ndërmarra nga kompanitë e huaja zbulojnë se kombet tjera Muslimane kanë rezerva të naftës dhe gazit por ato nuk mund të përfitojnë prej resurseve të veta.

Natyrisht, përdorimi joefikas i resurseve natyrore nuk është i vetmi problem ekonomik i botës Islamike. Megjithatë, zgjidhja e këtij problemi mund të fillojë procesin e zgjidhjes së shumë problemeve tjera. Ekonomitë e kombeve Muslimane përmbajnë dallime në strukturë dhe funksionim. Ekonomitë e disa kombeve varen nga resurset minerale, siç janë anëtarët e OPEK-ut, derisa ato të kombeve tjera varen nga bujqësia. Këto dallime reflektohen po ashtu, deri në një masë, në strukturat shoqërore të tyre, siç janë dallimet e mëdha sa i përket popullatave rurale dhe urbane. Zhvillimi i marrëdhënieve plotësuese dhe të ndihmuarit e njëri tjetrit në fushat e tyre përkatëse të ekspertizës mund t'i shndërrojë këto dallime në burim pasurish. E gjithë kjo do të jetë e mundshme me Unionin Islamik.

Ndërmarrjet e përbashkëta dhe partneritetet në projekte do të jenë një hap i rëndësishëm në drejtimin e duhur, sepse do t'iu mundësojnë vendeve të përfitojnë prej përvojave të njëra tjetrës dhe nga të ardhurat e fituara nga projektet investuese do të


THIRRJE PËR UNION ISLAMIK





Kazakhstan, which left the USSR in 1990, declared its independence in 1991. It has rich oil and natural gas reserves, and one-fifth of the former USSR's fertile agricultural lands. The Baykonur (Leninsk) Space Base, from which the first manned spaceship was launched, remains within its borders.

THIRTE PËR UNION ISLAMIK




Thanks to joint ventures, each Muslim country will benefit from the other country's experiences, and the investments will benefit both of them. Each country's different geography and economic conditions will turn into wealth and bring abundance.



përfitojnë të gjitha vendet pjesëmarrëse. Një mbështetje e tillë reciproke financiare është në përputhje me moralin Islamik, sepse të ndihmohet nevojtarët dhe të kesh një ndjenjë të përgjegjësisë shoqërore janë karakteristika të rëndësishme që Muslimanët përpiqen t'i arrijnë. Shumë vargje në Kur'an i përkujtojnë Muslimanët që të përkujdesen për nevojtarët.

Kohezioni i brendshëm i shoqërisë mund të shtrihet në marrëdhëniet ndërkombëtare. Pasi që bashkëpunimi ndërkombëtar brenda një partneriteti nuk mund të jetë i njëanshëm, nivelet e punësimit dhe të ardhurave do të ngriten në të dyja vendet. Për shembull, një vend do të prodhojë naftë dhe një tjetër do ta përpunojë atë dhe vendet e varura nga bujqësia do të kenë mundësi ta importojnë ushqimin që iu nevojitet nga vendet e zhvilluara bujqësore. Nevoja e një vendi që i mungon fuqia punëtore do të përmbushet nga një vend tjetër Islamik, derisa vendet e pasura do të jenë në gjendje të investojnë dhe ta ndihmojnë një vend të pasur për nga fuqia punëtore që nuk ka vende të mjaftueshme pune për popullin e vet. Kjo do të jetë në dobi të dy palëve. Shkëmbimi i njohurisë dhe përvojës do të nxitë përparimin dhe të gjithë Muslimanët do të përfitojnë nga zhvillimet teknologjike.

Ndërmarrjet e përbashkëta që realizojnë bashkimin e mundësive dhe mjeteve të botës Islamike do t'iu mundësojnë Muslimanëve të prodhojnë produkte të teknologjisë së lartë. Tregu i përbashkët Islamik do ta bëjë të mundshme që produktet e punuara nga Muslimanët të shiten në vendet tjera Muslimane pa pengesën e doganave, kuotave dhe pengesave tjera të vendkalimeve kufitare. Tregu do të zgjerohet, pjesa në treg dhe eksportet do të shënojnë rritje tek të gjitha kombet Muslimane, industrializimi do të përshpejtohet dhe zhvillimi ekonomik do të




sjell përparim të teknologjisë. Kur gjithë kjo të ndodhë, kombet Muslimane do të veprojnë si një partneritet ndaj grupeve tjera investuese dhe do të bëhen një pjesë e rëndësishme e ekonomisë botërore.

Standardet jetësore dhe pasuria e kombeve Muslimane do të shënojnë rritje dhe pabarazitë ekzistuese në mes tyre do të zhduken. Disa marrëveshje për tregti të lirë tashmë janë vendosur midis vendeve të Gjirit, Bregut të Paqësorit dhe Afrikës Veriore. Marrëveshjet tregtare të nënshkruara nga Turqia tashmë funksionojnë në botën Islamike. Bashkëpunimi bilateral ekziston në disa rajone; megjithatë, shtrirja e tyre duhet të zgjerohet. Një bashkëpunim i tillë do të ruaj të drejtat dhe interesat e gjithë kombeve Muslimane dhe do të bëjë që ato të gjitha të zhvillohen

THIRRJE PËR UNION ISLAMIK

Morocco



Tunisia



Morocco



Tunisia



Jordan



– një rezultat prej të cilit ato të gjitha do të nxjerrin një dobi shumë më të madhe se nëse nuk bashkëpunojnë me njëra tjetrën.

Gjithë këto mund të realizohen vetëm nën udhëheqjen dhe bashkërenditjen e një autoriteti qendror. Arritja e kësaj do të jetë e mundshme nëse kombet Muslimane përvetësojnë vlerat e Kur'anit dhe Sunnetin e Profetit (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të), ose, me fjalë tjera, nëse përvetësojnë kulturën Islamike. Unioni Islamik duhet të prijë në rrugën drejt këtij zgjimi kulturor, si edhe drejt bashkëpunimit pasues politik dhe ekonomik.

Bashkëpunimi reciprok në mes të Muslimanëve, pjesë e rregullave Islamike, duhet të përkrahen nga të gjithë Muslimanët, sepse Zoti i urdhëron njerëzit të përmbahen nga koprracia dhe t'i ruajnë nevojtarët dhe ta përkrahin njëri tjetrin. Në fakt, njerëzve të varfër u takon një pjesë e pasurisë së besimtarëve (Kur'an: 51:19). Siç shpall Kur'ani:

Njerëzit e ndershëm dhe të pasur ndër ju të mos betohen se nuk do t'u japin të afërmve, të varfërve dhe të mërguarve në rrugën e Allahut; le t'i falin ata dhe të mos ua marrin për keq! Vallë, a nuk doni ju që t'ju falë Allahu? Allahu është Falës e Mëshirëplotë. (Kur'an, 24:22)


Pasaniku le të shpenzojë sipas pasurisë që ka, ndërsa i varfri le të shpenzojë sipas asaj që i ka dhënë Allahu; Allahu nuk e ngarkon askënd mbi sa i ka dhënë. Pas vështirësisë, Ai sjell lehtësimin. (Kur'an, 65:7)

Zoti ynë po ashtu zbulon se besimtarët janë kujdestarë të njëri tjetrit (Kur'an: 9:71). Fjala "kujdestar" bart kuptime të tilla si shok, ndihmës, këshilltar dhe mbrojtës. Ajo po ashtu shpreh rëndësinë e bashkëpunimit dhe solidaritetit midis kombeve Muslimane. Bashkëpunimi që do të lind nga kjo vetëdije

vëllazërore midis kombeve Muslimane do t'iu sjellë përparim dhe pasuri Muslimanëve dhe do ta çrrënjos varfërinë, që është një problem i madh i botës Islamike. Shoqëritë që pasojnë vlerat e Kur'anit nuk do të përjetojnë uri, skamje dhe varfëri. Muslimanët do t'i zhvillojnë kombet e tyre duke ndjekur politika racionale dhe afatgjata, duke vendosur marrëdhënie të mira me kombet dhe popujt tjerë, duke e çmuar tregtinë dhe zhvillimin dhe duke mësuar nga përvojat e kulturave tjera. Kështu ka qenë në histori dhe, me vullnetin e Zotit, nën udhëheqjen e Unionit Islamik do të jetë kështu përsëri.



THIRRJE PËR UNION ISLAMIK



Moti Mescidi, 1662, Delhi

**Besimtarët dhe besimtare të
dashur për njëri-tjetrin, urdhërojnë për
të mirë, e ndalojnë nga e keqja, e falin
namazin dhe japin zeqatin, respektojnë
All-llahun dhe të dërguarin e Tij. Të
tillët do t'i mëshirojë All-llahu.
All-llahu është ngadhnyes, i urtë.
(Kuran:9/71)**

Badshahi Mosque, 1673, Pakistan

Krijimi i paqes dhe sigurisë

Jostabiliteti nuk prek vetëm një rajon të caktuar; më saktë, ai ka ndikim negativ në botë si tërësi. Bota Islamike është një rajon i tillë. Prandaj, kombet Muslimane nuk duhet të merren parasysh si entitete të ndara dhe të pavarura. Tensionet në Lindjen e Mesme ndjehen në Afrikën Veriore. Ngjarjet në rajonin Kaspik ndikojnë në të ardhmen e Lindjes së Mesme. Ajo që ndodhë në Gjirin Persik ka lidhje të drejtpërdrejt me Azinë Juglindore, që nënkupton se konflikte të tilla në dukje rajonale dhe tensionet ndjehen në tërë botën Islamike. Natyrisht, e njëjta vlen edhe për paqen. Për shembull, zgjidhja e konflikteve të tilla afatgjata si lufta Arabo-Izraelite do të kishte efekt pozitiv në mbarë botën Islamike.

Gjatë tërë shekullit njëzet, një pjesë e madhe e botës Islamike mbeti e bllokuar në luftëra, konflikte dhe jostabilitet të vazhdueshëm. Humbja rezultuese e resurseve gati sa nuk ndaloi zhvillimin ekonomik, u bë shkak që standardet jetësore të bien në nivelin më të ulët dhe ajo që është më e rëndësishmja kushtoi me jetët e miliona Muslimanëve. Madje edhe tani, grindjet dhe konfliktet midis Muslimanëve vazhdojnë dhe nxitin tensione kohë pas kohe. Luftërat dhe konfliktet midis kombeve Muslimane dhe jomuslimane janë burim i madh i jostabilitetit dhe pakënaqësisë. Një përfitim i rëndësishëm i Unionit Islamik është roli që ai do të luaj në sigurimin e paqes dhe sigurisë për botën Islamike. Unioni Islamik duhet të zgjedh grindjet dhe konfliktet ndërmuslimane, si edhe t'i tejkalojë luftërat, konfliktet dhe tensionet në mes tyre dhe vendeve jomuslimane, me anë të mjeteve paqësore dhe pajtuese. Për shembull, një paqe Arabo-Izraelite do t'ia sillte këto të mira botës Islamike:

- Paqja do të mundësonte që secili vend të zvogëlonte shpenzimet ushtarake dhe t'i orientonte resurset financiare drejt krijimit të pasurisë në shoqëri. Pasi që të gjitha vendet Muslimane do të ishin anëtare të paktit të përbashkët mbrojtës, ato do të arrinin siguri më të madhe dhe mbrojtje më të fuqishme me një buxhet më të vogël. Investimet që tani bëhen në industrinë dhe teknologjinë e armatimit do të mund të kanalizoheshin në zhvillimin edukativ, shkencor dhe kulturor.



THIRRJE PËR UNION ISLAMIK

Merrni parasysh faktet në vazhdim: Shpenzimet e përgjithshme për armatim të vendeve të Lindjes së Mesme në vitin 1991, kur shpërtheu lufta e Gjirit, ishin \$ 70.7 miliardë. Shpenzimet në armatim ranë në \$ 52.2 miliardë gjatë viteve në vazhdim, por së shpejti filluan të rriten përsëri. Shpenzimet ushtarake në vitin 2000 ishin \$ 61 miliardë dhe \$ 72 miliardë në vitin 2001.

- Paqëndrueshmëria e tanishme dhe konfliktet në botën Islamike bëjnë që shumë prej mjekëve, inxhinierëve, akademikëve, shkencëtarëve, mendimtarëve dhe shkrimtarëve nga rajoni të shpërngulen në Perëndim, ku ata vazhdojnë punën e tyre, sepse nuk ndihen të sigurt në vendet e tyre amë. Hulumtimi zbulon se kjo shpërngulje nga vendet Arabe i ka kushtuar botës Islamike \$ 200 miliardë. Në të vërtetë, 450,000 e këtyre emigrantëve janë të diplomuar kolegji apo universiteti.²⁴ Një mjedis paqësor do t'i eliminojë tensionet e brendshme dhe do t'i jap fund kësaj shpërngulje. Si përfundim, nga puna dhe aftësitë e individëve me edukim të lartë do të përfitojnë në radhë të parë Muslimanët.

- Paqja do t'ua bëj të mundshme kombeve Muslimane që të shkëmbejnë diturinë dhe

ekspertizën e tyre të akumuluar, të bashkojnë forcat e tyre në çdo fushë dhe t'i ndihmojnë njëri tjetrit të merren me mangësitë e tyre. Si pasojë, këto kombe do të bëhen shumë më efikase në zbatimin e planeve kombëtare të tyre të zhvillimit.

- Zhvillimi ekonomik do të marr hov. Aktualisht, ekzistojnë shumë konflikte midis kombeve Muslimane, posaçërisht lidhur me kufijtë, të cilat vetëm sa shtojnë problemet ekonomike. Për shembull, burimi i vështirësive që përjetojnë në transportimin dhe eksportimin e mallrave tregtare janë linjat e pasigurta të transportit. Kjo vlen po ashtu për ujë, i cili është shkaktari kryesor i konfliktit në Lindjen e Mesme. Konfliktet e tilla mund të zgjidhen nëse vendet Muslimane do të bashkëpunonin dhe do t'i zgjidhnin konfliktet e tyre në mënyrë paqësore.

- Dallimet kulturore dhe etnike do të shndërrohen në një burim të pasur në një mjedis paqësor, mjedis që do të karakterizohet me tolerancë dhe dialog. Njerëzit nuk do të kenë paragjykimet dhe do të jenë më produktiv dhe një përzierje e tillë e kulturave të ndryshme do të mundësojë ngritjen e një qytetërimi të ri.

- Paqja po ashtu do t'i forcojë Muslimanët që jetojnë jashtë botës tradicionale Islamike. Islami

është njëra prej feve me rritjen më të shpejtë në shumë vende jomuslimane. Nëse këto grupe etnikisht të ndryshme të Muslimanëve bashkohen, ato do ta ndihmojnë përhapjen e Islamit dhe do t'ia bëjnë të mundshme vetes të kenë ndikim më të fuqishëm kulturor në shoqëritë e tyre. Efikasiteti i përpjekjeve individuale të ndërmarra nga bashkësitë e vogla dhe të ndara Muslimane është i pakrahasueshëm me përpjekjet e bashkuara intelektuale të ndërmarra nga një aleancë e bashkuar. Natyrisht se Muslimanët do të ruajnë identitetet e tyre kombëtare, mirëpo, ata do të bëhen një forcë shumë më e madhe nëse veprojnë si një trup të udhëhequr nga vetëdija dhe morali Islamik.

- Një botë paqësore Islamike do të bëhet shembull për vendet tjera dhe konfliktet ekzistuese do të zgjidhen në mënyrë paqësore sipas shembullit të vendosur nga bota Islamike. Muslimanët do të jenë shembull i gjallë për gjetjen e paqes dhe sigurisë kur të praktikohen vlerat e Kur'anit. Veç kësaj, ata do të dëshmojnë për faktin se Islami është një fe e paqes dhe tolerancës. Paqja në botën Islamike madje do të mund t'i udhëzojë shumë njerëz drejt parimeve morale Islamike.

Rindërtimi i një qytetërimi madhështor

Me themelimin e Unionit Islamik, paqja dhe siguria do të rrënjosen, problemet ekonomike do të zgjidhen dhe do të ndodhë një përparim masiv kulturor, sepse do të ketë buxhete në rritje për edukim, shkencë dhe kulturë. Në këtë mënyrë, Muslimanët do të ndërtojnë një qytetërim të ri që do të shërbejë si shembull për pjesën tjetër të botës. Vënia në jetë e unionit dhe solidaritetit që urdhëron Kur'ani do të ndikojë që

vlerat e tij të kenë ndikim të drejtpërdrejt mbi jetën e përditshme, artin, dekorimin, modën, mjekësinë, shkencën dhe teknologjinë e gjithë Muslimanëve. Miqësia dhe ndjenja vëllazërore do të përparojnë, paqja dhe rendi do të sundojnë jetën shoqërore, njerëzit do të gjejnë më shumë kohë për të medituar dhe për të bërë hulumtime dhe do të kenë më shumë liri të menduarit dhe nuk do të kenë paragjykime kur të veprojnë kështu. Mjediset pa kaos, varfëri dhe telashe janë vendet ku formësohen ide të reja, dalin produkte të reja, bëhen shpikje të dobishme dhe arrihet përparim i vazhdueshëm. Unioni Islamik do të krijojë një mjedis të tillë në mbarë botën Islamike.

Në pjesën e parë të librit, ne kemi analizuar historinë e qytetërimit Islamik. Ky qytetërim është tregues i mjedisit në të cilin do të jetojnë gjeneratat e ardhshme të Muslimanëve. Historia dëshmon se Muslimanët të cilën praktikuan vlerat e Kur'anit ndërtuan një qytetërim të fuqishëm që jetoi për shumë shekuj. Në Kur'an, Zoti i urdhëron njerëzit që të mendojnë, vrojtojnë dhe vënë re hollësitë e brishta. Nga Muslimanët kërkohet që të mendojnë për qeniet në

mjediset që i rrethojnë ata, të përsiatin mbi rregullin në të cilin jetojnë dhe të përpiqen të kuptojnë urtësinë që qëndron prapa gjithë kësaj. Zoti ynë thotë:

A nuk e shohin ata qiellin që qëndron sipër tyre, si e kemi ndërtuar dhe zbukuruar, pa pasur kurrfarë plasaritje në të? Ndërsa Tokën e kemi shtruar dhe në të kemi shpërndarë male të palëvizshme dhe kemi bërë, që nga ajo, të mbijnë gjithfarëlloj bimësh të bukura, si mjet ndriçimi të mendjes dhe përkujtesë për çdo rob që i drejtohet Zotit të vet. Ne lëshojmë nga qielli ujë të bekuar dhe nëpërmjet tij krijojmë kopshte, drithëra që korren dhe palma hurme të larta me tufa frutash njëra mbi tjetrën. (Kur'an, 50:6-10)

Ata të cilët jetojnë sipas vlerave të Kur'anit, të cilët meditojnë pa rënë nën ndikimin e dogmave, besimeve të rrejshme ose paragjykimeve, mendojnë për çdo gjë që përjetojnë nga të gjitha këndvështrimet. Këto cilësi iu mundësojnë të zbulojnë gjëra të dobishme për njerëzimin dhe të sajojnë sisteme që lehtësojnë barrën e jetës dhe rrisin rehatinë e njeriut. Unioni Islamik do të hap një kapitull të ri në shkencë dhe teknologji për botën Islamike dhe, të pajisur me këtë vizion, Muslimanët do të ndërtojnë një qytetërim që krijon shkencë.

Një fushë në të cilën shfaqen të menduarit subtil i Muslimanëve dhe vetëdija e thellë është arti. Në thelb të artit qëndrojnë aftësitë për të reflektuar, për të vërejtur finesat, për t'u kënaqur me atë që sheh dhe për ta përcjellë këtë kënaqësi tek të tjerët. Vetëdija artistike e dikujt që beson në Kur'an dhe i vë në jetë vlerat e Kur'anit është e një natyre superiore, sepse Muslimanët konsiderojnë se arti është një formë hyjnore e bukurisë dhe veprat e artit i marrin si objekte që reflektojnë pushtetin dhe fuqinë e Zotit dhe madhësitinë e krijimit. Në

**Pastaj, Ai është që
nënshtroi detin, që prej
tij të hani mish të
freskët, e prej tij të
nxirrni stoli që i bani
(i vishni), e i sheh anijet
si çajinë (lundrojnë) në të
(me ushtimë e çajinë ujin
në det). Ua nënshtroi që
të shfrytëzoni nga
begatitë e Tij dhe ashtu
të falënderoni (Zotin).**

(Kuran: 16/14)

botën Islamike, artistët frymëzohen nga vlerat e Kur'anit dhe kanë thellësi të ndjenjave, talent dhe intelekt të patejkalueshëm. Me formimin e Unionit Islamik, do të krijohen shumë më tepër vepra arti që reflektojnë ndjenjën artistike të Muslimanëve, qytetet do të bëhen më të bukura, do të ngriten ndërtesa madhështore dhe kualiteti i jetës do të rritet pamasë.

Kombet Islamike do të njihen për pastërtinë e tyre, rregullin, veprat e artit, të arriturat kulturore dhe zhvillimet teknologjike. Banorët e tyre do të përfitojnë nga mjetet dhe pajisjet e siguruara përmes teknologjisë, sepse përparimi, pasuria dhe bukuria do ta dominojnë çdo aspekt të jetës. Muslimanët gjithmonë do të takojnë të bukurën, sepse shtëpitë e tyre, kopshtet, zbukurimet e shtëpive, veshja, muzika, argëtimi, teatrot, kinematë, pikturat dhe bisedat do të reflektojnë bukurinë e tyre të brendshme shpirtërore.

Mirëpo, që të ndodhë gjithë kjo, duhet të ndodhë një zgjim madhështor. Traditat e rrejtshme, strukturat shoqërore dhe mendësitë që frenojnë Muslimanët duhet të mënjanoohen dhe të zëvendësohen me një vizion dhe parime morale të bazuara në Kur'an, në mënyrë që unioni të jetë racional, stabil, plotë gjallëri dhe pa paragjykime – pikërisht siç ishte me gjeneratat e para të Muslimanëve. Islami



nuk kërkon largim nga kjo botë; më saktë, nga Muslimanët kërkohet që ta kuptojnë natyrën e vërtetë të botës dhe pastaj ta ndriçojnë rrugën që gjithë njerëzit ta pasojnë atë. Është e drejtë e Muslimanëve të kënaqen me të mirat e kësaj bote. Ata të cilët besojnë me sinqeritet dhe jetojnë sipas urdhrave të Zotit do të përjetojnë të gjitha gjërat e bukura që Zoti i ka shpallur në Kur'an, njëra prej të cilave është një jetë e mirë në Tokë, si vijon:

Gjithçka që keni ju, është kalimtare, ndërsa ajo që ndodhet tek Allahu, është e përhershme. Vërtet, Ne do t'i shpërblejmë ata që kanë duruar sipas veprave më të mira që kanë bërë. Cilindo mashkull apo femër që kryen vepra të mira, duke qenë besimtar, Ne do ta bëjmë që të kalojë jetë të bukur dhe do ta shpërblejmë sipas veprave më të mira, që ka bërë. (Kur'an, 16:96-97)

Njohja e tjerëve me parimet morale Islamike

“Le të dalë prej jush një grup që të thërrasë për në mirësi, të urdhërojë për vepra të mira e të ndalojë prej veprave të shëmtuara” (Kur'an, 3:104). Njëra prej detyrave të rëndësishme të Muslimanëve është ta urdhërojnë të mirën, ta ndalojnë të keqen dhe t'i thërrasin njerëzit në moralin Islamik.

Megjithatë, kaosi dhe rrëmuja e tanishme në botën Islamike i ndalon Muslimanët nga përmbushja e kësaj detyre, edhe pse shumë jomuslimanë kanë interesim të shtuar për Islamin dhe vlerat e Kur'anit. Ekzistenca dhe njësia e Zotit, parimet themelore të Islamit, jeta e Profetit tonë (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të), që urdhëron Kur'ani dhe mënyra se si duhet të jetë e ndërtuar shoqëria Islamike tani janë bërë tema të zakonshme në Perëndim. Pasi që është e natyrshme që njerëzit e interesuar t'iu drejtojnë Muslimanëve pyetje të tilla, Muslimanët duhet të jenë në gjendje ta përfaqësojnë Islamin në mënyrën më të mirë të mundshme. Në Perëndim kjo don të thotë nëpërmjet produksioneve profesionale audio-vizuale, konferencave, takimeve dhe botimeve. Për më tepër, në baza individuale ata duhet të shërbejnë si shembull për njerëzit me të cilët bien në kontakt.

Unioni Islamik është po ashtu i domosdoshëm për t'iu zgjidhur shumë probleme të shkaktuara nga distancimi i njerëzve nga morali fetar. Qarqet që kundërshtojnë moralin fetar punojnë që të mbizotërojnë mosbesimi dhe shpeshherë

bashkërendojnë veprimet e tyre në mënyrë që të lëvizin përpara së bashku. Pa marr parasysh se sa shumë

bazohet aleanca e tyre në egoizëm, veprimi

i bashkërenditur i tyre e bën shumë

të lehtë që ata t'iu arrijnë objektivat

e tyre. Edhe pse çdo sistem i të

menduarit që i kundërvihet

moralit fetar është i

përcaktuar të dështojë,



Muslimanët, prapëseprapë, duhet t'i luftojnë këto sisteme me anë të një lufte të madhe ideologjike për t'i mposhtur ato. Për këtë arsye, njëra prej përgjegjësive më urgjente të Muslimanëve është që t'u japin fund dallimeve të tyre të brendshme në mënyrë që të mund t'i përhapin vlerat e Kur'anit dhe t'i thërrasin njerëzit në rrugën e Zotit. Zoti ynë shpall përgjegjësinë e besimtarëve lidhur me këtë në ajetin në vazhdim:

Kurse jobesimtarët janë miq e mbrojtës të njeri-tjetrit. Nëse nuk veproni ashtu siç jeni urdhëruar, do të bëhet ngatërresë dhe shkatërrim i madh në Tokë. (Kur'an, 8:73)

Krijimi i Unionit Islamik do ta shtojë ritmin e të gjitha përpjekjeve të bëra për të përhapur moralin e Kur'anit. Si në shumë fusha tjera, një përpjekje e tillë e bashkuar do të shpërblehet shumëfish dhe dituria e vërtetë do të arrijë tek njerëzit shumë më shpejtë dhe në mënyrë shumë më të mirë. Tani, Muslimanët po bëjnë përpjekje individuale si edhe të bashkuara për të shpjeguar dhe përhapur Islamin. Mirëpo, Unioni Islamik do t'i bëjë këto përpjekje më praktike dhe më të rregullta. Për më tepër, ca njerëz të cilët pretendojnë se përfaqësojnë Islamin por shpalosin ashpërsi dhe vrazhdësi, të cilat nuk bëjnë pjesë në Islam, do të mposhten; Islami i vërtetë do të definohet dhe stereotipat e pasakta të krijuara nga njerëz të caktuar do të asgjësohen.



SHBA-TË
LINDJA E MESME
DHE
UNIONI
ISLAMIK


Sulmet e 11 Shtatorit (9/11) në Qendrën Tregtare Botërore dhe në Pentagon shënojnë një pikë kthese dhe fillimin e rendit të ri botëror. Disa ekspertë parashikuan që ky sulm do të çojë drejt një konflikti dhe dhune më të madhe, ndërsa shumica e zërave theksuan se përgjigja e Amerikës dhe politikat e ardhme duhet të jenë të matura dhe të drejta.

Si pasojë e sulmeve, Amerika filloi një ofensivë të gjerë kundër terrorizmit. Shumica e vendeve dhe organizatave ndërkombëtare e përkrahën këtë përpjekje, e cila, në thelb, është një veprim ushtarak i drejtuar kundër terrorizmit dhe të gjitha organeve që e përkrahin atë. Aktualisht, përveç disa sukseseve të pjesshme, kjo luftë nuk i ka arritur objektivat e saj ose nuk ka arritur një fitore bindëse.

Njëra prej arsyeve kryesore për këtë dështim është se strategjia Amerikane bazohet kryesisht në veprimet ushtarake deri në përjashtim të çfarëdo mase edukative dhe kulturore. Masat ushtarake, siç është largimi i regjimeve që përkrahin terrorizmin, nuk mund ta mposhtin terrorizmin, sepse terrorizmi është një problem socio-psikologjik dhe ideologjik. Një strategji e tillë vetëm ushtarake krijon tragjedi në të cilat shumë njerëz të pafajshëm humbin jetën, si edhe radikalizmin që, si pasojë, bëhet edhe një faktor tjetër që ushqen terrorizmin. Vetëm një luftë intelektuale mund ta shpërbëjë propagandën terroriste dhe ta çrrënjosë terrorizmin në mënyrë efikase.

THIRRJE PËR UNION ISLAMIK

The 9/11 attacks that targeted innocent people were denounced by Muslims, like the rest of the world.



Veprimet ushtarake duhet të përdoren vetëm kur kjo është e përshtatshme.

Për këtë arsye, lufta kundër terrorizmit duhet të zhvillohet brenda rregullave të ligjit ndërkombëtar dhe me përdorimin e masave paqësore por efikase. Çdo aktivitet që shpërfill ligjin dhe të drejtat njerëzore, në veçanti kur shkakton vdekjen e civilëve, do të hedh një hije mbi këtë luftë, madje edhe pse ajo filloi si një kauzë e drejtë. Për udhëheqjen Amerikane është me rëndësi të kujtojnë këto fakte kur përcaktojnë strategjinë e saj, sepse është psikologjia dhe ideologjia e terrorizmit që duhet të shkatërrohet. I ashtuquajtur "terrorizëm Islamik" që mendohet se qëndron pas 9/11 ushqen grupet radikale që interpretojnë Kur'anin në mënyrë të gabueshme. Morali i vërtetë i Islamit duhet t'i zëvendësojë interpretimet e tilla të shtrembëruara të fesë dhe njerëzit duhet ta mësojnë këtë moral që bazohet në Kur'an në vend të keqinterpretimeve që shpijnë drejt terrorizmit.

Përprjekjet e Amerikës për ta zgjidhur këtë problem nga jashtë nuk do të kenë sukses. Pasi që problemi buron nga një pikëpamje e gabueshme e moralit Islamik, zgjidhja e tij duhet të vjen nga brendia e botës Islamike. Muslimanët duhet të ndihmojnë në zëvendësimin e këtyre pikëpamjeve me të kuptuarit e drejtë të parimeve Islamike dhe t'i ndalojnë ata të cilët e keqkuptojnë Islamin për të mos vepruar nga zemërimi. Pra, politika Amerikane duhet

THIRRJE PËR UNION ISLAMIK



ta përkrah një zgjidhje që buron nga bota Islamike. Siç kemi pohuar gjatë tërë kohës, e vetmja zgjidhje realiste është krijimi i Unionit Islamik.

Është në interesin më të mirë të Amerikës ta përvetësojë këtë qasje, pa përmendur se është në interesin më të mirë të botës Islamike dhe të botës në përgjithësi. Ata të cilët mendojnë ndryshe duhet ta rishikojnë këtë qëndrim, pasi që ata lehtë mund ta tërheqin botën në gjakderdhje. Udhëheqja Amerikane duhet të jetë gjithashtu e kujdesshme të mos hutohet nga keqinterpretimet e tilla që e shtyjnë atë ta identifikojë Islamin si një fe dhe kulturë armiqësore. Njerëzit që qëndrojnë pas shtrembërimeve të tilla janë strategët dhe ideologët të cilët duan të ndodhë një luftë e përgjakshme midis Perëndimit dhe botës Islamike. Ata po bëjnë çmos që t'i paraqesin politikat antiterroriste Amerikane si luftë ndaj Islamit. Disa paraqitje të arsyeshme të udhëheqjes Amerikane, të cilat hedhin poshtë idenë e një lufte midis Perëndimit dhe Islamit, kanë pasur efekte pozitive; mirëpo, komuniteti botëror ka nevojë t'i shoh ato si politika Amerikane që kanë ndikim.



Si mund të ndihmojë Amerika në arritjen e paqes botërore?

Pas 9/11, administrata e Bushit shpalli një strategji të ri kombëtare për sigurinë dhe politikën e jashtme. Një javë pas sulmeve terroriste, Presidenti Bush shpalli kornizën e kësaj strategjie në fjalimin e tij drejtuar kombit. E njohur si "Doktrina e Bushit", ajo shpallte, në fakt, se Amerika do të angazhohej në sulme parandaluese për ta mbrojtur vetveten. Përderisa sulmet e tilla ndonjëherë mund të arsyetohen, në realitet ajo nënkuptoi fillimin e një epoke të re. Kjo strategji është krijuar nën psikologjinë e përhapur menjëherë pas këtyre sulmeve, duke nxitur tej mase ndjenjat patriotike të Presidentit Bush. Disa qarqe agresive në vend sakaq sugjeruan se kjo strategji e re duhet të ketë në shënjestër gati tërë Lindjen e Mesme dhe se kombi duhet të jetë i gatshëm ta përballojë një luftë 20 vjeçare në këtë rajon. Qarqet më pak nxitëse theksuan të metat e një qasjeje të tillë dhe pohuan se ajo rrezikonte përshkallëzimin e terrorizmit. Para se të ekzaminohen rreziqet e mundshme, është e nevojshme të qartësohet kuptimi i "sulmit parandalues".

Amerika, superfuqia e vetme botërore, në mënyrë krejt të



Paul Wolfowitz, the former American Deputy Secretary of Defense, was one of the theoreticians of the "Bush Doctrine" developed after 9/11.



American intervention in Bosnia-Herzegovina and Kosova played a major role in restraining Serbian violence.

natyrshme duhet të ketë interes politik, si edhe një strategji, në pjesë të ndryshme të botës. Veç kësaj, intervenimi ushtarak Amerikan ka pasur disa rezultate pozitive. Për shembull, në vitet e 1990-ta, intervenimi diplomatik dhe ushtarak Amerikan që ka pasur në shënjestër Serbinë, e cila së pari sulmoi Bosnjën e Hercegovinën e pastaj Kosovën, luajti një rol të rëndësishëm në ndalimin e agresionit Serb. Me rëndësi këtu është se a janë apo nuk janë politikat e tilla Amerikane në përputhje me ligjin ndërkombëtar dhe nëse janë apo nuk janë ato të drejta dhe pajtuese, në pajtim me të drejtat e njeriut dhe a i mbrojnë ato në mënyrë të drejtë të drejtat e secilit grup.

THIRRJE PËR UNION ISLAMIK

The twentieth century was full of wars that killed millions of people and caused heavy material losses. In this new century, humanity must seek peaceful solutions to all such problems.



Në marrëdhëniet ndërkombëtare, masat parandaluese mbrojtëse nga ana e vendeve individuale zakonisht pranohen me një shkallë tolerance. Natyrisht, çdo vend dëshiron ta mbrojë ekzistencën dhe të ardhmen e vet dhe prandaj zhvillon strategji për këtë qëllim. Mirëpo, kjo qasje mbrojtëse nuk duhet të lejojë intervenim të pajustificueshëm në punët e një kombi tjetër. Strategjia më e suksesshme dhe më e sigurt që një vend duhet ta përvetësojë është ajo që përpiqet ta ruaj paqen dhe lumturinë. Strategjitë paqësore i shpijnë njerëzit drejt përparimit dhe sigurisë dhe çdo përpjekje për ta çrregulluar paqen dhe rendin ekzistues është shumë e rrezikshme.

Ata të cilët mbështetin sulmet parandaluese, brenda udhëheqësisë Amerikane, propozojnë strategji shumë të rrezikshme që tejkalojnë të drejtat legjitime të një shteti për vetëmbrojtje. Sipas kësaj mendësie me të meta, e cila bën përpjekje për të përgatitur terrenin për të gjitha llojet e sulmeve, pohimi se “ata mund të përbëjnë një kërcënim në të ardhmen” është justifikimi i përkryer. Mirëpo, orientimi vetëm nga mjetet ushtarake për të zgjidhur konfliktet nuk mund të ketë sukses, siç e ka dëshmuar historia sa e sa herë.

Sipas kësaj logjike të mangët, marrëdhëniet ndërkombëtare nuk varen nga ligji, por nga forca. Këta njerëz do të dëshironin të shihnin se si Amerika tregon forcën e saj dhe u demonstroi qartë kundërshtarëve të saj se kombi është ende i fortë. Fajkonjtë e administratës së Bushit besojnë gabimisht, se Amerika mund ta mbajë fuqinë e saj superiore ushtarake vetëm nëpërmjet luftës dhe se për këtë arsye duhet gjithmonë ajo të jetë e para që sulmon. Megjithatë, jo të gjithë pjesëtarët e administratës së Bushit ndajnë këtë qëndrim të rrezikshëm. Kohë pas kohe, fajkonjtë fitojnë përparësi në politikën Amerikane. Mirëpo,

shumë burokratë si edhe këshilltarë përkrahin një politikë të matur dhe paqësore.

Të gjitha vendet, në veçanti Amerika, duhet të përpiqen për paqe dhe duhet ta mbrojnë dhe ta përkrahin atë me çdo kusht. Qarqet që mbështesin idetë se “fuqia është e drejtë” apo “përdorimi i forcës do t’i zgjidh problemet në masë të njëjtë me përdorimin e saj” janë, në realitet, duke e çuar vendin e tyre drejt një situatë pa rrugëdalje. Një aspekt i kësaj është rreziku i përshkallëzimit të terrorizmit. Shumë strategë theksojnë se Amerika ka filluar ta humbas fuqinë e saj ekonomike si edhe politike. Fuqia e ushtrisë Amerikane fare mirë mund të ketë përparësitë e saj, por kërcënimi i vazhdueshëm i luftës, si edhe gjendja e vazhdueshme e alarmit dhe gatishmërisë për luftë e trumbetuar prej fajkonjve, do t’i jap një goditje të rëndë ekonomisë së saj.

Veç kësaj, nëse ky shtet është gjithmonë në luftë diku në botë, njerëzit më nuk do ta konsiderojnë atë si mbrojtës të të drejtave njerëzore, demokracisë dhe lirisë. Si pasojë e politikave të saj prej agresive, Amerika do të shndërrohet në një komb që ngjallë frikë, në vend të respektit nga bashkësia botërore. Edhe nëse janë arritur disa objektiva ushtarake, Amerika do të vuaj ekonomikisht dhe do ta dëmtojë imazhin e saj ndërkombëtar. Pra, ky do të jetë vetëm një sukses i kufizuar për vendin. Në realitet, qeveria Amerikane po ashtu nuk dëshiron të përfundojë në një situatë të tillë dhe për këtë arsye duhet të jetë e kujdesshme dhe e matur kur merr parasysh pikëpamjet e mangëta të fajkonjve dhe të bëj gjithë çka është e mundur të ndjekë politika të arsyeshme.

Për më tepër, këto qarqe duhet të marrin në konsideratë shembullin që po e krijojnë për kombet tjera dhe të llogaritin

kostot e mundshme të vendeve tjera që sillen në të njëjtën mënyrë për t'i mbrojtur interesat e tyre. Është mjaftë e qartë se çfarë rrëmuje dhe konflikti do të përjetonte bota po ta përvetësonin strategjinë e sulmit parandalues vendet e tilla me armatim bërthamor si Rusia, Kina, India apo Izraeli. Madje vetëm mundësia e një skenari të tillë paraqet një kërcënim të madh.

Është e qartë se Amerika ka të drejtë t'i mbrojë interesat e saj kombëtare dhe ta mbrojë veten nga kërcënimet e mundshme. Bashkësia ndërkombëtare e respekton këtë, posaçërisht pas tragjedisë së 9/11. Mirëpo, kjo e drejtë mund të përdoret që Amerika dhe bota në tërësi të përfitojnë prej kësaj nëse përdorimi i saj është në përputhje me ligjin ndërkombëtar. Mekanizmat më të rëndësishëm për ta parandaluar që kjo strategji të mos zbres në nivelin e një lufte personale janë ligji ndërkombëtar dhe konsensusi i gjerë i bashkësisë ndërkombëtare i arritur brenda strukturës së saj. Nëse shpërfillen këto organizma, ithtarët e kësaj strategjie do ta shpijnë Amerikën në krizë dhe do të paraqesin kërcënim për paqen botërore.

Amerika duhet ta rishikojë strategjinë e saj nën dritën e të gjitha shqetësimeve të mësipërme. Rruga drejt paqes dhe stabilitetit botëror nuk mund të jetë agresioni dhe dhuna, por arsyeja e shëndoshë, drejtësia dhe maturia. Strategjia parësore për luftën e saj kundër terrorizmit duhet të jetë përkrahja e aktiviteteve kulturore. Për të mposhtur çdo ideologji që konsideron se dhuna është zgjidhje, që i konsideron raportet ndër-njerëzore si burim të përfitimit personal dhe agresionin si të ligjshëm, duhen luftuar rrethanat që nxisin terrorizmin. Pranimi i gjerë i moralit fetar, i cili kërkon tolerancë, ndërgjegje, dashuri dhe dhembshuri në vend të së keqes të nxitur prej ideologjive

THIRRJE PËR UNION ISLAMIK

The fact that war is not a solution has been expressed many times by American citizens and civil society, such as the American National Council of Churches. Many religious leaders have stated that pious Americans are in favor of peace.

Church Leaders Against War in Iraq
by repost : Thursday October 10, 2002 at 01:22 AM

Robert Edgar, general secretary of the National Council of Churches and a former six-term member of the U.S. House of Representatives, issued the following statement on September 12, 2002:

The Honorable George W. Bush
President of the United States of America
The White House
Washington, D.C. 20500

Dear Mr. President:

We, like all Americans, kneel in prayer and remembrance for the tragedy and violence that obliterated the lives of so many people one year ago. As American religious leaders, we have sought during this year to listen, to learn, and to grow in our faith and compassion both for persons in our congregations and also for those many outside of our churches. We applaud your leadership in bringing peoples of disparate faiths together to worship, to mourn, and to move on boldly with our lives - in a more caring fashion and with appreciation for the precious gifts of God given to all humankind. Today, however, we write out of concern that those same precious gifts may be damaged by actions being contemplated by the Administration.

We, leaders of American churches and church-related organizations, are alarmed by recent statements by yourself and others in the Administration about pre-emptive military action against Iraq for the expressed purpose of toppling the regime of Saddam Hussein. Understanding that Mr. Hussein poses a threat to his neighbors and to his own people, we nevertheless believe it is wrong, as well as detrimental to U.S. interests, to take such action.

We oppose on moral grounds the United States taking further military action against Iraq now. The Iraqi people have already suffered enough through more than two decades of war and severe economic sanctions. Military action against the government of Saddam Hussein would result in a large number of civilians being killed or wounded, as well as the displacement of multitudes of innocent people.

We urge the Administration to show a willingness to take unilateral military action when there continues to be no progress toward a new, verifiable inspection regime and when most



United for Peace and Justice is an NGO that uses the Internet to call for peace.



Veterans against the Iraq war is another NGO that carries out an anti-war campaign.

anti-fetare, do të sigurojë zgjidhje të qëndrueshme për terrorizmin dhe shumë të këqija tjera shoqërore.

Programet e përshtatshme kulturore mund të realizohen nëpërmjet bashkëpunimit Amerikan me organizatat joqeveritare, shumica e të cilave tani janë duke punuar në këto çështje. Kjo është një shenjë inkurajuese, pa dyshim, por zgjidhjet e qëndrueshme kërkojnë mbështetjen e shtetit dhe zgjerimin e shtrirjes së këtyre përpjekjeve.

Veç kësaj, qeveria Amerikane nuk duhet të harroj se parimet qendrore të Krishterimit kundërshtojnë luftën dhe armiqësinë. Zoti iu ndalon njerëzve të nxitin rrëmujë apo të rrezikojnë paqen dhe sigurinë. Po t'i respektoj Amerika besimet fetare, ajo duhet të bëhet një shembull për të gjithë njerëzit duke u përpjekur që të sjellë paqe dhe siguri, jo shqetësim dhe frikë. Ata pjesëtarë të administratës së Bushit të cilët shpesh ndiejnë nevojën ta përmendin besimin e tyre të Krishterë nuk duhet të harrojnë se Jezusi i urdhëron ata të jenë ambasadorë të paqes **“Të bekuar janë pajtuesit.”** (Mateu 5:9).

Udhëheqësit fetar Amerikan e kanë përkujtuar administratën e Bushit lidhur me këtë. Në një letër (me 50 nënshkrues) drejtuar Presidentit Bush në ditët para pushtimit Amerikan të Irakut, Këshilli Kombëtar i Kishave (NCC) dha porosi të rëndësishme:

Ne po ju shkruajmë të shqetësuar se ato dhurata të njëjta të çmuara (të Zotit) mund të dëmtohen përmes veprimeve të parashikuara nga kombi ynë.

Ne, udhëheqësit e kishave Amerikane dhe të organizatave që kanë lidhje me kishat, jemi të alarmuar nga deklaratat e kohës së fundit nga ana juaj dhe e të tjerëve në Administratë për aksionin parandalues ushtarak kundër Irakut me qëllimin e

THIRRJE PËR UNION ISLAMIK



Harun Jahja (Adnan Oktar)



shprehur të përmbysjes së regjimit të Sadam Huseinit. Duke e pasur të qartë se Z. Huseini paraqet kërcënim për fqinjët e tij dhe për popullin e tij, ne megjithatë besojmë se ndërmarrja e këtij aksioni është gjë e gabueshme, si edhe e dëmshme për interesat e SHBA-ve.

Ne kundërshtojmë që SHBA-të të ndërmarrin veprime të mëtejshme ushtarake kundër Irakut tani në baza morale... Aksioni ushtarak kundër qeverisë së Sadam Huseinit dhe periudha pas saj mund të rezultojë me një numër të madh të civilëve të vrarë apo të plagosur, si edhe do të shtohet vuajtja e një numri të madh njerëzish të pafajshëm.

... Si udhëheqës fetar të Krishterë përgjegjës për miliona qytetarë të SHBA-ve ne presim që qeveria jonë të reflektoj për parimet morale dhe vlerat që ne i konsiderojmë të shtrenjta – kërkimin e paqes, jo të luftës, bashkëpunimin me bashkësinë e kombeve, mospërmbysjen e qeverive me forcë; respektimin e ligjit dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare duke e vlerësuar lartë jetën njerëzore.²⁵

Shkatërrimi i shkaktuar nga lufta

Lufta është një e ligë që gjithnjë iu sjellë dhimbje dhe lot palëve në luftë dhe që shkakton humbje të tmerrshme. Morali fetar kërkon që njerëzit t'i zgjedhin konfliktet e tyre në mënyrë paqësore dhe në mënyrë pajtuese. Ata të cilët jetojnë sipas moralit fetar përmbahen nga pozicione të tilla të dëmshme si urrejtja, hakmarrja dhe zemërimi. Në vend të kësaj, ata përvetësojnë një qëndrim tolerant dhe falës. Kur njerëzit janë të larguar nga morali fetar, zhvillohet një mjedis i favorshëm për konflikt të brendshëm dhe të ndërsjellë shoqëror. Prandaj, dy luftërat botërore ishin të këqija që u shkaktuan nga ideologjitë

jofetare. Lufta e Parë Botërore shkaktoi rrënim nga Evropa deri në Lindjen e Mesme dhe mbyti më shumë se 10 milionë njerëz, ndërsa Lufta e Dytë Botërore, e cila, si edhe e para, nuk kishte arsyetim të vlefshëm, përfundoi me një gjakderdhje të tmerrshme që kushtoi me 55 milionë jetë. Të mbijetuarit ishin dëshmitarë të mizorive që rrallëherë janë parë në histori dhe miliona njerëz të pafajshëm vdiqën në kampet e përqendrimit.

Ajo që është për të ardhur keq është fakti se këto dy luftëra botërore dhe shkretimi që rezultoi prej tyre ende nuk i kanë bindur shumë njerëz se çfarë fatkeqësie e tmerrshme është në të vërtetë lufta. Lufta e Dytë Botërore nuk i dha fund konfliktit dhe luftës, në vend të kësaj, luftëra të reja shpërthyen në mbarë botën, vrasjet vazhduan dhe ambiciet politike të disa njerëzve mbytën me miliona njerëz, gjymtuan me mijëra e mijëra njerëz, shkatërruan qytete të tëra dhe shkretuan vende të tëra. Luftërat kanë shkaktuar po ashtu dëmtim serioz psikologjik për të mbijetuarit dhe dëmtuan mirëqenien shpirtërore të një gjenerate të tërë. Luftërat krijuan njerëz të cilët përjetojnë sulme ankthi, dridhen pa kontroll dhe përjetojnë frikë të madhe vetëm me të dëgjuar të fjalës “bombë” apo me të parë një uniformë. Disa prej tyre kanë mbetur skizofrenik për vite të tëra për shkak të terrorit që e kanë përjetuar dhe të tjerët kanë dështuar të ri-përshtaten në shoqëri.

Ata të cilët besojnë se lufta mund t’i zgjidhë problemet kanë besim vetëm në zgjidhjet ushtarake. Ata të cilët planifikojnë luftëra të reja, në veçanti në Lindjen e Mesme, duhet të kujtojnë tragjeditë e mëparshme njerëzore dhe të braktisin planet e tyre të rrezikshme. Kostoja e pushtimit të Irakut zbulon një dimension tjetër të këtyre çështjeve.

DARWINISM IS THE ROOT OF TERRORISM

Darwinism's encouragement of conflict, barbarity and war is in fact far more serious in scale than what is superficially touched on above. It is evident that Darwinist philosophy has brought humanity nothing but blood, suffering and tears. People educated in the Darwinist mindset have been brainwashed with ruthless ideas to treat one another as if they were animals and even regard killing one another as perfectly normal. Ideologies that favor violence and inflicted terrible disasters on mankind in the 20th century supported, on the basis of Darwinism, "conflict or war against those who are not of us" and even adopted this as their most important operational technique. Horrifying acts of terror in the present day show how particularly influential the false idea of "man as a fighting animal," which is inculcated by Darwinism in people's subconscious minds, is.



What supposedly justifies terror and violence for these people is such dangerous slogans, based on Darwinism, as "only the strong survive," "big fish eat little fish," "war is a virtue" and "man advances by waging war." Actually, once Darwinism is done away with there will be no more philosophies of "conflict."

The three Divine religions that most people in the world believe in, Islam, Christianity and Judaism, all oppose violence. As we shall be seeing in the sections that follow, all three religions wish to bring peace and harmony to the world, and oppose innocent people being killed and suffering cruelty and torture. Conflict and violence violate the morality that Allah has set out for man, and are abnormal and unwanted concepts. However, Darwinism sees and portrays conflict and violence as natural, justified and correct concepts that have to exist. For this reason, the root of the terrorism that plagues our planet is not any of the Divine religions, but in irreligion, and its expression in our times: "Darwinism" and "materialism." Since Darwinism is taught in just about all schools in almost every country in the world, as if it were a scientific fact, it is inevitable that new generations of terrorists will emerge. That is why it is a matter of the greatest urgency for young people taught that their ancestors were animals that came into being by so-called chance, that they have no responsibility toward Allah and that they can only survive by being victorious in war and conflict should be kept away from such dangerous ideas. Young people brought up in the light of such corrupt ideas can become ruthless enough to slaughter innocent children and perpetrate all kinds of actions that violate reason and good conscience.

Indeed, the communist, fascist and racist terror groups that have plagued the world in the last century have all been the product of this education system.


In conclusion, the solution lies in a powerful cultural campaign against Darwinism, the true root of terrorism, and teaching young people fear of Allah and to behave rationally and virtuously. The result will be societies that produce people full of peace, feeling of safety, forgiveness and compassion, as Allah reveals in the Qur'an.

**Mos bëni çrregullime në tokë
pas rregullimit të saj (me të
ardhur të pejgamberëve) dhe
luteni Atë duke pasur frikë
(dënimin) dhe duke shpresuar
(mëshirën): S'ka dyshim se
mëshira e All-llahut është
pranë atyre të mirëve.**


(Kuran: 7/56)



The two world wars caused great destruction and killed millions of people. Humanity needed a long period of time to heal their wounds.







Not a trace will remain of these painful sights once Darwinism has been intellectually eradicated and the Turkish-Islamic Union has been built. The warmth, affection, compassion and love brought with them by the moral values of the Qur'an will enfold all people, and all will, no matter what their faiths or beliefs, live together as brothers.

Mendimet për çmimin e pushtimit të Irakut

Shumë studime statistike të ndërmarra në Amerikë lidhur me kostot e pushtimit të Irakut zbulojnë se përveç shpenzimeve të drejtpërdrejta, ekzistojnë implikime tjera serioze që duhet të merren parasysh. Për shembull, studimi i bërë nga ana e Xhozef Bajdenit, kryesues i Komitetit për Marrëdhënie të Jashtme të SHBA., e vendos këtë shpenzim në nivelin e \$ 100 miliardë. Bajden po ashtu pohoi se \$ 50 miliardë të tjerë do të nevojiteshin për ta rindërtuar Irakun dhe se kostoja e përgjithshme do të ishte diku rreth \$ 150 miliardë. Aktualisht, duket se ky pushtim ishte i suksesshëm dhe se çdo gjë është përmbajtur brenda kufijve të llogaritur. Mirëpo, kjo nuk do të ndikojë që tragjeditë që përjetohen gjatë luftës të harrohen dhe nuk justifikon përdorimin e këtyre resurseve për këtë luftë në vend se ato të përdoren për prosperitetin e popullit Amerikan.

Kostoja prej \$ 100 miliardëve nuk konsiderohet një shumë domethënëse nga fajkonjtë e administratës së Bushit. Megjithatë, kjo shumë është tri herë shuma e buxhetit për edukim për fëmijët e moshës prej 0 deri në 12 vjeç, katër herë shuma e buxhetit për marrëdhënie me jashtë të shtetit dhe e mjaftueshme për t'i mbuluar shpenzimet e shëndetësisë për gjithë fëmijët Amerikan për 5 vite. Ky është me të vërtetë një fakt që të nxitë të mendosh: Se kjo shumë e të hollave shpenzohet në një pushtim që kushton me jetën e mijëra njerëzve në vend se të përdoret për të ngritur standardin e jetesës të Amerikanëve. Mirëpo, duke e ditur se këto shpenzime janë llogaritur duke u bazuar në kushtet ideale, shumë ekspertë të pensionuar ushtarak dhe të mbrojtjes thonë se shpenzimet do të ngriten, duke marr parasysh rreziqet potenciale të periudhës pas pushtimit.

Luftërat e kaluara Amerikane kanë treguar se shpenzimet e




The cost of invading Iraq became a major topic of discussion before and after the war.

këtyre luftërave tejkalojnë tej mase shumë e planifikuar. Për shembull, Sekretari i Thesarit në kabinetin e Linkolnit vlerësoi se kostoja e Luftës Civile për Veriun do të ishte \$240 milionë; në të vërtetë, kostoja e vërtetë ishte 13 herë më e lartë (\$3.2 miliardë). Në buxhetin e vitit 1966, \$10 miliardë ishin rezervuar për luftën në Vietnam, e cila pritej të mbaronte në verën e vitit 1967. Por lufta vazhdoi deri në vitin 1973 me një kosto të drejtpërdrejt prej ndërmjet \$110 dhe \$150 miliardë.²⁶ Veç kësaj, 47,000 ushtarë Amerikan vdiqën në vijën e frontit, 11,000 ushtarë tjerë vdiqën në

rrethana të ndryshme dhe 303,000 ushtarë në total u plagosën. Më shumë se 1 milion civil Vietnamez humbën jetën, 225,000 ushtarë Vietnamez u vranë në luftë dhe 570,000 u plagosën.²⁷

Këta shembuj zbulojnë se kostoja e luftës mund të ngritet pa kontroll kur gjërat nuk shkojnë sipas planit. Prandaj, të gjitha luftërat dhe pushtimet në të ardhmen duhet të parandalohen, sepse humbjet njerëzore dhe financiare në të dyja anët mund të ngriten në mënyrë dramatike. Për më tepër, një rend demokratik, paqësor dhe i moderuar nuk mund të krijohet në Lindjen e Mesme me anë të luftës, siç ka për qëllim të bëjë administrata e Bushit. Edhe po të arrihet sukses ushtarak, është pothuajse e pamundur të krijohet një paqe dhe rend i qëndrueshëm në këtë



mënyrë. Të fitosh një luftë në fushëbetejë nuk është domosdo e mjaftueshme për ta kontrolluar dhe sunduar një rajon politikisht. Dhe, ajo që zakonisht ndodhë pas çdo pushtimi është dëshmi shumë e mirë për këtë.

Lindja e Mesme mbështetet në baraspesha të pasigurta. Historia vërteton se është fare pak e mundshme që fuqitë e huaja t'i mbajnë këto baraspesha në mënyrë të drejtë dhe të mirë apo të arrijnë një rend që është i pranueshëm për popullatën shumë të ndryshme të këtij rajoni. Vetëm një fuqi që ndanë tipare dominuese kulturore dhe civilizuese të këtij rajoni mund ta arrijë këtë. Ky duhet të jetë një autoritet qendror që bashkon të gjitha kombet Muslimane, një autoritet që pasqyron dhe përfaqëson këtë vullnet. Ky autoritet është Unioni Islamik, i cili jo vetëm se do t'i zgjidhë problemet në Lindjen e Mesme, por gjithashtu të

The Turkish Islamic Union will be a giant step toward world peace. Thanks to this unity, various problems will be resolved peacefully, justly and quickly.



THIRRJE PËR UNION ISLAMIK

gjitha problemet ndërmjet Perëndimit dhe botës Islamike. Prandaj, Perëndimi, e në veçanti Amerika, duhet ta përkrahin formimin e Unionit Islamik, i cili do t'i bashkojë të gjitha kombet Muslimane nën një ombrellë paqeruajtëse, tolerante dhe konstruktive dhe të bashkëpunojë me të. Në këtë mënyrë, Amerika do të gjejë një union të besueshëm politik me të cilin do të mbajë gjallë dialogun



dhe bashkëpunimin, një union që do të shtrihet nga Maroku deri në Indonezi.

Shumë strategë dhe mendimtarë Amerikan kanë theksuar këtë fakt dhe Uilliam Nordhaus, një ekonomist dhe profesor me famë i Universitetit Jeil, pohon në pjesën e “përfundimeve dhe sugjerimeve” të këtij raporti të titulluar: “Pasojat ekonomike të një lufte me Irakun” si vijon:

Nga një këndvështrim politik, veprimet e njëanshme, posaçërisht ato të ndërmarra pa përkrahjen e botës Islamike, rrezikojnë irritimin e të moderuarve, trimërimin e radikalëve ... në ato vende. ²⁸

Kush qëndron pas pushtimit?

Është me interes të parashtrohet pyetja pse Amerika pushtoi Irakun përkundër dëmit dhe ndikimit negativ qartë të dukshëm që do të shkaktonte një akt i tillë. Shumë strategë mendojnë se ky pushtim ishte planifikuar mjaft kohë përpara 9/11 dhe filluan të dëgjohen dyshimet lidhur me pohimin e administratës së Bushit se Iraku kishte armët për shkatërrim në masë dhe me sa duket kishte për qëllim t’i përdorte ato.

Ky aksion ushtarak është pjesë e strategjisë së re Amerikane për Lindjen e Mesme. Ata të cilët e zhvilluan këtë strategji kishin vendosur tashmë në vitin 1997 që Amerika duhej ta godiste Sadamin dhe ta largonte atë nga pushteti. Shenjat e para të kësaj u shfaqën në vitin 1997, kur një grup strategësh në Uashington, nën ndikimin e lobit Izraelit, formuan Projektin për Shekullin e Ri Amerikan (PSRA) qendër hulumtuese për të avokuar për pushtimin e Irakut.

AMERICAN CASUALTIES FROM MAJOR WARS

Conflict	Population milyon	Military Personn elbin	Ratio population '%si	Fatalities	Ration population '%si
	3.5			4.435	
Revolutionary War	7.6	200	5.7%	2.260	0.127%
War of 1812	21.1	286	3.8%	1.733	0.030%
Mexican War		79	0.4%		0.008%
Civil War	26.2			110.070	
Union	8.1	2.803	10.7%	74.524	0.420%
Confederate	34.3	1.064	13.1%	184.594	0.920%
Combined		3.868	11.1%		0.538%
Spanish-American War	74.6			385	
World War I	102.8	307	0.4%	53.513	0.001%
World War II	133.5	4.744	4.6%	292.131	0.052%
Korean War	151.7	16.354	12.2%	33.651	0.219%
Vietnam War	204.9	5.764	3.8%	47.369	0.022%
First Persian Gulf War	260.0	8.744	4.3%	148	0.023%
		2.750	1.1%		0.000%

Conflict	Total Direct Costs of Wars (billions)	Total Direct Costs of Wars (billions)	Per capita cost	Cost
	dönemin kuru	2002 (\$)	2002 (\$)	GSMH'nin yıllık '%si
Revolutionary Wars				
War of 1812 (1812-1815)	0.1	2.2	447	63
Mexican War (1846-1848)	0.09	1.1	120	13
Civil War (1861-1865)	0.07	1.6	68	3
Union				
Confederate	3.2	38.1	1.357	84
Combined	2.0	23.8	2.749	169
Spanish-American War (1898)	5.2	62.0	1.686	104
World War I (1917-1918)	0.4	9.6	110	3
World War II (1941-1945)	16.8	190.6	2.489	24
Korea (1950-1953)	285.4	2896.3	20.388	130
Vietnam (1964-1972)	54.0	335.9	2.266	15
First Gulf War (1990-1991)	111.0	494.3	2.204	12
	61.0	76.1	306	1

The tables above reveal the losses inflicted on America by the great wars in which she participated.

Emrat më të shquar të PSRA-it, që më vonë u bënë njerëzit më me ndikim në administratën e Xhorxh U. Bushit ishin Sekretari i Mbrojtjes Donald Ramsfeld dhe Zëvendës Kryetari Dik Çejni. Madje edhe nëse ata fillimisht kishin për qëllim të krijojnë një rend stabil botëror nën udhëheqjen Amerikane, ata, të ndihmuar nga lobi Izraelit, përvetësuan besimin se një luftë në Lindjen e Mesme ishte e domosdoshme. Po të kishin bërë një vlerësim të plotë, shumë shpejt do ta kishin kuptuar se një besim i tillë ishte i gabueshëm. Nëse qëllimi ka qenë të krijohet stabilitet, është e qartë se lufta kurrë nuk sjellë stabilitet dhe rregull. Përkundrazi, ajo shkatërron rendin ekzistues dhe nuk sjellë asgjë tjetër përveç humbjes. Është një e vërtetë historike se stabiliteti mund të arrihet vetëm përmes ruajtjes së paqes.

Një artikull i titulluar “Pushtimi i Irakut nuk është një ide e re për klikën e Bushit: plani ishte vendosur 4 vjet para 9/11”, i publikuar në gazetën *Philadelphia Daily News* nën emrin e Uilliam Banç, thuhej si vijon:



Por në të vërtetë, Ramsfeld, Zëvendës-kryetari Dik Çejni dhe një grup i vogël ideologësh konservativ kishin filluar të bënin kornizën për një pushtim të Irakut nga Amerika qysh në vitin 1997 – gati 4 vjet para sulmeve të 9/11 dhe tre vjet para se Presidenti Bush të bëhej president.

Një grup i panjohur politik i krahut të djathtë, me një emërtim kërcënues i quajtur Projekti për Shekullin e Ri Amerikan ose PSRA – i bashkuar me Çejnin, Ramsfeldin, zëvendësin e lartë të Ramsfeldit Pol Uolfovicin dhe vëllanë e Bushit Xhebin – madje nxitën Kryetarin e atëhershëm Klinton qysh në Janar të vitit 1998 që ta pushtonte Irakun.

“Kërkojmë me ngulm nga ju që të ... shpallni një strategji të re e cila do t’i siguronte interesat e SHBA-ve dhe miqve dhe aleatëve tonë në mbarë botën,” shkruante në letrën drejtuar Klintonit, të nënshkruar nga Ramsfeldi, Uolfovici dhe të tjerët. “Ajo strategji duhet të ketë për qëllim, mbi të gjitha, largimin e regjimit të Sadam Huseinit nga pushteti.”²⁹

Por cila ishte arsyeja e anëtarëve të PSRA të jenë kaq këmbëngulës për rrëzimin e Sadamit? Po ky artikull vazhdon:

Ndërsa nafta është në sfond të deklarimeve politike të PSRA-së mbi Irakun, ajo nuk duket të jetë forca lëvizëse. [Ian] Lustik, [një profesor i shkencave politike të Universitetit të Pensilvanisë dhe ekspert për Lindjen e Mesme], megjithëse një kritik i politikës së Bushit, thotë se nafta konsiderohet nga ana e ithtarëve të luftës në radhë të parë si mënyrë për të paguar operacionin e kushtueshëm ushtarak.

“Unë jam nga Teksasi dhe çdo njeri që merret me naftë që unë e njoh është kundër aksionit ushtarak në Irak,” thotë Shmit i PSRA. “Tregut të naftës nuk i nevojitet çrregullimi.”

Lustik beson se një nxitës i fshehtë më i fuqishëm (për luftë) mund të jetë Izraeli. Ai thotë se fajkonjtë e administratës së Bushit besojnë se shfaqja e forcës në Irak to t’i bindte Palestinezët



Although oil seems to be the real reason for the war against Iraq, researchers say that very different reasons lie behind the scenes.

që ta pranojnë një plan paqësor me kushte të favorshme për Izraelin.³⁰

Shkurt, arkitektët e vërtetë prapa pushtimit janë Izraeli dhe aleatët e tij Amerikan. Në këtë pikë, përsëri bëhet e qartë se politika Amerikane për Lindjen e Mesme është tejet e ndikuar nga Izraeli. Një numër i Sionistëve radikal që veprojnë në interes të Izraelit ushtrojnë ndikim të madh mbi mekanizmat vendim-marrës të Amerikës dhe bindin Uashingtonin të veprojnë në pajtim me strategjinë e Izraelit për Lindjen e Mesme. Për më tepër, ata veprojnë kështu ndërsa pohojnë se interesat Amerikane dhe Izraelite janë identike, përkundër faktit se interesat Amerikane në Lindjen e Mesme nuk përputhen me përkrahjen e Sionistëve radikal në Izrael. Duke vepruar kështu, SHBA-të arrijnë ta fyejnë tërë botën Arabe. Interesave të Amerikës do tu shërbejë më mirë duke bindur Izraelin të zbuste

THIRRJE PËR UNION ISLAMIK



Copyright March 24, 2003 The American Conservative

Whose War?

A neoconservative clique seeks to ensnare our country in a series of wars that are not in America's interest.

By Patrick J. Buchanan

The War Party may have gotten its war. But it has also gotten something it did not bargain for. Its membership lists and associations have been exposed and its motives challenged. In a rare moment in U.S. journalism, Tim Russert put this question directly to Richard Perle: "Can you assure Americans overseas... that we're in this situation against Saddam Hussein and his approval for American security interests? And what would be the link in terms of Israel?"

Suddenly, the Israel connection is on the table, and the War Party is not amused. Posing themselves as an unanticipated foe, war neoconservative friends are doing what comes naturally, speaking stilted statements from political combat by claiming the status of a persecuted minority group. People who claim to be writing the foreign policy of the world superpower, one would think, would be a little more ready to be the subject of politics. Not so.

Former *Wall Street Journal* editor Max Boot kicked off the campaign. When these "Buchananites" first accused "neoconservative" and cite names like Wolfowitz and Cohen—it sometimes sounds as if what they really mean is "Israeli neoconservative."—Ted Boot readily concedes that a passionate attachment to Israel is a "key tenet of neoconservatism." He also claims that the National Security Strategy of President Bush "sounds as if it could have come straight out from the pages of *Commentary* magazine, the neocon bible." (For the uninitiated, *Commentary*, the bible in which Bush seeks divine guidance, is the mouthpiece of the American Jewish Committee.)

David Brooks of the weekly *Sunday* writes that attacks based on the Israel he has met go far beyond personal bias: "Here I get a steady stream of anti-Semitic comments in my e-mail, my newspaper and in my mailbox... Both *Sunday* is alive and thriving. It's just that its sponsor is no longer on the Buchananite right, but on the other end of the spectrum."



The relation of the pro-war group to Israel caused serious arguments in America. Patrick Buchanan's article, "Whose War?" deals with information that appeared in the media about this subject. "Is It Good for Jews?" an article that appeared in the New York Times, discusses the benefits Israel will get from the invasion of Iraq. The two articles in the National Review called attention to the error of presenting all Jews as being prowar.

politikat e tij dhe të bënte paqe me Arabët, duke shërbyer vet si ndërmjetës i drejtë.

Ky ndikim i njëjtë Izraelit mund të vërehet në fazën e planifikimit të pushtimit. Lobi Izraelit çorientojë strategët të cilët kishin pozita me ndikim në administratën e Bushit në mënyrë që ata të kuptojnë “nevojën” për të pushtuar Irakun. Mirëpo, kjo ka shkaktuar tensione të reja në rajon dhe gradualisht ka hapur rrugën për një aksion ushtarak që ka shkaktuar vdekjen e shumë civilëve të pafajshëm Irakian.

Pavarësisht nga fakti se sa shumë flasin këta strategë për interesat Amerikane, ata në të vërtetë mbrojnë interesat e Izraelit, sepse nuk është në interes të Amerikës të luftojë me tërë Lindjen e Mesme dhe t’i ofendojë dhe armiqësojë popujt e saj. Amerika nuk ka një ideologji dhe strategji anti-islamike, siç pohojnë disa qarqe. Siç kemi cekur më parë, Amerika ishte një prej aleatëve më të mëdhenj të Muslimanëve të Ballkanit (si të Bosnjës, Kosovës dhe Maqedonisë), të cilët ishin pre e barbarizmave Serbe gjatë viteve të 1990-ta. E vetmja “vijë e frontit” që ka efekt negativ tek masat Muslimane është në Lindjen e Mesme, për shkak të disa zyrtarëve të cilët, nën ndikimin e lobit Izraelit që është jashtëzakonisht i fuqishëm, marrin qëndrim pro-izraelit në politikën e jashtme. Posa të lirohen këta zyrtarë nga një manipulim i tillë dhe në këtë mënyrë të kenë mundësinë që ta vlerësojnë Lindjen e Mesme pa qenë të anshëm, do të zhvillohen politika më të drejta.

Kjo është arsyeja që qëndron pas strategjisë Amerikane për ri-rregullimin e Lindjes së Mesme, të cilën e miratoi administrata e Bushit pas 9/11. Radikalët Izraelit, duke luajtur mbi frikën e vjetër të zhdukjes së Izraelit, kanë kërkuar që një kohë të gjatë të ri-rregullojnë Lindjen e Mesme për ta bërë atë rajon lehtë të

kontrollueshëm
dhe më të sigurt për
Izraelin. Me këtë synim në
mendje, ata e kanë shtrirë ndikimin e
tyre mbi Amerikë dhe kanë manipuluar me
politikën e saj të Lindjes së Mesme me dekada.

Në të vërtetë, nuk është as në interes të Izraelit të jetë
në konflikt me botën Islamike. Çifutët, të Krishterët dhe
Muslimanët kanë të drejtë të bëjnë ibadet siç kanë dëshirë në këto
troje, por politikat e udhëheqjes Izraelite shtypin Muslimanët
dhe brengosin të Krishterët dhe madje edhe Çifutët. Do të ishte
shumë më mirë për Izraelitët, si edhe për banorët e Lindjes së
Mesme, po të tërhiqej Izraeli nga Territoret e Okupuara dhe të
bënte paqe të vërtetë në vend se të jetë në gjendje të
vazhdueshme lufte me tërë Lindjen e Mesme. Kjo atmosferë e
vazhdueshme e luftës dëmton Izraelin në mënyrë të
pashmangshme, sepse ai pastaj bëhet cak i radikalizmit që
pikërisht politikat e tij e kanë krijuar vet. Dhe pastaj, civilët e
pafajshëm Izraelit u ekspozohen sulmeve dhe jetojnë në frikë të
vazhdueshme. Prandaj është e domosdoshme, po ashtu për
sigurinë e 4.5 milionë qytetarëve Izraelit, për të luftuar në
mënyrë intelektuale filozofinë radikale Sioniste që përpiket të
bëjë luftë në Lindjen e Mesme si edhe të nxitë një
përplasje të qytetërimeve.

Sionizmi radikal, një ideologji raciste,
shoviniste dhe shtypëse, përpiket



Palestine must be a land where Jews, Christians and Muslims can live together in peace. It is possible to re-establish the security that once prevailed in Palestine under Muslim rule.

t'i largojë banorët Çifutë nga Palestina apo madje t'i vras ata për hir të shtetit Izraelit. Mirëpo, mungesa e vazhdueshme e njohurisë dhe keqinformimi bashkohen për të ndaluar si Çifutët ashtu edhe të Krishterët nga të kuptuarit e të vërtetës për Zionizmin radikal. Është përgjegjësi e secilit person që punon për paqen botërore të dëshmojë rrezikun që paraqesin pikëpamjet radikale ndaj tërë njerëzimit. Çifutët vërtet religjioz, bashkë me të Krishterët dhe Muslimanët e ndërgjegjshëm, duhet të bashkohen t'i thërrasin të gjithë në rrugën e drejtë. Kur njerëzit të arrijnë të kuptojnë të vërtetën për ideologjinë fashiste, social darviniste dhe shtypëse të njohur si Zionizmi radikal, kjo pengesë e madhe për paqen botërore do të largohet dhe njerëzit të cilët tani mbështesin dhunën do të bëhen mbrojtës të paqes.

Dünya sava

AMERİKA hiçbir askerî hareketinde bu günkü kadar Afrika'ya kadar, Amerika'nın Irak'a saldırısına karşı k

Irak'a saldırmaya hazırlanan... mense destek vermiyor. Fransa'nın, Çin ve Rusya Güvenlik Konseyi'nde başdünya genelinde ABD'ye artırırken, bu çatışma Av-ATO ve BM'de derin böüyor. İslam dünyasının ve

Both in Israel and America, many Jews advocate peaceful coexistence with Muslims and that both sides make sacrifices in order to establish this peace. Jews who advocate peace severely criticize the Israeli policy of violence against the Palestinians as well as the Iraqi war. In its website, Tikkun, a Jewish organization in America, reveals the blunders of pre-emptive military action. News about the anti-war demonstrations in Tel-Aviv in which both Jews and Arabs participated (above left). An article by Rabbi Arthur Waskow, "Why Jews Should Oppose War on Iraq," stresses that Judaism is against all kinds of violence and belligerence.

Ş istemiyor

yalnız kalmadı. Avrupa'dan Ortadoğu'ya, Asya'dan küresel düzeyde bir muhalefet dalgası güç kazanıyor.

Arap Birliği'nin karşı olduğu saldırıya karşı çok geniş bir küresel koalisyon oluştu. 146 üyeli Bağlantısızlar Hareketi Malezya'nın baskenti Kuala Lumpur'da yapılan

ezici çoğunluğu, İslam dünyasının geneli ve Afrika ağırlıklı olarak savaşa karşı.

Güvenlik Konseyi savaşa karşı

3,000 Jews, Arab demonstrate in Tel Aviv against Iraq war

Alternative Information Center, Press Release, 16 February 2003

On Saturday February 15th, over 3,000 Jews and Arabs demonstrated against the war on Iraq in Tel Aviv Museum's square. The demonstration was held in partnership with a Palestinian demonstration held in the center of Ramallah and simultaneously with over 600 demonstrations worldwide.

A joint Palestinian Israeli petition was read at the demonstration calling: "No to the war against Iraq! End the Israeli occupation! For a life of just peace in the Middle East! We, Israelis and Palestinians, are opposed to this war. This is not a war for the sake of security or justice, but rather a war for power, hegemony, control and greed. We are determined that for the sake of all the people of the Middle East will not be violence and death."

Speeches were held during the vigil by representatives of the who coordinated and participated in the demonstration as well Shafi, a Palestinian peace activist from Gaza, who spoke by his home in Gaza.

Participating organizations include: Balad, Gush Shalom, It House Demolitions, Hadash, Yesh Gvul, Black Laundry, M Jewish Partnership, The Alternative Information Center, Cf Peace: Bat Shalom, Machsom Watch, Noga-Feminist Jou Black, New Profile, Tand, WILP and Fifth Mother. Buses from throughout Israel.

For further information, please contact:
Ronni: 054-700640, 02-6261424, 02-6261159



Above: Between two and three and Jewish demonstrators in Cinematheque to the Museum against the U.S. led push for people. (Bryant Adeniyi/istat)

BM Güvenlik Konseyi'ne üye günluğu Irak'ın barışçı yoldan hırılmasından yana. Güvenlik

Yeni Şafak Gazetesi, 1.4.2003

Why Jews Should Oppose War on Iraq

The Jewish Obligation in This Hour

Jewish wisdom teaches: "Justice, justice shall you pursue. Seek just ends by just means." (Deut. 16:20 and Rashi) Disarming a dangerous dictator is a just end. But is war the just means to that end? What in truth will this war do?

WAR will kill innocent Iraqis by the thousands — many of them children — in what the Pentagon brags will be "Shock & Awe" attacks on Baghdad;

WAR will kill, wound and sicken countless American soldiers, in battle and for years after—just as veterans of the Gulf War still suffer incurable syndromes.

WAR will subject Americans, Israelis and civilians of many other nations to the danger of hellish terrorist reprisals, as is freely admitted by our CIA, FBI and Homeland Security Office;

WAR will give spurious legitimacy to further attacks on our civil liberties;

WAR will diminish the lives of all Americans, diverting hundreds of billions of dollars desperately needed for health care for our seniors, schools for our children, shelter for our homeless and food for our hungry.

But it is not enough to oppose this war passively. To reach the just end of disarming Iraq we American Jews must:

Add our voices to the swelling chorus of nations, world leaders, and religious groups that are beseeching America — **ENOUGH IS ENOUGH!**

Udhëheqësit fetar Çifutë bëjnë thirrje për Agjërim për Paqe

Që prej fillimit të krizës së Irakut, udhëheqësit fetarë nga mbarë bota kanë bërë përpjekje të sinqerta për paqe. Një përpjekje e tillë është bërë nga Rabini Vaskov, një udhëheqës i organizatës për paqe Shalom, e cila u bën thirrje njerëzve të agjërojnë për paqe. Shumë udhëheqës fetar të besimeve të ndryshme u bashkuan dhe edhe njëherë demonstuan se Judaizmi, Krishterimi dhe Islami janë të gjitha kundër luftës:

Ne u bëjmë thirrje Amerikanëve të agjërojnë:

Të reflektojnë, të kërkojnë një paqe të vërtetë, të lutën

Në emër të Zotit të mëshirës, i Cili na urdhëron të kërkojmë paqen dhe drejtësinë...

Zoti na bën thirrje të gjithë ne që ta kërkojmë paqen dhe ta aspirojmë atë.

Megjithatë ne me keqardhje të thellë shohim rrezikun se as qeveria e Irakut dhe as qeveria e SHBA-ve nuk po e merr këtë thirrje si synimin e saj parësor...

Zoti na bën thirrje t'i duam fqinjët tonë si vetveten, ta duam të panjohurin dhe të huajin, të mos u bëjmë të tjerëve asgjë që për ne është e urrejtur...

Zoti na bën thirrje t'i ushqejmë të uriturit, t'iu ofrojmë strehë të pastrehëve, t'i veshim të zhveshurit, ta shërojmë tokën, ta lirojmë mendjen dhe shpirtin...

Zoti na bën thirrje që të reflektojmë – të mendojmë, të ndiejmë dhe të lutemi para se të veprojmë.

E megjithatë ne shohim se pa asnjë

Jews Say, "No War!" ... why?

1. YHWH/GOD freed us all — respect world opinion
2. Don't bow down to presidents
3. Don't make inspections useless
4. Take time to reflect
5. Honor Mother Earth

6. Don't kill the innocent
7. Don't endanger Israel or Palestine
8. Don't rob the sick and poor
9. Don't oppress immigrants
10. Don't conquer for oil

THE
shalom
Oily
CENTER

www.shalomctr.org

Üstte Shalom grubu tarafından hazırlanan ve samimi olarak iman eden Yahudilerin neden savaşa karşı olmaları gerektiğini açıklayan ilan görülmektedir. İlanın başlığı:

Yahudiler "Hayır" diyor... Neden?

Altta ise, "Barış için Oruç" çağrısının metni yer almaktadır.

Seeking Peace

[\[Back to Peace Index\]](#)

HOME

Seeking
Peace

Pursuing
Justice

Healing
the Earth

Building
Community

Make a
difference!

Donate

to the Shalom
Center!

Subscribe

to Rabbi
Waskow's weekly
Thought-Letter

Email the
Shalom Center!

WE CALL UPON AMERICANS TO FAST:

TO REFLECT, TO SEEK A TRUER PEACE, TO PRAY

In the name of the God of compassion, Who commands us to see peace and justice — In times of profound spiritual crisis, our tradition teaches us to fast. Whether it is Jews on Yom Kippur, Christians during Lent, or Muslims during Ramadan — we turn away from filling our bellies to opening our hearts.

We are in spiritual crisis now, and we call all Americans to address this crisis through a fast that opens our hearts to compassion, our minds to wisdom, and our hands to acts of peace.

God calls on us all to seek peace and pursue it.

Yet with deep concern we see the danger that neither the government of Iraq nor the government of the United States is taking this calling as its primary goal.

We see that there may have been secret... a destroyer... of the Sec...



Haham Waskow

Harun Jahja (Adnan Oktar)

dëshmi të një rreziku të afërt dhe urgjent, qeveria jonë po vërsulet në një luftë që kërcënon të sjellë vdekje në shumë familje – në “familjet tona” si edhe tek ato të cilat jetojnë në një vend tjetër. Një luftë që mund ta gllabëroj në zemërim dhe shkatërrim një rajon të tërë të botës, që të gjitha traditat tona e konsiderojnë veçanërisht të shtrenjtë...

Në këtë moment të rrezikut të madh, ne i drejtohem Zotit...³¹


Ideologjia e vërtetë e Sadam Huseinit

Që nga dita e parë e pushtimit të Irakut, synimi kryesor i shpallur ishte të largohet regjimi i Sadamit. Një strategji e tillë, pavarësisht nga arsyetimet e ofruara, nuk mund të zbatohet me sukses me anë të mjeteve ushtarake. Jetët e humbura gjatë këtij pushtimi dëshmojnë se kjo ishte zgjidhje e gabueshme dhe që s’do të duhej të ndërmerrej kurrë. Mirëpo, është po ashtu e qartë se Sadami ishte një diktator i cili ishte i dëmshëm për rajonin dhe regjimi i të cilit duhej larguar.

Sadam Huseini është vetëm njëri prej shumë njerëzve të cilët, në vitet e 1960-ta, kishin devijuar nga socializmi Arab, i cili po pushtonte botën Arabe në atë kohë. **Socializmi Arab** bashkonte fashizmin ekstrem me një program fanatik majtist të botës së tretë të mbështetur nga Sovjetët. Stalinizmi, versioni Sovjetik i komunizmit, vulosi shenjën e tij mbi botëkuptimin e socialistëve Arab, të cilët zhvilluan politika agresive, shtypëse dhe nxitëse. Sadami ishte një militant prijës i Partisë Ba’th, mishërim i kësaj ideologjie të gabuar në Irak. Në rininë e tij, ai



Saddam Hussein was one of the many Arabs misled by the "Arab socialism" that pervaded the Arab world in 1960s.




Harun Jahja (Adnan Oktar)

organizoi dhe ndërmori sulme në organizatat dhe individët politik që kundërshtonin lëvizjen Ba'th përmes organizatës terroriste Xhihaz Hanin (Mjeti i Dëshirave). Pas puçit të parë Ba'thist, nën komandën e Sadamit u formua një njësi për marrjen në pyetje dhe viktimat e tij iu nënshtruan një torturimi të llahtarshëm. Është e njohur se Sadami madje shpiku teknika të reja të torturimit.

Nën ndikimin e ideologjisë Staliniste në të cilën ai besoi në mënyrë të zjarrtë, ai u bë një diktator i egër dhe i pamëshirshëm i njohur për egërsinë e tij. Në vitin 1980, ai ndezi një luftë të përgjakshme 8 vjeçare duke pushtuar Iranin; 2 vjet pasi që përfundoi kjo tragjedi, ai pushtoi Kuvajtin. Ai ishte i dhunshëm me të gjitha grupet dhe individët në vend që ai i konsideronte si kërcënime potenciale, siç e dëshmon sulmi i tij me armë kimike në fshatin Kurd të Halabjës (Iraku verior): 5,000 njerëz të pafajshëm vdiqën. Dhe ky ishte vetëm njëri prej krimeve kundër njerëzimit të regjimit të tij.

E gjithë kjo qartë dëshmon se Sadami nuk ishte i përshtatshëm për të sunduar Irakun. Njerëzit shpresojnë që udhëheqësi i tyre t'iu sjellë paqe, siguri, lumturi dhe përparim, si edhe paqe dhe qëndrueshmëri si për fqinjët e tyre në veçanti ashtu edhe për botën në përgjithësi.

Tani që Sadami dhe regjimi i tij janë larguar nga pushteti, strategjitë pas pushtimit janë më se të rëndësishme. Nuk mjafton të portretizohet Sadami si një tiran që të arrihet një paqe e qëndrueshme në Lindjen e Mesme. Ajo që nevojitet është një analizë që mund t'i korrigjojë kushtet dhe ideologjitë që e çuan atë drejt tiranisë. Ajo që e bëri Sadamin një diktator të përgjakshëm ishte ideologjia Ba'thiste dhe kultura fashiste që u përpoq t'i zgjidhte të gjitha çështjet me forcë apo edhe me



The radical Ba'th ideology made Saddam adopt a cruel policy even toward his own citizens. However, in order to totally eliminate the detrimental effects of this ideology, a cultural struggle must be carried out against the ideologies in question.

Harun Jahja (Adnan Oktar)

gjakderdhje. Një fushatë gjithëpërfshirëse edukative dhe politika të arsyeshme nevojiten poqë se dëshirohet që bota Arabe të pastrohet nga kjo ideologji dhe kulturë, dhe ato të dyja duhet t'i lëshojnë rrugën një gjenerate të qytetëruar dhe njerëzve të cilët janë të mëshirshëm, të dashur dhe të njerëzishëm, siç e kërkon morali Islamik. Në një shoqëri që praktikon këtë moral, nuk do të hasen probleme të tilla.

Nuk duhet të harrojmë se kjo ideologji dhe kulturë nxitëse nuk ekziston vetëm në Bagdad, por gjendet gjithashtu në shumë rajone tjera – shpeshherë nën maskën e fesë. Zgjidhja e vërtetë e këtij problemi qëndron në të treguarit njerëzve për parimet e vërteta morale të fesë në mënyrë efikase.

Zbatimi i ligjit dhe rendit

Është plotësisht e mundshme që pushtimi i Irakut do të shkaktojë paqëndrueshmëri gjithëpërfshirëse dhe të zgjatur në Lindjen e Mesme. Duket sikur qarqet me ndikim në politikën Amerikane duan ta ri-rregullojnë tërë Lindjen e Mesme e madje edhe Kaukazin dhe Azinë Juglindore, nëse nevojitet, edhe me anë të luftës. Disa anëtarë të administratës së Bushit shfaqin pikëpamjen se “Amerika do të mund të ndërmerre veprime ushtarake kundër ‘40-50 shteteve’”, përmes së cilës ata nxjerrin në shesh plane të tilla.³² Irving Kristol, një pjesëmarrës i PSRA-së, pohonte se “është gjithmonë shenjë e mirë kur populli Amerikan është i përgatitur për të luftuar,”³³ gjë që paraqet një tjetër shembull të kësaj mendësie. E gjithë kjo nënkupton se madje edhe ata të cilët sajojnë këto plane ndoshta nuk do të jetojnë mjaft gjatë për të parë fundin e kësaj gjendje të vazhdueshme lufte.

Kjo gjendje lufte, e cila do ta zhys botën në dhimbje dhe shkatërrim, do ta lëkund rendin botëror dhe do të ketë ndikim të

Dünya
IRAK SAVAŞI



Perle: ABD'nin savaşı sürecek

ABD'nin Irak politikasının 'mimar' olarak bilinen Pentagon'un eski başdanışmanı Richard Perle, Afganistan ve Irak'a yönelik saldırıların "terörle savaşın" bir bölümünü oluşturduğunu ve ABD'nin mücadelesini sürdüreceğini söyledi.

Paris/Amsterdam
REUTERS

25 Nisan— Fransa'da yayımlanan Les Echos gazetesine konuşan Richard Perle, Washington Yönetiminin...

Tercüman Gazetesi, 4.4.2003

Yeni hedef Suriye

ABD, gelecek hafta Suriye'ye bir ultimatom verecek ve talepleri reddedilirse askeri bir operasyon düzenleyecek

ABD yönetimi, İ. Saddam Hüseyin kitle imha silahları da Suriye'ye kaydırıldığı retler bulunduğu iddiaların bir çok ist. dış savaşta Suriye'ye karşı Suriye, savaşta Irak'ın malzeme sağlama politikasına yakın kay. ve Washington'un bir gün içinde bir ultimatum beklendiğini söyledi.

Şam'dan sonra Tahran İSTİKAMET SURIYE

ABD Temsilci Meclisi Üyesi Wexler, Türkiye'nin Suriye ve İran'la yakınlaşmasının Washington'da "Türkiye istikamet mi değiştiriyor" endişesi yarattığını söyledi. Bakan Gül ise bugün Suriye'ye geliyor

Yeni Şafak Gazetesi, 25.4.2003



IRAK'TA NAMLU HALKA DÖNDÜ

TÜRKİYE'NİN son dönemde İsrail ve Suriye'ye yakınlaşması ABD'yi endişelendirdi. Washington'da bir düşünce bin "Türkiye istikameti olup olmayacağı" sorularını sordu. ABD Temsilci Meclisi Üyesi ve Türk Dışişleri Genel Koordinatörü Robert Wexler dış bakanlık, Meclis Dışişleri Komisyonu üyesi, Başbakan Erdoğan ve Dışişleri Bakanı Gül'le görüşme toplantısında "Türkiye istikameti ne değiştiyse" sorularını sordu. Wexler, Dışişleri Komisyonu'nda görüşmelerde, "Amerika'da Bakan Gül'ün Suriye ziyaretinde yapılacak görüşmelerin amaçları" dedi. Komisyon üyesi Dan Coats, Wexler'i "Türkiye'nin Suriye ile yakınlaşması için istediği desteği" ABD Dışişleri Bakanı'nın son 27 saat içinde aldı. Bu kez bile Türkiye'ye gelmesi. Bu da o zaman için ne sorulduğuna nasıl cevapları" sorulduğunu söyledi. Özetle, Rusya İsrail'in sorularını yanıtlamak için "Bakanın Suriye'ye gidiyor" dedi.

Star Gazetesi, 29.4.2003


Some circles in the American government seek to secure stability and order in the Middle East through war. If their policies are followed, wars will follow one another and the so-called goal of establishing security will bring the entire region closer to war. However, establishing the Turkish Islamic Union will eliminate the possibility of war and thus enable a permanent order to exist.

madh në popullin e këtij rajoni dhe në njerëzimin në tërësi. Siç e theksuam më herët, Amerika dhe të gjitha kombet tjera gëzojnë të drejtën t'i mbrojnë interesat e tyre kombëtare dhe të ndërmarrin masa parandaluese ndaj situatave që e rrezikojnë sigurinë e tyre. Por si të gjitha kombet, Amerika, si e vetmja superfuqi, duhet ta përdor këtë të drejtë mbi bazën e sigurimit të rendit dhe paqes botërore. Strategjitë kombëtare të sigurisë të gjitha vendeve, veçanërisht të Amerikës, duhet të jenë në pajtim me ligjin ndërkombëtar në mënyrë që të parandalohen veprimet arbitrare. Gjithashtu, kur problemet siç është terrorizmi kërcënojnë sigurinë botërore, bashkëpunimi shumëpalësh dhe aleancat ndërkombëtare rrisin mundësitë për paqe. Ulja e tensionit dhe zgjidhja e konfliktit duke mbështetur forcat e moderuara dhe demokratike duhet të bëhet mënyra e ecjes përpara në vend të tentimit që dhuna të shtypet me dhunë. Nëse duam ta bëjmë shekullin njëzet e një shekull në të cilin do të garantohen përparimi dhe siguria e njerëzve, të gjithë liderët duhet të përjashtojnë çdo ambicie për krijimin e një rendi botëror në të cilin vetëm i forti sundon dhe gëzon të drejta nëpërmjet luftës së pandërprerë.

Si Amerika ashtu edhe kombet tjera perëndimore, si edhe të gjitha kombet Muslimane, dëshirojnë që kërcënimet potenciale për paqen në botë të eliminohen, dëshirojnë stabilitet ekonomik, bëjnë thirrje për forcimin e regjimeve demokratike, kërkojnë dhënien fund abuzimeve me të drejtat njerëzore, kërkojnë që t'iu jepet fund të gjitha formave të tiranisë mbi jetët e njerëzve dhe kërkojnë cilësi më të mirë të jetës dhe një hisë të barabartë në resurset e pasura natyrore të botës. Disa strategë i përshkruajnë Muslimanët si shënjestra të planifikuara, gjë e cila përveç se është


All-llahu thërret për
në xhennet, dhe atë që do,
e vë në rrugë të drejtë.
(Kuran: 10/25)





fyese për tërë botën Islamike, në masë të njëjtë është strategji e rrezikshme dhe me të meta. Njerëzit të cilët e interpretojnë në mënyrë të gabueshme fenë janë të ndjeshëm ndaj miteve dhe besimeve të rrejshme dhe bëhen ekstremist duke rënë ndesh me parimet e fesë. Persona të tillë që mund të gjenden në mesin e Muslimanëve, Çifutëve dhe të Krishterëve, janë të gjithë rrezik i madh për paqen në botë. Largimi i këtij rreziku është i mundshëm vetëm nëpërmjet ndalimit të ekstremizmit dhe formimit të një aleance të gjithë njerëzve të moderuar, paqedashës, të qytetëruar dhe besimtarë të sinqertë. Vetëm një aleancë e tillë mund ta dobësojë ndikimin e atyre që përfaqësojnë luftën si opsionin e vetëm dhe besojnë, në mënyrë të gabuar, se ajo garanton sigurinë. Kështu, do të parandalohen madje edhe më shumë gjakderdhje, lot dhe humbje financiare.

Për ta krijuar këtë aleancë, Perëndimorët duhet t'i braktisin paragjykimet e tyre, të arrijnë ta njohin dhe kuptojnë me të vërtetë botën Islamike dhe të formulojnë politika të përbashkëta që do ta ndihmojë atë të zhvillohet. Të gjitha palët mund t'i çrrënjosin keqkuptimet e ndërsjella me anë të programeve edukative dhe kulturore, sepse radikalizmi është rezultat i mosdijes. Ndërsa këto projekte edukative do të bëjnë të mundshme që



Perëndimi ta kuptoj më mirë Islamin, mitet dhe besimet e rrejtshme të rrënjosura në botën Islamike do të mënjanoher e toleranca dhe mirëkuptimi i ndërsjellë do të zënë vend. Urrejta, zemërimi dhe keqdashja do të zëvendësohen me paqe, tolerancë dhe siguri. Kultura e bashkëjetesës paqësore që do të rezultojë do të çoj drejt paqes midis qytetërimeve të ndryshme dhe simpatia kulturore dhe bashkëveprimi do të sjellin përparim shoqëror, në kundërshtim me pohimet e atyre të cilët përkrahin një përplasje qytetërimesh.

Është e qartë se botës Islamike i nevojitet një kulturë e tolerancës po aq sa edhe Perëndimit. Kohë pas kohe, disa Muslimanë bien nën ndikimin e pikëpamjeve fanatike që i bëjnë ata armiqësor ndaj njerëzve të besimeve tjera fetare apo grupeve etnike, edhe pse kjo është në kundërshtim me moralin Islamik. Gjatë historisë, shoqëritë Islamike ishin qendra të drejtësisë dhe tolerancës, në veçanti në kohën e Profetit tonë (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të). Që nga ajo kohë, historia ka pasur përplot shembuj të Krishterëve dhe Çifutëve të shtypur që kanë kërkuar strehim në tokat Muslimane, të njohur për mëshirën dhe mbrojtjen e tyre. Duke pasur këtë parasysh, veçanërisht në një kohë kur paqja është

aq shumë e nevojshme, Muslimanët duhet të zhvillojnë modele shembullore duke u bazuar në Sunnetin profetik dhe vlerat e Kur'anit. Këto modele do t'i zhvillojnë vlerat thelbësore të botës Islamike dhe do t'ua mohojnë mundësinë të gjitha forcave të huaja të pohojnë se do t'i sjellin stabilitet dhe demokraci botës Islamike. Më saktë, Unioni Islamik do të jetë prijës i kësaj udhe.

Muslimanët dhe Ithtarët e Librit

Në Kur'an, Zoti u bën thirrje Çifutëve dhe të Krishterëve "Ithtarëve të Librit" dhe shpall në hollësi se si Muslimanët duhet të bashkëveprojnë me ta. Që nga lindja e Islamit e më tej, toleranca dhe mirëkuptimi reciprok në mes të Muslimanëve dhe Ithtarëve të Librit zakonisht kanë qenë në nivel shumë të mirë, sepse edhe pse librat e tyre të shenjtë dhe disa prej besimeve të tyre janë ndryshuar, ato ende posedojnë vlera dhe koncepte morale të bazuara në shpallje hyjnore. Kur'ani inkurajon sjellje plot respekt dhe të qytetëruar midis Muslimanëve dhe Ithtarëve të Librit. Për shembull, Muslimanëve u janë të lejuara ushqimet e tyre dhe anasjelltas dhe meshkujve Musliman u janë të lejuara femrat e tyre (Kur'an: 5:5). Këto rregulla dëshmojnë se është e mundshme që individët që u takojnë këtyre tri bashkësive fetare të kenë marrëdhënie miqësore dhe të fqinjësisë së mirë, lidhje si kushëri dhe të pranojnë ftesën e njëri tjetrit për të ndarë ushqimin.

Profeti ynë (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të), ishte gjithmonë i drejtë dhe i mëshirshëm ndaj Çifutëve dhe të Krishterëve dhe kërkonte vendosjen e një atmosfere të tolerancës dhe dashurisë së ndërsjellë tek pjesëtarët e këtyre feve të shpallura në mënyrë hyjnore. Gjatë jetës së tij, ai bëri marrëveshje

*Ithtarët e librit mos i polemizoni
ndryshe (kurr i thirrni në fenë tuaj)
vetëm ashtu si është më së miri,
përveç atyre që janë mizorë dhe
thuajuni: "Ne i besuam asaj që na u
zbrit dhe që u zbrit juve dhe se Zoti
ynë dhe Zoti juaj është një, dhe
se ne i jemi dorëzuar Atij.
(Kuran: 19/46)*



dhe dha garanci që të Krishterët dhe Çifutët të mund t'i praktikonin fetë e tyre lirshëm dhe të vazhdonin të jetonin në bashkësi autonome. Në vitet e hershme të Islamit, disa prej Muslimanëve të cilët kanë duruar shtypjen dhe mizorinë e Mekës kërkuan strehim tek mbreti i Krishterë i Etiopisë, Negus, me bekimin e Profetit (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të). Në anën tjetër, besimtarët të cilët u shpërngulën në Medine me të krijuan një model të bashkëjetesës që u bë shembull për të gjitha gjeneratat pasuese. Në periudhën e rritjes së Islamit, ky shembull hyri në histori si shembull i tolerancës dhe drejtësisë Muslimane ndaj Çifutëve dhe të Krishterëve.

Për shembull, në tekstin e një marrëveshje të diktuar nga ana e Profetit tonë (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) dhe të shkruar nga i Krishteri Ibn Harris b. Ka'b dhe vëllezërit e tij të Krishterë thuhet: "Feja, kishat, jetët, morali dhe mallrat e gjithë të Krishterëve që jetojnë në Lindje dhe në Perëndim janë nën mbrojtjen e Zotit, Profetit dhe të gjithë besimtarëve. Asnjë prej atyre që jetojnë sipas fesë së Krishterë nuk do të detyrohet të kalojë në Islam me forcë. Nëse ndonjë i Krishterë i nënshtrohet ndonjë vrasjeje apo padrejtësie, Muslimanët duhet t'i ndihmojnë atij."³⁴ Dhe mandej lexoi këtë ajet nga Kur'ani: Diskutoni me ithtarët e Librit vetëm me mënyrën më të mirë, por jo me keqbërësit e tjerë. Dhe thoni: "**Ne besojmë në atë që na është zbritur neve dhe në atë që ju është zbritur juve.**". (Kur'an, 29:46)

Tregime të panumërta na rrëfejnë se Profeti ynë (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) merrte pjesë në gostitë martesore të Çifutëve dhe të Krishterëve, vizitonte të sëmurët e tyre dhe i pranonte ata me zemërgjerësi. Kur e vizituan atë të Krishterët e Najranit, ai shtroi gunën e tij dhe iu lut atyre të ulen

në të. Martesa e tij me një të Krishterë Egjiptiane të quajtur Maria është një shembull i kësaj mendësie. Pas vdekjes së tij, trajtimi i mirë që u bëhej Ithtarëve të Librit kishte në qendër të tij po të njëjtën tolerancë që Profeti (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) kishte treguar ndaj këtyre dy bashkësive gjatë gjithë jetës së tij.

Muslimanët u sollën me tolerancë dhe drejtësi ndaj Ithtarëve të Librit

Krishterimi kishte lindur në tokën Palestineze por u përhap drejt Sirisë dhe Irakut të sotëm për arsye të sundimin tiranik të kishës së Krishterë. Kur Profeti ynë (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) filloi t'ua mësoj njerëzve Islamin, kishte shumë bashkësi Çifute dhe të Krishtera në Arabinë Jugore. Prandaj, që nga fillimi i Islamit, Muslimanët, Çifutët dhe të Krishterët vazhduan komunikimin.

Me përhapjen dhe forcimin e Islamit, Çifutët dhe të Krishterët e këtij rajoni ranë nën sundimin Musliman. Marrëdhëniet e bazuara në tolerancë dhe mirëkuptim reciprok vazhduan dhe marrëveshjet e ndryshme të arritura në kohën e Profetit tonë (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) u japën bashkësive Çifute dhe të Krishtera disa privilegje që garantuan të drejtat dhe ekzistencën e tyre. Privilegjet e dhëna murgjve të Manastirit të Shën Katerinës në malin Sinaj janë shembull për këtë. Këto dokumente garantuan të drejtat ligjore, fetare dhe shoqërore të atyre Çifutëve dhe të Krishterëve të cilën ranë nën sundimin Musliman apo që pranuan sovranitetin e Islamit. Problemet u zgjodhën duke iu referuar këtyre dokumenteve. Për shembull, librat e historisë përmendin se të Krishterët në Damask

*O ju që besuat! Bëhuni plotësisht të vendosur për hirë të All-llahut, duke dëshmuar të drejtën, dhe të mos u shtyjë urrejtja ndaj një populli e t'i shmangeni drejtësisë; bëhuni të drejtë, sepse ajo është më afër devotshmërisë. Keni dro All-llahun se All-llahu di hollësisht për atë që veproni.
(Kuran: 5/8)*



All-llahu ju urdhëron që
t'u jepni amanetin të zotëve
të tyre dhe kur të gjykoni,
ju urdhëron të gjykoni me
të drejt mes njerëzve. Sa e
mirë është kjo që ju
këshillon. All-llahu dëgjon
dhe sheh si veproni.
(Kuran: 4/58)

ia prezantuan dokumentet që shënonin privilegjet e tyre Kalifit Umar kur ata hasën në ndonjë problem dhe kërkuan prej tij që ta zgjidh çështjen në pajtim me to.³⁵

Kalifët të cilët pasuan Profetin (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) praktikuan drejtësinë e Zotit sipas Sunnetit profetik. Në tokat e pushtuara, si popullata vendase ashtu edhe ardhacakët jetuan në paqe dhe siguri. Për shembull, Ebu Bekri, kalifi i parë, ia dha urdhrin në vazhdim ushtrisë së tij para se t'i dërgonte ata në drejtim të Sirisë:

Ndalni, o njerëz, që të mund t'iu jap dhjetë rregulla që t'i mbani përmendësh: Mos bëni tradhti dhe as mos u largoni nga rruga e drejtë. Ju nuk keni të drejtë të gjymtoni apo vritni një fëmijë apo një burrë apo grua të moshuar. Mos shkatërroni një dru palme dhe as mos e digjni atë dhe mos pritni asnjë dru që mbart frute. Ju nuk keni të drejtë të preni asnjë tufë dhensh apo kope devesh, përveç se për mbijetesën tuaj. Mund t'iu ndodhë të kaloni pranë njerëzve të cilët ua kanë kushtuar jetët e tyre shërbimit të manastirit; i leni ata në atë që ata ia kanë kushtuar jetët e tyre. Mund t'iu ndodhë, gjithashtu, të gjeni njerëz të cilët mund t'iu ofrojnë ju ushqime të llojeve të ndryshme. Mund të hani, por mos harroni ta përmendni emrin e Zotit.³⁶

Kritja rapide e Islamit solli Sirinë dhe Egjiptin e sunduar nga Bizanti si edhe Irakun e sunduar nga Sasanidët, nën sundimin Musliman. Secili prej këtyre rajoneve kishte popullata të mëdha të Krishtera. Këta Çifutë dhe të Krishterë ishin dëshmitar të dorës së parë të drejtësisë dhe mëshirës së Muslimanëve. Asnjërit prej tyre nuk iu kërkua apo nuk iu bë trysni të ndërrojnë fetë apo zakonet e tyre. Nuk ishte e lejuar asnjë praktikë apo ndërhyrje që do ta ndryshonte rendin ekzistues shoqëror apo që do t'i shqetësonte ata. Sekte të ndryshme të Krishtera që Roma ose Bizanti i kishin mbajtur nën zgjedhë në të vërtetë parapëlqyen sundimin Musliman. Historiani Perëndimor Filip K. Hiti shkruan:

Nën ndikimin e Islamit, Lindja tani u zgjua dhe u ri-afirmua pas një mijëvjeçari të dominimit Perëndimor. Për më tepër, haraçi i kërkuar nga pushtuesit e ri (Muslimanët) ishte madje edhe më i vogël se ai që kërkohet nga të vjetrit, dhe të pushtuarit tani mund të ushtronin praktikat e tyre fetare me më shumë liri dhe më pak ndërhyrje.³⁷

Sipas dijetarit dhe autorit të Prinstonit Samjuel Mofet:

Nën sundimin e kalifëve patriarkal dhe përgjatë viteve të trazuara të luftërave civile, përveç vrasjeve dhe tmerreve që mund të priten në secilën luftë, trajtimi i të Krishterëve në territoret e pushtuara (Muslimane) të Persisë dhe Sirisë Bizantine u dëshmuua si jashtëzakonisht bujar.³⁸

Kur analizojmë jetën e tyre shoqërore dhe fetare nën sundimin Islamik, na shfaqet kjo pamje:

Në territorin Islamik, ekzistonte liri e vërtetë e praktikimit të fesë. Askush nuk detyrohej ta ndërronte fenë e vet dhe bashkësitë që rebeloheshin dhe ktheheshin më vonë nën autoritetin e Islamit u jepeshin të drejta të njëjta si më parë. Autoriteti Islamik, përveç disa përjashtimeve, kurrë nuk ndërhyri në zgjidhjen e patriarkëve apo emërimin e autoritetit fetar dhe garantoj të mos ndërhynte me nënshkrimin e marrëveshjeve të ndryshme. Këto komunitete vazhduan të flasin gjuhët e tyre në jetën e tyre private si edhe në jetën e tyre fetare. Në shkollat e Krishtera dhe Çifute, edukimi fetar vazhdoi lirshëm dhe manastiret dhe institucionet tjera që edukuan udhëheqësit e ardhshëm fetar të komunitetit ruajtën statusin e tyre të pavarur. Në mënyrë të njëjtë, faltoret e besimeve tjera fetare u mbrojtën nga ana e autoriteteve Muslimane. Gjatë pushtimit, faltoret asnjëherë nuk u dëmtuan, sepse mbrojtja e sinagogave dhe kishave u garantua nëpërmjet marrëveshjeve të bëra me Ithtarët e Librit që nga koha e Profetit (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të).

Në marrëveshjet që shkojnë prapa në kohë në periudhën fillestare të Islamit, nenet e tyre u lejonin Muslimanëve të qëndrojnë në manastire derisa ishin në udhëtim. Kjo dëshmon se Muslimanët bënë përpjekje të zhvillojnë dialog të bazuar në respekt të ndërsjellë me Ithtarët e Librit. Për më tepër, këto bashkësi u lejuan t'i rindërtonin kishat e braktisura apo të ndërtonin sinagoga dhe kisha të reja kur ata donin. Për shembull, manastiri i Shën Sergius jashtë Madejnit u shkatërrua nga Patriarku Mar Emme (644-647 të e.s.) por u rindërtua në kohën e kalifit Uthman. Shumë shembuj të tillë mund të përmenden: Ukba, guvernatori i Egjiptit, ndihmoi ndërtimin e manastirit për Nestorianët; gjatë sundimit të Mu'avijes u rinovua një kishë në Edesa dhe Kisha Markos u fut në përdorim në Aleksandri. Fakti

se kishat dhe sinagogat në Palestinë, Siri, Jordani, Egjipt dhe Irak ende vazhdojnë të jenë atje është një tregues për respektin e Muslimanëve për fetë tjera të shpallura hyjnore. Një tjetër shembull i tolerancës Muslimane është Manastiri i Malit Sinaj, njëra prej vendndodhjeve më të rëndësishme për haxhillëk e Krishterimit.

Burimi i tolerancës së Muslimanëve është morali Kur'anor, i cili thotë:

... Sikur Allahu të mos u kishte dhënë njerëzve mundësinë për t'u mbrojtur nga njëri-tjetri, do të shkatërroheshin manastiret, kishat, sinagogat dhe xhamitë, në të cilat përmen-det shumë emri i Allahut. Vërtet, Allahu e ndihmon këdo që e ndihmon Atë ... (Kur'an, 22:40)

Ithtarët e librit ishin të lirë t'i kremtojnë festat e tyre si pjesë të zakoneve të tyre fetare në faltoret e tyre si të dëshironin dhe udhëheqësit Musliman shpesh iu bashkoheshin këtyre kremtimeve. Patriarku Nestorian Isho'jab III (650-60 të e.s) i shkroi një letër Ipeshkvit të Persisë pas pushtimit Musliman që shpreh mëshirën dhe tolerancën e udhëheqjes Muslimane ndaj Ithtarëve të Librit nga një perspektivë e Krishterë.

Arabët të cilëve Zoti iu ka dhënë në këtë kohë qeverisjen e botës ... nuk e persekutojnë fenë e Krishterë. Në të vërtetë, ata e përkrahin atë, i nderojnë priftërinjtë tonë dhe të shenjtit e Zotit dhe u ndajnë të mira kishave dhe manastireve.³⁹

Përveç këtyre lirive dhe respektit, është e jashtëzakonshme gjithashtu drejtësia dhe paanësia me të cilën u trajtuan këto komunitete. Ndjenja për drejtësi e udhëheqësve Musliman ishte e njohur dhe shumë të Krishterë sollën rastet e tyre në gjykatat Islamike edhe pse ata kishin gjykatat e veta. Në një kohë, numri i të Krishterëve që përdornin gjykatat Islamike arriti numër aq të madh sa që patriarku Nestorian Mar Timoti I (780-825 të e.s)

Thuaju (o i dërguar): "O ithtarë të librit (Tevrat e Inxhill), ejani (të bashkohemi) te një fjalë që është e njejtë (e drejtë) mes nesh dhe mes jush: të mos adhurojmë, pos All-llahut, të mos ia bëjmë Atij asnjë send shok, të mos konsiderojmë njëri - tjetrin zotër pos All-llahut!" E në qoftë se ata refuzojnë, ju thoni: "Dëshmoni pra, se ne jemi muslimanë (besuam një Zot)!"
(Kuran: 3/64)



Ata (ithtarët e librit) nuk janë të njejtë. Nga ithtarët e librit ka që janë në rrugë të drejtë, gjatë natës lexojnë ajetet e All-llahut duke u lutur. I besojnë All-llahut dhe së ditës, këshillojnë për të mirë dhe largojnë nga të këqijat përpiqen për punë të dobishme, edhe ata janë prej të mirëve.
(Kuran: 3/113-114)

lëshoi një deklaratë që ua tërhiqte vërejtjen të Krishterëve për këtë.

Ihtarët e Librit që jetonin në vendet e sunduara nga Muslimanët nuk konsideroheshin si të robëruar, por si dhimmi, që u jepte atyre një status ligjor: popullata jomuslimane e cila e njihte autoritetin Musliman paguante një taksë të quajtur xhizje. Në shkëmbim, jetët dhe prona e tyre ishin të mbrojtura, ata gëzonin lirinë e të menduarit dhe të praktikimit të fesë, ishin të liruar nga shërbimi ushtarak dhe u lejohej të zgjidhnin çështjet e tyre të brendshme me anë të ligjeve të veta. Kohë pas kohe, taksa (xhizja) madje u kthehej atyre. Shumica e historianëve pranojnë faktin se dhimmit jetuan nën një sistem tolerant dhe të drejtë. Historiani i mirënjohur Bernard Luis thotë:

Por përgjithësisht pozita e tyre (dhimmive) ishte tej mase superiore ndaj asaj të atyre komuniteteve të cilat dallonin nga kisha e themeluar në Evropën perëndimore në të njëjtën periudhë kohe. Ata gëzonin të drejtën e ushtrimit të lirë të fesë së tyre. ... Atyre rrallë herë u është kërkuar të martirizohen apo të mërgojnë për shkak të besimeve të tyre.⁴⁰

Profeti ynë (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: **“Në Ditën e Gjykimit unë do të polemizoj më çdonjërin i cili shtyp një person nga mesi i Popullit të Lidhjes (dmth. një dhimmi), apo shkel të drejtën e tij, apo i ngarkon një përgjegjësi e cila tejkalon fuqinë e tij apo merr diçka prej tij kundër dëshirës së tij,”⁴¹** duke përshtetur në këtë mënyrë sjelljen korrekte ndaj dhimmive. Në përputhje me këtë moral, Muslimanët e konsideronin si një përgjegjësi të rëndësishme të tyre mbrojtjen e jomuslimanëve që ishin nën autoritetin e tyre. Gjatë një lufte me armatën Bizantine, Profeti ynë (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) urdhëroi që të kthehej taksa e mbledhur nga jomuslimanët, sepse armata Muslimane nuk ishte

All-llahu ju urdhëron që t'u
jepni amanetin të zotëve të
tyre dhe kur të gjykoni, ju
urdhëron të gjykoni me të
drejt mes njerëzve. Sa e mirë
është kjo që ju këshillon.
All-llahu dëgjon dhe sheh
si veproni.

(Kuran: 4/58)

në gjendje t'i mbronte ata.⁴² Ky është lloji i moralit që ai ua mësoi Muslimanëve. Një shembull tjetër i mirë i mëshirës dhe konsideratës janë fjalët e Umarit thënë një plake dhimmi: **“Pasha Allahun, ne nuk do të ishim të drejtë nëse marrim prej tij kur është i ri dhe e turpërojmë atë kur të jetë plakur.”**⁴³ Vetëm marrja e xhizjes nga jomuslimanët nuk është e padrejtë, sepse Muslimanët duhej të shërbenin në ushtri; jomuslimanët ishin të liruar nga shërbimi ushtarak.

Për shekuj me radhë, Muslimanët jetuan përkrah Çifutëve dhe të Krishterëve në paqe dhe siguri. Ata Çifutë dhe të Krishterë të cilët jetuan në tokat e qeverisura nga Muslimanët u kyçën në tregti të lirë dhe siguruan pronën, zgjodhën profesionin e tyre të dëshiruar, kishin zyrat e tyre në burokracinë shtetërore dhe madje punonin në pallatin e sundimtarit. Ata përfituan prej politikës zyrtare të lirisë së mendimit, ishin pjesë e jetës shkencore dhe kulturore të shoqërisë së

tyre dhe shkruan libra që ne i kemi ende në posedim sot. Ushtrimi i të drejtave të tyre nuk sfidohej apo ndalohej. Nëse e marrim parasysh se në të njëjtën kohë në Evropë njerëzit që u takonin feve tjera apo sekteve jo-ortodokse dëboheshin, persekutoheshin dhe vriteshin dhe librat që publikonin pikëpamje tjera digjeshin në grumbuj librash, liritë dhe paqja që mbizotëronin në botën Islamike bëhen edhe më domethënëse.

Të gjitha këto praktika janë kërkesa të moralit Kur'anor të porositura për Muslimanët. Paqja dhe siguria ishin norma në tokat e administruara nga Muslimanët që praktikonin këto parime morale. Administratat Muslimane kërkonin lumturinë dhe përparimin e njerëzve dhe zhvilluan sisteme që vendosën standardet për gjeneratat e ardhshme. Bota Islamike e sotme ka nevojë t'i kthehet moralit Kur'anor dhe rrugës së Profetit tonë (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të).

Të gjitha këto fakte historike të çojnë tek një çështje tjetër e rëndësishme: Ri-modelimi i botës Islamike sipas vlerave të Kur'anit nuk është i rëndësishëm vetëm për Muslimanët, por gjithashtu edhe për të gjithë pjesëtarët e besimeve tjera fetare që jetojnë këtu si edhe për pjesëtarët e të gjitha qytetërimeve, në veçanti të atyre që jetojnë në Perëndim. Ekzistenca e kombeve të fuqishme e bazuar në vlerat e Kur'anit do t'i mënjanojë shqetësimet e Perëndimit për botën Islamike dhe do të bëhet njëri prej gurthemeleve të paqes botërore.

Zgjidhja e Unionit Islamik për Lindjen e Mesme

Me themelimin e tij, Unioni Islamik do ta zgjidh konfliktin Izraelito-Palestinez duke paraqitur një front të bashkuar për të demonstruar kotësinë e strategjisë “përçaj dhe sundo” prej disa dekadash të Izraelit apo për t'i kundërvënë vendet Islamike njërën kundër tjetrës. Kjo do ta bind Izraelin të bëjë paqe të vërtetë me fqinjët e tij Arab duke u tërhequr në kufijtë e tij para vitit 1967, që është zgjidhja më e përshtatshme për Muslimanët Arab si edhe për Çifutët Izraelit.

Që paqja në Lindjen e Mesme të bëhet një e ardhme reale, duhen shëruar lëvizjet Arabe dhe Izraeli duhet t'i braktis politikat e tij të agresionit, okupimit dhe imperializmit. Unioni Islamik mund t'i arrijë të dy këto objektiva, sepse nën sundimin Islamik në Lindjen e Mesme, Çifutët dhe Muslimanët jetuan në paqe përkrah njëri tjetrit. Për shembull, gjatë sundimit Otoman, shumë Çifutë jetuan në Jerusalem dhe në qytetet tjera Palestineze pa përjetuar asnjë lloj paragjykimi apo armiqësie. Problemi buron nga dëshira e Izraelit për të sunduar gjithë Tokën e Shenjtë, një ambicie që vazhdon të shkaktojë vdekje dhe

gjakderdhje në Lindjen e Mesme.

Sipas Islamit, Çifutët, si trashëgimtar të Jakubit (paqja qoftë mbi të), kanë të drejtë të jetojnë në trojet e paraardhësve të tyre, profetëve Izraelit dhe të bëjnë ibadet në vendet dhe tempujt e tyre të shenjtë në këto troje. Mirëpo, është e papranueshme që të kërkojnë sovranitet mbi tërë rajonin, t'i

detyrojnë njerëzit të cilët e kanë populluar këtë pjesë për mijëra vite të largohen nga toka e tyre dhe ta destabilizojnë Lindjen e Mesme në mënyrë që të vazhdojnë këtë pushtim.

Unioni Islamik do të propozojë zgjidhjen vijuese për Izraelin:

1) Izraeli do të tërhiqet nga të gjitha Territoret e pushtuara, duke përfshirë Jerusalemin Lindor dhe do të bëj paqe me të gjitha kombet Arabe.

2) Në tokat e udhëhequra nga Palestinezët (si Jerusalemi Lindor, al-Khalil [Hebroni], Bregu Perëndimor, etj.), sinagogat do të mbrohen dhe Çifutët dhe të Krishterët do të kenë të drejtën e lëvizjes së lirë.

3) Unioni Islamik do të ndalojë çdo lloj sulmi terrorist mbi qytetarët Izraelit.

4) Unioni Islamik do ta luftojë antisemitizmin në mbarë botën dhe do të mbrojë sigurinë dhe paqen e komuniteteve Çifute. Nëse një plan i tillë gjithëpërfshirës paqësor vihet në jetë, do të arrihen paqja dhe stabiliteti në Lindjen e Mesme për herë të parë në këtë shekull. Të gjitha resurset financiare të shpenzuara në armë dhe luftëra atëherë do të shpenzohen për lumturinë, përparimin, shëndetin dhe edukimin e njerëzve.

*I dërguari i besoi asaj që iu shpall prej Zotit të Tij, si dhe besimtarët. Secili i besoi All-llahut, engjëjve të Tij, shpalljeve të Tij, të dërguarve të Tij. Ne nuk bëjmë dallim në asnjërin nga të dërguarit e Tij, dhe thanë: "Dëgjuam dhe respektoam. Kërkojmë faljen tënde o Zoti ynë! Vetëm te Ti është ardhmëria jonë."
(Kuran: 2/285)*



Harun Jahja (Adnan Oktar)

Po edhe nga ithtarët e librit ka që
besojnë All-llahun, e besojnë atë që u
është shpallur juve, e besojnë atë që
është shpallur atyre, janë të bindur
ndaj All-llahut, dhe argumentet e
All-llahut në shpallje nuk i shesin
për pak send të kësaj jete, të tillët
kanë shpërblimin e vet te Zoti i tyre,
e All-llahu është që llogarinë
e bën shpejt.

(Kuran: 3/199)





UNIONI
ISLAMIK
DHE
PERËNDIMI



Stabiliteti që do të pasojë në botën Islamike, i krijuar me anë të bashkëpunimit politik dhe ekonomik midis kombeve Muslimane, do t'i mundësoj Perëndimit të vendos marrëdhënie të harmonishme me Muslimanët. Me formimin e Unionit Islamik, kombet Muslimane së pari do t'i zgjidhin dallimet e tyre të brendshme dhe pastaj do të ndjekin politika të balancuara dhe stabile ndaj botës së jashtme. Dallimet midis kombeve Muslimane, si edhe tensionet midis kombeve Muslimane dhe jomuslimane, do të zgjidhen nga Unioni Islamik në mënyrë paqësore dhe të drejtë.

Ndikimi negativ i gjendjes së konfliktit mbi Amerikë

Tensionet artificiale midis Islamit dhe Perëndimit, si edhe skenarët për "përplasjen e civilizimeve" të promovuara prej qarqeve të caktuara, janë të dëmshme për botën Islamike dhe Perëndimin. Pra, masat e njerëzve jetojnë në frikë dhe të shqetësuara. Kjo situatë doli në shesh më shumë pas 9/11. Një pjesë e madhe e popullit Amerikan vuan prej efekteve psikologjike që burojnë nga insinuatat e vazhdueshme të mjeteve të komunikimit se "ne mund të sulmohemi përsëri në çdo kohë". Shifrat e hulumtimit të publikuara në *Journal of the American Medical Association* nga Dr. Uilliam E. Shelenger janë të rëndësishme. Një studim i bërë në Uashington D.C. dhe

Nju Jork me 2,273 subjekte që kishte për qëllim vlerësimin e ndikimit të 9/11 në opinionin Amerikan dha këto rezultate:

Përhapja e PTSD-së së mundshme (çrregullimi nervor post-traumatik) në mesin e njerëzve të cilët ishin në Nju Jork Siti më 11 Shtator ishte 11.2 për qind, krahasuar me 4.3 për qind për mbarë vendin. ... Veç kësaj, hulumtuesit zbuluan se përhapja e PTSD-së së mundshme u shoqërua në mënyrë të shprehur me numrin e orëve të raportimit televiziv të sulmeve që pjesëmarrësit treguan se i kishin përcjellë dhe me numrin e llojeve të ndryshme të ngjarjeve potencialisht traumatike që ata lajmëruan t'i kenë parë.⁴⁴

Këto shifra janë vetëm një shembull i vogël i dëmit që mbi shpirtin njerëzor shkaktojnë tensioni dhe konflikti. Është e qartë se është e rrezikshme të përshkallëzohet tensioni dhe të nxiten shqetësimet e njerëzve.

Sigurisht se për administratën e Bushit është e rëndësishme që t'i ndër marr masat e nevojshme parandaluese për ta mbrojtur Amerikën ndaj sulmeve si edhe për të larguar çfarëdo shqetësimi në lidhje me këtë. Megjithatë, strategjia e propozuar nuk duhet ta shtojë edhe më shumë tendosjen dhe mendjet e njerëzve nuk duhet lënë nën përshtypjen e rrezikut të vazhdueshëm. Politikat



duhet të ngjallin qetësi dhe të ndjekin metoda paqësore.

Mënyra më e mirë për t'u liruar nga shqetësimet e administratës së Bushit, si edhe nga ato të publikut, është formimi i Unionit Islamik. Kjo do t'i ndalonte përpjekjet e atyre njerëzve dhe organizatave që përpiqen ta bëjnë të ligjshëm terrorizmin nëpërmjet keqinterpretimit të Islamit. Për më tepër, kjo mund ta demaskoj faktin se interpretimet e tyre të meta fetare, të cilat i bëjnë të gjithë Muslimanët të dyshimtë, nuk posedojnë kurrfarë vërtetësie dhe në këtë mënyrë ndalojnë krijimin e çfarëdo hutie mendore tek masat e njerëzve. Efikasiteti i propagandës së atyre që duan të krijojnë tension, si edhe përpjekjet e tyre për ta përhapur atë, do të dobësohen dhe do të shuhën në mënyrë të natyrshme. Do të krijohet një mjedis i favorshëm për tolerancë, paqe, dialog dhe bashkëpunim dhe do të dominojnë politikat paqësore.

Rreziku i shpërbërjes së Perëndimit

Politika Amerikane post 9/11, e në veçanti pushtimi i Irakut, shkaktuan mosmarrëveshje serioze dhe përçarje në Perëndim. Në Amerikë, u jetësua një ndarje në mes të përkrahësve të luftës dhe mbrojtësve të paqes, dhe secila palë akuzoi tjetrën për barbarizëm apo tradhti. Gjatë periudhës përgatitore para pushtimit dhe në periudhën pas pushtimit, dolën në shesh mosmarrëveshje serioze në organizma të tillë ndërkombëtar si KB dhe UE, gjë që shtyri disa strategë të pohojnë se aleanca Perëndimore do të shpërbëhej. Për shembull, miliona njerëz në gjithë Perëndimin dhe në mbarë botën demonstuan kundër pushtimit.

E gjithë kjo mund të parandalohej nga një Union Islamik i

Dünya barış için yürüdü

Radikal Gazetesi, 16.2.2003



Gökkuşunu beyaz indirdiler... (Text describing the protest and the significance of the white banner.)



Dün dünyanın önde gelen şehirlerinin meydanları, 'ya-ya ya-ya' sesleri ile yankılandı. Oslaca sükûta yux bizi... (Text describing the global nature of the protests and the atmosphere.)

Zaman Gazetesi, 19.1.2003



War caused serious divisions in the West, and anti-war demonstrators organized mass demonstrations.

fuqishëm, i cili do t'iu përgjigjej shpejt kërkesave legjitime të Perëndimit për asgjësimin e armëve të pretenduara për shkatërrim në masë dhe për ndalimin e përkrahjes së terrorizmit. Masat e ndërmarra nga ana e Unionit Islamik do të jepnin rezultate të shpejta dhe rezultatet e dëshiruara do të mund të arriheshin pa fushatën pasuese ushtarake, e cila shkaktoi humbje të mëdha të jetës dhe pasurisë.

Shpenzimet e tepruara të mbrojtjes

Kur analizojmë buxhetet kombëtare, del se pjesa më e madhe e tyre përbëhet prej shpenzimeve të mbrojtjes dhe atyre ushtarake. Gjatë shekullit njëzet, 250 luftëra me një shtrirje të vogël apo të gjerë janë zhvilluar dhe 110 milionë njerëz kanë vdekur. Në Luftën e Parë Botërore kanë marr pjesë 20 vende. Dhjetë milionë njerëz kanë vdekur dhe shkatërrimi u përhap nga vija e parë e frontit dhe shkretoi zonat civile urbane. Në luftën më të keqe në histori, Luftën e Dytë Botërore, luftuan 110 milionë ushtarë, prej të cilëve 27 milionë vdiqën në vijën e parë të frontit dhe 25 milionë civil të tjerë humbën jetën. Kjo luftë shkretoi me dhjeta shtete në një rajon që shtrihet nga Oqeani Atlantik deri në Oqeanin Paqësor.

Për shembull, në Gjermani u shkatërruan 1.5 milion shtëpi, duke lënë të pastrehë 7.5 milion njerëz. Veç kësaj, në Unionin Sovjetik 6 milion shtëpi u shkatërruan, si edhe 1,700 qytete të vogla dhe të mëdha dhe 70,000 fshatra.⁴⁵

Midis viteve 1990-2000, shpërthyen 56 konflikte të armatosura në 44 rajone të ndryshme të botës.

Me pak fjalë, shekulli i fundit ishte një shekull tejet i përgjakshëm. Më i trishtueshëm është fakti se këto humbje shtuan investimet ushtarake dhe ndikuan në rritjen edhe më të madhe të buxheteve kombëtare mbrojtëse, në vend se kjo të ishte një mësim dhe kauzë për paqe. Shpenzimet materiale të luftërave kryesore të shekullit njëzet ishin tejet të mëdha: Lufta e Parë Botërore i kushtoi botës \$2.85 trilion, Lufta e Dytë Botërore i kushtoi \$4 trilion, lufta Koreane kushtoi \$340 miliard, lufta e Suezit kushtoi \$13 miliard, lufta e Vietnamit kushtoi \$720 miliard, lufta Izraelito-Arabe kushtoi \$21 miliard, lufta në


Afganistan e 1979-89 kushtoi \$116 miliard dhe lufta Irak-Iran kushtoi \$150 miliard.⁴⁶

Gjatë gjithë këtij shekulli, buxhetet ushtarake kanë vazhduar të rriten. Raportet e publikuara në vitin 2002 treguan se shpenzimet e përgjithshme ushtarake në botë kishin arritur shumën prej \$1 trilion. Si krahasim, 1.2 miliard njerëz jetojnë me të ardhura prej nën \$1 në ditë, 113 milion fëmijë nuk kanë qasje në shkollim dhe çdo vit më shumë se 11 milion fëmijë vdesin për shkak të varfërisë dhe kushteve të këqija për jetesë. Për të njëjtat arsye, një në çdo 48 fëmijë lind i vdekur.⁴⁷

Amerika ndodhet në krye të listës sa i përket buxhetit ushtarak prej \$400 miliard në vit; \$45 miliard shtesë u kërkuan nga Kongresi për luftën kundër terrorizmit të administratës së Bushit. Kjo shifër është më e lartë se shpenzimet e marra së bashku të gjitha vendeve të G8.⁴⁸ Pason Rusia (\$60 miliard) dhe Kina (\$42 miliard).⁴⁹ Veç kësaj, Amerika ka baza ushtarake në mbi 40 shtete dhe prezencë më të vogël apo më të madhe në 132 prej 190 shteteve anëtare të KB-ve. Ndihma ushtarake për vendet

It will be proper and conscientious to divert that part of the budget allocated to weaponry to the education of children and poverty.






e huaja është një faktor i rëndësishëm i kostos së buxheteve të shteteve Perëndimore, e në veçanti në rastin e Amerikës.

Mund të supozohet se ekonomia e Amerikës lehtë mund të absorbojë një buxhet aq të lartë mbrojtës, por shifrat zbulojnë se ky shpenzim ka ndikim të konsiderueshëm negativ. Mendoni për faktet në vazhdim: Pikërisht tani në Amerikë, 31 milion njerëz – duke përfshirë 12 milion fëmijë – jetojnë nën kufirin e varfërisë; 3% of amvisërive të SHBA-ve përjetojnë uri dhe 7% e amvisërive të SHBA-ve rrezikohen nga uria dhe një pjesë e madhe e tyre nuk marrin asnjë ndihmë nga shteti. Që nga viti 1994, ndihma për këta njerëz ka rënë për një të tretën.⁵⁰

Këto shifra tregojnë për urgjencën e bërjes së



paqes në botë në mënyrë që të ulet sasia e të mirave që gllabërohen prej buxheteve të mbrojtjes. Unioni Islamik do t'i jap fund gjithë konfliktit dhe tensionit brenda botës Islamike dhe në këtë mënyrë do të krijojë një mjedis të paqes dhe të qenies të kënaqur në mbarë botën që do t'iu mundësojë si kombeve Muslimane ashtu edhe atyre jomuslimane pakësimin e shpenzimeve të tyre ushtarake. Si rezultat, investimet e bëra në teknologjinë e armatimit dhe të hollat e shpenzuara në zhvillimin e armatimit do të orientohen drejt edukimit, mjekësisë, shkencës dhe kulturës. Reduktimet e tilla do ta mundësojnë përdorimin e shumë më tepër të mirave për të zgjidhur problemet si uria, varfëria, dëmtimi ekologjik dhe sëmundjet ngjitëse. Me zbutjen e çështjeve të sigurisë, standardet jetësore të gjitha vendeve do të rriten dhe do të zbatohen politikat e dizajnuara për përmirësimin e cilësisë së jetës. Fondet e dedikuara për projektet kulturore dhe edukative do të rriten dhe do të lind një gjeneratë e shëndosh shpirtërisht, e fortë fizikisht, e mëshirshme dhe e përzemërt.

Kjo atmosferë e paqes është urgjentisht e nevojshme në tri rajone problematike të botës Islamike: Ballkan, Azi Qendrore dhe Lindje të Mesme. Amerika ka një prani ushtarake në të tri këto rajone. Çdo vit, ajo ndanë fonde shumë të mëdha për Izraelin për shkak të konfliktit Arabo-Izraelit. Ndikimi i njëanshëm dhe i fuqishëm i lobit Izraelit mbi politikën e jashtme Amerikane luan një rol të rëndësishëm në përcaktimin e sasisë së kësaj ndihme në Kongres. Hulumtimi i bërë nga ekonomisti Tomas Staufer zbulon se ndihma për Izraelin që nga viti 1973 i ka kushtuar popullit Amerikan \$1.6 trilion në total. Ndarja e kësaj shumë me popullatën e tanishme të Amerikës e vendos këtë shifër në \$5,700 për person.⁵¹ Amerika ka mundësi dhe u ndihmon aleatëve të saj, Izraelit si edhe vendeve tjera, por mënjanimi i arsyeve themelore

The Cost of Israel to the American People

by Richard Curtiss

How many Americans are aware that Israel, with a population of only 5.8 million people, is the largest recipient of U.S. foreign aid, and that Israel's aid plus U.S. aid to Egypt's 75 million people for keeping the peace with Israel has, for many years, consumed more than half of the U.S. bi-lateral foreign aid budget world-wide?

Not few. Americans understand, however, is the steep price they pay in many other fields for the U.S.-Israel relationship, which is a product of the influence of Israel's powerful lobby on American domestic politics and has nothing to do with U.S. strategic interests, U.S. national security, human rights, and fair play overseas.

Under its financial cost, unwavering U.S. support for Israel, which is a result of the influence of Israel's powerful lobby on American domestic politics and has nothing to do with U.S. strategic interests, U.S. national security, human rights, and fair play overseas.

CHRISTIAN SCIENCE MONITOR [csmonitor.com](http://www.csmonitor.com)

Economist tallies swelling cost of Israel to US

By David R. Zaretzki | Staff writer of The Christian Science Monitor

Since 1972, Israel has cost the United States about \$1.8 billion, if divided by today's population, that is more than \$5,700 per person. This is an estimate by Thomas Stauffer, a consulting economist in Washington. For decades, his analyses of the Middle East scene have made him a frequent thorn in the side of the Israel lobby.

For the first time in many years, Mr. Stauffer has tallied the total cost to the US of its backing of Israel in its drawn-out, violent dispute with the Palestinians. So far, his figures, the tall adds up to more than twice the cost of the Vietnam War.

And now Israel wants more. In a meeting in the White House late last month, Israeli officials made a pitch for \$4 billion in additional military aid to defray the rising costs of dealing with the country's recession-battered economy.

Considering Israel's deep economic troubles, it is likely to be structured so they don't pay perhaps 10 years out.

Israel's request could be part of a level with Israel.

Israel is the largest recipient of US aid in 2003. It has been getting \$3 billion.

Adjusting the official aid to 2001's given Equival \$177 billion and jump

"Consequently, politically, if not total costs of US Middle East aid

The Cost of Israel to U.S. Taxpayers

U.S. Spending More On Aid to Israel Than On War on Drugs

By Paul E. Smith

FEBRUARY 16, 1996, Page 46

The United States spends \$4 billion annually on domestic drug enforcement. It's a lot of money, but few Americans begrudge it. Most feel there is a direct connection between increased drug use and the explosion of crime that has so degraded the quality of life in America.

If it takes 10 years to begin addressing a problem that starts out as a cancer rising at the heart of the country, so be it, so long as statistics show, despite signs and stories.

Harder to understand, however, is the migration demonstrated by Americans over the staggering annual cost of Israel to U.S. taxpayers. People can differ over the total cost of Israel. One year just cost the more than \$4 billion that has flowed from the United States to Israel since 1949 in explicit grants, foreign loans, and loan guarantees? The year has three explicit annual tranches into inflation-adjusted 1996 dollars, in which case they might not approach \$300 billion? Do you also count the interest that those coffers have on American taxpayers, since the U.S. government has had to borrow every cent of them? In that case the amount starts past 1,000 billion and starts climbing toward \$200 billion.

Friends of Israel would argue that America's financial mismanagement is not the fault of its Israeli client state. They even go so far as to say that federal loan guarantees to Israel over the American taxpayer's wallet, since Israel "has never defaulted on a loan." The truth, however, is that Israel has never repaid a U.S. government loan because Congress requires U.S. government loans for that year.

Until it does, the "Clinton Amendment," named after one of Israel's greatest benefactors, the late California Democratic Adam Clinton, and attached to every foreign aid appropriation bill since 1984, mandates that the annual level of U.S. economic aid to Israel cannot sink below the level of interest Israel must pay on outstanding loan just over the American taxpayer's wallet.

There is no reason to believe that the Israelis are about to increase their practice of successfully lobbying Congress to forgive loans to Israel, and to have the U.S. taxpayers bear the costs of such loans and they are forgiven. It is certain, therefore, that they will repeat this pattern when it is time to begin repaying the principal and interest on the \$30 billion in loan guarantees they currently are collecting at the rate of \$2 billion annually. (Repayment of principal and interest begins only 10 years after the Israeli government borrows the money.)

Every year, the American government gives millions of dollars to Israel to establish security and to support it. This is quite normal for nations who are allies. However, a permanent peace in the Middle East will enable such expenses to be lowered so that aid can be increased to such essential social sectors as education, health, and caring for the needy.

për këtë ndihmë do të jetë një zhvillim pozitiv për ekonominë Amerikane dhe për të ardhmen e qytetarëve Izraelit. Mesazhi kryesor i propagandës së Sionistëve radikal pohon se Izraeli është nën kërcënim të vazhdueshëm prej fqinjëve të tij dhe për këtë arsye ka nevojë të mbrohet. Ka pasur luftëra dhe përleshje midis Izraelit dhe shteteve fqinje Arabe për dekada dhe tensioni midis tyre ekziston ende. Mirëpo, kjo situatë nuk është krijuar vetëm nga një palë në konflikt. Në ndikimin e Sionizmit radikal, Izraeli ka ndjekur shpeshherë politika agresive dhe armiqësore.

Nuk është e vështirë të ndryshohet kjo situatë dhe t'u lejohej të dy popujve të gjejnë paqen dhe sigurinë. Krijimi i Unionit Islamik do të jetë një hap i rëndësishëm drejt paqes në rajon, sepse do t'i mbrojtë të drejtat e Krishterëve dhe Çifutëve që jetojnë në Lindjen e Mesme dhe në pjesën tjetër të botës Islamike, ashtu që Perëndimi nuk do të ketë nevojë të sajojë strategji të veçanta dhe të zotojë fonde për mbrojtjen e tyre.

Sigurimi i burimeve të energjisë

Në fillim të shekullit njëzet, thëngjilli ishte burimi i vetëm më i rëndësishëm i energjisë. Në vitet e 1950-ta, thëngjilli u zëvendësua nga nafta. Para Luftës së Dytë Botërore, industria zhvillohej me anë të energjisë së avullit, ndërsa thëngjilli shërbente si lëndë djegëse; pas asaj lufte, në mënyrë dramatike u shtua përdorimi i naftës dhe motorit me djegie të brendshme. Në pjesën e dytë të shekullit njëzet, gazi natyror u paraqit si burim alternativ energjie dhe filloi të luaj një rol të rëndësishëm në ekonominë botërore.

Aktualisht, vendet që kanë rezerva të naftës dhe gazit natyror kanë rëndësi të madhe për ekonominë botërore sa i

përket prodhimit, klimës politike dhe kapacitetit teknologjik. Kriza e naftës e vitit 1973 tregoi se sa i rëndësishëm është ky burim i energjisë për ekonominë botërore. Ngritja e befasishme dhe e shpejtë e çmimeve të naftës shkaktoi rrëmujë dhe recesion global dhe kriza të ngjashme u përjetuan në vitet që pasuan këtë ngjarje.

Për këtë arsye, rezervat e mëdha të shteteve Muslimane të naftës, gazit natyror dhe të mineraleve tjera të çmueshme luajnë një rol domethënës në marrëdhëniet e Perëndimit me vendet Muslimane. Rëndësia gjeopolitike e këtyre vendeve është një tjetër arsye vendimtare pse Perëndimi kërkon të ketë kontroll mbi këto burime dhe ndikim në rajon. Për ta forcuar pozitën e tij, Perëndimi zhvillon një shumëllojshmëri strategjish që ngjasojnë me mendësinë kolonialiste të së kaluarës së tyre imperialiste. Këto strategji destabilizojnë rajonin, gjë që, si pasojë, ka ndikim negativ në interesat e Perëndimit.

Aktualisht, Amerika konsumon afro 20 milion barel naftë në ditë. Në vitet e 1950-ta, ajo prodhonte 52% të prodhimit botëror; sot, ajo importon 53% të konsumit të saj. Hulumtimi sugjeron se rezervat Amerikane do të shpenzohen brenda 20 viteve të ardhshme. Duke e ditur se 24% e importeve të saj vijnë nga rajoni i Gjirit, rëndësia e këtij rajoni për Amerikën është e pamohueshme. Gjithashtu, rezervat në Azinë Qendrore janë një lloj të rëndësishme për Amerikën dhe botën. Vartësia e Evropës nga nafta dhe gazi natyror nga këto rajone është madje edhe më e madhe. Si rezultat i këtyre realiteteve, ekziston një nevojë urgjente për bashkëpunim të vërtetë midis Perëndimit dhe vendeve të pasura me naftë.

Perëndimi duhet ta përkrah zhvillimin kulturor dhe ekonomik të këtyre vendeve në mënyrë që të krijoj dhe të mbaj

THIRRJE PËR UNION ISLAMIK





The global economy depends upon the oil exported from the Islamic world, especially the Gulf region. That region alone contains two-thirds of the world's known oil reserves: Iraq has 11% of the world's oil reserves. The United Arab Emirates has 9.2%, Kuwait has 8.6%, Iran has 13%, and other OPEC countries have 22.6%. In addition, research reveals that the oil exports of the Gulf region will increase by 125% between 2000 and 2020. No doubt, the prevalence of stability and peace in these regions, as well as true democracy, will enable humanity to benefit from these resources in the best way. This is only possible through the establishment of the Turkish Islamic Union.

gjallë një bashkëpunim të tillë. Krijimi i qëndrueshmërisë, paqes dhe një demokracie që funksionon në këto rajone të pasura me resurse natyrore do të mundësojë që bashkësia botërore të përfitojë prej këtyre rezervave në mënyrën më efikase. Kaosi dhe paqëndrueshmëria në këto rajone, në anën tjetër, do të ndalojnë apo së paku do ta pengojnë tej mase, nxjerrjen, prodhimin dhe dërgimin e këtyre resurseve në vendet tjera. Në kohëra konfliktesh, çështjet e sigurisë e vështirësojnë shumë sigurimin e këtyre resurseve natyrore. Për të njëjtat arsye, dërgimi i këtyre burimeve bëhet edhe më problematik dhe më i shtrenjtë, sepse duhet të vendosen linja më të gjata transporti. Themelimi i Unionit Islamik do t'i zgjidhë të gjitha këto çështje në kuadër të një sistemi të sigurisë.

Unioni Islamik do të kontribuojë për zhvillimin e një modeli që do t'i përdorë të gjitha këto burime të energjisë në mënyrën më efikase pa dëmtuar asnjë vend. Vendet Muslimane do të lëvizin si pjesë të një aleance ekonomike, pikërisht siç do të veprojnë në të gjitha fushat tjera dhe do të zhvillojnë politika të përbashkëta për përdorimin e resurseve. Pasi që ky union do t'i ndalojë regjimet që t'mos i çrregullojnë këto politika, të cilat bazohen në drejtësi, do të mundësohet ndjekja e politikave stabile dhe të baraspeshuara sa u përket çështjeve vitale ekonomike, në veçanti prodhimit të naftës dhe përcaktimit të çmimit.

Përgjegjësitë e Perëndimit

Çdo vend zhvillon dhe ndjekë një politikë të jashtme duke pasur interesat e veta në qendër të vëmendjes në përpjekje që ajo të jetë në dobi të popullit të vet dhe të ardhmes së kombit të vet.

Megjithatë, kjo arrihet përmes të kuptuarit se asnjë vend nuk shkel apo nuk dëmton interesat e vendit tjetër. E njëjta gjë vlen për marrëdhëniet e Perëndimit me vendet Muslimane. Kohë pas kohe, disa vende Perëndimore zhvillojnë aso politika në raport me botën Islamike që në thelb të tyre nuk kanë asgjë tjetër pos interesave të tyre, madje edhe me çmimin e nevojave më themelore të botës Islamike. Kjo, si pasojë, krijon ndjenja anti-perëndimore në mesin e disa qarqeve Muslimane dhe një mosbesim dhe ankth reciprok midis qytetërimeve. Në realitet, frika dhe brengat e të dyja palëve mund të zgjidhen.

Mirëpo, kjo kërkon që qeveritë Perëndimore, e në veçanti ajo Amerikane, të jenë të kujdesshme ndaj influencës dhe dëshirës se disa qarqeve të fuqishme për një konflikt të qytetërimeve. Këto qarqe mund të definoohen si vijon:


1- Përkrahësit e vijës së ashpër me një perspektivë social-darviniste

Kjo mendësi, e cila konsideron se qytetërimet joperëndimore janë primitive, ishte pikëpamja dominuese në shekullin e nëntëmbëdhjetë dhe në fillim të shekullit njëzet. Me sa duket, kjo ishte vërtetuar shkencërisht nëpërmjet teorisë së evolucionit të Darvinit; mirëpo, në realitet, është mbetje e kolonializmit. Siç e dimë, Darvini pohonte se njerëzimi dhe majmunët evoluuan nga paraardhësi i njëjtë dhe se ekzistonin dallime të mëdha midis racave, sepse disa ishin tejet të zhvilluara ndërsa të tjerat ishin ende "gjysmë-majmunë".

Kjo teori u pranua gjerësisht në kohën e formulimit të saj, por është hedhur poshtë me anë të fakteve të fuqishme shkencore të përfituara gjatë disa dekadave të fundit. Imperialistët perëndimor përdorën pretendimet e ashtuquajtura shkencore të

THIRRJE PËR UNION ISLAMIK

Darvinit për të arsyetuar eksploatimin e tyre e madje edhe skllavërimin e kombeve tjera. Me pretendimin se raca e bardhë ishte superiore ndaj “racave më të ulta që bëjnë përpjekje për mbijetesë”, ata u përpoqën që t’ i legjitimojnë politikat e tyre të kolonializmit dhe imperializmit. Ndërsa kolonializmi po lëvizte me një hap të shpejtë, kolonialistët pretendonin t’ua sillnin civilizimin këtyre vendeve. Mirëpo, pas një kohe, përparimet shkencore e ekspozuan teorinë e Darvinit si teori të cilës i mungon substanca shkencore dhe si asgjë më shumë se një mit. Gjithashtu u bë e qartë se imperialistët u sollën vendeve që i kolonizuan eksploatim dhe mjerim, në vend të qytetërimit. Ende vazhdojnë të ekzistojnë efektet dhe mbetjet e kësaj mendësie



Western imperialists, who saw some nations as "primitive" and "un-evolved," received support from Darwinism. According to this misguided theory, some nations, including the Aborigines of Australia, could not complete their development and thus were supposedly inferior to the white race.

imperialiste dhe logjike darviniste, megjithëse në një shkallë shumë më të vogël.

Në kohën e tanishme, disa qarqe në Perëndim, nën ndikimin e kësaj mënyre të gabueshme të gjykimit, nisen nga premisa e superioritetit të racës dhe qytetërimit të tyre kur përcaktojnë se çfarë marrëdhënie do të ketë Perëndimi me pjesën tjetër të botës. Natyrisht, ky është një gabim shumë i madh që vetëm do të shkaktojë më shumë tension dhe do të përkeqësojë problemet ekzistuese. Të dyja qytetërimet, si ajo Perëndimore ashtu edhe ajo Islamike kanë rrënjë të thella në histori dhe të dyja kanë influencuar shumë njëra tjetrën. Për më tepër, sa i përket kësaj, dallimet që ekzistojnë midis qytetërimeve nuk duhet përdorur si stimulim për të kënaqur komplekset e superioritetit, si burim të konfliktit. Përkundrazi, të dy qytetërimet duhet parë si plotësuese dhe të dobishme për njëra tjetrën. Veç kësaj, të gjitha propozimet e bëra nga përfaqësuesit e grupeve ushtarake-industriale të interesit duhet pranuar me kujdes, sepse ato e shohin tensionin ndërkombëtar si një treg potencial dhe burim të përfitimit ekonomik – qoftë edhe me çmimin e jetëve njerëzore.

2- Mbështetësit e Krishterimit militant

Krishterimi është një fe e paqes dhe dashurisë, sepse Bibla i urdhëron të Krishterët t'i duan madje edhe armiqtë e tyre dhe t'iu bëjnë mirë njerëzve. Shumë të Krishterë ndjekin këtë këshillë dhe jetojnë në paqe. Shumë kisha dhe udhëheqës fetar në Amerikë hyjnë në kuadër të këtyre parametrave. Mirëpo, disa udhëheqës tjerë të Krishterë kanë ruajtur instinktet e tyre kryqtare, siç reflektohen ato në komentet e tyre agresive dhe të pajustificueshme kundër Islamit. Në njërën anë, ata u bëjnë keq

Muslimanëve dhe, në anën tjetër, shtrembërojnë Dhiatën e Vjetër duke sugjeruar se së shpejti do të ketë një luftë midis Muslimanëve dhe Perëndimit – dhe, çka është edhe më e keqe, se kjo luftë është e domosdoshme. Këto gabime të Krishtera pasqyrojnë një vizion strategjik që përputhet me disa elemente radikale Sioniste në Izrael dhe gabimi i tyre duhet t’iu shpjegohet nga vëllezërit e tyre të Krishterë.

3- Sionistët radikal

Në mesin e atyre të cilët e dëshirojnë një “kryqëzatë” të tillë kundër Islamit, më të eturit janë politikanët radikal Izraelit dhe lobi Izraelit në Amerikë që ndajnë të njëjtin mendim. Në vend se të largohen nga Territoret e Okupuara dhe të bëjnë paqe me Arabët, ata besojnë se Izraeli duhet t’i vazhdoj politikat e tij të vijës së ashpër pa lëshuar pe. Ashtu siç e kërkon strategjia e “Murit të Hekurt” e propozuar në vitet e 1920-ta nga udhëheqësi fashist Sionist Jabotinski, ata do të donin ta shihnin Izraelin si Spartën e ditës së sotme⁵² me Amerikën që financon këtë makineri luftime.

Administrata e Bushit, si edhe administratat e ardhshme Amerikane, duhet të jenë shumë të kujdesshme kur merren me këtë pikëpamje radikale Sioniste. Mirëpo, ka Çifutë liberal si edhe ortodoks të cilët kërkojnë që Izraeli ta mbrojë paqen, siç e kërkon Judaizmi i vërtetë dhe të cilët mbështetin paqen midis Çifutëve dhe Arabëve. Ata duhet t’i kundërvihen kësaj lëvizje radikale Sioniste dhe t’i ndalojnë ata të cilët duan ta zhytin botën në konflikt që të mos e bëjnë këtë.

Sa për botën Islamike, çështja më fundamentale është të themelojnë Unionin Islamik. Duke marr parasysh mungesën e



Haham Meir Kahane

The Kach, a radical organization established by Rabbi Meir Kahane in Israel that operates in America under the name of the Jewish Defence League, carried out activities against Muslims in Palestine. Kach embraces some fanatical ideas,

among them the idea that Jews are superior to all other people and that all non-Jews are animals (goyim). For this very reason, they advocate the ethnic cleansing of all Arabs in all lands ruled and occupied by Israel.

The murder of 67 Muslim worshippers, along with the wounding of 300 others, in the Ibrahim Mosque in 1994 was just one of this fanatic group's deeds.

tanishme të një autoriteti qendror që i përfaqëson të gjitha vendet Muslimane, Perëndimi e ka shumë të vështirë të vendos një dialog qytetërues në baza të shëndosha. Ndonjëherë, për veprime të veçanta faji hidhet tek Muslimanët në përgjithësi dhe, herëve tjera, çështjet që kanë të bëjnë me botën Islamike trajtohen si incidente të izoluara. Andaj, strategjitë e gabueshme dhe incidentet e dëmshme që rezultojnë shkaktojnë tension në botën Islamike si edhe rrëmujë në Perëndim. Mosekzistimi i një institucioni qendror për të mbrojtur të drejtat e Muslimanëve, për të shprehur vendimet dhe kërkesat e tyre të përbashkëta dhe për të ofruar udhëzim për Perëndimin shkakton telashe të mëdha. Pra, domosdoshmëria e Unionit Islamik të propozuar nga ne përsëri bëhet e qartë.



LAJMI
I MIRË
I UNIONIT
ISLAMIK

Ky libër u shkrua në verën e vitit 2003. Do të kishte qenë shumë vështirë të flitet për një Union Islamik 20, 30, 40, apo 50 vite më parë, sepse as bota në përgjithësi dhe as bota Islamike në veçanti nuk përmbushën kriteret e nevojshme për formimin e një unioni të tillë. Përkundrazi, shumë rrethana do ta kishin ndaluar atë. Mirëpo, pas një vargu ndryshimesh nga viti 1980 e këndej, ideja e një unioni të tillë nuk ishte më jorealiste. Le të analizojmë këto ndryshime një nga një.

Muslimanët janë bërë më të lirë

“Unioni Islamik” i fundit ishte Perandoria e madhe Otomane. Që nga rënia e saj, bota Islamike është ndarë në shumë shtete komb që mbetën nën sundimin kolonial, disa për një periudhë të zgjatur kohe. Që nga viti 1920 e këndej, pjesa më e madhe e Lindjes së Mesme, Afrikës Veriore, nën-kontinentit Indian dhe Muslimanëve të Azisë Juglindore ranë nën sundimin e fuqive koloniale Evropiane, në veçanti të Francës dhe Britanisë. Muslimanët e Azisë Qendrore dhe të Kaukazit së pari ranë nën sundimin e Rusëve dhe më vonë, edhe më keq, të Sovjetëve. Muslimanët e Ballkanit ranë nën sundimin e popujve të tillë jomuslimanë si Serbët dhe Kroatët, sunduesit e të cilëve, pas Luftës së Dytë Botërore, pranuan komunizmin.

Me pak fjalë, shumica e Muslimanëve jetuan nën sundimin kolonial. Me fundin e kolonializmit në vitet e 1950-ta dhe 1960-ta, Muslimanët filluan ta fitojnë

pavarësinë e tyre. Britania së pari u tërhoq nga nën-kontinenti Indian dhe pastaj nga Lindja e Mesme. Në nën-kontinentin Indian, u krijuan India, Pakistani Perëndimor dhe Lindor (që më vonë themeloi Bangladeshin). Në Lindjen e Mesme, kombet e ndryshme Arabe fituan pavarësinë e tyre. Në Juglindje, Malajzia dhe Indonezia shpallën pavarësinë e tyre në vitin 1965.

Në fund të viteve të 1980-ta u shpërbë Blloku Lindor dhe në vitin 1991 Unioni Sovjetik u rrëzua dhe shumë popuj Musliman fituan pavarësinë e tyre. Në Azinë Qendrore, kombet Muslimane Turke më në fund u çliruan nga pushtimi Rus/Sovjetik pas 150 viteve dhe u bënë republika të pavarura. Fundi i komunizmit gjithashtu çliroi Muslimanët e Ballkanit. Bosnja dhe Hercegovina u çlirua nga Jugosllavia a dominuar nga Serbët dhe një komb Musliman lindi në Evropën Qendrore dhe Shqipëria u çlirua nga regjimi tiranik dhe gjakpirës komunist i Enver Hoxhës.

Përveç Muslimanëve që jetojnë si pakica në vende të ndryshme ose nën pushtim (si Palestina dhe Kashmiri), Muslimanët tani sundojnë veten e tyre. Ky ndryshim i madh politik bëri të mundshme që të flitet për një Union Islamik.

Ideologjitë jofetare po humbin ndikimin e tyre

Edhe pse kombet Muslimane u bënë të pavarura nga vitet e 1950-ta e këndeje, kjo nuk nënkupton domosdo se ato kishin arritur të vetëdijesohen. Përkundrazi, në disa prej këtyre vendeve Islamike, mbizotëruan ideologjitë që u kundërvihen parimeve qendrore të Islamit. Një shembull është socializmi Arab, i cili thellësisht preku botën Arabe në vitet e 1950-1960-ta. Papritur, fitoi në rëndësi nacionalizmi militant Arab që ishte i papajtueshëm me parimet morale të Islamit dhe i mbështetur në

Harun Jahja (Adnan Oktar)




THIRRJE PËR UNION ISLAMIK

During the twentieth century, major changes took place in the Islamic world: In 1950s and 1960s, many Muslim countries became independent, and in the 1990s, communism collapsed, which enabled most Muslims living under its system to achieve a better and more comfortable life.



Harun Jahja (Adnan Oktar)



metodat dhe retorikën Marksiste. Edhe pse ra gati po aq shpejt sa edhe ishte shfaqur, shpenzoi kohë dhe shkaktoi tension.

Përveç kësaj, kombet Muslimane ishin shpërndarë midis skajshmërive dhe ishin ndarë në dy kampe kryesore të dominuara nga Amerika dhe Bashkimi Sovjetik. Pavarësisht se lëviznin bashkë, ato ishin gati të ndara në mënyrë të barabartë midis këtyre dy poleve. Pjesa më e madhe e vendeve Arabe ishin të afërta më Bashkimin Sovjetik. Egjipti "Musliman" nuk shihte ndonjë problem në mbajtjen e anës Indisë gjatë luftës së saj me Pakistanin Musliman. Definimi i botës Islamike si i tillë u bë i mundshëm vetëm për nga aspekti politik, strategjik dhe kulturor pas përfundimit të luftës së ftohtë, kur "bota Islamike" filloi të luante një rol të rëndësishëm.

Procesi i spastrimit të botës Islamike nga mbeturinat e epokës së luftës së ftohtë ende vazhdon. Zhvillimet që ndodhin përkrah tij sugjerojnë se një klimë më demokratike dhe më tolerante po merr formë, një klimë që do të krijoj një atmosferë më të favorshme për një kuptim, shpjegim

dhe praktikim më të mirë të vlerave të Kur'anit. Dallimet tradicionale ndërmuslimane po zbuten me zhvillimet e fundit në Lindjen e Mesme, siç është rasti me Sunnit dhe Shi'at Irakian që falen së bashku në të njëjtën xhami për të parën herë në histori.

Qytetërimi fiton në rëndësi në marrëdhëniet ndërkombëtare

Fundi i luftës së ftohtë i dha fund ndarjes “së dhunshme” të Muslimanëve në dy kampe kundërshtarë politike. Qytetërimet, në vend të ideologjive politike, kanë filluar të fitojnë në peshë. Siç ka thënë Samuel Hantington, njerëzit më nuk përcaktohen me pyetjen “cilës anë i takon?” por “kush je?”⁵³ Për shumë njerëz, të shpërndarë nga Ballkani në Azinë Qendrore dhe nga Lindja e Largët në Afrikë, të cilët më parë identifikoheshin si “socialist”, “jugosllav”, “sovjetik”, “antikomunist” ose “nacionalist”, u bë më e rëndësishme që të përcaktohet se cilin qytetërim e përfaqësonin.

Teoria e “përplasjes së qytetërimeve” e Hantingtonit, e cila e shpreh këtë fakt, është e rëndësishme në këtë aspekt. Hantingtoni parashikoi se shekulli njëzet e një do të karakterizohej për nga qytetërimet më shumë se për nga shtetet kombëtare apo grupimet politike dhe se identiteti mbizotërues do të jetë identiteti i “qytetërimit”. Dhe, ai kishte të drejtë. Ai gjithashtu me saktësi parashikoi se këto qytetërime do të mbështeteshin në fe. Mirëpo, ai e kishte gabim që sugjeroi se konflikti do ta përcaktonte marrëdhënien midis qytetërimeve, sepse ka më shumë mundësi që kjo marrëdhënie do të mbështetet mbi miqësi dhe bashkëpunim. Që të arrihet kjo, gjithçka që duhet bërë Hantingtoni dhe të tjerët, të cilët mendojnë sikurse ai, është ta braktisin botëkuptimin e njëanshëm Social Darwinist që i çorienton ata.

Fundi i luftës së ftohtë nuk është e vetmja arsye që bota të karakterizohet për nga civilizimet. Një tjetër arsye e rëndësishme është rënia e ateizmit dhe ngritja e fesë. Këto zhvillime janë ngushtë të lidhura me fillimin e rënies së filozofive materialiste, për arsye të zbulimeve të reja shoqërore dhe shkencore që po i përgënjeshtrojnë ato, që kanë pasur monopol kulturor mbi botën për dy shekujt e kaluar. Në veçanti, zhvillimet shkencore po i gërryejnë rrënjët e materializmit dhe kjo u mundëson njerëzve që t’i shohin më qartë dëshmitë e ekzistencës së Zotit. Në një kohë kur besimi në Zotin po merr vrull dhe njerëzit përsëri po u kthehen parimeve morale fetare, besimi në Islam po ashtu po rritet me shpejtësi.

Gjithkush po flet për Islamin

Një tjetër zhvillim që bie në sy është njohja universale e faktit se Islami është feja që ka rritjen më të shpejtë në botë. Veç

kësaj, Islami është tema më me rëndësi e çështjeve aktuale. Situata rreth 30 apo 40 vite më parë ishte tërësisht e ndryshme. Bota mendonte brenda kornizave të kufizuara ideologjike të luftës së ftohtë dhe shumë njerëz besonin, për shkak të ndikimit të botëkuptimit materialist, se morali fetar nuk mund të ishte faktor përcaktues në jetët e njerëzve dhe bashkësive. Por në fillim të viteve të 1980-ta, Islami papritur u bë tema më e përfolur në planet dhe Perëndimi kuptoi se morali i Islamit ishte një fuqi madhështore që mund t'i vinte në lëvizje si njerëzit ashtu edhe kombet.

Në vitet e 1990-ta, interesi i Perëndimit për Islamin u rrit edhe më shumë, siç dëshmohet, pjesërisht, me rritjen e numrit të artikujve mbi Islamin që paraqiten në mjetet e komunikimit. Interesimi më i madh për Islamin lindi pas 9/11, një tragjedi që ishte në kundërshtim të plotë me parimet morale të Islamit. Perëndimorët, në veçanti Amerikanët, filluan të bëjnë përpjekje të mëdha për ta kuptuar dhe njohur Islamin për së afërmi. Aktualisht, studiuesit dhe anëtarët e mjeteve të komunikimit janë shumë të interesuar për Islamin. Edhe pse një pjesë e këtij studimi është e njëanshme, ai po tërheq vëmendjen e botës ndaj Islamit dhe po ndikon që një numër shumë më i madh i njerëzve të njihen me parimet e tij morale (Për më shumë informacion, ju lutemi të shihni *Ngritjen e Islamit* të Harun Jahjasë [Kuala Lumpur: A. S. Noordeen, 2003]).

Shtimi i dialogut global dhe i solidaritetit midis Muslimanëve

Një tjetër zhvillim i rëndësishëm që i hapi rrugën Unionit Islamik është globalizimi, një proces që filloi në vitet e 1980-ta dhe mori vrull në vitet e 1990-ta me përparimet në teknologjinë e

Yeni Şafak Gazetesi, 2.10.2002

ABD'den İslâm atağı!

11 Eylül, Amerikalıları İslam'a yöneltti

MOSES VETTER / ISTANBUL
A
11 Eylül saldırıları ABD'nin İslam dünyasına karşı duyulan korkularını ortadan kaldırdı. ABD'de İslam'a ilgi arttı. İslam dinini öğrenmek isteyenlerin sayısı arttı. İslam dinini öğrenmek isteyenlerin sayısı arttı.

ABD'de İslam'a ilgi arttı. İslam dinini öğrenmek isteyenlerin sayısı arttı. İslam dinini öğrenmek isteyenlerin sayısı arttı.

Yeniçağ Gazetesi, 2.2.2002



Charles her gün Kuran okuyor



Evrende her gün Kuran okuyan, Müslümanlarla yakın ilişkide olan Prens Charles, Irak savaşına karşı okuyor. Blair Muhammed, İbrahim İbrahimden rahatsızdır.

İlkokulda yagunlaşması İngiltere'nin karma okulu'nda çekilme konusuna.



Sabah Gazetesi, 10.2.2003

BLAIR: KUR'AN'DAN ÇOK ETKİLENDİM

Milli Gazete, 12.1.2001

Islam is the most rapidly spreading religion in the world. Many people in the West are making an effort to learn about its morality and frankly express the admiration and interest they feel for Islam.

komunikimit, në veçanti Internetit. Ka Muslimanë të cilët e shohin globalizimin si bartës të kulturës Perëndimore dhe kështu e konsiderojnë atë si zhvillim negativ. Mirëpo, në realitet, ky proces i mundëson tërë botës të hyj në një dialog të thellë kulturor me vetveten me një gjuhë të përbashkët. Globalizimi gjithashtu e bën më të lehtë për Muslimanët të kenë qasje ndaj informacionit dhe të rrisin bashkëpunimin e tyre dhe dialogun me njëri tjetrin në nivele të papara më parë. Në fakt, globalizimi ka qenë një katalizator i rëndësishëm për ndriçimin mendor të vazhdueshëm të botës Islamike.

Interneti, një dhuratë e rëndësishme për tërë njerëzimin, vërteton rritjen e gjerë të dialogut midis Muslimanëve. Duke iu

falënderuar atij, përpjekjet e përbashkëta u zgjeruan dhe u rrit dhe u bë e larmishme mundësia e qasjes. Si rezultat i kësaj, gjenerata të tëra të reja që mendojnë, lexojnë, zhvillojnë ide dhe krijojnë zgjidhje lindën në gjithë botën. Dr. Farish A. Nur, një shkencëtar politik nga Malajzia i cili ligjëron në Universitetin Freie të Berlinit si profesor vizitor, thotë si vijon lidhur me efektet e globalizimit në botën Islamike:

Si rezultat i përmirësimit të teknologjisë komunikuese dhe lehtësimit të rrjedhës së lirë të informacionit dhe dijes, Muslimanët tani janë të lirë (ose më të lirë) të hyjnë drejtpërdrejt në thelb të vet mësimin Islam: Tekstet kryesore, tregimet dhe idetë e mendimit Islamik nuk janë më të kufizuara në libra të rrallë të vendosur në librari të largëta...

Njëra prej pasojave të këtij shkatërrimi të hierarkive tradicionale dhe strukturave të ngurta edukative është krijimi i përbërësve të rinj të ndërgjeshëm dhe të shkolluar për Islamin. Qasja ndaj teksteve dhe diturisë Islamike ka nënkuptuar se femrave Muslimane dhe Muslimanëve laik u është lejuar po ashtu të mësojnë, të diskutojnë dhe të komentojnë më shumë për Islamin. Kjo po ndodhë në mbarë botën Muslimane duke iu falënderuar krijimit të rrjeteve globale Islamike...⁵⁴

Për të përdorur terminologjisë e Nurit: “këto janë shkëndija të një bote Muslimane ku koha dhe hapësira më nuk shërbejnë si barriera.”⁵⁵

Të dyja, si interneti ashtu edhe mjetet e komunikimit global bashkojnë Muslimanët e botës. Një ngjarje në një vend Islamik mund të shikohet në të gjitha vendet tjera menjëherë dhe kështu kjo bëhet një çështje Muslimane gjithandej. Të gjitha këto mjete dëshmojnë se bota Islamike mund t’i gëzohet një të ardhmeje shumë më të ndritshme.

Hulumtimi i Otomanëve nga perëndimorët

Siç e kemi theksuar që nga fillimi, nga krijimi i Unionit Islamik do të kenë dobi Muslimanët dhe jomuslimanët njëlloj dhe ai do të ketë natyrë të drejtë, demokratike dhe përparimtare. Pas formimit të tij, qytetërimet tjera, në veçanti Perëndimi, do të kenë të bëjnë me një autoritet stabil dhe të besueshëm me të cilin do të jenë në gjendje të kenë marrëdhënie miqësore dhe paqësore. Pasi që Unioni Islamik do të jetë përgjegjës për ndalimin dhe kurimin e elementëve radikal që paraqiten në emër të Muslimanëve, Perëndimi nuk do të ketë shkak për brenga të tilla.

Një shenjë që profetizon ardhjen e këtij unioni është domosdoshmëria e tij, të cilën e pranon Perëndimi. Është diagnostifikuar një boshllëk autoriteti në dheun e vjetër Otoman dhe ideja që ndërtimi i një sistemi të ngjashëm do të mund ta shëronte këtë problem po gjen shumë e më shumë mbështetës. Siç e dëshmon historia, Perandoria Otomane solli paqe dhe stabilitet në këtë rajon. Dhe, bazuar në këtë sukses, zbatimi i modelit Otoman në këtë rajon të trazuar do të arrijë shumë sa i përket zgjidhjes së problemeve dhe trazirave të tij të tanishme. Për shembull, në artikullin e tij, të titulluar “Një botë që ende vizitohet nga fantazmat Otomane” The New York Times (9 Mars 2003), David Fromkin fillon duke thënë se “Një fantazmë po i ndjekë SHBA-të. Ajo është fantazma e Perandorisë Otomane” dhe vazhdon:

Sot, personalitetet më ambicioze në administratën e Bushit propozojnë jo vetëm që të pushtohet Iraku, por që atë ta përdorin si bazë për transformimin e Lindjes së Mesme Arabe. Një herë më parë

në historinë moderne, vendet Perëndimore – Anglia dhe Franca – filluan ribërjen e këtyre tokave Otomane. Pas daljes fitimtar nga Lufta e Parë Botërore, ata ri-vizatuan hartën e Lindjes së Mesme. Iraku ishte njëri prej shteteve artificiale që u krijua.

Pas Luftës së Parë Botërore, Britania dhe Franca, morën kontrollin mbi tokat Arabe duke e mposhtur Perandorinë Otomane, dhe me këtë, një stoli joshëse; mundësinë që depozite të pafund naftë mund të gjendeshin atje.

Evropianët dhe partnerët e tyre Amerikan të biznesit shpresuan të krijonin regjime stabile dhe miqësore. Pasi që ri-vizatuan kufijtë në fillim të viteve të 1920-ta, Britania dhe Franca futën në përdorim një sistem shtetëror dhe u përpoqën gjithashtu të ofrojnë udhëzim politik. Por sistemi nuk rezistoi. Në vend të kësaj, rajoni u bë më i trazuar dhe më i paqëndrueshëm.

Nëse kujtojmë të kaluarën, bëhet e qartë se shumë karakteristika të Lindjes së Mesme, disa prej të cilave Presidenti Bush do të dëshironte t'i ndryshonte, u formuan nga sundimi pesë shekullor Otoman.⁵⁶

Gazetari Britanik Timothy Garton Ash shprehu pikëpamje të ngjashme në një artikull të botuar në The Guardian (27 Mars 2003). Ash duke u marr me problemet e Shqiptarëve në Kosovë dhe të Kurdëve në Irakun verior thotë: “në të dyja rastet, ne ende po luftojmë, pothuajse një shekull më vonë, me trashëgiminë e Perandorisë Otomane,” dhe konkludon:

Ta pranojmë: kur kjo luftë e përgjakshme të ketë mbaruar, ne do të kthehemi prapa në vitin 1918, duke u përballur me shumë prej pyetjeve të njëjta me të cilat përballeshin stërgjyshërit tonë, nga Ballkani deri në Lindjen e Mesme. Dhe ne ende nuk i kemi përgjigjet. Nganjëherë mendoj se duhet të ri-sajojmë Perandorinë Otomane.⁵⁷

Është e qartë se në një kohë kur madje Perëndimi është duke diskutuar se si të ri-sajohet Perandoria Otomane, Muslimanët duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë kësaj çështje. Zhvillimet që ndodhën që nga fillimi i shekullit pesëmbëdhjetë Hixhri dëshmojnë se Muslimanët ndodhen në një udhëkryq historik. Ne të gjithë duhet të jemi të denjë për këtë përgjegjësi.

THE OTTOMANS LEFT AND PEACE CAME TO AN END
The New York Times wrote that the fragmentation of the Ottoman Empire lay at the root of most of the international problems and conflicts.

The truth on which the world is agreed...



The Guardian Osmanlı gitti, sorun başladı

İHSAN DÖRTKARDEŞ DHA

İngiliz The Guardian gazetesi yazarlarından Timothy Ash, Osmanlıları çok inşinden bu yana Ortadoğu ve Balkanlar'da bölünce kadar büyük sorunlar henüz yaşanmadığını belirttik. "Bunun, Osmanlı İmparatorluğu'na yeniden canlandırılmak gerek diye düşünüyorum" dedi. Ash, Kasım Irak'taki Kürt sorununu ise "Patlamaya en büyük bomba" diye nitelendirdi.

"Kürt denklemleri" olarak tanımladığı sorunun Irak'taki diğer etnik gruplar ve Türkiye başta olmak üzere bölge ülkeleri hesabına katıldığından şüphe çekilmesinin bir tabloya ortaya çıktığına vurgulayan Ash, şöyle devam etti:

Sınırları kim çizecek?

"Bu sorunun çözümü için...

sumanlar şimdiden Irak çapında bütün Kürtlere bireysel haklar ve 'Irak Kürdistanı'na özerklik tanıyan federal sistemden söz ediyor. Peki 'Irak Kürdistanı'nın sınırları kim çizecek? Ya Irak'taki seçmenlerin büyük çoğunluğunun istekleri ile Iraklı Kürtlerin hakları beherle örtülmesin? Osmanlıların çöküşünden bu yana Ortadoğu ve Balkanlar'da pek çok sorun...

THE GUARDIAN: AS THE OTTOMANS LEFT,
THE PROBLEMS BEGAN

Milliyet Gazetesi, 28.4.2003

Ortadoğu Gazetesi, 4.12.2002

OSMANLIYI ARIYORLAR

Kafkaslar'dan Balkanlar'a ve Ortadoğu'ya kadar birçok ülkede bugün var olan savaşların Osmanlı hâkimiyetinin bitiminden sonra ortaya çıktığı, yabancıların gündeminde

THEY WISH THE OTTOMANS WERE BACK
The fact that present day wars in many countries, from the Caucasus to the Balkans and the Middle East, began with the end of Ottoman rule is on foreigners' agendas.

Yeni 700 yıl boyunca Arabistan'da her bölgeye barış ve adalet getiren Osmanlılar'ın Cihan İmparatorluğu çabuk düşer kurulsun. Bugün barış yitmiş dünyaya Osmanlılar zamanında yüzyüzlük karışık kâhde yapamalıydık...

Yeni akli Hıristiyanlar katliamlarından dolayı...
Churchill hakkı çıktı

Osmanlı gitti, barış bitti

Bir zamanlar Sultan II. Abdülhamit'in şahsi mülkü olan Gazze'de İsrail işgalcileri ölüm sağıyor. Yine Abdülhamit'e ait Musul toprakları da yeni bir savaşa hazırlanıyor.

II. ABDULLAH MURADDEĞULİ İSTANBUL

Bir zamanlar Sultan II. Abdülhamit'in şahsi mülkü olan Gazze'de İsrail işgalcileri ölüm sağıyor. Aynı şekilde Abdülhamit'e ait Musul toprakları da yeni bir savaşa hazırlanıyor. İsrail işgalcileri Gazze'yi vuruyor, vuruşları artıyor. İsrail işgalcileri Gazze'yi vuruyor, vuruşları artıyor. İsrail işgalcileri Gazze'yi vuruyor, vuruşları artıyor.



THE OTTOMANS LEFT AND PEACE
CAME TO AN END

II. ABDÜLHAMİT FİLİSTİN'İ SATMADI

II. Abdülhamit, Kravun'un oğlu...
Fırat'ın, Osmanlı toprakları...
Fırat'ın, Osmanlı toprakları...
Fırat'ın, Osmanlı toprakları...



Yeni Şafak Gazetesi, 18.12.2001

Türkiye ve Suriye karşılıklı vize kaldırdı

TURKEY AND SYRIA HAVE LIFTED THE VISA REQUIREMENTS BETWEEN THEM

...i vizelerin kaldırılmasına ...ulması da imza altına alındı

Mesut ER | SABAY

Suriye Cumhurbaşkanı Şam'da Türkiye Cumhurbaşkanı Erdoğan ile görüşme yaptı. İki lider, karşılıklı vize kaldırma kararını imzaladılar. Erdoğan, Suriye'deki gelişmeler hakkında bilgi verdi. Erdoğan, Suriye'deki gelişmeler hakkında bilgi verdi. Erdoğan, Suriye'deki gelişmeler hakkında bilgi verdi.

DOLMABAĞÇE'DEKİ ÇALIŞMA OFISİNDE BAŞ BAŞA GÖRÜŞME



...i vizelerin kaldırılmasına ...ulması da imza altına alındı

Suriye sınırında artık her gün bayram!

Her yılın Eylül ayının ikinci yarısında, her 4-5 günde bir kez bayram olur. Suriye sınırında artık her gün bayram! Suriye sınırında artık her gün bayram!



Star Gazetesi, 24.07.2009

Ortadoğu'da dev birlik

Çok milletli Ortadoğu'da dev birlik. Ortadoğu'da dev birlik. Ortadoğu'da dev birlik.



EVERYDAY IS NOW A FEAST ON THE SYRIAN BORDER

Zaman Gazetesi, 20.09.2009

A GIANT UNION IN THE MIDDLE EAST

Basra ve Edirne birbirine bağlanacak

Basra ve Edirne birbirine bağlanacak. Basra ve Edirne birbirine bağlanacak. Basra ve Edirne birbirine bağlanacak.

BASRA AND EDİRNE WILL BE LINKED TOGETHER



“Önce İslâm Birliği”



Arabî Kur'anını ve İslâmî Ahlakını İnan Abdullâh bin Abdülâzîz

Gücümüzü aramızdaki çekişmelerle tüketiyoruz

Suudi Arabistan Kralı Abdullâh bin Abdülâzîz'in himayesinde yapılan Uluslararası İslâmî Diyalog Toplantısı, Mekke'de başladı. Krallık Sarayı'nda açılış dönü gerçekleştirilen toplantıya İslâm dünyasından yaklaşık 600 davetli katıldı.

Suudi Arabistan Kralı Abdullâh bin Abdülâzîz'in himayesinde yapılan Uluslararası İslâmî Diyalog Toplantısı, Mekke'de başladı. Krallık Sarayı'nda açılış dönü gerçekleştirilen toplantıya İslâm dünyasından yaklaşık 600 davetli katıldı.



Kur'an'ın üçte biri diyalogdan bahsediyor

KUR'ANIN üçte biri diyalogdan bahsediyor. Kur'an-ı Kerim'in üçte bir kısmı diyalogun önemini vurguluyor. Bu diyalogun amacı, İslâmî değerleri korumak ve dünyaya yaymaktır.

"BEFORE ALL ELSE, TURKISH-ISLAMIC UNION"

Sabah Gazetesi, 10.02.2009

Hürriyet Gazete'sinde BU SORUNU YENİ OSMANLILAR ÇÖZER



Hürriyet, Gazete'ye girerek 410'u çocuk 1300 kişinin olduğu İsrail saldırısında ağır mağdurların acılarını dinledi. Gazete'de Hamas'a destek azaldı

THE NEW OTTOMANS WILL RESOLVE THIS PROBLEM

Vakit Gazetesi, 17.07.2009

Müslümanlar İslâm Birliği ile AYAAĞA KALKABİLİR

MUSLIMS CAN GET BACK ON THEIR FEET WITH ISLAMIC UNION



bu şekilde oluyor. Bu Gazete'deki İslâmî hareketin temel amacı, Türkiye'de İslâmî değerlerin korunması ve yayılmasıdır. Bu hareketin amacı, İslâmî değerleri korumak ve dünyaya yaymaktır.




PËRFUNDIM

E ARDHMJA E NDRITSHME QË E PRET BOTËN

Gjatë këtij libri, ne kemi ekzaminuar gjendjen e botës Islamike, nevojën urgjente për krijimin e Unionit Islamik dhe përfitimet që do të rezultojnë nga kjo për Muslimanët dhe kombet tjera njëlloj. Siç patëm mundësi të shohim në kapitullin e mëparshëm, zhvillimet e kohës së fundit qartë dëshmojnë se bota Islamike ka arritur pjekurinë për një ndryshim të madh dhe rrënjësor. Kur'ani dhe literatura e haditheve sugjeron se periudha që po afron do të jetë e ndritshme për Muslimanët e mbarë botës, me vullnetin e Zotit. Themelimi i Unionit Islamik do ta shpejtojë procesin dhe do të fillojë një epokë të re të begatisë dhe përparimit për njerëzimin në përgjithësi.

Situata e tanishme mund të duket se është shumë negative në shikim të parë, ndërsa në realitet çdo zhvillim negativ sinjalizon afrimin e një periudhe të bekuar. Lufta, skamja, uria, shtypja dhe tirania kundër Muslimanëve në mbarë botën janë shenja të Fundit të Kohës të profetizuara nga ana e Profetit tonë (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të). Se gjithë këto zhvillime po ndodhin është një shenjë e qartë se sundimi global i moralit Islamik po afron, siç është profetizuar nga ana e Profetit tonë (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) (Allahu e di më së miri). Prandaj, situata e tanishme nuk duhet t'i bëjë Muslimanët të ndjehen të dëshpëruar dhe të pashpresë;



përkundrazi, ajo duhet t'i motivojë
ata dhe ta shtojë përkushtimin dhe
ngazëllimin e tyre. Veç kësaj, ata duhet të
veprojnë me ndërgjegjen se humbja e shpresës
për lehtësim nga Zoti nuk është një opsion, sepse

**“Mos e humbni shpresën në mëshirën e
Allahut. Shpresën në mëshirën e Allahut
nuk e humb askush, përveç jobesimtarëve”.**

(Kur'an, 12:87)

Dijetari i madh Bediuzaman Said Nursi
sqaroi, në Hutben e famshme të Damaskut
(Hutbe Samije), kushtet në të cilat jetojnë
Muslimanët, tërhoqi vërejtjen për rreziqet e

THIRRJE PËR UNION ISLAMIK

rënies në dëshpërim dhe foli për të ardhmen e ndritshme që i pret ata, si vijon:

Dëshpërimi është sëmundja më e dëmshme. Ajo ka përshkuar zemrën e botës Islamike... Një dëshpërim i tillë që i ka zënë frymën moralit tonë sublim, duke e shmangur vëmendjen tonë nga interesat e përgjithshme kah interesat tona personale. Është pikërisht ky dëshpërim i njëjtë që ka thyer fuqinë tonë shpirtërore... Dëshpërimi është sëmundja më e llahtarshme e popullit tonë... Ajo është preteksti i frikacakut, i të dobëtisë dhe të paaftit... Vetëm Islami është ai i cili vërtetë edhe shpirtërisht do t'i përshkojë kontinentet e së ardhmes dhe do ta udhëzojë njerëzimin drejt lumturisë si në këtë botë ashtu edhe në botën tjetër.⁵⁸


Harun Jahja (Adnan Oktar)

Fundi i kohës

Literatura e haditheve është burimi më i spikatur që zbulon ardhmërinë e ndritshme të botës Islamike. Kjo literaturë, e cila përshkruan në hollësi natyrën e Fundit të Kohës (periudhës para Ditës së Fundit), zbulon se këto shenja bartin ngjashmëri të madhe me ngjarjet që po ndodhin tani. Shenjat më të dukshme janë se njerëzit përpiqen të distancohen nga qëllimi i krijimit të tyre dhe, rrjedhimisht, marrin pjesë në shkatërrimin shpirtëror të shoqërisë duke ndryshuar ligjin e Zotit, duke mohuar haptas ekzistencën e Zotit, duke përhapur kaos dhe rrëmujë rreth e rrotull botës dhe duke shtuar dekadencën. Shenjat tjera përfshijnë fatkeqësitë e shpeshta natyrore (si tërmetet dhe vërshimet, thatësirat dhe uria); rritja e numrit të luftërave, konflikteve dhe gjakderdhjes; shfaqja e bidateve (risive, që ndryshojnë mësimin burimor të Profetit); varfëria e përhapur gjithandej; ngjarjet e habitshme dhe tronditëse; dhe humbja gati e plotë e kënaqësisë dhe qëndrueshmërisë. Në

Fundin e Kohës, mbytja, vrasja dhe luftimet do të shpeshohen dhe shtypja e Muslimanëve do të përkeqësohet edhe më shumë. Veç kësaj, Muslimanët që jetojnë gjatë kësaj periudhe do t'i nënshtrohen një dhune dhe tiranie të tillë dhe shumica prej tyre nuk do të mund të gjejnë rrugëdalje nga mjedisi mizor në të cilin jetojnë.

Pas kësaj periudhe të vështirë dhe kaotike, Zoti do ta dërgojë shpëtimtarin e shenjtë, Mehdiun (ai që udhëzon në rrugën e drejtë), i cili do t'i nxjerr njerëzit nga errësira e mosdijes në dritën e diturisë së vërtetë. Ky person i shenjtë do të ndriçojë mendjen e botës Islamike së pari dhe pastaj do t'i sjellë paqe, dashuri dhe parime morale tërë botës. Me ardhjen e tij, të gjitha ideologjitë antifetare që mohojnë ekzistencën e Zotit do të përgënjeshtrohen krejtësisht, morali fetar do të kthehet në gjendjen e tij të pastër dhe burimore, siç shpallet në Kur'an dhe në hadithe dhe bota Islamike do të arrijë fuqi ekonomike, politike dhe shoqërore.



Siç theksojnë
disa dijetarë Islamik, Mehdiu do
të jetë me siguri një entitet shpirtëror
(Allahu e di më së miri). Ne besojmë se
Mehdiu do të jetë një qenie shpirtërore me
karakter superior, që do të mishërojë në
vetvete besimin dhe shpirtin e njerëzve të
devotshëm dhe heroik.

Këto hadithe po ashtu zbulojnë se Isai
(paqja qoftë mbi të) do të kthehet në Tokë
gjatë Fundit të Kohës. Ardhja e tij e dytë
është njëra prej ngjarjeve më madhështore të
Fundit të Kohës dhe është shpallur në një
numër hadithesh dhe në shumë ajete
Kur'anore. Zoti shpall në Kur'an se Isai nuk
është mbytur e as kryqëzuar, por se Ai bëri
që njerëzve t'iu duket kështu dhe pastaj e
ngriti atë në praninë e Tij (Për më shumë
informacion, ju lutemi shihni Isai do të
kthehet të Harun Jahjasë [London: Ta-

Ha Publishers Ltd., 2001)).

Kjo e vërtetë është shpallur në Suren Nisa':

Dhe për fjalët e tyre: "Ne e vramë Mesihun – Isain, të birin e Merjemes, të dërguarin e Allahut". Por, ata as e vranë, as e kryqëzuan, por ashtu u është dukur. Ata që nuk u pajtuan për çështjen e tij, me siguri që gjenden në dyshim për të. Ata nuk kanë ditur kurrjë për të, por vetëm kanë hamendësuar. Ata, në të vërtetë, nuk e kanë vrarë, por, Allahu e ka ngritur pranë Vetes. Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Gjithëdijsëm. (Kur'an, 4:157-158)

Kur të kthehet Isai (paqja qoftë mbi të), ai do të njihet për nga respekti i tij, ndershmëria dhe superioriteti i tij, pikërisht ashtu siç ishin të gjithë profetët tjerë. Ata të cilët do ta shohin atë do ta njohin atë në çast dhe nuk do të kenë

kurrfarë dyshimi në zemrat e tyre. Një faktor që do ta bëj të njohur atë është se ai nuk do të ketë të afërm, familje dhe asnjë njeri i cili do ta njoh atë përpara kësaj. Askush nuk do ta njoh atë për nga zëri i tij, pamja fizike apo fytyra e tij kur ai të kthehet. Askush nuk do të jetë në gjendje të thotë: “Unë e njoh atë prej më herët,” sepse çdokush i cili e kishte njohur atë do të ketë jetuar dhe vdekur 2,000 vite më parë.

Kur të kthehet Isai, ai do të sundojë me anë të Kur’anit. Ai do t’i lirojë të Krishterët nga mitet e tyre dhe do t’i thërras ata të jetojnë sipas vlerave të Kur’anit. Në këtë mënyrë, Islami dhe Krishterimi do të bashkohen në një besim dhe bota do të hyjë në një epokë të re të artë në të cilën do të mbizotërojnë paqja, lumturia, siguria,

kënaqësia dhe prosperiteti. Epoka e Artë, sikurse koha e Profetit tonë (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të), do të jetë një kohë e bekuar e karakterizuar me drejtësi në vend të mizorisë. Do të ketë përparim aq të madh sa që ata të cilët dëshirojnë t'u japin lëmoshë të varfërve nuk do të mund ta gjejnë askënd për ta pranuar atë. Zhvillimet në shkencë dhe teknologji do të rritin kualitetin e jetës dhe mirësia dhe rehatia do të shtohen. Ngado që të kthehen, njerëzit do të shohin përparim dhe bukuri.

Disa prej haditheve të Profetit (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) për Fundin e Kohës janë të paraqitura më poshtë.

Karakteristikat e Epokës në të cilën do të paraqitet Mehdi

Mehdiu, njëri prej fëmijëve të mi, do të vjen në jetë, me mirësinë e Allahut, me afrimin e Ditës së Gjykimit dhe dobësimin e zemrave të besimtarëve për shkak të vdekjes, urisë dhe zhdukjes së sunetit dhe shfaqjes së risive dhe humbjes së mjeteve me të cilat të urdhërohet e drejta dhe të ndalohet e gabuara. Drejtësia dhe mbarësia e tij do t'i qetësojnë zemrat e besimtarëve dhe miqësia dhe dashuria do të vendosen midis kombeve jo-arabe dhe arabe.⁵⁹

Një kohë kur bota do të jetë në harxh (çrregullim dhe rrëmuje të plotë), do të shfaqet fitneja (turbullira), rrugët do të ndërpriten, disa njerëz do t'i atakojnë të tjerët, të moshuarit s' do të kenë mëshirë për të rinjtë dhe të rinjtë s' do t'i respektojnë të moshuarit, Zoti do ta dërgojë një njeri (Mehdiun). Ky njeri do t'i çrrënjosë armiqtë dhe do t'i pushtojë kështjellat e prapësisë, do ta mbështes besimin në Fundin e Kohës mu ashtu siç e mbështeta unë më parë dhe do ta mbush me drejtësi këtë Tokë ku dhuna mbizotëroi më parë.⁶⁰

Trazirat, korrupsioni dhe frika do të shfaqen në Perëndim... Korrupsioni do të përhapet me shpejtësi.⁶¹

Korrupsioni, të cilit s'mund t'i shmanget askush, do të shfaqet dhe përhapet menjëherë prej aty ku shfaqet në një vend tjetër.⁶²

Para se të shfaqet Mehdiu, tregtia dhe rrugët midis kombeve do të ndërpriten dhe mosmarrëveshjet mes njerëzve do të shtohen.⁶³

Mehdiu nuk do të shfaqet përveç nëse masakrohen njerëzit e pafajshëm dhe ai do të shfaqet kur ata në Tokë dhe ata lartë në qiej nuk do të mund të durojnë më masakra të tilla.⁶⁴

Mënyra e jetës gjatë kohës së Mehdiut

Mu ashtu sikurse Profeti ynë mbështeti Islammin në fillim, Mehdiu do ta mbështes Islammin në fund.⁶⁵

Mëria dhe urrejtja e ndërsjellë do të ngritet (hiqet)... Toka do të mbushet me paqe, siç mbushet një enë me ujë; fjala (kalima) do të bëhet një (dmth, vetëm Islami do të mbizotërojë) dhe vetëm Allahu do të adhurohet; lufta do të ndalojë (domethënë luftës do t'i vjen fundi).⁶⁶

Gjatë kësaj kohe, ujqërit dhe delet do të luajnë bashkë dhe gjarpërinjtë nuk do t'u bëjnë dëm fëmijëve. Njerëzit do të mbjellin vetëm një grusht farë, mirëpo do të korrin 700 grushte sosh. Hipokrizia, interesi, tradhtia bashkëshortore dhe shprehia e pirjes do të marrin fund dhe nuk do të ketë shkelje të besimit. E liga do të shkatërrohet, dhe më nuk do të ketë asnjë njeri i cili nuk do ta dojë Profetin tonë (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të).⁶⁷

Në fundin e kohës do të ketë një kalif (pasardhës) i cili do të jep pasuri madje pa e llogaritur atë.⁶⁸

Nuk do të mbetet më armiqësi mes njerëzve dhe armiqësia, lufta dhe zilia do të zhduken përfundimisht.⁶⁹

Në atë kohë, banorët e qiejve dhe të Tokës dhe të gjitha kafshët e egra, shpezët dhe madje edhe peshqit në oqeanë do të jenë të kënaqur me kalifatin (sundimin) e tij. Në kohën e tij, madje edhe lumenjtë do të kenë ujë të bollshëm. Mehdiu do t'i zbulojë thesaret.⁷⁰

Gjatë kësaj (periudhe), umeti (populli) im do të çoj një jetë të tillë të rehatshme dhe të pabrenga që ata kurrë më parë nuk e kanë njohur.⁷¹

Gjatë kohës së Mehdiut, do të mbizotërojë drejtësia deri në atë masë sa që çdo pronë e marr me dhunë do t'i kthehet pronarit të saj, veç kësaj, prona e një personi tjetër, madje edhe nëse dikush e mban me dhëmbë atë, do t'i kthehet pronarit të saj. ... Siguria do të mbizotërojë në Tokë dhe disa femra të vetme do të kenë mundësi ta kryejnë haxhin pa qenë të shoqëruara nga një grup meshkujsh.⁷²

Siç zbulojnë hadithet e përmendura, bota Islamike është në rrugë për një ndryshim të madh dhe të rëndësishëm. Si për gjithçka tjetër, Zoti ka përcaktuar një fat për botën Islamike, sepse: "Allahu ka vendosur vetëm që ta përsosë dritën e Vet" (Kur'an, 9:32). Ky ajet shpall se Zoti do të bëjë që vlerat Kur'anore të përhapen në mbarë botën, se filozofitë jofetare do të rrënohen dhe se e keqja do të shkatërrohet në mënyrë që paqja dhe siguria të mund t'iu sillen gjithë njerëzve. Me emrin e Zotit, këto ditë të numëruara do të pasohen me

zotërimin global të parimeve morale Islamike, gjë që do të mundësojë që paqja dhe siguria të zbresin mbi njerëzimin. Nuk duhet harruar se Zoti ka shpallur:

Allahu u ka premtuar atyre prej jush, që besojnë dhe që bëjnë vepra të mira, se do t'i bëjë mëkëmbës në Tokë, ashtu si i ka bërë ata para tyre dhe që do t'ua forcojë fenë e tyre, me të cilën Ai është i kënaqur dhe që frikën do t'ua shndërrojë në siguri. Le të më adhurojnë Mua e të mos Më shoqërojnë asgjë (në adhurim). Sa për ata që, pas kësaj, mohojnë (besimin), pikërisht ata janë të mbrapshtët. (Kur'an, 24:55)

Secili Musliman duhet ta përmirësoj karakterin e tij apo të saj dhe të shtoj numrin e veprave të mira të bëra në dobi të Islamit dhe të Muslimanëve për t'u përgatitur për këtë epokë të lavdëruar. Që kjo kohë në të cilën njerëzit do të hyjnë në fenë e Zotit në turma të vjen me shpejtësi, njëra prej përgatitjeve më të rëndësishme është të krijohet Unioni Islamik.

Thirrje drejtuar Botës së Islamit


Aktualisht, sistemet jofetare të mendimit po rrënohen në mbarë botën dhe njerëzit po i kthehen besimit dhe moralit fetar. Për më tepër, Islami është bërë tema më e rëndësishme në agjendën botërore dhe vëmendja e njerëzve është drejtuar nga feja e vërtetë. Zhvillimi teknologjik i kohës sonë ka bërë më të lehtë bashkëpunimin ndër-musliman dhe ka krijuar mundësinë që masave t'iu komunikohet bukuria e moralit Islamik.

Mirëpo, disa pjesë të botës Islamike ende vuajnë nga varfëria dhe mosdija. Ata të cilët përfitojnë nga kjo situatë veprojnë në emër të Islamit, por në kundërshtim me Islamin dhe në këtë mënyrë ndikojnë që Muslimanët të akuzohen në sytë e botës. Qarqet të cilat kundërshtojnë moralin Islamik përdorin dobësinë dhe rrëmujën e tanishme të Muslimanëve për t'i mbajtur ata nën zgjedhë

dhe planifikojnë tirani edhe më të keqe. Zgjidhja për tensionin dhe konfliktin e vazhdueshëm të botës Islamike, si të brendshëm ashtu edhe të jashtëm, qëndron në formimin e Unionit Islamik që do t'i bashkojë të gjithë Muslimanët dhe që do t'i udhëzojë ata në rrugën e drejtë. Prandaj, secili Musliman duhet të punojë për krijimin e tij.

Të gjitha qeveritë Muslimane duhet të përgatiten për Unionin Islamik duke përmirësuar marrëdhëniet e tyre me vendet tjera Muslimane dhe duke organizuar aktivitete kulturore që do ta ndihmojnë ngritjen e moralit Islamik në vendet e tyre. Të gjitha OJQ-të, shoqatat, shoqatat bamirëse, pjesëtarët e mjeteve të komunikimit dhe udhëheqësit intelektual Musliman duhet të bëjnë përpjekje të vërteta për të zgjidhur dallimet midis Muslimanëve dhe për të arritur unitet dhe solidaritet. Të gjithë Muslimanët duhet të punojnë për të krijuar këtë unitet

THIRRJE PËR UNION ISLAMIK



Islamik, pavarësisht nga xhamia apo shkolla që e ndjekin, faqet e Internetit që vizitojnë dhe shoqatat bamirëse apo shoqatat që u takojnë. Për më tepër, ata duhet t'i inkurajojnë Muslimanët tjerë ta ndjekin shembullin e tyre.

Është lutje e të gjithë Muslimanëve që qytetërimi madhështor Islamik, i cili do të sjell mirësi, drejtësi dhe paqe për Muslimanët dhe jomuslimanët njëlloj, të lulëzoj përsëri. Me vullnetin e Zotit, formimi i Unionit Islamik do të bëjë që të gjitha këto të bëhen realitet. Të gjithë Muslimanët të cilët dëshirojnë të luajnë një rol në këtë detyrë të shenjtë duhet ta bëjnë lutjen në vazhdim dhe pastaj të veprojnë në pajtim me të:

Ejani, t'i shërojmë përçarjet midis Muslimanëve. Le të mbyllim hendeqet midis Muslimanëve të cilët nuk falen në xhamitë e njëri tjetrit, të cilët nuk lexojnë librat e njëri tjetrit dhe të cilët janë armiqësor ndaj njëri tjetrit për shkak të dallimeve të vogla ideologjike. Le t'i



heqim këto ndasi artificiale. Le të jetë shtëpia e Zotit, xhamia, vendi i adhurimit jo i këtij apo atij grupi apo sekti por i tërë Muslimanëve. Le ta përshëndet dhe të bisedoj secili Musliman me secilin Musliman tjetër. Le t'u japim fund grindjeve midis komuniteteve apo individëve dhe të gjithë Muslimanët le të punojnë së bashku me përukje dhe tolerancë për t'i shërbyer fesë së Zotit. Mos ta harrojmë urdhrin e Zotit:

Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (Kur'anin) dhe mos u përçani! Kujtoni dhuntinë e Allahut për ju, sepse, kur ishit në armiqësi, Ai i pajtoi zemrat tuaja e, në saje të dhuntisë së Tij, u bëtë vëllezër. Dhe ju ishit buzë greminës së zjarrit, ndërsa Ai ju shpëtoi prej saj. Kështu, Allahu jua shpjegon shpalljet e Veta, që ju të drejtoheni në udhën e drejtë. (Kur'an, 3:103)



MASHTRIMI I
EVOLUCIONIT

Darvinizmi, me fjalë të tjera teoria e evolucionit, u prezantua me qëllim të mohimit të faktit të krijimit, por që në të vërtetë nuk është asgjë përveç një marrëzi e dështuar joshkencore. Kjo teori, e cila pretendon se jeta lindi rastësisht nga materia e pajetë, u zhvlerësua nga faktet shkencore të “projektimit” të qartë në gjithësi dhe në gjërat e gjalla. Në këtë mënyrë, shkencë vërtetoi se Allahu krijoi gjithësinë dhe gjallesat në të. Propaganda e zhvilluar sot për të mbajtur në jetë teorinë e evolucionit mbështetet kryekëput në shtrembërimin e fakteve shkencore, interpretimin e paragjykuar dhe gënjeshttrat dhe pavërtetësitë e maskuara si shkencë.

Mirëpo kjo propagandë nuk mund ta fsheh të vërtetën. Fakti se teoria e evolucionit është mashtrimi më i madh në historinë e shkencës ka ardhur në shprehje shumë e më shumë në botën shkencore gjatë 20-30 viteve të fundit. Hulumtimet e bëra pas viteve të 80-ta në veçanti kanë zbuluar se pohimet e Darwinizmit janë krejtësisht të pabaza, gjë që është thënë nga një numër i madh i shkencëtarëve. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në veçanti, shumë shkencëtarë prej fushave të ndryshme biologjia, biokimia dhe paleontologjia pranojnë gjymtinë e Darwinizmit dhe e përdorin konceptin e projektimit inteligjent për të shpjeguar zanafillën e jetës. Ky “projektim inteligjent” është një shprehje shkencore e faktit se Allahu i krijoi të gjitha gjallesat.

Ne kemi ekzaminuar rënien e teorisë së evolucionit dhe provat e krijimit në mënyrë shumë të hollësishme shkencore në shumë prej punimeve tona dhe vazhdojmë ta bëjmë këtë. Duke pasur parasysh rëndësinë e madhe të kësaj çështjeje, do të jetë shumë e dobishme që ta bëjmë një përmbledhje të saj këtu.

Dështimi shkencor i Darwinizmit

Teoria e evolucionit, edhe pse është një doktrinë që i ka fillimet në Greqinë e lashtë, u përqaftua gjerësisht në shekullin e nëntëmbëdhjetë. Zhvillimi më i rëndësishëm që e bëri teorinë temën kryesore të botës së shkencës ishte botimi në vitin 1859 i librit Origjina e Llojeve të Çarlls Darvinit. Në këtë libër, ai doli me pretendimin se llojet e ndryshme në tokë nuk janë krijuar veç e veç, por rrjedhin nga një stërgjysh i përbashkët dhe kanë ndryshuar nga njëra-tjetra nëpërmjet ndryshimeve të vogla me kalimin e kohës. Teoria e Darvinit nuk mbështetet në asnjë zbulim shkencor konkret, siç e pranoi edhe ai vet, ajo ishte vetëm një “supozim”. Veç kësaj, ashtu siç e pranoi Darvini në kapitullin e gjatë të librit të tij të titulluar “Vështirësitë e Teorisë”, teoria dështoi përballë një sërë çështjesh vendimtare.


Darvini mbështeti të gjitha shpresat e tij në zbulimet e reja shkencore, të cilat shpresonte që do të zgjidhnin këto vështirësi. Mirëpo, në kundërshtim me atë që ai shpresonte, zbulimet shkencore zgjeruan përmasat e këtyre vështirësive. Disfata e darvinizmit përballë shkencës mund të përmbledhet në tre tituj kryesorë:

1) Teoria nuk arrin të shpjegoj se si ka zënë fill jeta në tokë.

2) Nuk gjendet asnjë zbulim shkencor që tregon se “mekanizmat e evolucionit” të propozuara nga kjo teori, posedojnë asnjë force evoluese.

3) Të dhënat fosile provojnë pikërisht të kundërtën e ideve të parashtruara nga kjo teori.

Në këtë pjesë, do të shtjellojmë në vija të përgjithshme këto tri çështje themelore:



Çarls Darvini

Pengesa e parë e pakapërcyeshme: Zanafilla e jetës

Teoria e evolucionit pretendon se të gjitha speciet rrjedhin nga një qelizë e vetme e shfaqur në Tokën primitive 3.8 miliardë vjet më parë. Si është e mundur që një qelizë e vetme të ndërtojë miliona specie të gjalla e të komplikuar dhe, nëse me të vërtetë ka ndodhur diçka e tillë, përse nuk gjendet asnjë gjurmë në të dhënat fosile janë disa nga pyetjet në të cilat teoria nuk është në gjendje të jap përgjigje. Por në fillim, duhet të pyetemi: Si u krijua kjo “qelizë e parë”?

Meqë teoria e evolucionit e mohon krijimin dhe çfarëdo ndërhyrje të mbinatyrshme, ajo supozon se “qeliza e parë” është shfaqur rastësisht pa asnjë projektim, planifikim apo rregullim, përbrenda ligjeve të natyrës. Sipas kësaj teorie,

materia e pajetë duhet të ketë krijuar rastësisht qelizën e gjallë. Por kjo hipotezë bie ndesh me ligjet më të pakundërshtueshme të biologjisë.

“Jeta rrjedh nga jeta”

Darvini, në librin e tij, nuk ka folur kurrë mbi zanafillën e jetës. Koncepti primitiv shkencor në periudhën kur jetoi ai supozonte se gjallesat zotërojnë një konstrukt shumë të thjeshtë. Sipas teorisë së krijimit të rastësishme që besohet në mesjetë, lëndët e pajetë/inorganike, duke u bashkuar, mund të formojnë një qenie të gjallë. Në atë periudhë ishte shumë i përhapur mendimi se insektet formoheshin nga tepricat e ushqimeve, ndërsa minjtë nga gruri. Për të provuar diçka të tillë janë bërë eksperimente nga më të çuditshmet: Një leckë e ndotur me pak grurë mbi të, në një anë, ndërsa në anën tjetër një shkencëtar, duke pritur që pas një kohe të formoheshin minj.


Gjithashtu mendohej se shfaqja e krimbave në një copë mishi ishte dëshmi e krijimit të vetvetishëm/spontan. Por më vonë do të kuptohej se ata krimba nuk formoheshin vetvetiu në mish, por nga larvat e padukshme për syrin që silleshin nga mizat.

Madje edhe kur Darvini shkroi librin *Origjina e Llojeve*, besimi se bakteret formoheshin nga materia e pajetë ishte një gjë e pranuar gjerësisht në botën e shkencës.

Por vetëm 5 vite pas botimit të librit të Darvinit, Lui Paster shpalli përfundimet e arritura pas shumë studimeve dhe eksperimenteve të gjata që rrëzuan plotësisht krijimin spontan, i cili përbënte gur-themel in e teorisë së Darvinit. Në ligjëratën e tij

triumfale në Sorbonë në vitin 1864, Pasteri tha: "Kurrë më nuk do të rimarr veten krijimi spontan prej grushtit vdekjeprurës të dhënë nga ky eksperiment i thjeshtë."⁷³

Mbrojtësit e teorisë së evolucionit i kundërshtuan për një kohë të gjatë zbulimet e Pasterit. Mirëpo shkenca, e cila po përparonte duke nxjerrë në dritë ndërtimin kompleks të qelizës së organizmit të gjallë, e përforcoi edhe më tepër pavlefshmërinë e pretendimeve mbi krijimin e rastësishëm të jetës.



**Biologu Frances
Lui Paster**

Përpjekjet e pafrytshme të shekullit njëzet

Evolucionisti i parë, i cili u mor me çështjen e zanafillës së jetës në shekullin e njëzet ishte biologu i njohur rus Aleksandër Oparin, i cili u mundua të provonte, me anë të një sërë tezash të hedhura nga vetë ai në vitet 1930, se qeliza e gjallë mund të krijohej rastësisht. Por këto punime do të dilnin të pasuksesshme dhe Oparin do të detyrohej ta bënte këtë rrëfim:

Mirëpo, fatkeqësisht, çështja e zanafillës së qelizës përbën ndoshta pikën më të errët të gjithë studimit të evolucionit të organizmave.⁷⁴

Pasuesit evolucionist të Oparinit u munduan të bënin eksperimente për të gjetur një zgjidhje për këtë çështje. Më i njohuri nga këto eksperimente ishte ai që u ndërmor në vitin 1953 nga kimisti amerikan Stenli Miler, i cili, duke bashkuar gazrat, që ai pretendonte se kishin ekzistuar në atmosferën primitive në një ambient eksperimental dhe duke i ekspozuar ato ndaj një burimi të jashtëm energjie, Milleri formoi disa molekula organike (aminoacide) të pranishme në strukturën e proteinave.

Mezi kishin kaluar disa vite para se të zbulohesh se ky eksperiment, i cili atëherë u paraqit si një hap i rëndësishëm në emër të evolucionit, ishte i pavlefshëm, sepse atmosfera e përdorur në këtë eksperiment ishte shumë më e ndryshme nga kushtet reale të Tokës.⁷⁵

Pas një periudhe të gjatë heshtjeje, Milleri pranoi se atmosfera e



*Stanley
Miller*

përdorur nga ai nuk ishte reale.⁷⁶

Të gjitha përpjekjet evolucioniste që u ndërmorën gjatë shekullit të njëzet për të shpjeguar zanafillën e jetës përfunduan pa sukses. Xhefri Bada, gjeo-kimisti i njohur nga Instituti Skrips i San Diegos, në një artikull të botuar në vitin 1998 në revistën "Earth (Toka)", pranon këtë fakt:

Sot, duke e lënë pas shekullin e njëzet, akoma përballemi me problemin më të madh të pazgjidhur që kishim kur hymë në shekullin e njëzet: Si zuri fill jeta në tokë?⁷⁷

Ndërtimi i ndërlikuar i jetës

Shkaku kryesor që çështja mbi zanafillën e jetës ka hyrë në një dilemë të tillë është se madje ata organizma të gjallë që mendohej të jenë më të thjeshtat kanë ndërtim jashtëzakonisht të ndërlikuar. Qeliza e një



I gjithë informacioni për gjallesat është i ruajtur në molekulën e ADN-së. Kjo mënyrë tejet efikase e ruajtjes së informacionit vetvetiu është një dëshmi e qartë se jeta nuk u krijua rastësisht, por u projektua në mënyrë të qëllimshme, apo, më mirë të themi, u krijua në mënyrë të mrekullueshme.

gjallese është shumë më e ndërlikuar se të gjitha produktet teknologjike që ka arritur të prodhojë njeriu. Sot, madje edhe në laboratorët më të përparuara të botës, duke bashkuar materie kimike organike, nuk do të mund të arrijmë kurrë të përfitojmë një qelizë të vetme.

Kushtet që nevojiten për formimin e një qelize janë aq të shumta sa kurrë nuk mund të shpjegohen me rastësi. Probabiliteti që proteinat, njësia bazë e qelizës, të sintetizohen rastësisht është 1 në 10^{950} (për një proteinë mesatare me 500 aminoacide). Në matematikë probabilitetet më të vogla se 10^{50} konsiderohen të pamundura.

Molekula e ADN-së përmban informacionet gjenetike si një bankë informacionesh me kapacitet të pabesueshëm. Nëse do ta hidhnim në letër informacionin që përfshin ADN-ja e njeriut, do të krijohej një bibliotekë me 900 volume enciklopedike me nga 500 faqe secili.

Në këtë pikë shfaqet një dilemë shumë interesante: ADN-ja mund ta kopjoj/përsëris vetveten vetëm me ndihmën e disa proteinave të specializuara (enzimave). Mirëpo, sinteza e këtyre enzimave mund të realizohet vetëm me anë të informacionit të koduar në ADN. Pasi që ato të dyja janë të varura nga njëra tjetra, ato duhet të ekzistojnë në të njëjtën kohë për kopjim/përsëritje. Kjo e sjellë skenarin se jeta ka zënë fill vetvetiu në një rrugë pa krye. Prof. Lesli Orgel, një evolucionist me reputacion nga Universiteti i San Diegos në Kaliforni, e pranon këtë fakt në botimin e revistës *Scientific American* të Shtatorit të vitit 1994:

Është krejtësisht e pamundshme që proteinat dhe acidet nukleike, duke qenë të dyja komplekse për nga ndërtimi, të jenë krijuar vetvetiu në të njëjtin vend dhe në të njëjtën kohë. Po ashtu duket e pamundshme ta kemi njërin pa tjetrën. Dhe kështu, në shikim



të parë, njeriut do t'i duhej të vjen në përfundimin se, në të vërtetë, jeta kurrë nuk ka mundur të zë fill me anë të mjeteve kimike.⁷⁸

Padyshim, nëse është e pamundur që jeta të ketë zënë fill nga shkaqet natyrore, atëherë duhet të pranohet se jeta u “krijua” në mënyrë të mbinatyrshme. Ky fakt zhvlerëson në mënyrë të qartë teorinë e evolucionit, qëllimi kryesor i së cilës është të mohoj krijimin.

Mekanizmat imagjinarë të evolucionit

Çështja e dytë e rëndësishme që e bën teorinë e Darvinit të pavlefshme është se të dy konceptet e paraqitura nga kjo teori si “mekanizma të evolucionit”, u kuptua se në të vërtetë nuk zotërojnë asnjë forcë evoluese.

Darvini e mbështeti hipotezën e tij në tërësi në mekanizmin e “seleksionimit natyror.” Rëndësia që i jepte këtij mekanizmi mund të kuptohet fare lehtë edhe nga titulli i librit të tij: Origjina e Llojeve nëpërmjet seleksionimit natyror”...

Seleksionimi natyror pohon se ato gjallesa që janë më të fuqishme dhe që i përshtaten më mirë kushteve natyrore të

vendbanimeve të tyre do të mbijetojnë në luftën për jetë. P.sh., në një kope sorkadhesh që kërcënohet prej kafshëve të ndryshme grabitqare, do të mbijetojnë vetëm ato sorkadhe që vrapojnë më shpejt. Kështu që kopeja e sorkadheve do të përbëhet nga individët më të fortë dhe më të shpejtë. Mirëpo, sigurisht që ky mekanizëm nuk mund të shkaktojë evoluimin e sorkadheve e t'i kthejë në një lloj tjetër gjallese, për shembull, në kuaj.

Për këtë arsye, mekanizmi i seleksionimit natyror nuk zotëron asnjë forcë evoluese. Edhe Darvini ishte i ndërgjegjshëm për këtë realitet, ndaj në librin e tij *Origjina e Llojeve* u detyrua të pohonte:

Seleksionimi natyror s'mund të bëjë asgjë përderisa nuk shfaqen dallime dhe ndryshime të dobishme individuale.⁷⁹



Lamarck



Ndikimi i Lamarkut

Si mund të formoheshin këto ndryshime të dobishme? Darvini, kësaj pyetjeje u mundua t'i përgjigjej nga këndvështrimi i të kuptuarit primitiv të shkencës së asaj kohe. Sipas biologut francez Shevalie Lamark (1774-1829), i cili ka jetuar para Darvinit, gjallesat ia përcollën brezit pasardhës të gjitha ndryshimet fizike, të cilat kishin fituar gjatë jetës së tyre. Ai pohonte se këto cilësi, të cilat u akumuluan nga një brez në tjetrin, bënë që të formohen specie të reja. Për shembull, ai pohonte se gjirafat evoluuan nga antilopat gjatë përpjekjeve të tyre për të arritur gjethet e pemëve të larta, qafat e tyre u zgjatën nga njëri brez në tjetrin

Edhe Darvini ka dhënë shembuj të ngjashëm. Në librin e tij Origjina e Llojeve, për shembull, ai thotë se disa arinj për të gjetur ushqim në thellësi të detit me kohë u shndërruan në balena.⁸⁰

Por zbulimet e Gregor Mendelit (1822-1884) të ligjeve të trashëgimisë, të cilat u saktësuan nga shkencë e gjenetikës, e cila lulëzoi në shekullin e njëzet, hedhën poshtë plotësisht legjendën e përcjelljes së karakteristikave të fituara në brezat pasardhës. Kështu, u vërtetua përfundimisht se seleksionimi natyror ishte një mekanizëm joefektiv.

Neo-darvinizmi dhe mutacionet

Për të gjetur një zgjidhje, darvinistët nxorën në dritë "Teorinë Sintetike Moderne", apo siç njihet ndryshe Neo-Darvinizmin, në fund të viteve 1930. Neo-Darvinizmi shtoi mutacionet, të cilat janë shtrembërime të formuara në gjenet

Mutacionet – çarjet apo zëvendësimet që ndodhin në molekulën e ADN-së – janë rezultat i efekteve të jashtme siç janë rrezatimi apo veprimi kimik. Ky fëmijë Vietnamez që ka pësuar mutacion është viktimë e armës bërthamore.



e gjallesave për shkak të faktorëve të tillë të jashtëm si rrezatimi apo gabimet në përsëritje, si “shkaqe të ndryshimeve të dobishme” përveç mutacionit natyror.

Modeli, i cili edhe sot e ruan vlerën në emër të evolucionit, është Neo-Darvinizmi. Sipas kësaj teorie miliona gjallesa në botë u formuan si rezultat i një procesi me anën e të cilit organe të shumta komplekse të këtyre organizmave (p.sh., veshët,



mushkëritë dhe krahët) iu nënshtruan “mutacioneve,” domethënë çrregullimeve gjenetike. Por ekziston një fakt i prerë shkencor që plotësisht e hedh poshtë këtë teori: Mutacionet nuk i zhvillojnë gjallesat, përkundrazi, ato janë gjithmonë të dëmshme.

Arsyeja për këtë është shumë e thjeshtë: ADN-ja zotëron një ndërtim shumë të ndërlikuar dhe çdo ndikim spontan mbi këtë molekulë, mund vetëm t’i shkaktojë dëm asaj. Gjeneticisti amerikan B. G. Ranganathan e shpjegon këtë fakt si në vazhdim:

Së pari, mutacionet e vërteta janë shumë të rralla në natyrë. Së dyti, shumica e mutacioneve janë të dëmshme pasi që janë të rastësishme, më parë se ndryshime të rregullta në strukturën e gjeneve; çfarëdo ndryshimi i rastësishëm në një sistem tejet të rregullt do të ndikojë për të keq, jo për të mirë. Për shembull, nëse një tërmet do të dridhte një ndërtim tejet të rregullt siç është një ndërtesë, do të ndodhte një ndryshim i rastësishëm në kornizën e ndërtesës, i cili sipas të gjitha gjasave, nuk do të ishte një përmirësim.⁸¹

Nuk çudit fakti se deri më sot nuk është vëzhguar asnjë rast i ndonjë mutacioni të dobishëm, domethënë, i cili është parë të zhvilloj kodin gjenetik. Është vërtetuar se të gjitha mutacionet janë të dëmshme. Është kuptuar se mutacioni, i cili është paraqitur si një “mekanizëm i evolucionit,” është në të vërtetë një dukuri gjenetike që dëmton gjallesat dhe i lë të gjymtuara. (Efekti më i zakonshëm i mutacionit në qeniet njerëzore është kanceri.) Natyrisht, një mekanizëm shkatërrues nuk mund të jetë “mekanizëm evolutiv.” Seleksionimi natyror, në anën tjetër, “s’ mund të bëj asgjë i

vetëm," siç e pranoi edhe Darvini. Ky fakt na tregon se nuk ekziston ndonjë "mekanizëm evolutiv" në natyrë. Pasi që nuk ekziston asnjë mekanizëm evolutiv, asnjë proces i tillë i imagjinuar i quajtur "evolucion" nuk ka mundur të ndodhë.

Të dhënat fosile: asnjë gjurmë e formave kalimtare

Të dhënat fosile janë treguesi më i qartë se skenari që sugjerohet nga teoria evolucionit nuk ka ndodhur kurrë.

Sipas kësaj teorie, të gjitha gjallesat kanë evoluar nga një paraardhës. Një specie, e cila ekzistonte më parë, me kalimin e kohës, u shndërrua në diçka tjetër dhe të gjitha speciet u krijuan në këtë mënyrë. Me fjalë të tjera, ky transformim u zhvillua gradualisht gjatë një periudhe të gjatë prej qindra miliona vjetësh.

Po të kishte qenë kështu, lloje të shumta kalimtare duhej të kishin ekzistuar dhe jetuar brenda kësaj periudhe të gjatë transformimi.



Fosili i pilivesës i vjetër 150-200 milionë vjet (Jurasiq – periudha e vonshme) nuk ndryshon nga mostrat që jetojnë sot.

Për shembull, disa krijesa gjysmë peshk-gjysmë zvarranik duhej të kishin jetuar në të kaluarën të cilat kishin fituar disa tipare zvarranikësh, përveç tipareve të peshkut të cilat ato tashmë i kishin. Apo duhej të kishin ekzistuar disa zvarranik-zogj, të cilët fituan disa tipare të zogjve përveç tipareve të zvarranikëve që ato tashmë i kishin. Meqë këto gjallesa do të duhej të kishin ekzistuar në një periudhë kalimtare, gjallesat duhet të kenë qenë të gjymtuara dhe me një sërë të metash. Evolucionistët, këto qenie imagjinare që besojnë të kenë jetuar në të kaluarën, i quajnë “forma kalimtare”.

Nëse me të vërtetë do të kishin ekzistuar gjallesa të tilla në të kaluarën, atëherë do të duhej të kishte me miliona dhe madje miliarda sosh për nga numri dhe llojllojshmëria. Ajo që është më me rëndësi, mbetjet e këtyre qenieve të çuditshme do të duhej të haseshin në të dhënat fosile. Darvini, në librin *Origjina e Llojeve*, këtë fakt e shpjegon kështu:

Nëse teoria ime është e vërtetë, atëherë forma kalimtare të panumërta që lidhin speciet e të njëjtit grup, duhet të kenë ekzistuar sigurisht... Si rrjedhim, provat për ekzistencën e tyre të mëparshme do të mund të gjendeshin vetëm në mbetjet fosile.”⁸²

Shpresat e venitura të Darvinit

Mirëpo, edhe pse janë bërë shumë kërkime intensive për të gjetur fosilet që nga mesi i shekullit të nëntëmbëdhjetë në mbarë botën, ende nuk është gjetur asnjë formë kalimtare. Të gjitha fosilet, në kundërshtim me atë që shpresonin

evolucionistët, tregojnë se jeta në Tokë u shfaq rastësisht, krejt papritur dhe plotësisht e formuar.

Një paleontolog i njohur britanik, Derek V. Ager, edhe pse një evolucionist, e pranon këtë realitet:

Problemi ynë është ky: Tek analizojmë me hollësi të dhënat fosile në nivelin e klasave apo llojeve, hasim gjithmonë e më tepër jo evolucion gradual, por shpërthim të papritur të një lloji në llogari të një tjetri.⁸³

Me fjalë të tjera, te fosilet e gjetura, të gjitha llojet e gjallesave shfaqen papritmas dhe në formën e tyre të përfunduar, pa asnjë formë të ndërmjetme në mes. Kjo është pikërisht e kundërta e supozimeve të Darvinit. Për më tepër, kjo është një provë shumë e fortë që gjallesat janë krijuar. I vetmi shpjegim që një specie e gjallë të shfaqet papritmas e plotë dhe pa paraardhës nga i cili të ketë evoluar është se ajo u krijua. Kjo e vërtetë është pranuar po ashtu nga biologu i mirënjohur evolucionist Douglas Futuyuma:

Krijimi dhe evolucioni janë dy shpjegimet e vetme që mund të bëhen rreth origjinës së qenieve të gjalla. Krijimi dhe evolucionin, në mes tyre, shter shpjegimet e mundshme për zanafillën e gjallesave. Organizmat ose janë shfaqur në tokë të zhvilluara plotësisht, ose jo. Në rast se nuk janë zhvilluar gradualisht, ato duhet të jenë zhvilluar nga specie që kanë ekzistuar më parë me anë të ndonjë procesi modifikimi. Në rast se janë shfaqur plotësisht të zhvilluara, ato me të vërtetë duhet të jenë krijuar nga ndonjë intelekt i plotfuqishëm.⁸⁴

Fosilet tregojnë se qeniet e gjalla u shfaqën në Tokë të formuara plotësisht dhe në gjendje të përkryer. Me fjalë të tjera “origjina e llojeve,” në kundërshtim me supozimin e Darvinit, nuk është evolucionin, por krijimi.



Teoria e evolucionit pohon se gjallesat evoluan gradualisht njëra prej tjetrës.

Të dhënat fosile, megjithatë, e përgënjeshtrojnë këtë pohim në mënyrë të qartë. Për shembull, në Periudhën Kambriane, diku rreth 550 milion vite më parë, dhjetëra gjallesa krejtësisht të veçanta u shfaqën papritur. Këto gjallesa të vizatuara në fotografitë më lartë kanë struktura shumë të ndërlikuara. Ky fakt, të cilit në literaturën shkencore i referohet si “Shpërthimi i Kambrianit”, është dëshmi e kulluar e krijimit.


Përralla e evolucionit të njeriut


Çështja që trajtohet më shpesh nga mbrojtësit e teorisë së evolucionit është prejardhja e njeriut. Mendimi darvinist mbi këtë çështje thotë se qeniet njerëzore moderne që jetojnë sot kanë evoluar nga disa krijesa të ngjashme me majmunët.

Gjatë kësaj periudhe të supozuar, e cila mendohet të ketë filluar rreth 4-5 milionë vjet më parë, pretendohet se kanë jetuar “forma kalimtare” midis njeriut modern dhe të parëve të tij. Ka katër “kategori” bazë në gjithë këtë skenar të imagjinuar:

1. Australopiteku
2. Homo habilis
3. Homo erektus
4. Homo sapiens

Stephen
Jay Gould





Paraqitjet e trilluara të qenieve primitive njerëzore shpesh përdoren në tregimet e sjellura nga gazetatat dhe revistat që janë pro evolucionit. I vetmi burim për këto tregime, të bazuara në paraqitjet e trilluara, janë imagjinatat e autorëve të tyre. Prapseprap evolucionit ka pësuar disfatë të tillë përballë fakteve shkencore sa që gjithnjë e më pak raporte në lidhje me evolucionin tani paraqiten në revistat shkecore.

Evolucionistët i japin emrin “Australopitek” (që do të thotë “majmuni i jugut”), të ashtuquajturit paraardhës të parë të njeriut të ngjashëm me majmunët. Këto qenie të gjalla nuk janë në fakt asgjë tjetër, përveçse një specie e zhdukur majmuni. Kërkimet e shumta të Lordit Solli Cukerman dhe Profesorit Çarlls Oksnard, dy anatomistë me famë botërore nga Anglia dhe SHBA-ja, rreth mbetjeve të australopitekeve tregojnë se këto qenie i përkisnin një lloji të majmunit të zhdukur dhe se nuk kishin asnjë ngjashmëri me qeniet njerëzore.⁸⁵

Evolucionistët e quajnë fazën tjetër të evolucionit njerëzor “homo,” domethënë “njeri”. Sipas këtij pretendimi,

qeniet e gjalla të serisë “homo” ishin më të zhvilluara se australopitekët. Evolucionistët i vendosën fosilet e këtyre krijesave të ndryshme pranë njëra-tjetrës me një renditje të caktuar dhe përpiluan një plan imagjinar evolucioni. Ky plan është imagjinar, sepse faktikisht asnjë lidhje evolucionare mes këtyre klasave të ndryshme nuk është provuar. Ernst Majër, njëri prej mbrojtësve më të rëndësishëm të teorisë së evolucionit në shekullin e njëzet në librin e tij Një argument i gjatë pohon se: “në veçanti (enigmat) historike si zanafilla e jetës apo e Homo sapiensit, janë tejet të vështira dhe mund madje t’i bëjnë ballë një shpjegimi përfundimtar të kënaqshëm.”⁸⁶

Kur konturojnë zinxhirin Australopitek > Homo Habilis > Homo Erektus > Homo Sapiens, evolucionistët nënkuptojnë se këto specie kanë qenë paraardhëse të njëra-tjetrës. Mirëpo, zbulimet më të fundit të paleo-antropologëve tregojnë se Australopiteku, Homo Habilis dhe Homo Erektus kanë jetuar në të njëjtën periudhë në pjesë të ndryshme të botës.⁸⁷

Për më tepër, një segment i caktuar njerëzish i klasifikuar si Homo Erektus ka jetuar deri në kohërat moderne. Homo sapiens, Neandertalët dhe Homo Sapiens Sapiens (njeriu modern) kanë bashkëjetuar në të njëjtin rajon.⁸⁸

Kjo, sigurisht, provon përfundimisht se këto specie nuk ishin paraardhëse të njëra-tjetrës. Stefën Xhej Gould, njëri prej paleontologëve të universitetit të Harvardit, megjithëse është evolucionist, e shpjegon qorrrokakun në të cilin gjendet teoria darviniste në këtë mënyrë:

Çfarë i ndodhi shkallës sonë, nëse bashkekzistojnë tri linja hominide (A. Afrikanus, Robust Australopitekët robust

(shtatmëdhën) dhe H. Habilis) që nuk rrjedhin nga njëra-tjetra? Për më tepër, asnjë nga të tre nuk shfaq ndonjë tendencë evolutive gjatë qëndrimit të tyre në tokë.⁸⁹

Me pak fjalë, i gjithë skenari i evolucionit njerëzor që po mbahet gjallë me ndihmën e vizatimeve të ndryshme të krijesave imagjinare “gjysmë-majmun-gjysmë-njeri”, që shfaqen në media apo libra shkollorë, domethënë, sinqerisht, me anë të metodave propagandistike, s’janë gjë tjetër veçse një mit pa asnjë bazë shkencore.

Lordi Solli Cukerman, një nga shkencëtarët më të njohur dhe më të spikatur të Mbretërisë së Bashkuar, e ka studiuar këtë çështje për vite me radhë dhe ka kryer një punë kërkimore 15-vjeçare mbi fosilet e Australopitëkut. Edhe pse evolucionist, ai arriti në përfundimin se, në të vërtetë, nuk ekziston asnjë pemë gjenealogjike midis majmunit dhe njeriut.

Cukerman gjithashtu bëri një “spektër interesant të shkencave”, duke i radhitur ato nga ato që ai i konsideronte si më shkencoret tek ato që i konsideronte si më joshkencoret. Sipas spektrit të Cukermanit, më “shkencoret,” duke marrë parasysh mbështetjen e tyre në argumente, janë shkenca e fizikës dhe kimisë. Më pas vijnë shkencat biologjike dhe pastaj shkencat shoqërore. Në fund fare, në pjesën që konsiderohet të jetë si pjesa më “joshkencore”, radhitet “perceptimi jashtë-shqisor” – konceptet si telepatia dhe shqisa e gjashtë – dhe në fund të fundit u vendos “evolucioni i njeriut”. Cukerman shpjegon kështu arsytimin e tij:

Më pas zhvendosim regjistrin e të vërtetës objektive në drejtim të atyre fushave të shkencës të konsideruara si shkenca biologjike, si p.sh. perceptimi jashtë-shqisor apo interpretimi i historisë së

fosileve të njeriut, ku për (evolucionistin) besnik gjithçka është e mundur – dhe ku besimtari i zjarrtë (i evolucionit ndonjëherë është në gjendje të besojë shumë gjëra kontradiktore në të njëjtën kohë.⁹⁰

Siç shihet, evolucioni njerëzor nuk është gjë tjetër veçse një përmbledhje e “disa interpretimeve të paragjykuara të fosileve të zhvarrosura prej njerëzve të caktuar, të cilët ndjekin verbërisht teorinë e tyre.

Formula e Darvinit!

Përveç të gjitha provave teknike me të cilat jemi marrë gjer më tani, le ta shtjellojmë njëherë, se çfarë paragjykimi kanë evolucionistët me një shembull të thjeshtë që të kuptohet madje edhe prej fëmijëve:

Teoria e evolucionit pohon se jeta u krijua rastësisht. Sipas këtij pohimi, atomet e pajetë dhe të pavetëdije u bashkuan për të formuar qelizën dhe pastaj ata disi formuan gjallesat tjera, duke përfshirë edhe njeriun. Le të mendojmë për këtë. Kur i bashkojmë elementet që janë bazë e ndërtimit jetës si karboni, fosfori, nitrogjeni dhe potasiumi, vetëm një grumbull formohet. Pa marrë parasysh se çfarë trajtimi i nënshtrohet, ky grumbull atomesh nuk mund të formojë madje as edhe një gjallesë të vetme. Nëse dëshironi, le ta formulojmë një “eksperiment” në lidhje me këtë çështje dhe ta shtjellojmë në emër të evolucionistëve atë që ata vërtet e pohojnë pa e shprehur zëshëm me emrin “formula e Darvinit”:

Le të vendosin materialistët plot materiale të pranishme në përbërjen e gjallesave si fosfori, nitrogjeni, karboni, oksigjeni,

hekuri dhe magneziumi në fuçi të mëdha. Veç kësaj, le të shtojnë në këto fuçi çfarëdo lloj materiali që nuk ekziston në kushte normale, por që ata mendojnë se është i domosdoshëm. Le të shtojnë në këtë përzierje aq sa të dëshirojnë amino acide – të cilat nuk kanë mundësi të formohen në kushte natyrore – dhe proteina – që një e vetme e ka probabilitetin e formimit 10 në 950 – sa të duan. Le t'ia ekspozojnë këto përzierje deri në masën që dëshirojnë nxehtësisë dhe lagështisë. Le t'i përziejnë këto me çfarëdo pajisje të përparuar teknologjike që të duan. Le t'i vënë shkencëtarët më të shquar pranë këtyre fuçive. Le të presin këta ekspert me radhë pranë këtyre fuçive për miliarda dhe trilionë vite. Le të lejohen të përdorin të gjitha llojet e kushteve që ata besojnë të jenë të domosdoshme për formimin e një njeriu. Pa marrë parasysh se çfarë bëjnë, ata nuk mund ta krijojnë një njeri prej këtyre fuçive, të themi një profesor që ekzaminon strukturën e qelizës së tij nën një mikroskop elektronik. Ata nuk mund të krijojnë gjirafa, luanë, bletë, kanarina, kuaj, delfinë, trëndafila, orkide, zambakë, karafila, banane, portokaj, molla, hurma, domate, pjepër, shalqi, fiq, ullinj, rrush, pjeshka, pallojë, fazanë, flutura shumëngjyrëshe apo me miliona gjallesa si këto. Me të vërtetë, ata nuk do të mund të përfitonin as edhe një qelizë të vetme prej cilësdo prej tyre.

Thënë shkurt, atomet e pavetëdijshe nuk mund të formojnë qelizën duke u bashkuar. Ato nuk mund të marrin një vendim të ri dhe ta ndajnë këtë qelizë më dysh dhe pastaj të marrin vendime tjera dhe të krijojnë profesorët të cilët së pari shpikin mikroskopin elektronik dhe pastaj ekzaminojnë strukturën e qelizës së vet nën atë mikroskop. Materia është një grumbull i pavetëdijsëm, i pajetë dhe ajo vjen në jetë me krijimin e lartë të Allahut.

Teoria e evolucionit, e cila pohon të kundërtën e kësaj, është një gjykim plotësisht i gabuar i kundërt me arsyen. Të

menduarit madje edhe vetëm për pak kohë për pohimet e evolucionistëve zbulon këtë të vërtetë, sikurse në shembullin më lartë.

Teknologjia e syrit dhe veshit

Një çështje tjetër që mbetet pa përgjigje nga teoria e evolucionit është cilësia e shkëlqyer e perceptimit të syrit dhe veshit.





Krahasuar me kamerat dhe makinat që regjistrojnë zërin, syri dhe veshi janë shumë më kompleks, shumë më të suksesshëm dhe posedojnë projekte shumë më superiore në raport me këto produkte të teknologjisë së avancuar.

Para se të kalojmë te syri, le t'i përgjigjemi shkurtimisht pyetjes "Si shohim ne?" Rrezet e dritës që vijnë nga një objekt, bien në retinën e syrit duke dhënë një imazh të përmbysur të objektit. Këtu, këto rreze drite transformohen në sinjale elektrike nga qelizat dhe pastaj përcillen në një zonë të vogël në pjesën e prapme të trurit, ku ndodhet "qendra e shikimit". Këto sinjale elektrike perceptohen në këtë qendër të trurit si imazh pas një sërë procesesh. Le të mendojmë pak, duke u bazuar në këto njohuri teknike.

Truri është i izoluar tërësisht nga drita. Kjo do të thotë se pjesa e brendshme e trurit është në errësirë të plotë dhe drita nuk arrin atje. Qendra e shikimit është një vend në errësirë të plotë ku nuk hyn kurrë dritë. Ka mundësi që të jetë vendi më i errët që ekziston. Megjithatë, ne shikojmë një botë të ndritshme plot dritë në këtë errësirë të plotë.

Imazhi i formuar në sy është kaq i mprehtë dhe i qartë, sa që as teknologjia e shekullit njëzet nuk ka arritur ta realizojë. Për shembull, shikoni librin që jeni duke e lexuar, duart me të cilat e mbani atë dhe pastaj ngrini kokën dhe shikoni përreth. A keni parë ndonjëherë një imazh të tillë të mprehtë e të qartë si ky në ndonjë vend tjetër? Edhe ekrani më i zhvilluar i televizorit i prodhuar nga prodhuesi më i fuqishëm i televizorëve në botë nuk mund të sigurojë një imazh aq të mprehtë për ju. Ky është një imazh tre-dimensional, me ngjyra dhe jashtëzakonisht i pastër. Për vite të tëra, mijëra inxhinierë janë përpjekur të prodhojnë një televizor tre-dimensional, i cili mund të arrijë cilësinë e shikimit të syrit. Ata kanë arritur të shpikin një sistem TV tre-dimensional, por ai nuk mund të shihet pa vendosur një palë syze speciale 3-D. Për më tepër, bëhet fjalë vetëm për një tre-dimensional artificial. Sfondi është më i mjegulluar, ndërsa plani i parë duket sikur është dekor prej letre. Asnjëherë s'ka qenë e mundur të arrihet një imazh me cilësinë e syrit. Edhe në kamera apo në televizor, ka një humbje të cilësisë së imazhit.

Evolucionistët pretendojnë se mekanizmi që prodhon këtë imazh të mprehtë e të qartë është formuar krejt rastësisht. Nëse dikush do t'ju thoshte se televizori në dhomën tuaj është formuar si rezultat i bashkimit të rastësishëm të miliona atomeve, çfarë do të mendonit ju? Si mund ta bëjnë atomet atë që mijëra njerëz s'e bëjnë dot?

Nëse një pajisje që prodhon një imazh më primitiv se syri nuk mund të jetë formuar rastësisht, atëherë është shumë e qartë që edhe syri apo imazhi që shikohet prej tij nuk mund

të jenë krijuar rastësisht. E njëjta gjë vlen edhe për veshin. Veshi i jashtëm i kap tingujt dhe i drejton te veshi i mesëm, i cili ia përcjell veshit të brendshëm duke i përforcuar ato. Veshi i brendshëm ia dërgon valët zanore trurit, duke i kthyer në sinjale elektrike. Ashtu si me shikimin, procesi i dëgjimit përfundon në qendrën e dëgjimit në tru.

Ajo që thamë për syrin është e vërtetë edhe për veshin. D.m.th. truri është i izoluar nga tingujt, ashtu si është i izoluar edhe nga drita: asnjë tingull nuk mund të depërtojë brenda. Prandaj, s'ka rëndësi sa zhurmë ka jashtë, brenda trurit mbizotëron një qetësi absolute. Megjithatë edhe tingujt më të mprehtë perceptohen nga truri.

Nëpërmjet trurit tonë, i cili është i izoluar nga tingujt, ne dëgjojmë simfoninë e ekzekutuar nga një orkestër apo zhurmat në një vend të mbushur plot me njerëz. Megjithatë, nëse bëhet një matje ekzakte e nivelit të tingujve në trurin tonë në këto momente, do të kuptonim se një qetësi absolute mbizotëron aty.

Ashtu si në rastin e imazhit, dekada të tëra përpjekjesh kanë kaluar për të krijuar dhe riprodhuar tinguj sa më të afërt me origjinalin. Rezultatet e këtyre përpjekjeve janë regjistruarit e zërit, sistemet HI-FI dhe sistemet e ndryshme për kapjen e tingujve. Pavarësisht nga teknologjia e përparuar dhe përpjekjet e mijëra inxhinierëve e ekspertëve, nuk është përfituar asnjë tingull që të ketë të njëjtën mprehtësi dhe qartësi si tingulli që kapet nga veshi. Mendoni për sistemet HI-FI të cilësisë më të lartë të prodhuar nga kompania më e madhe e industrisë së muzikës. Edhe në këto pajisje, kur regjistrohet zëri, humbet një pjesë e cilësisë. Kur

ndizni një HI-FI gjithmonë dëgjoni një zhurmë të lehtë para se të fillojë muzika. Veshi i njeriut asnjëherë nuk e kap një tingull të shoqëruar me zhurmë; ai e kap tingullin pikërisht ashtu siç është, i mprehtë e i qartë. Kështu ka qenë gjithmonë që nga krijimi i njeriut.

Kujt i takon ndërgjegjja që sheh dhe dëgjon në brendi të trurit?

Kush shikon një botë joshëse në trurin tonë, dëgjon simfonitë dhe cicërimën e zogjve dhe ndien aromën e trëndafililit?

Nxitjet që vijnë prej syve, veshëve dhe hundës së një personi shkojnë në tru si impulse nervore elektro-kimike. Në



Dikush që shikon një fokë e përfytyron atë në trurin e tij. Ngjashëm, në trurin e tij ai hulumton dhe studion tiparet e kësaj krijese që ai sheh në trurin e tij. Gjërat që ai mëson ia zbulojnë atij përsosmërinë e krijimit të Zotit dhe superioritetin e urtësisë dhe dijenisë së Tij.

librat e biologjisë, fiziologjisë dhe biokimisë, mund të gjeni shumë hollësi për mënyrën se si ky imazh formohet në tru. Mirëpo, kurrë nuk do të mund të ndesheni me faktin më të rëndësishëm: Kush i pranon këto impulse nervore elektrokimike si imazhe, tinguj, aroma dhe ngjarje shqisore në tru? Ekziston një ndërgjegje në tru që i pranon gjithë këto pa ndier ndonjë nevojë për një sy, vesh apo hundë. Kujt i takon kjo ndërgjegje? Natyrisht se nuk u takon nervave, shtresës yndyrore dhe neuroneve që e përbëjnë trurin. Kjo është arsyeja pse darvinistët-materialist, të cilët besojnë se gjithçka përbëhet prej materies, nuk mund të japin përgjigje në këto pyetje.

Sepse kjo ndërgjegje është shpirti i krijuar prej Allahut, i cili nuk ka nevojë as për syrin për të shikuar imazhet dhe as për veshin për t'i dëgjuar tingujt. Për më tepër, nuk ka nevojë për trurin për të menduar.

Çdo njeri që e lexon këtë fakt të qartë shkencor do të duhej të mendonte thellë për Allahun e Gjithëfuqishëm dhe të ketë frikë dhe të kërkoj strehim tek Ai, sepse Ai ngjesh tërë gjithësinë në një vend plotësisht të errët prej disa centimetrave kub në një formë tre-dimensionale, me ngjyra, me hije dhe të ndritshme.

Një besim materialist

Informacioni që kemi paraqitur deri tani tregon se teoria e evolucionit është një pretendim që bie hapur në kundërshtim me faktet shkencore. Pretendimi i teorisë në lidhje me prejardhjen e jetës është në kundërshtim me

shkencën, mekanizmat e evolucionit të propozuara nga kjo teori nuk kanë asnjë forcë evolutive, dhe fosilet tregojnë se format kalimtare nuk kanë ekzistuar kurrë. Prandaj, teoria e evolucionit duhet të hidhet poshtë si një ide joshkencore. Në këtë mënyrë shumë ide, si modeli i gjithësisë me qendër Tokën, janë nxjerrë jashtë agjendës së shkencës gjatë historisë.

Por teoria e evolucionit vazhdon të mbahet me vendosmëri në listën e teorive shkencore. Disa njerëz madje përpiqen t'i paraqesin kritikën në adresë të saj si "sulm ndaj shkencës". Po pse ndodh kjo gjë?

Arsyeja për këtë situatë të krijuar është se për disa njerëz të cilët u përkasin disa qarqeve të caktuara, teoria e evolucionit është shndërruar në një besim dogmatik të domosdoshëm. Këto qarqe kapen fort pas filozofisë materialiste dhe ndikohen nga Darwinizmi, i cili për ta është shpjegimi i vetëm materialist për natyrën.

Nganjëherë ata e pranojnë hapur këtë. Riçard Levontin, gjenetist i famshëm nga universiteti i Harvardit dhe në të njëjtën kohë një evolucionist i njohur pranon se është "së pari materialist, pastaj shkencëtar":

Nuk është puna se metodat dhe institucionet e shkencës në njëfarë mënyrë na detyrojnë të pranojmë një shpjegim material për botën, por përkundrazi, ne jemi të detyruar nga përkrahja jonë arbitrare e kauzës materialiste të krijojmë një aparat hetimi dhe një sërë konceptesh që japin shpjegime materiale, edhe nëse janë kundër intuitës, pa marrë parasysh se sa të mjegullta janë për të panisurën. Për më tepër, materializmi është absolut, kështu që ne nuk mund të lejojmë të dalë në skenë një Qenie Hyjnore.⁹¹

Këto fjalë janë deklarata të qarta se Darwinizmi është një dogmë e mbajtur gjallë për hir të lidhjes me filozofinë

materialiste. Sipas kësaj dogme asgjë nuk ekziston përveç materies. Prandaj, ajo predikon se materia e pajetë dhe e pavetëdijshme krijoi jetën. Ajo këmbëngul se miliona specie të gjalla, (si zogjtë, peshqit, kafshët, insektet, pemët, lulet, balenat dhe qeniet njerëzore) u shfaqën si pasojë e bashkëveprimit të materies si shiut, rrufeve dhe kështu me radhë prej materies së pajetë. Ky besim është në kundërshtim të plotë si me arsyen ashtu edhe shkencën. Por darvinistët vazhdojnë të mbrojnë këtë besim me qëllim që “të mos lejojnë daljen në skenë të një Qenie Hyjnore.”

Kushdo që nuk e shikon prejardhjen e gjallesave me paragjykim materialist do ta kuptojë këtë të vërtetë të qartë: të gjitha gjallesat janë rezultat i krijimit të një Krijuesi, i Cili zotëron fuqi, dije dhe inteligjencë superiore. Ky Krijues është Allahu, i Cili krijoi tërë gjithësinë nga asgjëja, i Cili e konstruktoi atë në mënyrën më të përkryer dhe u dha formë të gjitha gjallesave.

Teoria e evolucionit: Magjia më e fuqishme në botë

Çdo njeri i lirë prej paragjykimit dhe ndikimit të çfarëdo ideologjie të caktuar, që përdor arsyen dhe logjikën e tij apo të saj, do të kuptojë qartë se besimi në teorinë e evolucionit, i cili na përkujton besëtytnitë e shoqërive pa dijeni të shkencës apo qytetërimit, është plotësisht i pamundshëm.

Siç u shpjegua më lartë, ata që besojnë në teorinë e evolucionit mendojnë se disa atome dhe molekula të hedhura në një fuçi të madhe do të mund të krijonin profesorë dhe studentë universiteti që janë në gjendje të mendojnë dhe

gjykojnë; shkencëtarë si Ajnshtajni dhe Galileo; artistë si Hemfri Bogart, Frenk Sinatra dhe Luçano Pavaroti; si edhe antilopa, drurë limoni dhe karafila. Për më tepër, pasi që shkencëtarët dhe profesorët të cilët besojnë në këto gjepura janë njerëz të shkolluar, është krejtësisht e arsyeshme të flitet për këtë teori si për “magjinë më të fuqishme në histori.” Asnjëherë më parë asnjë besim apo ide tjetër nuk ua ka larguar aftësinë e të gjykuarit të njerëzve, nuk ka pranuar t’i lejojë ata të mendojnë me mençuri dhe me arsye dhe ua ka fshehur të vërtetën sikur ata t’i kishin sytë e lidhur. Kjo është një verbëri madje edhe më e keqe dhe më e pabesueshme se adhurimi i Zotit të Diellit Ra nga egjiptianët, adhurimi i totemeve në disa pjesë të Afrikës, adhurimi i Diellit nga populli i Sabës, adhurimi i idhujve që kishin mbaruar me duart e tyre nga ana e fisit të Profetit Ibrahim (paqja qoftë mbi të) apo adhurimi i Viçit të Artë nga ana e popullit të Profetit Musa (paqja qoftë mbi të).

Në të vërtetë, Allahu ka theksuar këtë mungesë arsyeje në Kuran. Në shumë vargje, Ai zbulon se mendjet e disa njerëzve do të jenë të mbyllura dhe se ata do të jenë të pafuqishme të shohin të vërtetën. Disa nga këto vargje jepen në vazhdim:

Sa për ata që mohojnë, njësoj është, i paralajmërove apo nuk i paralajmërove - ata nuk besojnë. Allahu i ka vulosur zemrat e tyre, ndërsa në veshët dhe sytë e tyre kanë mbulesë; ata i pret një dënim i madh. (Sure Bekare: 6-7)

...Ata kanë zemra me të cilat nuk kuptojnë. Ata kanë sy me të cilët nuk shohin. Ata kanë veshë me të cilët nuk dëgjojnë. Ata janë si kafshët, bile edhe më të humbur! Ata janë të pavetëdijshëm. (Sure A’raf: 179)

Edhe sikur Ne t'u hapnim atyre një derë në qiell dhe të

ngjiteshin vazhdimisht lart në të (e të shihnin engjëjt e fshehtësitë), ata vetëm do të thoshin: "Neve na janë ndalë sytë (të parët). Jo, ne jemi njerëz të magjepsur. (Sure Hixhr: 14-15)

Fjalët nuk mund ta shprehin se sa është e habitshme se si kjo magji ka arritur të mbajë një komunitet aq të gjerë në skllavëri, t'i largojë njerëzit nga e vërteta dhe të mos ndërpritet për 150 vjet. Është e kuptueshme se një apo disa njerëz do të mund të besonin në skenarë dhe pohime të pabesueshme përplot marrëzi dhe mungesë arsyeje. Mirëpo, "magjia" është shpjegimi i vetëm i mundshëm për njerëzit në mbarë botën që besojnë se atomet e pavetëdijshme dhe të pajetë papritur vendosën të bashkohen dhe të formojnë një gjithësi që funksionon me një sistem të organizimit, rregullit, arsyes dhe vetëdijes së përkryer; një planet të quajtur Tokë me të gjitha veçoritë e saj të përshtatura në mënyrë aq të përkryer për jetën; dhe gjallesat përplot sisteme të panumërta komplekse.

Në të vërtetë, Kurani rrëfen ngjarjen e Profetit Musa dhe Faraonit për të treguar se disa njerëz të cilët përkrahin filozofitë ateiste në të vërtetë ndikojnë tek të tjerët me anë të magjisë. Kur iu tha Faraonit për fenë e vërtetë, ai i tha Profetit Musa të ndeshet me magjistarët e tij. Kur Musai e bëri këtë, ai u tha atyre që të tregojnë aftësitë e tyre të parët. Vargjet pasojnë:

"Hidhni ju!" – u përgjigj ai. Kur magjistarët hodhën shkopinjë të tyre, i magjepsën sytë e njerëzve, i frikësuan ata dhe shfaqën një magji të madhe. (Sure A'raf: 116)

Sic kemi vënë re, magjistarët e Faraonit ishin në gjendje

të mashtrojmë çdo njeri, përveç Musait dhe atyre të cilët i besuan atij. Mirëpo, dëshmia e tij zhduki magjinë, apo “gëlltiti atë që ata kishin sajuar,” siç përshkruhet në ajet.

Atëherë Ne i kumtuam Musait: “Hidhe shkopin tënd!” - dhe ai filloi të gëlltiste gjithçka që trilluan ata. Në këtë mënyrë, doli në shesh e vërteta dhe dështoi ajo që kishin bërë ata. (Sure A’raf: 117-118)

Siç kemi vënë re, kur njerëzit e kuptuan se ata u magjepsën dhe se ajo që panë ishte vetëm një iluzion, magjistarët e Faraonit humbën gjithë besueshmërinë e tyre. Edhe në ditët tona, përveç nëse ata të cilët, nën ndikimin e një magjie të ngjashme, besojnë në këto pretendime qesharake nën maskën e tyre shkencore dhe kalojnë jetët e tyre duke i mbrojtur ato, i braktisin besimet e tyre paragjykuese, ata po ashtu do të poshtërohen kur e vërteta e plotë shfaqet dhe magjia prishet. Në të vërtetë, Malkolm Magerixh, një filozof ateist dhe përkrahës i evolucionit, pranoi se ishte i brengosur pikërisht nga kjo perspektivë:

Unë personalisht jam i bindur se teoria e evolucionit, posaçërisht shtrirja e zbatimit të saj, do të jetë njëra prej shakave më të mëdha në librat e historisë në të ardhmen. Brezat e ardhshëm do të çuditen se si një hipotezë aq jo bindëse dhe e dyshimtë ka mundur të pranohej me naivitetin e pabesueshëm që ajo posedon.⁹²

Se e ardhmja nuk është larg: Përkundrazi, njerëzit së shpejti do ta shohin se “rasti” nuk është hyjni dhe do të shikojnë prapa në teorinë e evolucionit si në mashtrimin më të keq dhe magjinë më të tmerrshme në botë. Ajo magji tashmë ka filluar të ngrihet me shpejtësi prej shpatullave të njerëzve në mbarë botën. Shumë njerëz që e shohin fytyrën e saj të vërtetë po pyeten me habi se si është e mundur që të jenë kapluar prej saj.

Engjujt thanë: "Larg nga të metat je
Ti o Zot! Ne nuk kemi asnjë dije
tjetër përveç asaj që na mësove Ti.
Vërtet, Ti je i
Gjithëdijshtëm e i Urtë."
(Sure Bekare: 32)



SHËNIMET

1. "Islam: Empire of Faith." An Empires Special, PBS Home Video.
2. Ibid.
3. Ibid.
4. Ibid.
5. L Carl Brown, ed. Imperial Legacy: The Ottoman Imprint on the Balkans and the Middle East (Columbia University Press: 1997).
6. Eugene A. Myers, Arabic Thought and the Western World in the Golden Age of Islam (New York: Frederick Ungar, 1964), 10, 133, 134.
7. Daniel Pipes, "Islam and Islamism," The National Interest (Spring 2000).
8. Ahmet Davutoglu, Stratejik Derinlik- Turkiye'nin Uluslarası Konumu (Strategical Depth: Turkey's International Status) (Istanbul: Kure Publications, 2001), 250.
9. Sahih Bukhari.
10. "Saladin," The Encyclopedia Britannica, 2002 CD Edition.
11. Sahih Bukhari.
12. Sahih Muslim.
13. Ibid.
14. Sahih Bukhari and Sahih Muslim.
15. Bediuzzaman Said Nursi, Risale-i Nur Collection, "The Twenty-First Flash, Your Second Rule."
16. "The Impact of the Industrial Revolution on Families." Online at: www.asis.com/sfhs/women/sophie.htm
17. Demetrios Yiokaris, Islamic Leage Study Guide-1997, United Nations: Study Guides. Online at: www.vaxxine.com/cowac/islmlcg1.htm.
18. "Islamic Countries have the resources to match the west, scientist", Arabic News.com, 28 May 2000. Online at: www.arabicnews.com/ansub/Daily/Day/000628/2000062848.html.
19. Anthony H. Cordesman and Arleigh A. Burke, "The Gulf and Transition: Executive Summary and Major Policy Recommendations" (October 30, 2000).
20. Anthony H. Cordesman and Arleigh A. Burke, "The US Military and the Evolving Challenges in the Middle East" (March 9, 2002), 3.
21. Ibid.
22. Ibid., 4.
23. Jim Nichol, "Central Asia's New States: Political Developments and Implications for U.S. Interests," CRS (Congressional Research Service) Issue Brief for Congress (June 13, 2003). Online at: www.ncseonline.org/NLE/CRS/abstract.cfm?NLEid=16833.
24. "\$200 billion, Arab loses of braindrain," Arabic News.com, February 27, 2001. Online at: www.arabicnews.com/ansub/Daily/day/010227/2001022720.html.
25. "Church Leaders Against War In Iraq," Houston Independent Media Center (October 10, 2002). Online at: <http://houston.indymedia.org/news/2002/10/4622.php>.
26. Arthur Okun, The Political Economy of Prosperity (Washington, DC: Brookings, 1970), chapter 3.
27. "Vietnam War," Britannica Online. Online at www.britannica.com.
28. William D. Nordhaus, "The Economic Consequences of a War with Iraq" Yale University (October 29, 2002). Online at: www.econ.yale.edu/~nordhaus/iraq.pdf
29. William Bunch, "Invading Iraq not a new idea for Bush clique," Philadelphia Daily News January 27, 2003.
30. Ibid.
31. "Invitation to sign Multi-Religious Call to Fast for Peace," The Shalom Center (October 26, 2002). Online at: www.endthewar.org/frontps/faith/callt

oprayer.htm.

32. John Pilger, "The truths they never tell
NOTES

415

Harun Yahya - Adnan Oktar
us," New Statesman (November 26, 2001).

33. Grant Havers and Mark Wexler, "Is
U.S. Neo-Conservatism Dead?" The
Quarterly Journal of Ideology 24, nos. 3-4
(2001).

34. Orhan Atalay, Dogu-Bati
Kaynaklarinda Birlikte Yasama
(Coexistence in Eastern-Western
Sources) (Istanbul: Gazeteciler ve
Yazarlar Foundation Publications, 1999),
95.

35. Levent Ozturk, Islam Toplumunda
Hristiyanlar (Christians in Islamic
Community) (Istanbul: Iz Publications,
1998), 123; al-Tabari, Ta'rih I (History I)
(1850).

36. Al-Tabari, Ta'rih 1, cited in Majid
Khaduri, War and Peace in the Law of
Islam (Baltimore: Johns Hopkins
University Press, 1955), 102; reprint New
York: AMS Press, 1979.

37. Philip K. Hitti, History of Arabs from
the Earliest Times to the Present (London:
Macmillan, 1958), 143.

38. Samuel H. Moffet, A History of
Christianity in Asia, vol. 1, Beginnings to
1500 (New York: Orbis Books, 1998), 338.

39. W. H. C. Frend, "Christianity in the
Middle East: A Survey Down to A.D.
1800," in Religion in the Middle East, ed. A.
J. Arberry, vols. I-II (Cambridge: 1969),
I:289.

40. Bernard Lewis, The Arabs in History
(Oxford: Oxford University Press, 1993),
101-03.

41. Abu Dawood.

42. Abu Yusuf, no. 139.

43. "Caliph Omar and the Blind Beggar."

Online at:

[www.geocities.com/am_1_99/
CaliphOmar1.html](http://www.geocities.com/am_1_99/CaliphOmar1.html).

44. "Study Shows New Yorkers Suffered
Most Post-9/11 Psychological Stress,"
Scientific American (August 7, 2002).

45. Kemal Girgin and Isik Birben, 21.
Yuzuil Perspektifinde Dunya Siyaseti
(World politics in the Light of Twentyfirst
Century) (Istanbul: 2002), 25.

46. Ibid., 30.

47. UNDP 2002 Annual Report.

48. "Global Issues That Affect
Everyone,"

<http://globalissues.org/Geopolitics/ArmsTrade/Spending.asp>

49. Military Budgets of Selected
Countries, 2001. Online at:

[www.infoplease.com/ipa/A0904504.ht
ml](http://www.infoplease.com/ipa/A0904504.html).

50. USDA (United States Department of
Agriculture) report.

51. David R. Francis, "Economist Tallies
swelling cost of Israel to US," The
Christian Science Monitor December 9,
2002.

52. The Spartan state, adopted as a role
model by all fascist systems, was founded
as a military state by the lawmaker
Lycurgos around the 8th century BCE.
Sparta was literally a state of war and
violence.

53. Anouar Boukhars, "The 'global divide'
is not Islam vs. America," Global
Beat Syndicate (May 12, 2003).

54. Dr. Farish A. Noor, The Caliphate:
Coming Soon To A Country Near You?The
Globalisation of Islamic Discourse and its
Impact in Malaysia and Beyond (Institut fur
Islamwissenschaft; Freie Universitat of
Berlin, 2000), 31. Online at:
[www2.ucsc.edu/globalinterns/cpapers/
noor.pdf](http://www2.ucsc.edu/globalinterns/cpapers/noor.pdf).

55. Ibid., 26

56. David Fromkin, "A world still haunted
by Ottoman Ghosts," New York Times
March 9, 2003.

57. Timothy Garton, The Guardian, March
27, 2003.

58. Bediuzzaman Said Nursi, Hutbe-i Samiye (Damascus Sermon).
59. Al-Muttaqi al-Hindi, Al-Burhan fi `Alamat al-Mahdi Akhir az-Zaman, 66.
60. Ibid., 12.
61. Mukhtasar Tazkirah Qurtubi, 440.
62. Ibn Hajar Haythami, Al-Qawl al-Mukhtasar fi `Alamat al-Mahdi al-Muntazar, 23.
63. Ibid., 39.
64. Ibid., 37.
65. Ibid.
66. Sunan Ibn Majah.
67. Ibn Hajar al-Haythami, Al-Qawl al-Mukhtasar, 43.
68. Sahih Muslim.
69. Ibid.
70. Ibn Hajar al-Haythami, Al-Qawl al-Mukhtasar, 36.
71. Sunan Ibn Majah.
72. Ibn Hajar al-Haythami, Al-Qawl al-Mukhtasar, 23.
- 73- Sidney Fox, Klaus Dose, *Molecular Evolution and The Origin of Life*, New York: Marcel Dekker, 1977, s. 2
- 74- Alexander I. Oparin, *Origin of Life*, (1936) New York, Dover Publications, 1953 (Reprint), s.196
- 75- "New Evidence on Evolution of Early Atmosphere and Life", *Bulletin of the American Meteorological Society*, c. 63, Kasım 1982, s. 1328-1330
- 76- Stanley Miller, *Molecular Evolution of Life: Current Status of the Prebiotic Synthesis of Small Molecules*, 1986, s. 7
- 77- Jeffrey Bada, *Earth*, Şubat 1998, s. 40
- 78- Leslie E. Orgel, *The Origin of Life on Earth*, *Scientific American*, c. 271, Ekim 1994, s. 78
- 79- Charles Darwin, *The Origin of Species: A Facsimile of the First Edition*, Harvard University Press, 1964, s. 189
- 80- Charles Darwin, *The Origin of Species: A Facsimile of the First Edition*, Harvard University Press, 1964, s. 184
- 81- B. G. Ranganathan, *Origins?*, Pennsylvania: The Banner Of Truth Trust, 1988.
- 82- Charles Darwin, *The Origin of Species: A Facsimile of the First Edition*, Harvard University Press, 1964, s. 179
- 83- Charles Darwin, *The Origin of Species*, s. 172, 280
- 84- Derek A. Ager, "The Nature of the Fossil Record", *Proceedings of the British Geological Association*, c. 87, 1976, s. 133
- 85- Douglas J. Futuyma, *Science on Trial*, New York: Pantheon Books, 1983. s. 197
- 86- Solly Zuckerman, *Beyond The Ivory Tower*, New York: Toplinger Publications, 1970, s. 75-94; Charles E. Oxnard, "The Place of Australopithecines in Human Evolution: Grounds for Doubt", *Nature*, c. 258, s. 389
- 86- J. Rennie, "Darwin's Current Bulldog: Ernst Mayr", *Scientific American*, Aralık 1992
- 87- Alan Walker, *Science*, c. 207, 1980, s. 1103; A. J. Kelso, *Physical Anthropology*, 1. baskı, New York: J. B. Lipincott Co., 1970, s. 221; M. D. Leakey, *Olduvai Gorge*, c. 3, Cambridge: Cambridge University Press, 1971, s. 272
- 88- *Time*, Kasım 1996
- 89- S. J. Gould, *Natural History*, c. 85, 1976, s. 30
- 90- Solly Zuckerman, *Beyond The Ivory Tower*, New York: Toplinger Publications, 1970, s. 19
- 91- Richard Lewontin, "The Demon-Haunted World", *The New York Review of Books*, 9 Ocak 1997, s. 28
- 92- Malcolm Muggeridge, *The End of Christendom*, Grand Rapids: Eerdmans, 1980, s.43